

**AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS**

---

**BOTIME TË VEÇANTA CX  
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË**

**Libri 45**

**BESIM BOKSHI**

**PERIODIZIMI I NDRYSHIMEVE  
MORFOLOGJIKE TË SHQIPES**



**PRISHTINË**

**2010**

**KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS**

---

**SPECIAL EDITIONS CX  
SECTION OF LANGUAGE AND LITERATURE  
Book 45**

**BESIM BOKSHI**

**LA PÉRIODISATION DES  
CHANGEMENTS MORPHOLOGIQUES  
EN ALBANAIS**

Approved at the Meeting of the Section of Language and Literature,  
held on 01.10.2010, on the grounds of the reports of  
academician Idriz Ajeti and academician Rexhep Ismajli

Editor: academician Mehmet Kraja, secretary of the Section of Language and Literature



**PRISHTINA  
2010**

**AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS**

---

**BOTIME TË VEÇANTA CX  
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË  
Libri 45**

**BESIM BOKSHI**

**PERIODIZIMI I NDRYSHIMEVE  
MORFOLOGJIKE TË SHQIPES**

U miratua për botim në mbledhjen e Seksionit të Gjuhësisë  
dhe të Letërsisë mbajtur më 01.10.2010, në bazë të recensioneve të  
akademik Idriz Ajeti dhe akademik Rexhep Ismajlit

Redaktor: akademik Mehmet Kraja, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë  
dhe të Letërsisë



**PRISHTINË  
2010**



**BESIM BOKSHI**

**PERIODIZIMI I NDRYSHIMEVE  
MORFOLOGJIKE TË SHQIPES**



## H Y R J E

Është konstatuar se përcaktimi i kronologjisë a periodizimi i zhvillimeve në strukturën e një gjuhe përbën një punë të vështirë e në disa elemente - punë të pasigurt. Megjithëkëtë në bazë të rezultateve të arritura në studimet diakronike të strukturës morfologjike të shqipes besuam se është e mundur të bëhet një periodizim i ndryshimeve morfologjike me një numër të vogël pasigurish e momentesh të diskutueshme.

Deri tash janë bërë, me sa dimë, nëntë periodizime të fazave të zhvillimit të gjuhës shqipe.

I. I pari periodizim është i H. Pedersenit (*KZ* 36, 340). Ky periodizim, i bërë kalimthi, është i mëngët. Pedersenin ka paraparë tri periudha: periudhën e parë e la fare pa e përcaktuar me ndryshime fonetike a morfologjike, ndërsa periudhën e dytë e ka vendosur kur **ū** kalon në **i** dhe kur krijohet **y**-ja, që nuk përftohet nga **ū**. Ai nuk e ka shënuar kohën relative të këtyre ndryshimeve, d.m.th. as të kësaj periudhe. Për periudhën e tretë ka menduar të jetë krijuar në kohën kur është diftonguar **e**-ja në **ie** dhe kur është përfutur metafofia. Këtë periudhë e ka përcaktuar si periudhë të kohës historike. Mbase për metafofinë më parë ka shprehur mendimin se është kryer në kohën pas sundimit romak, mund të nxirret përfundimi, që ka nxjerrë Sh. Demiraj, se periudha e tretë (historike) ka filluar pas sundimit romak, që do të thotë se periudha e dytë do të ketë qenë në kohën e sundimit romak.

Siç shihet, periodizimi i Pedersenit nuk sjell ndonjë ndihmesë me peshë për zgjidhjen e kësaj problematike.

II. Periodizimi i dytë është periodizimi i E. Çabejt. Hiq mendimin e pamatur të tij se historia e gjuhës fillon me shkrimin e asaj gjuhe e se periudha para kësaj është periudhë parahistorike, kalimi i tij në periodizim të matur është një kontribut me vlerë orientuese, sepse nuk shoqërohet me përcaktim të ndryshimeve gjuhësore të periudhave të parapara, por përcakton metodologjinë, sipas së cilës duhet “të ngjitemi përpjetë nëpër kohë, nga e tashmja në të shkuarën, në mënyrë retrospektive. Epokat e njohura të historisë së gjuhës do të shërbejnë për të ndriçuar, përse të jetë e mundur, periodat më pak të qarta, dhe pas këtyre edhe ato më të errëtat”. Ai thotë se “nga kjo skicë e shkurtër (që kishte paraqitur në Hyrje të veprës *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe – Fonetikë historike*) del vetvetiu edhe një farë ndarje e historisë së shqipes në perioda të ndryshme”. Ai parapau tri perioda: Periodën prehistorike, periodën historike përpara shkrimit dhe periodën e re, qëkurse shkruhet gjuha. Për sqarimin e këtyre periodave ai shënoi:

“1. Do të krahasojmë më parë dialektet e sotme me njëri-tjetrin dhe këto dialekte me gjendjen... e dokumenteve të moçme dhe te të folët e kolonive shqiptare. Kështu ne do të formojmë një ide sesi ka qenë shqipja në mejetë.

2. Do të kërkojmë të hetojmë sesi mund të ketë qenë gjuha dhe zhvillimi i saj gjatë këtyre kohëve të mesjetës dhe të antikës... Duke studiuar lidhjet e kontaktet që ka pasur shqipja në kohë antike e në mesjetë me gjuhët fqinje të Gadishullit Ballkanik e të Italisë në këtë gollë të errët do të mundim të ndritim disa pika...

3. Edhe më e erët na paraqitet natyrisht koha prehistorike e gjuhës. Nga lidhjet që paraqet shqipja e sotme me gjuhët motra indoeuropiane do të mund të lëshohet dritë, sado e pakë, përmbi këtë periodë më të lashtë të saj”.

Nga sa u shënuar shihet se E. Çabej në këtë periodizim u mjaftua me udhëzime se si duhet të arrihet përcaktimi i këtyre periodave të

parapara prej tij, pa dhënë vetë asnjë shembull konkret të zhvillimeve gjuhësore. Nga ana tjetër perioda e dytë që para shqipes së shkruar deri në antikë nuk është ndonjë periodizim për të qenë.

III. Periodizimin e gjuhës shqipe në veprën *Emrat në shqipe* (Në Vepra 3, f. 17-9) S. Riza e sjell pasi shënon se nuk dyshon aspak:

1) se poshtë-lart historia e gjuhës s'onë duhet periodizuar paralelisht me historinë e popullit t'onë;

2) se historia e gjuhës s'onë duhet ndarë në tri periudhat e njohura të lashtësisë, të mesjetës e të kohëve të reja ose moderne, dhe

3) se letrarishtja shqiptare dhe “popullorçeja” përkatëse, në zhvillimin e tyre qysh nga Buzuku e tëhu, përbëjnë pikërisht periudhën e tretë në historinë e gjuhës s'onë”.

Këto tri periudha ai i ndau në faza përbërëse:

#### I. *Shqipja e lashtë:*

1) *e hershme,*

2) *e vonë;*

#### II. *Shqipja e mesjetës :*

1) *e hershme* (shek. V-XII),

2) *e vonë* (shek. XII- XV);

#### III. *Shqipja e kohëve të reja:*

1) *e kohës së teksteve të vjetra* (nga mesi i shek.XVI deri në mes të shek. XVIII),

2) *parabashkëkohore* (nga mesi i shek. XVIII deri në Rilindje),

3) *bashkëkohore* (nga Rilindja e tëhu).

Mendojmë se ky periodizim është i arsyetueshëm edhe me faza të ndryshimeve morfologjike. Edhe për këto ndryshime përfundimi i shek. V shënon përfundimin e një periudhë, ashtu si dhe shekulli XII dhe XV.

Por Riza ka lënë pa e përcaktuar kohën e përfundimit të shqipes së lashtë të hershme dhe fillimin e shqipes së lashtë të vonë dhe deri në çfarë lashtësie arinë shqipja e lashtësisë së hershme.

E metë e këtij periodizimi është mungesa e dallimit të këtyre periudhave me karakteristika gjithësore.

IV. A. Desnickaja në punimin *Rekonstrukcija elementov drevnoalbanskogo jazyka i obščebalkanskije lingvističeskie problemy*<sup>1</sup> ka bërë ndarjen në katër periudha:

1. Protoshqipja,
2. Shqipja e vjetër,
3. Shqipja e mesme dhe
4. Shqipja e re.

*Protoshqipja a shqipja e lashtë* është e kohës që nga ndarja e shqipes nga gjuha e lashtë ie. deri në kontaktet e saj me latinishten, *shqipja e vjetër* shtrihet në mijëvjeçarin e parë të erës sonë, ndërsa *shqipja e mesme* arrin deri në gjysmën e parë të mijëvjeçarit të dytë dhe *shqipja e re* shtrihet në fazën e parë në shekujt XV – XVIII dhe në fazën e dytë deri në kohën tone.

Ajo është shprehur se protoshqipja paraqet lidhje gjenetike e areale brenda unitetit indoevropian dhe se zbulimi i elementeve të individualitetit të saj mund të bëhet me metodën e gjuhësisë krahasuese indoevropiane. Për shqipen e vjetër, për periudhën e mijëvjeçarit të parë të erës sonë, ka çmuar se është arritur një modifikim i fuqishëm i gjuhës si gjuhë e tipit të ri evropian me vija karakteristike të arealit gjuhësor ballkanik. Për këtë periudhë ajo ka veçuar këto ndryshime fonetike:

1. Zëvendësimi i tonit me theksin dinamik në kohën romane

---

<sup>1</sup> Actes du Premier Congrès International des études Balkaniques et Sud-Est Européennes, VI, Sofia 1968, dhe në *Sravnitelnoe jazykoznanie i isrorija jazykov*, Leningrad

dhe vendosja e tij me “rregullim mekanik” në rrokjen e parafundit.

2. Me krijimin e theksit fillon procesi “i dobësimit e i reduktimit tingujve në rrokje të patheksuar dhe gradualisht edhe i shkatërrimit të sistemit të vjetër të fleksionit. Veçanërisht e pëson lakimi.

3. Rënia e tingujve në pozitë intervokale që shkaktoi shkurtimin e shumë fjalëve të fondit autokton e të huazuara nga latinishtja.

4. “Dukuritë fonetike, që dalin nga lidhja e rrokjeve në frazë e mbrenda fjalës, kanë luajtur një rol mjaft të rëndësishëm në fonetikën historike të gjuhës shqipe dhe janë treguar mjaft të rëndësishme në proceset e rindërtimit të strukture së saj”. Ajo është shprehur se “dukuritë e sandhit kanë ndryshuar jo vetëm formën fonetike të fjalëve të caktuara, por edhe kanë sjellë risi në karakterin morfologjik” të tyre.

5. Bëhet palatalizimi që shkakton opozicione të reja morfologjike me fleksion të brendshëm.

Desnickaja ka thënë se pjesa më e madhe e këtyre proceseve ka ndodhur në shqipen e vjetër dhe kanë vepruar në ndryshimin e strukturave morfologjike të saj. “Krahas formimit të trajtave analitike u përftua edhe regjenerimi i morfologjisë flektive”. Në këtë periudhë formohen dy tipat e lakimit d.m.th. u krijua kategoria e shquarësisë dhe e joshquarësisë.

Kjo studiuese është shprehur se “kuptohet vetiu që kufizimet e dukurive të rindërtuara për periudhat e shqipes së vjetër e të shqipes së mesme nuk janë të kushtëzueshme”. Kështu ajo nuk i shënoi ndryshimet që do të kenë ndodhur në shqipen e mesme e në shqipen e re.

Ne çmojmë se periudha e protoshqipes apo e shqipes së lashtë, siç e quan ajo, deri te kontakti me latinishten përbën një epokë të veçantë në zhvillimin e gjuhës sonë. Kjo na vërtetohet edhe me ndryshimet morfologjike dhe me disa ndryshime fonetike. Periudha e mijëvjeçarit të parë vërtet është periudhë në të cilën janë zhvilluar dukuri shumë të rëndësishme në strukturën morfosintaksore të shqipes, disa nga të cilat i

ka shënuar edhe Desnickaja, por kjo periudhë mijëvjeçare nuk mund të përbëjë një gjendje unike të ndryshimeve. Ato e bëjnë të ndarë në periudha këtë kohë mijëvjeçare. Pa qenë në gjendje të përcaktonte relacionet kohore të dukurive të shënuara prej saj, kjo studiuese e merituar e shqipes nuk u orvat të përcaktonte kufij periudhash brenda kësaj kohe të gjatë të “shqipes së vjetër”.

Mendojmë se Desnickaja e ka vendosur në kohë të pasaktë krijimin e theksit dinamik të shqipes, brenda kohës së ndikimit të latinishtes. Kjo nuk përputhet me mendimin tonë se theksi është përfutur para kontaktit të protoshqipes me latinishte e se efekti i parë i tij mbingujt fundorë të temave kishte përfundur në kohën e këtij kontakti. Disa mospajtime të tjera dalin në shqyrtimet në këtë vepër. Megjithëkëtë kontributi i Desnickajas në këtë temë është avancues.

V. Qëndrimi i Sh. Demirajt në veprën *Gramatikë historike e gjuhës shqipe* (Prishtinë, 1988, f. 56-7) është se “periodizimi i gjuhës shqipe, ashtu si edhe i çdo gjuhe tjetër, nuk mund të bëhet veçse duke u mbështetur në kritere kryesisht gjuhësore, për të vënë kështu në dukje sa më mirë tiparet gjuhësore që e dallojnë një periudhë nga tjetra”. Ai konsideron se “historia e mirëfilltë e një gjuhe fillon që nga koha kur ajo, si rrjedhim i ndryshimeve të shkallë-shkallshme sasiore të “nënës” së saj, është formuar përfundimisht si një gjuhë cilësisht e re. Në bazë të këtij këndvështrimi, çdo gjuhë ka “parahistorinë” dhe historinë e saj”.

Ai shprehet se “parahistoria” e shqipes shënon një periudhë disashekullore dhe fillimin e kësaj periudhe e sheh te koha e ngulitjes së theksit dinamik në një rrokje të caktuar dhe te prapavendosja e përcaktorëve të pavetëmjaftueshëm. Këto mandej kanë mundësuar që të zhvillohen procese të tjera si reduktimi i tingujve fundorë, prapavendosja dhe përngjitja e nyjës shquese etj. E këto kanë shkaktuar zhvillimin e një vargu procesesh të tjera si riorganizimin e sistemit rasor dhe lakimin binar të emrit, lakimin në ballë të fja-

lës, evolucionin e kategorisë së gjinisë dhe të kategorisë së shquarësisë dhe pashquarësisë.

Ai mendon se “rregullsitë e theksimit të mbarë shqipes ... janë kristalizuar qysh para depërtimit të sllavizmave në gjuhën shqipe” dhe se ky kristalizim shënon “përfundimisht formimin e shqipes si një gjuhë cilësisht e dallueshme nga “nëna” e saj”.

Duke u nisur nga kjo kohë e formimit të shqipes, Sh. Demiraj historinë e kësaj gjuhe e ndan në katër periudha:

1. **Periudha e parë** apo **shqipja e vjetër** që është e kohës që nga formimi i shqipes deri në përfundimin e rotacizmit në shekujt VII- VIII.

2. Periudha e dytë apo shqipja e mesme që shtrihet deri në shek. XIV-XV kur shqipja “pasurohet me forma të tilla si ato të kohës së kryer, të së ardhmes, të habitores si edhe me format e pashtjelluara të tipit tue / tuke punuar dhe pa punuar; gjatë kësaj periudhe në dialektin verior zhvillohet edhe forma e pashtjelluar e tipit me punue”.

3. **Periudha e tretë** apo **shqipja e re**, që përmbledh kohën deri në gjysmën e shek XIX, brenda së cilës përftohen format e pashtjelluara *për të punuar, me të ardhur dhe një të ardhur* dhe

4. Periudha e fundit apo **shqipja e sotme**.

Siç shihet Sh. Demiraj ka bërë periodizimin e shqipes që ai e konsideron të krijuar si gjuhë e dallueshme esencialisht nga gjuha prej së cilës rrjedh pak para depërtimit të sllavizmave. Periudhën para kësaj kohe e quan parahistorike dhe e konsideron të filluar në kohën e ngulitjes së theksit dinamik. Për këtë qasje origjinale ndaj periodizimit të shqipes imponohen disa vërejtje:

1) Ndryshimet e shkallë-shkallshme sasiore të një gjuhe nuk e shkaktojnë ndryshimin e emrit të saj, përderisa vijon ta flasë populli me të njëjtin emër. Kjo do të thotë se edhe ilirishtja do të ishte gjuhë ilire edhe pas shek. VI po të kishte vijuar që populli të quhej ilir.

2) Ngulitja e theksit në një rrokje të caktuar është në fakt kristalizim i rregullsisë së theksimit, kështu që theksimi (theksi dinamik) nuk mund të merret si dukuri që e dallon shqipen nga “nëna” e saj, sepse këtë dukuri e ka pasur edhe ajo në kohë mjaft të lashta.

3) Prapavendosja e përcaktorëve të pavetëmjaftueshëm të emrit nuk mund të jetë e njëkohshme me krijimin e theksit dinamik, sepse theksi gjeti të njëjtin eptim të gjuhës së lashtë ie. dhe të njëjtën renditje të zakonshme të tipit ie., që ishte renditja regresive Mbiemër - Emër etj.

4) Ka shënuar se shqipja është krijuar “si gjuhë cilësisht e dallueshme nga nëna e saj” para kontaktit me sllavishtet. Por koha para kontaktit me sllavishten është tepër e gjatë, prandaj Sh. Demiraj duhej të shënonte në mënyrë të qartë se kjo kohë do të ishte në prag të huazimeve nga sllavishtja. Po atëherë çfarë dimension i kohor ka kjo periudhë e parë e shqipes, kur shihet e përfunduar në shek. VII- VIII, brenda së cilës edhe qenkan përfutur pronorët me pjesë të aglutinuara: [ynë, tonë, jonë etj.] dhe paska përfunduar rotacizmi si proces i mbramë i kësaj periudhe, duke mos i prekur këta përemra.

5) Periudha e dytë (shqipja e mesme) që nga përfundimi i rotacizmit (shek. VIII) deri në shek. XIV-XV është periudhë e gjatë që të përbëjë një tërësi.

6) Për periudhën e tretë (shqipja e re) deri në gjysmën e dytë të shek. XIX sjell përfundimin e trajtave foljore të pashtjelluara: *për të punuar, me të ardhur, një të ardhur*, të cilat nuk mund të jenë formime kaq të reja.

VI. Në punimin *Ndryshimi i strukturës së temave emërore të shqipes* (Gjurmime albanologjike, 1, 1971) kishim konstatuar këto sisteme nëpër të cilat kishte kaluar zhvillimi i temave emërore të shqipes:

Sistemi A, të cilin e përbënin bazat a temat e gjuhës indoevropiane.

Sistemi B, të cilin e përbëjnë bazat e temat ie. që gjeti theksi dinamik.

Sistemi C, të ccilin e përbëjnë tipat e temave që krijoi theksi dinamik.

4. Sistemi D, të cilin e përbëjnë tipat e temave që njih shqipja edhe në periudhën e saj të dokumentuar.

Sistemi A është përcaktuar si sistemi i temave që ka pasur gjuha e lashtë indoevropiane. Ky system është reduktuar në katër tipa të temave të tipi ie dhe kjo përbën fazën A/2 të iëtj sistemi:

Sistemi A

A/1 A/2

- |           |   |          |
|-----------|---|----------|
| 1. T(ø)   |   | 1. T(ø)  |
| 2. T(ĩ)   | } | 2. T(ø)  |
| 3. T(ũ)   |   |          |
| 4. T(ö)   |   |          |
| 5. T(c)   |   |          |
| 6. T(ā) → |   | 3. T(ā)  |
| 7. T(s) → |   | 4. T(s). |

Tema T(ø) ishte njërrrokëshe (mus, sus, ghem etj. Emrat e temave në -ĩ, -ũ e në konsonant (c) u integruan në temën në -ö, që u tipizua si temë e gjinisë mashkullore e polarizuar në gjini me temën në -ā si temë e gjinisë femërore. Tema njërrrokëshe dhe tema në sonantet (s = -n,-r) mbetën neutrale në gjini, d.m.th. përmblihdnin emra të të tri gjinive. Emrat asnjans ish in në të gjitha temat. Këtë numër të reduktuar të temave në katër tipa të fazës A/2 të sistemit A e gjeti theksi dinamik kur u krijua në gjuhën shqipe. Këto tema me theksin si element të ri, që nuk e kishin temat e tipit ie., përbënë sistemin B. Sistemet A/2 dhe B si sisteme të protoshqipes, janë të periudhës mjaft kohë para kontaktit të saj me

latinishten. Pas kësaj theksi ushtron ndikim të fuqishëm në tingujt fundorë të këtyre temave, duke bërë që të bjerë vokali tematik -ō, të reduktohet -ā-ja e temës në -ë dhe të humbë konsonanti fundor të temës njërrrokëshe. Me këto ndryshime formohet sistemi i ri C i temave emërore. Ky sistem kaloi nëpër tri faza deri sa gjatësia e zanores u lidh me tipin e rrokjes fundore dhe u krijua kështu një sistem i ri, sistemi D që në fazën  $D/2$  arrin në shqipen e sotme.

Sistemi  $C/1$  është menduar të ketë qenë nga fillimi i huazimeve latine dhe me fazën  $C/3$  arrin deri pas përfundimit të kohës së huazimeve nga latinishtja.

Duhet thenë se me ndryshimin e strukturës së temave emërore nuk ka mundur të dalë ndonjë periodizim më i detajuar i shqipes.

Për zhvillimin e sistemit rasor të shqipes kemi arritur në përfundim se ai ka kaluar në shtatë, respektivisht në tetë nivele:

1. Sistemi i parë është sistemi rasor i gjuhës së lashtë ie., që e kemi konsideruar të qëndrueshëm deri disa kohë para kontaktit me latinishten, d.m.th. në kohën e sisteneve A e B të temave emërore, pra deri sa qe mbaresa rasore e tipi ie.

2. Sistemi i dytë formohet në kohën e krijimit të sistemit  $C/1$  të temave, d.m.th. në kohën e huazimeve nga greqishtja e vjetër e nga latinishtja. Këtë sistem e karakterizon mungesa e mbaresave rasore. Mbaresa ie. kishte mbetur vetëm mbaresë numri.

3. Sistemi i tretë është po ashtu sistem pa mbaresa rasore. Këtë e karakterizon krijimi i nyjës së përparme të mbiemrit e të gjinores si dhe kalimi i nyjës shquese në postpozicion pas mbiemrit në grupin nominal të plotë: Mbiemër - Nyjë shquese - Emër. Ky sistem është i kohës së sistemit  $C/2$  të temave dhe kalon edhe në sistemin  $C/3$  pas huazimeve latine.

4. Sistemi i katërt është kur aglutinohet nyja shquese. Ky sistem, i formuar para shek, VIII, karakterizohet nga krijimi i lakimit të shquar e nga mungesa e mbaresës rasore.

5. Sistemi i pestë krijohet mjaft shpejtë pas të katërtit. Ky sistem karakterizohet me krijim të mbaresës rasore, d.m.th. të lakimit të pashquar që ka shqipja e sotme. Edhe ky sistem del i krijuar para përfundimit të rotacizmit (para shek. VIII).

6. Sistemi i gjashtë është po ashtu i tërë shqipes me karakteristikat e shënuara në veprën *Rruga*<sup>2</sup>. Toskërishtja del me këtë sistem edhe në kohën e Matrëngës, ndërsa gegërishtja e kohës Buzukut del me një sistem të shtatë. Dallimet e këtyre sistemeve shprehen në rrafsh të kuptimit në dimensionin e drejtimit.

7. Sistemi i shtatë, që është i teti për gegërishten, është sistem i përbashkët i të dy dialekteve në gjendjen e sotme<sup>3</sup>.

Këtij periodizimi të zhvillimit të sistemit rasor i ndihmon, përveç zhvillimit të temave emërore, edhe zhvillimi i sistemit të mbaresave të shumës në katër nivele.

VII. Gert Klingenschmitt në studimin e tij *Das Albanische als Glied der indogermanischen Sprachfamilie*,<sup>4</sup> ka bërë këtë periodizim:

Faza e parë ka qenë parlashtoshqipja (Voruralbanisch), të cilën e vendos brenda kohës romake. Pas kësaj autori e ndan lashtoshqipen (Uralbanisch) para ndarjes dialektore, ndërsa pastaj kalon te shqipja e vjetër të cilën e përbëjnë gegërishtja e vjetër dhe toskërishtja e vjetër (gjuha e Buzukut, Budit, Bardhit, Bogdanit dhe Perikopeja e ungjillit e gjuha e Matrëngës). Si shqipe të re e përcakton shqipen nga shekulli XIX.

Autori për shqipen e vjetër thotë se ka pasur pesë rase: nominativ, akuzativ, genitive, lokativ (rasë parafjalore) dhe ablativ. Ai

<sup>2</sup> Botimi i dytë, f. 374 – 416

<sup>3</sup> Shih arsyet e unifikimit në vep. e cit., f. 420 – 423

<sup>4</sup> Të botuar te Jens E. Rasmussen (Hg.), *In honorem Holger Pedersen*, Wiesbaden 1994, f. 221-233.

përcakton edhe format e theksuara e të patheksuara të përemrave vetorë, shënon edhe disa forma foljore të asaj kohe.

VIII. Në Konferencës shkencore “Çështje të diakronisë së shqipes”, që u mbajt në Prishtinë më 2009, Seit Mansaku doli me kumtesën “Disa çështje të studimit diakronik të gjuhës shqipe: rreth problemit të periodizimit të historisë së saj”<sup>5</sup>. Në këtë kumtesë ai shpreh mendimin se mund të bëhet një periodizim i saktë i historisë së gjuhës shqipe dhe se “është bërë nga studiuesit më në zë të historisë së gjuhës shqipe”, por mendon se ka ende shumë çështje “për të cilat nuk mund të thuhet se janë zgjidhur përfundimisht”.

Në periodizimin e tij ai pranon se “Caktimi i shekujve VI-VII nga Shaban Demiraj si fillim i formimit të gjuhës shqipe si gjuhë e veçantë e dalë nga ilirishtja, besoj se është një kufi i pranueshëm, por është bërë jo aq shumë mbi bazën e dëshmimeve gjuhësor, sesa nga rrethanat historike”. E pranon ndarjen e S. Rizës të shqipes së mesme në shqipe të mesjetës së hershme, por jo në shek. V- XII (si Riza), po në shek. VII-XII, dhe në shqipe të mesjetës së vonë në shek. XIII-XV.

S. Mansaku bën këtë periodizim, që po e shënojmë në mënyrë të përmbledhur:

1. Periudha indoevropiane e shqipes që përfshin kohën që kur shqipja u shkëput nga trungu indoevropian deri në kohën e kontakteve të shqipes me greqishten e vjetër dhe me latinishten, në fund të mijëvjeçarit të parë para erës sonë.

2. Periudha e shqipes së lashtë, ose ilirishtja që përfshin kohën që nga fillimi i mijëvjeçarit të parë të erës sonë deri në shekullin VI të erës sonë, kur mendohet se shqipja doli si gjuhë e veçantë, si rezultat i ndryshimeve të shkallëshkallshme të fazës së fundit të gjuhës së ilirëve të jugut.

3. Periudha e shqipes mesjetare ose arbërishtja, që përfshin

<sup>5</sup> Shih: *Çështje të studimeve diakronike të shqipes*. Materialet e konferencës shkencore, 6 korrik 2009 Prishtinë, ASHAK, 2009, ff. 17-26.

një kohë të gjatë që nga shek. VII... deri në shek. XV... Kjo periudhë ndahet në: shqipe të mesjetës së hershme, shekujt VII-XI dhe në shqipe të mesjetës së vonë, shekujt XII-XV.

4. Periudha e shqipes së shkruar, ose periudha e shqipes së re që fillon nga mesi i shekullit XVI ... deri në kohën tonë... Kjo periudhë mund të ndahet në tri nënperiudha: shqipja e teksteve të vjetra, shekujt XVI-XVIII, shqipja e Rilindjes kombëtare, shekulli XIX deri në Kongresin e Manastirit, shqipja e sotme, nga Kongresi i Manastirit deri në ditëtë tona. Ai e quan ilirishte periudhën antike, arbërishte periudhën mesjetare dhe shqipe periudhën e fundit.

Në këtë kumtesë Seit Mansaku nuk jep asnjë element gjuhësor, me të cilët do të karakterizoheshin periudhat e shënuara dhe kapërcimi nga një periudhë në tjetrën. Ai premtan se këtë do ta bëjë në një rast tjetër.

Mendoj se në këtë kumtesë Mansaku përforcoi më tej një periodizim të arsyeshëm me anë të seleksionimit të mendimeve të Desnickajas, Rizës e Demirajt, bazuar në disa periudha historike të popullit tone. Ky është një kontribut që e sjell periodizimin e shqipes krejt pranë një verzioni që do të jetë i pranueshëm nga studiuesit e ardhshëm të kësaj problematike albanologjike, duke e mbështetur edhe me të dhëna gjuhësore.

IX Tash vonë në materialet e botuara të Konferencës shkencore “Selman Riza gjuhëtar i shquar” të organizuar nga Universiteti “Luigj Gurakuqi” i Shkodrës për nder të 100-vjetorit të lindjes, David Luka del me kumtesën “Sprovë për periodizimin e historisë së gjuhës shqipe”.

Për periodizimin e historisë së shqipes ai ka përcaktuar “tri faza të mëdha: *prehistoria, koha e formimit, historia*.”

**Prehistorinë** e përbën “koha e *nënës së shqipes*. “Në këtë periudhë dukuritë dalin të përbashkëta me gjuhët e tjera simotra indoevropiane me të cilat grupohet”.

**Si kohë të formimit** të gjuhës shqipe ai përcakton shekujt I-IV.

**Historia** thotë se nis në shek. V. Ai shton se “Idioma e re tani mund të emërtohet shqipja e vjetër. Që këtu nis periodizimi i historisë së gjuhës shqipe”.

*Periudha e shqipes së vjetër është, sipas tij, nga shek. V deri në shek. XIV. Këtë periudhë e ndan në etapën e parë (shek. V – IX) dhe në etapën e dytë (shek. X – XIII).*

*Në etapën e parë nuk veprojnë më apofonia e metafohia, përftohen diftongjet e reja, bëhet ngulitja e theksit në një rrokje të caktuar dhe rregullimi mekanik i tij në rrokjen e parafundit, janë bjerrë gjatësitë e lashta të zanoreve, “guturalet indoevropiane e kanë përfunduar ciklin e tyre” dhe hundorësia e zanoreve “Mbase ka nisur në mesjetën e hershme”. Në morfologji është përfutur lakimi binar i emrit dhe formimi i nyjave. Në fjalëformim “ndikimi latin ka përfunduar”. Ky studiues mendon se “tipari themelor që e karakterizon këtë etapë, është fillimi i ndarjes dialektore të shqipes” dhe thotë se fillimi i rotacizmit duhet kërkuar rreth shek. III.*

Etapa e dytë “nis me ndikimet e mirëfillta të slavishtes në gjuhën shqipe”. Në të “nuk vepron më p.sh. refleksi *s* : *sh*, dhe nuk bie okluzivi (*b, d, g*) në trup të fjalës”.

**Periudha e dytë (ose shqipja e mesme)**, shek. XIV – XVIII “nis me dokumentimin e shkrimit të saj”. Dhe “as që mund të flitet për ndryshime në strukturën morfologjike të shqipes.

**Periudha e tretë (ose shqipja e sotme)**, shek. XIX deri në ditët e sotme.

Siç shihet, ky periodizim ka mjaft përcaktime të pasakta, të hamendshme e të diskutueshme. Megjithëkëtë ky është periodizimi me të cilin insistohet për të përcaktuar kohën e ndryshimeve fonetike e morfologjike.

•

Në këtë vepër janë veçuar ndryshimet që njëra pas tjetrës e ndanë protoshqipen nga gjuha e lashtë indoevropiane, d.m.th. ndryshimet e shkallë-shkallshme në kohën parabolkanike e ballkanike deri kah shek. V para erës së re, kur fillon të bëhet i evidentueshëm ndikimi i greqishtes së vjetër. Kjo përbën fazën e parë të protoshqipes së hershme, ndërsa fazën e dytë të saj e përbëjnë ndryshimet nga shek. V deri te kontakti me latinishten, d.m.th. aty nga shek. II p. erës së re<sup>6</sup>. Për përcaktimin e kohës së fillimit të huazimeve latine, duhet pasur parasysh se përvetësimi i tyre kalon, siç thotë G. Bonnet në *Les mots latins de l' albanais*, nëpër një proces bilinguizmi të popullatës së zaptuar nga disa gjenerata, prandaj themi se kjo kohë duhet shtyrë në drejtim të shek. I p. e. re. Periudhë tjetër shënojnë ndryshimet që janë kryer brenda kohës së huazimeve latine e lashtogreke deri në përfundim të shek. V. Shihet se kjo ndarje e ndryshimeve morfologjike bëhet nën kriterin e dy periudhave historike të popullit shqiptar. Periudhën e sundimit romak dhe disa shekuj përtej saj i bashkon ilirishtja. Edhe me shekullin e gjashtë fillon një periudhë tjetër e historisë së popullit tonë jashtë sundimit romak. Kemi shënuar në vijim ndryshimet morfologjike e sintaksore që janë zhvilluar nga shek. VI deri në përfundim të shekullit VIII, që nuk përbën ndonjë periudhë të shënuar historike, por që shënon përfundimin e rotacizmit si një ndryshim i madh dallues i dy dialekteve të shqipes. Periudhën tjetër e kemi menduar të përfundueshme në shek. XII (IX–XII) si shekull i mbarimit të Mesjetës së hershme, siç e ka vlerësuar S. Riza. Po në pajtim me S. Rizën na ka dalë si tërësi edhe periudha brenda shekujve XIII–XV, në të cilën janë zhvilluar ndryshime morfosintaksore që shihen të përciella në gjuhën e shkrimeve të autorëve të vjetër. Ndryshimet morfologjike e sintaksore që zhvillohen pas kësaj kohe na shpjen te gjendja e sotme e dialekteve në komponentet kryesore.

Ndryshimet morfologjike janë renditur njëra pas tjetrës sipas vjetërsisë së përfuturit. Kufizimi i tyre në periudha është bërë për t'i

---

<sup>6</sup> Me shek. V përfundon një periudhë në historinë e ilirëve dhe fillon një e re, kur krijohen mbretëritë.

ndarë si të njëkohshme karshi ndryshimeve pasuese, të cilat, edhe pse vijojnë në kontinuitet, afrohen më tepër koharisht me ndryshimet që vijnë pas, të cilat largohen gradualisht mjaft nga të mëparmet. Kufijtë e ndarjes janë përcaktuar qoftë nga periudhat historike, qoftë nga ndonjë ndryshim i rendësishëm në sistemet strukturore.

Periudha e parë në dy fazat e shënuara mund të quhet periudha e protoshqipes së hershme, ndërsa periudha e dytë deri në përfundim të huazimeve latine – periudha e protoshqipes së vonë apo e ilirishtes<sup>7</sup>. Periudha e shekujve VI–VIII do të mund të quhej periudhë e shqipes së vjetër, ndërsa ajo e shekujve IX–XII – periudhë e shqipes së Mesjetës së hershme (apo e arbërishtes së hershme), kështu që ajo e shekujve XIII–XV – do të ishte periudha e shqipes së Mesjetës së vonë (a e arbërishtes së vonë).

Me terminin “protoshqipe”, që përdoret nga studiuesit për kohën e largët, si para vendosjes në Ballkan, ashtu edhe deri në përfundim të periudhës së ndikimit latin, shprehet një qëndrim neutral ndaj çëhtjes së prejardhjes konkrete të gjuhës shqipe. Mjaft të tjerë protoshqipen ballkanike e quajnë ilirishte.

Ndryshimet që gradualisht e larguan protoshqipen nga gjuha indoevropiane u bënë tepër të mëdha në kohën brenda kontaktit me latinishten. Në atë kohë ajo kishte kaluar në gjuhë analitike pa mbaresa rasore, kishte krijuar nyjën shquese, kishte lakimin përemëror (dëftor e vetor) e nyjor me tri rase të realizuar me variacion teme etj. Kështu ajo ishte gjuhë esencialisht tjetër nga gjuha e saj “nënë”, nga indoevropianishtja. Dallim i madh nga kjo gjendje e protoshqipes së vonë bëhet edhe në periudhën e shekujve VI–VIII. Bëhen në kontinuitet ndryshime tepër domethënëse për strukturën morfosintaksore të shqipes: aglutinohet nyja shquese, d.m.th krijohet lakimi i shquar, krijohen mbaresat rasore, d.m.th. krijohet lakimi i pashquar, kështu që shqipja kalon nga një strukturë analitike

<sup>7</sup> Ilirishtja natyrisht e kalon kufirin e kontaktit me latinishten.

në një strukturë sintetike-analitike. Ndryshime morfologjike dhe përfitime formash të reja bëhen edhe në periudhat pasuese. Të gjitha ndryshimet në strukturën morfologjike të shqipes brenda kontaktit me greqishten e vjetër e laltinishten e pas tyre dëshmojnë për një zhvillim tërësisht të pavarur nga ndikimet e gjuhëve përreth.

Kuptohet se përfundimi i një ndryshimi e ka arsyen e nismës në periudhën paraprake.



# A. KOHA PARA KONTAKTIT ME LATINISHTEN

## Faza e parë

### 1. Sistemi i temave emërore

Në procesin e tipizimit të temave në gjini: tema në **-ō** për gjininë mashkullore, tema në **-ā** për gjininë femërore u bë edhe zgjerimi i këtyre temave me emra të temave të tjera. Kështu, siç e kemi shtjelluar në veprën *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*<sup>8</sup> në temën në **-ō** u integruan, përveç emrave të gjinisë mashkullore edhe emrat e gjinisë femërore të temave në **-ī**, **-ū** e në konsonant, duke kaluar në mashkullorë. Të pandikuar nga ky proces mbetën emrat e temës atematike njërrrokëshe [*\*mūs*, *\*sūs*, *\*ǵhem*, *\*vreg* etj.] dhe emrat e temës në sonantet **-n**, **-r** [*\*ǵheimen*, *\*māter* *\*enmen* etj.], që janë tema neutrale në gjini, d.m.th që përmbledhin emra të të tri gjinive.

Ky reduktim i numrit të temave emërore në katër tipat e shënuar është fillimi i rrugës së mëvetësimit të shqipes, është procesi i parë morfologjik që e ndau protoshqipen nga gjuha e lashtë ie. dhe nga gjuhët indoevropiane të kohës. Kuptohet se reduktimi i numrit

---

<sup>8</sup> Bokshi Besim, *Rruga e formimit të fleksionit nominal të sotëm të shqipes*, ASHAK, Prishtinë, botimi II, 2007, ff. 191-192.

të temave ka tërhequr edhe reduktimin e tipave të lakimit të emrave, por pa e cënuar tipin e eptimit ie.

Ky sistem i temave emërore tregon se shqipja ishte ende në kohën e tonit me dy seritë e gjatësive të zanoreve (zanore të gjata e zanore të shkurtra).

Këtu jemi në mbështetje të mendimit të Çabejt se "shkallët e ndryshme të ndërrimit fonetik bashkë me strukturën morfologjike ...i kanë caktuar gjuhës shqipe që në periodën e saj prehistorike ...karakterin e saj të veçantë dhe i kanë shënuar vendin e saj në rrethin e idiomave simotra indoevropiane"<sup>9</sup>.

## 2. Gjinia

Reduktimi i shënuar i numrit të temave emërore dhe tipizimi i dy temave për gjininë mashkullore e femërore tregon se që në kohën e protoshqipes së hershme ishte kaluar nga shënimi i gjinisë natyrore të emrave (gjini mashkullore e femërore të gjallesat, gjini asnjansë të jogjallesat) në gjininë gramatikore të tyre. Këtë kalim e vërtetojnë edhe huazimet nga greqishtja e vjetër, në të cilat nuk u respektua ndarja e gjinisë sipas gjallësive (bashkë me emrat e sendeve të personifikuara) dhe jogjallësive, që e kishte kjo gjuhë, por u integruan në gjininë mashkullore, femërore e asnjansë në bazë të strukturës së temës emërore korresponduese me atë të protoshqipes brenda sistemit të shënuar të temave emërore të asaj kohe.

<sup>9</sup> E. Çabej, IV, *Mbi disa rregulla të fonetikës historike të shqipes*, f. 208.

### 3. Mbaresat e shumësit

Mbaresat rasore të tipit të gjuhës së lashtë indoevropiane kuptimin e numrit e kishin të pandashëm nga kuptimi i rasës. Mbar-esa e asaj kohe ishte pra grup elementesh të numrit e të rasës. Mbar-si mbaresat e emërores së shumësit do të mbesin më vonë vetëm me vlerë të mbaresës së numrit, ne po shënojmë vetëm mbaresat e kësaj rase në njëjës e në shumës.

Mbaresa plur. *\*-ōs* (<*\*-ō-es*) ishte përftuar që në faza të hershne të gjuhës ie., me ç'rast ajo ishte futur brenda temës, duke shënuar opozicionin e numrit me gjatësi të vokalit: sing. *-ōs* ~ plur. *-ōs*. Ky përfundim i shumësit tani u zëvendësua nga *\*-ō-i*: sing. *\*-ō-s* ~ plur. *\*-ō-i*. Mbaresa e shumësit *\*-i* ishte mbaresë e përemrave dhe kaloi tek emrat përmes përdorimit më të hershëm me mbiemra. Me këtë mbaresë doli shumësi i të gjithë emrave të gjinisë mashkullore të temës në *-ō*, ndërsa emrat asnjans e kishin mbaresën *-ā* në shumës në opozicion me *-ōs* të njëjësit. Mbaresa *\*-i*, që ishte neutrale në gjini, u përdor edhe me emrat e temës në *-ā*, duke e zëvendësuar mbaresën *-s*: sing. *-ā-θ* ~ plur. *-ā-s* (<*-ā-es*) → sing. *-ā-θ* ~ plur. *-ā-i* (*-ā* = tingull fundor i temës). Por te tema në *-ā* zëvendësimi nuk qe i plotë; ai përmbloodhi vetëm mbiemrat dhe kategorinë e fjalëve emra-mbiemra, ndërsa ata që ishin vetëm emra mbetën me mbaresën plur. *-s*: sing. *-ā-θ* ~ plur. *-ā-s*<sup>10</sup>. Emrat e temës njëjërkshe atematike e kishin mbaresën e shumësit *-es* në opozicion me mbaresën *-s* të njëjësit: sing. *vreg-s* ~ plur. *vreg-es* etj., ndërsa emrat e temës në *-n*, *-r* e kishin mbaresën e shumësit *-ā*: sing. *gheimen-θ* ~ plur. *ghemen-ā*, sing. *māter-θ* ~ plur. *māter-ā* etj., të përftuar nga përgjithësimi i mbaresës së shumësit të emrave të gjinisë asnjansë, e cila e nxori nga

<sup>10</sup> Shih detajisht B.Bokshi, *Rruga*, f. 134 -146.

përdorimi mbaresën **-es** të emrave të gjinisë mashkullore e femërore të kësaj teme.

E kësaj kohe do të ketë qenë edhe zhdukja e dualit në sistemin e numrit të emrave, mbasi nuk shihen shenja të këtij elementi të numrit nga emrat e huazuar përkatës dhe nuk është ruajtur ndonjë relik i formës së veçantë të emrit në dual. Edhe format e emrave me pjesë simetrike si [brekë, gërshtë, shkekë etj.], që në rrafshin kuptimor do të ishin të afërt me emrat në dual, janë emra që kanë vetëm formën e shumës (pluralia tantum).

Në këtë kohë protoshqipja e kishte në përdorim të parë shumësin matematikor të ndihmuar nga shumësi kolektiv në një masë të konsiderueshme, siç e tregojnë prapashtesat që formojnë emra kolektivi. Këto prapashtesa duket të kenë qenë më të shumta se në fazat e mëvonshme të zhvillimit të shqipes, kur përdorimi i shumësit kolektiv bëhet më i dobët.

## 4. Vetorët

### a) *Trajtat tonike*

Në këtë kohë protoshqipja formën e vetës së parë shumës të vetorit *\*nōs*, që ishte formë e një rase të varur që nga gjuha ie., e ngriti në vlerë të rasës emërore, në vend të formës burimore të kësaj rase që ishte me **v-** si në sanskritishte (*vay-ám*), gotishte (*veis*),

hetitishte *vēš*), apo me **m-** si në lituanishte (*mēs*), prusishte (*mes*), sllavishte (*my*), armenishte (*mekh*) etj.

Forma e kallëzores **\*nōs** mori edhe vlerën e dhanores, d.m.th. u bë sinkretike për këto dy rasa, gjë që përcillet edhe te forma **ne** e përftuar prej saj më vonë.

Ne kemi pranuar tezën e G. Meyer-it se forma e emërores shumë e vetës së dytë **ju** rrjedh nga emërorja e gjuhës së lashtë ie. **\*jus** me **ĵ** gjysmëvokalike. Në këtë kohë ekzistonte edhe forma **\*vōs** që, si formë e kallëzores, ishte bërë edhe formë e dhanores paralelisht me formën **\*nōs**.

Forma e vetës së parë njëjës në rasën emërore do të ketë qenë **\*ezu** (< **\*égo**), ndërsa veta e dytë njëjës në emërore do të ketë qenë **\*tū**.

Format tonike të kallëzores së vetës së parë e të dytë njëjës kanë qenë **\*mē**, **\*tē**, ndërsa të dhanores **\*mēni** përkatësisht **\*tui**. Shihet se në këtë kohë format e kallëzores për këto veta nuk kishin dalë edhe në vlerë të dhanores. Kjo do të realizohet më vonë<sup>11</sup>.

## **b) Trajtat atone**

Në kohën e tonit forma atone e dhanore-kallëzores së vetës së dytë shumë ishte, siç e caktoi G. Meyer-i, **\*vōs apo \*ves**<sup>12</sup>. Në të njëjtën kohë ekzistonte edhe varianti aton i dhanore-kallëzores së vetës së parë shumë **\*nōs**<sup>13</sup>.

Trajtat atone të vetës së tretë njëjës **i** – për kundrinën e

<sup>11</sup> Shih për këto çështje B. Bokshi, *Për vetorët e shqipes*, Prishtinë, 2004.

<sup>12</sup> Më vonë kjo kaloi në **\*vē** e pastaj në **u**, siç dëshmohet te Buzuku e në të folmen e Semanit, para se të zëvendësohej nga **ju**.

<sup>13</sup> Nga kjo do të përftohet forma **\*nē** e padëshmuar, që u zëvendësua nga forma **na**.

zhdrejtë, e – për kundrinën e drejtë nuk rrjedhin nga dëftor-vetori, që është edhe i shqipes së sotme pa elementet deiktike, por nga një përemër tjetër dëftor, që ishte bërë brenda kësaj periudhe edhe vetor i vetës së tretë. Ato i takojnë përemrit **\*is (\*ei), \*iā (\*eiā), \*id**. Invarianta e dhanores **i**, siç shënon Sh. Demiraj, ”mund të jetë refleksi i një forme më të hershme **\*ei** ose **\*ii**”, ndërsa e e kallëzores “mund të jetë refleksi i një forme më të hershme e kësaj rase **\*en** (a **\*em**)<sup>14</sup>. Ky përemër, nga i cili nuk u krijua nyja shquese, u zëvendësua nga përemri i rrënjës në **\*to**, d.m.th. nga përemri i sotëm, përveç formave tonike të emërores njëjës të gjinisë mashkullore **\*is** e të gjinisë femërore **\*eiā**, të cilat u bënë pjesë e paradigmës së përemrit zëvendësues. Kështu del i saktë edhe në rastin e shqipes mendimi G. Meyerit dhe i M. La Pianës se “pasi ky përemër ishte defektiv që në indoevropianishte, në disa rase të deklinacionit të tij që zëvendësuar sigurisht nga tema të tjera përemërore”<sup>15</sup>. Ky përemër zëvendësues i ruajti edhe dy format e shënuara atone, sepse nuk i kishte krijuar të vetat, ngase nuk ishte bërë edhe vetor para procesit të zëvendësimit.

Meqë kalimi i përemrit të rrënjës **\*to** në një shquese është bërë për një kohë relativisht të gjatë, zëvendësimi i atij përemri do të jetë i një kohe mjaft të hershme, i kohës para se të krijohet theksi.

Dalja nga përdorimi i formave të plota të dëftor-vetori të mëherëshëm do të jetë bërë ngase me përemrin zëvendësues kishin arritur të jenë sinonimikë si dëftorë dhe se trajtat e plota të përemrit zëvendësues do të kenë qenë më shprehëse. Para se të krijoheshin elementet deiktike do të ketë ekzistuar edhe një dëftor tjetër në opozicion deiktik me përemrin e rrënjës **\*to**. Përemri **\*is, \*eiā, \*id**, me faktin që u zëvendësua nga përemri në **\*to**, nuk ishte në opozicion deiktik me të. Me këtë përemër protoshqipja hyn në një lashtësi të thellë të përdorimit të dëftorit në funksion të vetorit të vetës së tretë.

<sup>14</sup> Shih Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1988, f. 457.

<sup>15</sup> *Studi linguistici albanesi*, I, f. 134-36.

Variantet atone të vetës së parë e të dytë njëjës ishin **\*mōi**, **\*tōi** për dhanore dhe **\*mē**, **\*tē** për kallëzore<sup>16</sup>. Format e sotme **mē**, **tē** janë përftuar edhe nga dhanorja edhe nga kallëzorja. Është afër mendsh që trajtat atone të vetës së parë e të dytë të jenë krijuar para atyre të vetës së tretë, të cilat në atë kohë nuk kanë forma përkatëse kundrinore për shumës.

Renditja *kundrinë e zhdrejtë* – *kundrinë e drejtë* e këtyre trajtave atone të vetorëve, që dalin në shqipen e sotme: [*mē-i (m' i)*, *mē-e (>ma)*, *i-e (→ ia)* etj.] është e kësaj kohe, e krijuar në përputhje me renditjen anticipuese a regresive, që ishte e zakonshme për kundrinat e plota përemërore e emërore.

## 5. Pjesoret

Protoshqipja e ka pasur participin medio-pasiv të prezentit me formantin **\*-mō** ~ **\*mā** nga gjuha e lashtë ie.<sup>17</sup>, apo që në kohën e afërsisë së saj me balto-sllavishten<sup>18</sup>. Ky particip reflektohet si i leksikalizuar në emra: *bimē* – që bin, *pēshtymē* – që pēshtyhet, *mjelm* – që millet etj. Në këtë kohë ky particip kishte kaluar si në baltosllavishten nga participi i njëkohësisë në përticip të prezentit medio-pasiv. Është koha pra kur të gjithë participat shënonin kohën përkatëse e jo më perfektivitetin- imperfektivitetin.

Kjo pjesore kalon më vonë në variant të lirë si pjesore

<sup>16</sup> Shih vep. e cit. f.102.

<sup>17</sup> Për gjuhën ie. shih V. Pisani, *Glottologia indeuropea*, Torino, 1961, f. 131.

<sup>18</sup> Shih B. Bokshi, *Pjesorja e shqipes (vështrim diakronik)*, f. 22 dhe E. Hamp, *Baltistica*, IX(I), 1973, f. 47.

pësore e perfektit, d.m.th. bëhet sinonimike me pjesoren më **\*-nō** (>**-n**), **\*-nā** (>**nē**)<sup>19</sup>.

Protoshqipja e kësaj kohe në sistemin e saj participor e pati edhe participin aktiv të prezentit me të njëjtin formant që e kishin edhe gjuhët e tjera ie. **\*-nt** të zgjeruar me **-i-**, siç ka vërejtur Fr. Boppi<sup>20</sup> pra mashk. **\*-ntiō** ~ fem. **\*-ntiā**, që kaluan shumë më vonë në formantet **-s** ~ **-sē**: [*bas* ~ *basē* → *base*, *mēsues* ~ *mēsuesē* → *mēsuese*] etj. Kjo pjesore veprorë e prezentit kaloi pastaj në emër vepruesi, si në shembujt e sipërm, duke dalë kështu jashtë sistemit participor.

Në sistemin participor të kësaj kohe ishte edhe participi pasiv i perfektit me prapashtesën **\*-nō** ~ **\*-nā** (> **-n** ~ **n-ē**), i cili në shqipen e fazës së dokumentuar del me të njëjtën vlerë kohore e diatezore: [(i,e) lanë (larë), (i,e) lodhun (lodhur) etj.]. Pranë tij e në opozicion diatezor më të ka qenë në këtë kohë edhe participi vepror i perfektit me formantin **\*-lō** ~ **\*-lā** (*-l* ~ *l-ē*), që sot del i transformuar në emër veprimi a në emër abstrakt: [nisëlë, plasëlë, ngrënëllë, përpjekëlë etj.]<sup>21</sup>. Kjo pjesore është paralele me pjesoren e perfektit aktiv në sllavishten e përbashkët me të njëjtin formant **\*-lō** ~ **\*-lā** e në tokarishte e pjesërisht edhe në armenishte. Nga format e gjinisë së kësaj pjesoreje u nominalizua vetëm forma e gjinisë femërore, gjë me të cilën arsyetohet mungesa e emrave të veprimit në gjininë mashkullore.

Në këtë kohë protoshqipja e kishte krijuar edhe participin mediopasiv të futurit. Kështu prapashtesën **-shēm** (*-shm-e*) e kemi kundruar të përfutur nga **\*-siō** (*\*-siā*) e futurit dhe **\*-mō** (*\*-mā*) e mediopasivit të njëkohësisë: **\*-siō-mō** > **-shēm**. Me këtë mënyrë të formimit të participit pasiv të futurit me **-shēm** protoshqipja del në një vijë me greqishten e vjetër, e cila të njëjtin particip e ka krijuar nga bashkimi i prapashtesës **\*-**

<sup>19</sup> Shih *vep. e cit.*, f. 63-68.

<sup>20</sup> Shih A. Xhuvani e E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1962, f. 43.

<sup>21</sup> Shih edhe shembujt të tjerë në E. Çabej, *Studime gjuhësore*, III, Prishtinë, 1976, f. 253.

**siō** të futurit me prapashtesën *\*menō* të mediopasivit të njëkohësisë, p.sh. participi pasiv i futurit *lusomenos*, i futurit ekzakt *lelusómenos*, i futurit të dobët *ludhesómenos*. Forma me **-shēm**, si formë e participit pasiv të futurit mbështetet edhe në kuptimin e mbiemrit prejpjesor, p.sh. *i thyeshëm* = që mund të thyhet a që do të thyhet, *i pishëm*, = që mund të pihet a që do të pihet etj. Nga kjo kuptohet se ky paritcip është krijuar kur participi mediopasiv ishte ende paritcip i njëkohësisë e jo i prezentit.

## Faza e dytë

### 6. Theksi dinamik

Krijimi i theksit të intensitetit i gjeti katër tipat e shënuar të temave emërore. Me vendosjen në një rrokje të caktuar të temës bashkë me tingullin fundor ky theks u bë element konstitutiv i temës dhe element që e dalloi më tej sistemin e temave të shqipes nga sistemi i temave të gjuhës ie.

Që karakteri i theksuar dinamik i theksit në shqipen e sotme ka qenë i tillë edhe në lashtësi e vërteton ndikim i tij i fuqishëm mbi tingujt fundorë të temave emërore që në kohën e kontaktit të shqipes me latinishten.

Nuk mund të përcaktohet distanca kohore midis sistemit të temave emërore me katër tipat e shënuar dhe krijimit të theksit, por largësia kohore e theksit nga kontaktet e para me latinishten duhet të ketë qenë relativisht e gjatë, sepse deri në këtë kontakt do të duhej që theksi ta kishte shkaktuar rënien e tingullit tematik **-ō**, reduktimin e **-ā**-së së temës në **-ë** dhe heqjen e bashkëtingëllores së tenës njërrrokëshe *mūs* > *mi*, *ghem* > *dhe* etj. Kështu përftimi i theksit dinamik në gjuhën shqipe del të jetë i kohës së protoshqipes së hershme, do të thoshim edhe më i lashtë se ç'ka menduar W. Meyer-Lübke.

Krijimi i theksit nënkupton se gjatësitë e vjetra të zanoreve të kohës së tonit ishin transformuar në tipare zanoresh më të hapura

a më të mbyllura, më të prapme a më të parme kur theksi binte mbi to. Këto tipare dalluese të dy serive të zanoreve, që ishin shfaqur që në kohën e tonit, nën theks do të pësojnë një transformim gradual kualitativ duke përfunduar në zanore që i ka shqipja përmes procesit të kalimit nga sistemi me dy seri zanoresh në sistemin me një seri. Tani zanoret e theksuara ishin të gjata, ndërsa të patheksuarat – të shkurtra. Kjo lidhje e theksit me gjatësinë (përveç në zanoret fundore) tregon se kemi të bëjmë me një theks që A. Martinet e shënon si theks jo thjeshtësisht dinamik, por “më tepër kuantitativ se dinamik”, i cili, sipas tij, vetëm si i tillë mund të sqarojë ndryshimet që pësojnë zanoret e patheksuara<sup>22</sup>.

### a) Për lëvizjen e theksit

Mendohet se theksi dinamik i shqipes ishte i lëvizshëm<sup>23</sup>.

Në këtë rast njëra mundësi do të mund të ishte që edhe në protoshqipen theksi të kishte zënë të njëjtin vend që zinte toni më parë, siç ka ndodhur në greqishten, në latinishten, në lituanishten e në disa gjuhë sllave, që do të thotë se kishte mbetur i lëvizshëm si toni e se do të ishte mbërthyer më vonë në një rrokje të caktuar të femës emërore. Mundësia tjetër mund të ishte që në protoshqipen toni të kishte pësuar një rregullim mekanik si në latinishten, duke zënë pozitë në rrokjen e parafundit (me përjashtim kur penultima ishte e shkurtër) dhe theksi i shqipes të ketë rënë po në atë rrokje që binte toni, që do të thotë se lëvizte për të ruajtur pozitën në rrokjen

<sup>22</sup> A. Martinet, *Économie de changements phonétiques*, Paris, 1970, f. 171.

<sup>23</sup> Shih E. Çabej, *Studime gjuhësore III*, Prishrinë, 1976, f. 108-110; Sh. Demiraj, *Fonologjia historike e shqipes*, Tiranë, 1996, f. 33-35; K. Topalli, *Fonetika historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 63-65.

e parafundit gjatë eptimit. Neve na duket më e besueshme që në protoshqipen të jetë zhvilluar kjo e dyta.

Mendimi për lëvizjen e theksit në një kohë të lashtë në gjuhën shqipe bazohet në disa shembuj të paktë nga gjuha e sotme. Kështu përmenden *vesht / vësht* nga njëjësi \**vénest-*, *vënesht-/ vëresht-*, nga shunësi \**venést-*, *jetër* nga njëjësi \**éter*, *tjerë* nga shunësi \**etéri*. Neve na del se këtu përfundon lista e shembujve të tillë.

Shembulli (*i*) *poshtër* – mbiemër, *pështjerë* – ndajfolje nuk mund të merret si shembull i lëvizjes së theksit për të përfutur ndajfoljen nga mbiemri. Profesor Çabej, duke shënuar se *i poshtër* me **-r-në** e saj duket se ruan mbaresën e komparativit, ka lënë të kuptohet se theksi e gjeti si fjalë që mbaronte me **-r**, si *moter* etj., prandaj zuri pozitën paroksitone që ka, ndërsa te *pështjerë* theksi ra mbi **-e** jo për ta dalluar atë nga mbiemri, por pse ndajfolja kishte në fund një zanore, me të cilën dallohej nga mbiemri, prandaj theksi ra edhe këtu në pozitë paroksitone. Forma *shtërpinj* është përfutur nga rrënja \**srep* që dha *shtrap* dhe prapashtesa e theksuar e kolektivit \**-injō*, siç e ka përcaktuar Jokli, pra nga *srepinjō* që nuk lidhet me emrin *gjarpën* që rrjedh nga baza \**serp* (\**serp*: \**srep* është një dubletë rrënjësh si në latinishten *serpo*: *rēpo* (< \**srepo*), dhe sufiksi **-en**: \**serpen*, i cili, si emër asnjans që ishte, e kishte shumësin me **-ā**: \**serpenā*. Emri kolektiv *shtërpinj* më vonë u bë shumës i emrit *shtrap*. Po kështu duhet përjashtuar edhe shumësin *dhëndurë*, sepse **-urë** nuk është mbaresë shumësi, por prapashtesë, e cilësuar si e tillë edhe nga Xhuvani e Çabej në punimin *Prapashtesat e gjuhës shqipe* e siç e tregojnë edhe shembujt: [lëkurë, pëlhurë etj.]. Është thënë se kësaj prapashtese “nuk i dihet as gurra as lidhja që mund të ketë me trajtat e rumanishtes, të italishtes e të greqishtes”, në të cilat, po ashtu, nuk është mbaresë shumësi. Kështu mund të thuhet se edhe kjo prapashtesë e theksuar në këtë shembull do të ketë shënuar një shumës kolektiv dhe me kohë ka kaluar në mbaresë shumësi matematikor vetëm për këtë emër. Që nga Meyeri është

pranuar se emri *krahën* është formuar me sufiksin **-en**, që d.m.th. se theksi ra në pozitë paroksite si te të gjithë emrat e temës në **-n**, **-r**, prandaj sot kemi [*gjarpën, emën, motër, vjehër, shemër, krahën* etj.]. Nuk mund të kuptohet se si emri *gërhanë* të mund të vësh-trohet si shumësi i emrit *krahën*. Këtu kemi të bëjmë më dy emra të përftuar nga një rrënjë më sufiksa të ndryshëm: *krah-en* dhe *krah-anë* (folja *kreh*) dhe theksi në të dyja ra në rrokje të parafundit.

Edhe pse janë vetëm dy shembujt e shënuar për lëvizjen e moçme të theksit, na duken të mjaftueshëm për të besuar se theksi dinamik në protoshqipe në fillimet e tij ka qenë i vendosur në një rrokje të caktuar të temës, por i lëvizshëm gjatë eptimit të fjalës nominale. Lëvizja e theksit ka pasur lidhje me fleksionin e zhvilluar nominal, meqë theksi është krijuar në kohën kur ekzistonte tipi i temave emërore ie., që domethënë edhe fleksioni nominal i tipit të gjuhës ie.

Ndërkaq, të dy shembujt *vesht - vënesht* dhe *jetër - tjerë* e dëshmojnë lëvizjen e theksit vetëm në lidhje me shumësin. Në latinishten, në greqishten e vjetër e në të gjitha gjuhët që e kanë, lëvizja e theksit del e lidhur me shënimin e rasës: në latinishte theksi ka lëvizur në rasat e varura të njëjësit të disa emrave imparasilabikë: *dráco – dracónis, dracónem* etj. dhe në gjinoren e shumësit: *dóminos – dominórum, ágri – agrórum* etj., apo në greqishten e vjetër: *άνδροπος - ανδρόπων, vuç - vύκτα* (emërore e kallëzore njëjës), *vuκός - vuκτί* (gjinore e dhanore shumësi).

Pse shqipja nuk e ka ruajtur lëvizjen e theksit, siç e kanë ruajtur gjuhët e tjera me fleksion të zhvilluar rasor?

Shembujt e gjuhëve të tjera tregojnë se, po të ishin mbaresat rasore të shqipes së sotme reflekse të mbaresave të vjetra të gjuhës së lashtë ie., theksi do të ishte edhe sot i lëvizshëm, duke ndjekur pozitën paroksite brenda formave rasore të tipit: [*fushavet, vepëravet, hekuravet* etj.]. Mungesa e kësaj lëvizjeje tregon se mbaresat

rasore që ka shqipja nuk janë vijim i mbaresave indoevropiane. Të shtuara mbi formën e emërores shumë të ato janë relativisht të reja, jashtë kohës së lëvizjes së theksit, d.n.th. pasi shqipja kishte mbetur pa fleksion dezinencial rasor. Ndryshe do të duhej thënë se në gjuhën shqipe nuk ka pasur lëvizje të theksit

Këtu është e nevojshme të shtjellohet çështja pse shqipja nuk ka ruajtur asnjë shembull të vendosjes paroksite të theksit për shkak të rasës nga format e lashta rasore.

Emrat e temave të shënuara dyrrrokëshe në **-ǫ** e në **-ā** gjatë lakimit nuk dilnin me ndonjë rrokje më shumë as në njëjës, as në shumë. Emrat e temës njërrrokëshe në konsonant dilnin me një rrokje më tepër në rasat e njëjësit e të shumësit, por theksi nuk kishte pse të levizte, pasi në këto rase zinte pozitën parafundore. Vetëm emrat e temës në **-n**, **-r** fitonin një rrokje më tepër gjatë formave rasore të njëjësit e të shumësit, për shkak se emërorja njëjës e këtyre emrave ishte me mbaresë zero. Kështu nevoja për ta lëvizur theksin në rrokje të parafundit për shkak të rasës do të duhej të kishte ekzistuar në kalimin nga emërorja – në rasat e varura në njëjës dhe nga emërorja e njëjësit në rasat e shumësit.

Kjo mungesë e dëshmisë për lëvizje të theksit për shkak të rasës nga koha e fleksionit rasor të tipit të gjuhës së lashtë ie. do të jetë bazuar në faktin se në njëjës forma e emërores me mbaresë zero të emrat e temës në **-n**, **-r** mbeti e vetmja formë pas humbjes së fleksionit dezinencial rasor, kështu që format e rasave të tjera bashkë me theksin e tyre paroksite nuk ekzistonin më. Në shumë forma e emërores kishte rrokje të barabarta me rasat e tjera. Ajo mbeti formë e vetme e shumësit dhe, në raport me formën e njëjësit me mbaresën zero, kishte një rrokje më shumë, prandaj theksi do të vazhdonte të qëndronte në pozitën paroksite në shumë edhe pas humbjes së mbaresave rasore. Kjo lëvizje ishte edhe tani e kufizuar, sepse dilte vetëm në rastet e emrave të temës paroksite në **-n**, **-r**, meqë tema në **-ǫ**, me rënien e këtij tingulli, mbeti temë oksitone në

bashkëtingëllore: [gjak, tul, asht etj.] dhe theksi në shumës nuk kishte pse të lëvizte, mbasi mbaresa e shumësit e mbante në pozitë paroksite. Edhe emrat e temës paroksite në **-ā** pas reduktimit të kësaj zanoreje në **-ë** mbeteshin paroksite edhe në shumës, sepse në vend të **-ë-së** së njëjësit vinte mbaresa e shumësit. Kjo lëvizje e kufizuar e theksit vetëm te emrat në **-n**, **-r** do të jetë hequr nga përdorimi, sepse mungonte në të gjitha rastet e tjera.

Format *vesht*, *vënesh* nuk i takojnë temës paroksite më sonante. Lëvizja e theksit këtu ka arsye tjetër. Njëjësi *vénest* do t'i ketë takuar temës në **-ō** : *vénestō*- si shembull i fjalës me theks nistor. Edhe shumësi kishte të njëtat rrokje, por theksi kishte lëvizur në rrokjen e parafundit: *venéstoi* > *venésti*, sepse shumësi mori mbarsë tjetër pas rënies së mbaresës **-i**.

### **b) Për theksin nistor**

Theksi dinamik i shqipes u vendos në rrokjen e parafundit të temave të shënuara. Në tipin atematik njërrrokësh theksi do të binte në të vetmen rrokje, në emrat e temës në **-ō**, ku ishin integruar edhe emrat e temave në **-u**, **-i** e në konsonant theksi ra në rrokjen që paraprinte (*\*sókō*-, *\*uléksō*-, *\*álbō*- etj.), ashtu si dhe te emrat e temës në **-ā**, ku kishte edhe emra të gjinisë asnjane (*\*pólnā*, *\*spúdnā*, *\*trékā*, *\*bhálā* etj.) dhe tek emrat e temës në **-n**, **-r** (*\*ghèimen*, *\*máter*, *\*énmen* etj.). Nga ana tjetër, siç jemi shprehur më parë<sup>24</sup>, theksi i gjeti të temës në sonantet **-n**, **-r** edhe disa emra që më herët ishin të bazave a temave të tjera, kështu që vendi i theksit tregon se p.sh. për *dhëndër* duhet menduar se qe në një formë të afërt me atë të latinishtes *gèner*, për *vjehërr* - një formë të ngjaj-

<sup>24</sup> B. Bokshi, *Rruga.*, f.200-201.

shme me *sócer* të latinishtes dhe *suehur* të gjermanishtes, pra të afërt në një *\*sue-sur* e jo si para theksit *\*suesuro* apo *\*suekuro*, për shemër një *\*sm-mer* e jo *\*sm̄-meri*, për *gjarpër* një *\*serpen* e jo *\*serpeno* e ndonjë tjetër. Kjo flet se tema në sonantet **-n, -r** ishte zgjeruar edhe me emra të temave të tjera, kur para këtyre zanoreve ishin këto sonante.

Kështu emrat që u përmendën nuk janë shembuj që vërtetojnë se protoshqipja kishte theks nistor. Theksin nistor nuk e vërtetojnë as format si [emënë, dimënë, gjarpënë etj.], sepse **-ë**-ja fundore këtu është e re, shumë e shumë kohë pasi theksi ishte vendosur në pozicion paroksiton të këtyre fjalëve. Kjo **-ë** është përfutur nën presionin e zhvillimit të sistemit të temave dhe i takon kohës pak para periudhës së shqipes së dokumentuar dhe shtrihet edhe në shkrimet e autorëve tanë të vjetër. Atëherë ishte krijuar edhe tema e tipit [pezëmë, kumbullë, kungullë, shembëllë etj.]<sup>25</sup>. Nuk mund ta dëshmojë theksimin nistor as shembulli *ager*, që shkon me trajtën femërore *gare*, kështu që në formën burimore *a-ger* (apo *o-ger*) theksi do të zinte pozitë paroksitone, ashtu si dhe te *afër*. Theksi nistor nuk shihet as te *akull*, që lidhet me *kal*-iti, sepse pjesa *kal* e sllavishtes fjalën *akull* nuk e shpie në kohë aq të hershme sa është vendosja nistore e theksit. Formimi *a-kal* nuk paramendon edhe një zanore fundore, që të kishim pasur vendosjen e theksit në rrokjen e parë të fjalës trirrokohe. Te *avull* jemi në një etimologji të pasigurt, kur shohim në përbërje të saj emrin *valë*, siç ka menduar Jokli, sepse kjo etimologji e përjashton fjalën rumune *abur* të marrë nga shqipja me kuptimin “avull”. Nga ana tjetër po të kishim pasur *a-valë*, si do të mund të arsyetohej kalim *-l- > -ll* dhe *-a- > -u-* ?

Fjala *esëll* (*esull*) është ndajfolje me parashtesën mohuese **e-**, që ka kuptimin “pa ngrënë mëngjesin”, por edhe mbiemër me kuptimin: “jo i dehur, që i ka dalë rakia”. Duket se kjo fjalë lidhet vërtet me emrin

<sup>25</sup> Shih vep. e cit., f. 219 – 20.

*sillë*, ashtu si dhe fjala *egjëll* me emrin *gjellë*, prandaj këto mund të dëshmojnë për një theks nistor te fjalët trirrokëshe.

Që nga Hans Krahe<sup>26</sup> është besuar se shqipja kishte një theksim nistor që shihet në toponimet: [Drívastum, Ísamnum, Dúrachion, Púlatum], që e dëshmon theksimi në format e sotme: [Drisht, Ishëm, Durrës, Pulët]. Mendohet se theksin nistor të shqipes e vërtetojnë edhe huazimet pa theks nistor në gjuhët dhënëse te fjalët trirrokëshe, siç janë: *μαχανά* – *mokënë*, *oleáster* – *voshtë*, *compáter* – *kumtër*.

Guillaume Bonnet, pasi shënon se “theksi në latinishten klasike ka mbetur përgjithësisht stabil” e se “Studimi i fjalëve që hynë në shqipen tregon se ato e kanë ruajtur masivisht theksin në vendin që ishte i latinishtes”, shfaq mendimin se ka pasur edhe përjashtime theksimi në latinishten klasike, siç është, sipas tij, theksimi në rrokjen e katërt nga fundi në dy shembuj: *co(n)socerum* – *krushk* dhe *præsbyterum* – *prift*. Si mbetje të tjera të shmangies nga evolucioni me zhvendosje të theksit në rrokje nistore kur gjendej para grupit konsonantik me **-r**, ai sjell shembujt: *cúlcitram* – *kultër*, *cómpatrem* – *kumtër*, *óleastrum* – *voshtë*. Sipas kësaj bien poshtë vlerësimet që bëhen për shembujt që shënuam si vërtetim të theksit nistor në protoshqipe, duke mbetur vetëm fakti se shqipja e ka respektuar edhe këtu vendin e theksit të latinishtes e të greqishtes. Kjo mbëshetet edhe në faktin se shqipja këto fjalë i ka bërë shpejtë fjalë dyrokëshe me theks paroksiton. Për *μαχανά* Bonnet-i mendon se doli në gjuhën shqipe me theks në rrokjen nistore nga presioni i tipit të temës në **-n** : *mokënë* si *femënë* etj. Ky studiuues e vë në dyshim praninë e theksit nistor të fjalët trirrokëshe të ilirishtes<sup>27</sup>.

Theksimi i sufiksave të lashtë në rrokjen e parafundit (p.sh. *-ungë* < *\*-un-gā*, *\*-ēnīā* > *-onjë*, *\*-inīō* > *-inj*, *\*-ijā* > *-ijë*, *\*-atā* > *-atë*, *\*-atō* > *-at*, *\*-arō* > *-ar*, *\*-anā* > *-anë* etj.) tregon se edhe fjalët

<sup>26</sup> Shih Sh. Demiraj, *Fonologjia historike e shqipes*, Tiranë, 1996, f. 40.

<sup>27</sup> Shih veprën e tij *Les mots latins de l'albanais*, Paris, 2000, f. 135-43.

e prejardhura me tri a më shumë rrokje janë theksuar në rrokjen e parafundit, mbasi këta sufiksa nuk mund të ishin sufiksa të fjalëve me dy rrokje. Kështu mbetet të besohet që fjalët trirrokëshe vetëm kur ishin fjalë të parme, apo edhe kur ishin fjalë të prejardhura me prefiksa, do të kenë pasur theks nistor<sup>28</sup>. Kjo e vështirëson argumentimin për prani të kësaj vendosjeje të theksit në protoshqipen.

Vendosja e theksit në rrokjen e parafundit të fjalët me dy rrokje është në fakt edhe vendosje nistore e theksit, kështu që ai do të kishte qenë i së njëjtës kohë me theksimin e supozuar nistor të disa emra me tri rrokje. Nga trajtimi i theksit paroksiton si nistor u kalua në trajtim të tij si parafundor, sepse përmbliidhte emrat e të gjitha temave, me përjashtim të temës njërrrokëshe dhe të temës tepër të rrallë trirrokëshe. Ky dominim i trajtimit të theksit jo më si nistor në temat dyrrrokëshe, por si parafundor, shkaktoi edhe theksimin parafundor të temave me më shumë se dy rrokje që në kohë mjaft të hershme, siç mund ta dëshmojnë edhe ata pak shembuj të fondit autokton të shqipes: *lërë* < \**elénā*, *mbesë* < \**nepōtiā* e mbase edhe Aulona e ndonjë tjetër. Nga kjo shihet se s'ka se si të mendohet që theksimi paroksiton ka qenë më i vonshëm se theksimi nistor dhe se zotërimi i theksimit paroksiton edhe të fjalët shumërrrokëshe mund të kualifikohet vetëm këtu si "rregullim mekanik i theksit".

Theksimi në rrokjen nistore dhe parafundore të fjalës përbën ritmin bariton a gjysmëbariton të shprehjes, që imponon një renditje të caktuar të segmenteve të grupit nominal, të sintagmës nominale e të frazës e që është cilësuar si renditje anticipuese a regressive. E tillë është renditja e mbiemrit para emrit, e emrit përcaktues para emrit të përcaktuar dhe renditja e përbërësve të frazës Subjekt - Objekt - Verb, ashtu si dhe renditja e kundrinës së zhdrejtë para kundrinës së drejtë. Këto ishin bërë renditje më të zakonshme që në gjuhën e lashtë ie. dhe ritmi bariton a gjysmëbariton i theksimit i bëri edhe më të natyrshme në protoshqipen e kohës. Elemente të theksuara dalin prefiksat, preverbat ashtu si dhe përcaktuesit e em-

<sup>28</sup> Shih këtë vlerësim edhe te Sh. Demiraj, vep. e cit., f. 38.

rave. Dëshmi e kësaj janë shembujt *esëll*, *agër*, *afër* dhe më të vonshmet *sot* e *sonte*. Nga ky ritëm janë formuar kompozita të tipit *më-mëdhe etj.* e sekuenca të tjera që s'ka pse të shtjellohen këtu.

## 7. Reduktimet në sistemin e rasave

Fakti që përemrat dëftorë e vetorë do të mbesin vetëm me format e tri rasave pa mbaresa, po me variacion teme: emërore, dhanore e kallëzore, na shtyn të mendojmë se rënia e mbaresave rasore, që do të realizohet më vonë në kohën e huazimeve të para nga latinishtja, nuk mund të jetë shkaktuar vetëm nga efekti i theksit dinamik mbi tingujt fundorë, por do të jenë edhe proceset e funksionalizimit të parafjalëve, si në gjuhët që përfatuan strukturën analitike, proceset e preferimit të sintagmave parafjalore në vend të formave rasore në funksionet konkrete lokativale, d.m.th. në vend të funksionimit të SN-së si SP me parafjalë zero.

Mosruajtja e formës së rrjedhore së përemrave vetorë e dëftorë me variacion teme, që do të ishte e ndryshme nga format e tri rasave të shënuara, tregon se edhe kur ekzistonin mbaresat rasore të tipit të gjuhës së lashtë ie. dhe para efektit të theksit kishte filluar dhe ishte zhvilluar procesi kur parafjalët po ua merrnin mbaresave rasore aftësinë për të shënuar funksionet lokativale a “konkrete” të emrit. Kështu duhet të mendohet se format e emrit në rrjedhore, në instrumental-sociativ ishin përjashtuar nga forma e kallëzores me parafjalët përkatëse **prej**, **me**, **për**. Në këtë kohë edhe emri në kallëzore e dhanore pa parafjalë mund të ishte vetëm kundrinë e drejtë respektivisht kundrinë e zhdrejtë e jo plotës rrethor. Të gjithë rrethorët i realizonte kallëzorja me parafjalët për-

katëse. Nga kjo rezulton edhe se kallëzorja me parafjalën **në** (në formën e kohës) e përjashtoi vendoren me të njëjtën parafjalë, duke realizuar ajo vetë edhe kuptimin e të qëndruarit edhe kuptimin e drejtimit me parafjalën e njëjtë.

Në ndryshimin e mbaresave rasore nën ndikimin e theksit në këtë kohë duket të jetë unifikuar mbaresa e gjinores me dhanoren, që do të thotë se dhanorja tani e kishte edhe përdorimin adnominal të gjinores.

Kështu, në këtë periudhë duket të kenë mbetur në përdorim vetëm format rasore të rasave abstrakte a “gramatikore”: emërore, dhanore e kallëzore.

Duhet të rikujtojmë këtu se forma përemërore **si**, **so** u bë formë e rrjedhore së dëftorit në kohë shumë të vona. Kuptimi i tyre fillimor ka qenë **si** = i tillë, **so** = e tillë etj. Format e vetorëve **me**, **te** janë forma të kallëzores, që poashtu shumë vonë, mbasi u krijuan mbaresat e reja rasore, mbasi u krijua forma rasore e rrjedhore kaluan në vlerë të kësaj rase<sup>29</sup>.

Meqë parafjalët nuk u përdorën për të shënuar rasën dhanore e kallëzore në funksionet e tyre kundrinore, mbetet të përfundohet se atëherë nuk mund të flakëshim mbaresat rasore të këtyre rasave.

## 8. Perfekti analitik jovepror

Në veprën *Pjesorja e shqipes* kemi arsyetuar se perfekti analitik pësor i shqipes nuk është krijuar nën ndikimin e latinishtes, siç mendojnë disa gjuhëtarë. Si në gjuhë të tjera edhe në gjuhën

<sup>29</sup> Shih: B. Bokshi, *Rruga...*f. 375- 8.

shqipe perfekti analitik pësor në zëvendësim të perfektit pasiv sintetik u krijua nga grupi verbal me këpujën *jam* e me sintagmën adjektivale të realizuar nga pjesorja pësore e perfektit në funksion të mbiemrit ende të panyjësuar. Në të gjitha gjuhët që e kanë, përfekti i tillë është krijuar në kohë të lashta si p.sh. në latinishten arkaike, në oskishten e umbrishten, në gjuhët keltike e gjermanike (gotishtja). Edhe nga kjo anë rrjedh se edhe perfekti i tillë i shqipes, i krijuar pa ndikim nga latinishtja, nuk mund të jetë i kohës së protoshqipes së vonë apo edhe më i ri si në asnjë gjuhë tjetër. Kështu rezulton se edhe perfekti analitik pësor i gjuhës shqipe është krijuar para huazimeve latine.

Perfekti i tillë analitik, meqë e zëvendësoi perfektin jovepror sintetik do t'i ketë pasur që nga fillimi kuptimet e diatezave të mesores e të pësores që i kishte perfekti i zëvendësuar. Shumë më vonë ai mori edhe kuptimin e vetvetores që e ka edhe sot.

## Shënim:

Mendojmë se reduktimi i numrit të temave emërore, mosruajtja e ndarjes së gjinisë në emra gjallesash e jogjallesash, humbja e dualit, lëvizja e shënuar e mbaresave të numrit, gjendja e pjesoreve, kalimi i përemrit dëftor \*is, \*eiā, \*id edhe në funksion të vectorit dhe krijimi nga ai i trajtave atone kundrinore të njëjësit janë zhvillime që ishin krijuar para kontaktit ndikues të greqishtes së vjetër mbi protoshqipen, ashtu siç janë paragreke edhe transformimet e zanoreve ē > o dhe ō > a. Kjo do të thotë se këto zhvillime

përbëjnë periudhën e protoshqipes paraballkanike e ballkanike deri në shekullin e pestë para erës së re.

Faza e dytë e zhvillimeve të kësaj gjuhe fillon me theksin (theksin dinamik), i cili, siç kemi shënuar në veprën *Rruga*<sup>30</sup> ...do të jetë krijuar në kohën e kontakteve me greqishten e lashtë kah periudha e dialekteve, aty kah shek. IV para e. së re, afërsisht kur është shfaqur edhe në këtë gjuhë. Në këtë kohë përemri i rrënjës në *\*to* do ta ketë zëvendësuar përemri dëftor-vetor më të lashtë *\*is*, *eĵā*, *\*id*. Në këtë fazë fillon procesi i dobësimit të tingujve fundorë të temave dhe nisin levizjet kah krijimi i strukturës analitike që do të përfundojë me kalimin në periudhën pasuese të ndikimit të latinishtes.

---

<sup>30</sup> B. Bokshi, *Rruga.*, botimi i dytë, f. 204.

## **B. KOHA NGA KONTAKTI ME LATINISHTEN**



# I .PERIUDHA DERI NË PËRFUNDIM TË SHEKULLIT V

## 1. Sistemi i temave që krijoi theksi dinamik

Huazimet nga latinishtja janë të kohës kur theksi e kishte ushtruar veprimin e tij mbi tingujt fundorë të temave emërore, duke krijuar një sistem të ri me rënien e -*ō*-së, me reduktimin e -*ā*-së në -*ë* dhe me rënien e bashkëtingëlloreve në tipin njërrokësh<sup>31</sup>, atëherë pra kur ishin këto tema të përfutuara në rrugë fonetike drejtpërdrejt nga sistemi i mëparshëm me katër tipa të temave:

1. \**mūs*, \**sūs*, \**ghēm*, \**ureg* etj. → mi, thi, dhe, re etj.
2. \**tūlo*, \**sōko*, \**ōstho*(←\**ōsthī*), \**glūno* (←\**glūnū*), \**ulāksō* (←\**ulāks*) etj. → tul, gjak, asht, glun, lesh etj.
3. \**lāmā*, \**kēsā*, \**spūdnā*, \**pōlnā*, \**bhālā* etj. → lamë, kohë, punë, pelë, ballë etj.
4. \**gheimen*, \**māter*, \**enmen* etj. → dimën, motër, emën etj.  
(Emrat e shënuar kanë pasur përbërje tingëllore të kohës).

Ky sistem i temave emërore të shqipes me këtë numër kaq të reduktuar të tipave, trashëguar nga sistemi i mëparm, përballë sistemeve të pareduktuara të temave emërore në gjuhët greke e latine, në procesin e adaptimit nuk do të mund të përmbliidhte brenda tij të

<sup>31</sup> Shih arsyetimin në veprën e cituar.

gjitha fjalët emërore të huazuara. Huazimet nga këto gjuhë e begatuan këtë sistem me dy tema të reja: me tipin e temës paroksite në konsonant e në sonante përveç **-n -r**: [*pellëg, farmëk, qelëq, kallëm, kumbëll, shekëll* etj.] dhe me temën proparoksite në **-ë** para sonanteve **-n,-r**: [*femënë, mokënë, retënë, letërë* etj.].

Tipat e temës paroksite në **-ë** (<-*ā*): [*kohë, punë, pelë* etj.] dhe oksitone në konsonant (me rënie të **-ō-së**): [*tul, gjak, asht* etj.] ishin të polarizuara në gjini që nga sistemi i mëhershëm. Modelet paroksite të huazimeve me **-ā**, duke qenë të gjinisë femërore, do të integrohen në tipin me **-ë** të gjinisë femërore: *coxā* → *kofshë*, *luctā* → *luftë* etj., ndërsa ato të modeleve me vokale të tjera do të integrohen në tipin e temës mashkullore oksitone në konsonant: *fructus* → *fruit* (>*fryt*), *civitatem* → *qutat* (> *qytet*), *pisces* → *peshk*<sup>32</sup> etj. Në tipin paroksiton me **-n, -r**, që është neutral në gjini, integrohen emrat e greqishtes e të latinishtes të së njëjtës temë: *grāmen* → *gramën*, *tégmen* → *timën*, *πέπων* → *pjepën*, *δάμουν* → *djemën* etj. Në këtë tip do të hyjnë edhe emrat e modelit proparoksiton me **-n e -r + zanore**, përveç **-ā-së**, sepse tipi me këto zanore në këtë sistem do ta ketë replikën me zanore zero, që domethënë se janë të gjinisë mashkullore e asnjëse edhe kur janë të gjinisë femërore në gjuhën dhënëse (p.sh. emri *fraxinus* → *frashën*): *mārginem* → *margjën*, *órfanus* → *vorfën*, *léporem* → *lepër*, *σπάργανον* → *shpargën*, *λάκωνον* → *lakën*, *δρόπανον* → *drapën*, *μαστίκινος* → *mështekën* etj. Në këtë tip të temës integrohen edhe emrat e modelit paroksiton me përfundim në **-kr+zanore** (përveç **-ā-së**) përmes një **-ë**-je anapitike në mes të këtij grupi konsonantik: *ώκρος* → *okër*, *céntrum* → *qendër*, *lúcrum* → *lukër* etj.

Te foljet e kësaj kohe është edhe mbaresa **-ë** e vetës së parë njëjës e aoristit sigmatik [*pash-ë, rash-ë, thash-ë* etj.] dhe e imperfektit të dëftores [*jesh-ë, kesh-ë, vjel-ë* etj.], që konsiderohet e përfutur nga mbaresat ie. **-ā**.

<sup>32</sup> Shih arsyetimet në veprën e cituar, f. 205-8.

## 2. Mbaresat e shumësit

Sistemi i shënuar i temave, i krijuar nën ndikimin e fuqishëm të theksit mbi tingujt fundorë, tregon, bashkë me elemente të tjera, se shqipja në atë kohë e kishte flakur sistemin rasor mbaresor të ie. Nga fleksioni i vjetër ishte ruajtur vetëm opozicioni i numrit, kështu që nga mbaresat e vjetra ishin ruajtur mbaresat e emërores shumësi \*-i nga \*-ōi, -e nga \*-āi, -ē e asnjansit nga \*-ā dhe ishte krijuar shumësi një me njëjës (lopë, mollë etj.) nga emërorja sing. -ā-θ ~ plur. -ā-s (<-ā-es). Pa mbaresë të numrit kishin dalë edhe emrat e temës njërrrokëshe në zanore të theksuar: [mi, thi, dhe, re] etj. Në paradigmen sing. *vreg-s* ~ plur. *vreg-es* theksi e përjashtoi nga emërorja e njëjësit mbaresën -s dhe konsonantin para saj, duke e nxjerë tingull fundor të temës zanoren e theksuar (*re*, *mi* etj. në formën përkatëse të kohës). Në shumësin *vreg-es* theksi ka mundur të heq vetëm mbaresën -es, kështu që shumësi i këtyre emrave do të dilte i pasistemuar me bashkëtingëllore të ndryshme *vreg*, *mis* (<*mūs*), *this* (< *sūs*), *dhem* (< *ǵhem*). Kjo formë e shumësit, që nuk mund të qëndronte, u mënjana me anë të barazimit të shumësit me njëjës, d.m.th. duke flakur këtë mbaresë të parregullt të numrit të këta emra. Pa mbaresë numri dalin edhe disa emra që hynë më vonë në këtë temë si p.sh. *shtëpi*, *rrufe*, *kala* etj. Disa të tjerë e ruajtën formimin e shumësit sipas kërkesave të temave nga të cilat erdhën (*pe* ~ *penj* < \**pen* ~ \**pen-i*, *ftua* ~ *ftonj* < \**fton* ~ \**fton-i*, *thua* ~ *thonj* < \**thon* ~ \**thon-i* etj. ), ndërsa disa të tjerë jo: sing.- plur. *sy* nga *sy* ~ *synj* < \**syn* ~ \**syn-i* etj.<sup>33</sup>

Këto mbaresat, si të vetmet në shumësi, nuk mund të shënonin më emëroren, kështu që nga shënimi i rasës dhe i numrit kishte mbetur vetëm shënimi i numrit.

Funksionimi i mëvonshëm i formës së emërores së shumësit

<sup>33</sup> Shih B. Bokshi, *Rruga*, f. 104-105.

si temë e shumësit, mbi të cilën janë shtuar mbaresat e reja rasore, tregon po ashtu se kjo formë nuk kishte vlerë rasore. Kjo, natyrisht, vlen edhe për emëroren e njëjësit.

### 3. Mbaresa e gjinisë dhe sufiksati feminativë

Opozicioni në gjini i temës oksitone në konsonant dhe paroksitone në *-ë* te mbiemrat e ka nxjerrë tingullin *-ë* mbaresë të gjinisë femërore. Forma mashkullore e mbiemrit është me mbaresë zero: bujar ~ bujar-ë (= bujar-e). Kur këta mbiemra janë edhe emra (emra-mbiemra) - *ë*-ja është edhe sufiks feminativ, d.m.th. e shënon gjallesën e seksit femëror. Është koha kur ende nuk ishte krijuar tema paroksitone në *-e*: [nuse, dele etj.], e cila, si temë që ka vetëm emra të gjinisë femërore, do të shkaktojë që forma femërore e mbiemrit t'i takojë kësaj teme, d.m.th. të dalë me mbaresë *-e* të gjinisë e të sufiksit feminativ. Kjo ndodh shumë më vonë kur tema paroksitone në *-ë* neutralizohet në gjini, duke pranuar edhe emra të gjinisë mashkullore (*burrë, atë, Kolë* etj.). Mbaresën *-ë* si sufiks feminativ e si mbaresë të gjinisë femërore më të lashtë e vërtetojnë edhe emrat e veglave të përfutur nga leksikalizimi i invarianteve të gjinisë femërore të emrave të vepruesit (nomina agentis): [kapsë, grisë, fshisë etj.]. Mbaresa dhe sufiksi *-e* e zëvendësoi më vonë *-ë*-në te fjalët që ishin mbiemra e emra-mbiemra e jo te fjalët që ishin vetëm emra si p.sh.: [plak-ë, zog-ë, kunat-ë] e as te emrat e shënuar të veglave.

Mbiemrat e temave të tjera, të cilat, siç thamë, ishin neutrale në gjini, nuk kishin si ta dallonin gjininë me mbaresa, sepse të dy gjinitë qëndronin brenda së njëjtës temë: [(i,e) lagun (lagën), (i,e)

egër, (i,e) poshtër, (i,e) vogël, (i,e) ambël] etj. Gjendja e kësaj kohe e mbiembrave të temës në zanore të theksuar është errësuar.

Në këtë kohë shqipja ka krijuar edhe sufiksa të tjerë feminativë si [-**eshë**, -**ushë**, -**onjë**.] (princeshë, arushë, ulkonjë etj.). Me përfundimin në -**ë** dhe me theksin e tyre këta sufiksa e sigurojnë strukturën e temës femërore paroksite në -**ë**, kështu që, ndërsa sufiksi -**ë** mund t' i shtohet vetëm temës tipike mashkullore oksitone në konsonant [plak ~ plak-ë etj.], këta sufiksa mund t' u shtoheshin edhe temave të tjera emërore: [bari ~ bareshë, ari ~ arushë etj.].

Të tre këta sufiksa janë sinonimikë në shqipen e sotme dhe arsyeja e përdorimit të njërit a të tjetrit nuk është e përcaktueshme. Kjo na orienton t'i shohim me burim nga sufiksa që nuk ishin feminativë, d.m.th. sinonimikë.

Sufiksi -**eshë** tërë përdorimin e ka me emra të mocionit. Ai konsiderohet se buron nga sufiksi -**issa** i latinishtes dhe mendohet të jetë përforcuar më vonë nga sufiksi -**essa** i italishtes. Pranë këtij është edhe sufiksi -**esh**, etimologjia e të cilit nuk dihet. Siç shënohet në veprën *Prapashtesat e gjuhës shqipe* të A. Xhuvanit e E. Çabejt, emrat e formuar me prapashtesën -**esh** “duket se kanë dalë prej emrash që shënojnë një individ...” dhe se në fakt prej tyre janë krijuar emra vendesh, lagjesh, pyjesh, kullosash e familjesh: [Martanesh (Martin), Petresh (Petër) etj.]. Nga ky përdorim nuk është i largët përdorimi për të shënuar mashkullin e familjes a të vendit. Duhet menduar pra se Martanesh ka shënuar gjithçka që është e Martinit (në gjininë mashkullore njëjës), pra edhe mashkullin, përkundër Martaneshë, që do të ketë shënuar edhe femrën. Kështu sufiksi feminativ -**eshë** ka qenë i analizueshëm në -**esh** + -**ë**, me -**esh** si sufiks i plotë semantik e me -**ë** si sufiks modifikativ feminativ. Nga kjo mund të thuhet se -**eshë** nuk rrjedh nga lat. -**issa**. Latinizmat me -**issa**, që do të japin -**eshë**, ndihmuan që ky sufiks i shqipes të përdorej i tëri si sufiks feminativ, duke e humbur lidhjen me sufiksin -**esh**. Format me -**sh** janë përfutur kah shek. X me kalimin  $s > sh$ .

Pranë sufiksit **-ushë** është edhe sufiksi **-ush**, që në përdorim primar ka kuptim deminutiv e përkëdhelie tek emrat e gjallesave: [kalush, babush, vidush etj.] . Këtij sufiksi i është shtuar feminativi **-ë** për të shënuar të njëjtat krijesa të vogla të seksit femëror: [minushë (minush), lepurushë (lepurush) etj.]. Kjo shihet edhe te mbiemrat: [larush-e, bardhush-e, vogëlush-e etj.] dhe tek emrat e përveçëm: [Tanush - Tanushë, Mirush - Mirushë etj.]. Tek mbiemrat **-e-ja** e ka zëvendësuar **-ë**-në shumë më vonë. Nga kjo gjendje u krijua gradualisht sufiksi feminativ **-ushë**: [dren ~ drenushë, ari ~ arushë etj.] (pas s > sh ).

Sufiksi **-onjë** duket se përdorimin primar e pati si augmentativ e pejorativ. Emrat e formuar nga emri i gjinisë femërore + **-onjë** duket se e arsyetojnë një përdorim të tillë primar: [shkabonjë (shkabë), gabonjë (gabë), zgërbonjë (zgarbë), shqiponjë (shqipe)]. Përdorimi si në [ulkonjë, biskonjë etj.] u bë i mundur kur ky sufiks e humbi kuptimin augmentativ-pejorativ dhe u bë sufiks femërorizues.

#### 4. Krijimi i nyjës shquese

I kësaj kohe është edhe krijimi i nyjës shquese, e cila ishte prepozitive ndaj emrit [i pus], ndaj mbiemrit në grupin e plotë nominal [i | thellë | pus] (= i thelli pus, pusi i thellë) dhe me nënkuptim të emrit [i | thellë] (= i thelli). Në sintagmën nominale nyja qëndronte para dhanores adnominale [i | saj | pus](= i saji pus – pusi i saj); e | tij | arë (= e tija arë – ara e tij) etj. Transformimi i përemrit anaforik në nyjë përfundoi në këtë kohë pas një procesi relativisht të gjatë nëpër fazën e një artikuloidi. Për gjuhën shqipe, si për gjuhët neolatine më vonë, krijimi i nyjës është i lidhur me krijimin e strukturës analitike.

Emrat e ditëve të javës janë dëshmi e kohës kur nyja në gjuhën shqipe nuk përdorej ende me emrat e përveçëm dhe dëshmi e gjendjes pa mbaresa rasore: [*e* | *Hënë* | *ditë*] (= dita e Hënës), [*e* | *Mart* | *ditë*] (= dita e Martit), [*e* | *Mërkur* | *ditë*] (= dita e Mërkurit) etj. Në këto sintagma e-ja ishte një shqese e emrit të përgjithshëm *ditë*. Këtu shihet se mungon nyja e emrave Hënë, Mart etj, që do të dilte para këtyre emrave: [*e* | së Hënë | *ditë*], [*e* | të Mart | *ditë*] etj. ,ashtu si dhe mbaresa rasore e gjinore a e dhanores adnominale. Emrat e ditëve të javës *e martë*, *e mërkurë*, *e shtunë* janë huazuar nga latinishtja në kohën para përhapjes së krishterimit të latinët, që do të thotë se nyja shqese në protoshqipen është e kohës së huazimeve të para nga latinishtja, pra e kohës para se të krijoheshin emrat *septimana*, *sabati* e *dominica*, që i solli krishterimi.

Nyja u përftua nga përemri dëftor që është edhe sot, por pa elementet deiktike **a-**, **kë-**.

Kjo ishte faza e parë e pozitës së njëjës në gjuhën shqipe. Në këtë kohë ishte krijuar plotësisht sistemi i njëjzimit, d.m.th. ishte krijuar kategoria gramatikore e shquarsisë me të tri elementet e saj: një shqese, një joshqese dhe një zero. Përemri dëftor dhe nyja shqese, që u përftua nga ai, dalloheshin vetëm në punë të theksimit: përemri ishte i theksuar, ndërsa nyja shqese e patheksuar.

## 5. Sistemi i rasave

Përemri dëftor kishte mbetur paradigmatic jo me mbaresa, por me variacion teme. Në gjininë mashkullore e femërore njëjës kishte forma për emërore, dhanore e kallëzore, ndërsa në gjininë

asnjanëse dhe në shumës për të tri gjinitë kishte formën sinkretike për emërore-kallëzore dhe formën e dhanores. Në funksion të mbiemrit limitativ ky përemër përcaktonte funksionin rasor të emrit. Edhe format rasore të nyjës, që kishin më shumë trajta sinkretike, përcaktonin disa vlera rasore të emrit.

Renditja e zakonshme e segmenteve të grupit nominal, të sintagmës nominale e të frazës, që ishte anticipuese a regresive, ishte bërë renditje e detyrueshme për shkak se nuk kishte mbaresa rasore. I vetmi ndryshim në renditje ishte kalimi nga renditja e mëparme Subjekt – Objekt – Verb në renditjen Subjekt - Verb - Objekt. Kjo renditje e segmenteve të frazës, që e kanë gjuhët me strukturë analitike, ishte tepër e zakonshme dhe edhe e detyrueshme në rastet kur nuk përdorej mbiemri limitativ dëftor a nyja. Ajo është e tipit të përzier, renditje “e thyer”, sepse renditjen S – V e ka renditje progresive, ndërsa renditjen V – O e ka regresive.

Kjo renditje regresive (V–O) në nivel të sintagmës verbale, që është në përpurhje me renditjen e segmenteve të grupit nominal Mbiemër – Emër e të sintagmës nominale Emër i përcaktuar – Emër përcaktues, tregon se format kundrimore të patheksuara të vetorëve, që nga kjo kohë, mund të kalonin në enklizë ndaj kallëzuesit (V), i cili tani nuk ishte segment fundor i frazës si më parë, ashtu siç është qendja në gjuhën angleze. Kjo vendosje enklitike në protoshqipen e kësaj kohe është ruajtur me urdhëroren pozitive:[lejo-më etj.]. Kur zotëronte renditja më e hershme S – O – V si renditje e zakonshme, trajtat kundrinore të patheksuara do të qëndronin proklitike ndaj kallëzuesit që ishte segmenti i fundit<sup>34</sup>. Kjo topikë u tregua rezistente ndaj kërkesës së renditjes pasuese S – V - O, për enklizë, kështu që përveç rastit të urdhërores, format e patheksuara kundrinore të vetorëve nuk kaluan në enklizë të foljes. Me ndryshimin e vendit, folja (V) e mori me vete edhe pozicionin proklitik të këtyre trejtave të vetorëve.

<sup>34</sup> Shih në B. Bokshi, *Për vetorët e shqipes*, f. 168-69.

Kundrina e zhdrejtë vazhdonte të qëndronte para kundrinës së drejtë.

Kështu, mjetet e ndryshme: përemër dëftor, një, renditje e detyrueshme përbëjnë karakterin e përzier të sistemit rasor të kësaj kohe e më vonë.

Sintagma parafjalore edhe në këtë kohë e deri në shqipen e sotme nuk doli në funksion të sintagmës nominale, d.m.th. nuk doli shënuese e rasave “gramatikore” a “abstrakte”, kështu që asnjë parafjalë nuk është bërë shënuese e ndonjëres nga këto rasa. Edhe sintagma nominale vijoi të mos dalë në funksion të sintagmës parafjalore, d.m.th. nuk doli në funksion të rrethanorit, siç del në shqipen e fazës së dokumentuar: [shkoi fushave, u ngjit malit, erdhi natën] etj. Kështu sistemi tri rasash i kësaj kohe ishte i kufizuar vetëm në rasat që shënonin funksionet abstrakte a gramatikore të fjalisë, ndërsa funksionet konkrete a lokative i realizonin parafjalët, d.m.th. sintagma parafjalore me emrin në njëjërën nga rasat ekzistuese. Mbase nominativi dhe akuzativi në relacion me verbin mund të dalloheshin edhe pa prani të dëftorit në funksion të mbiemrit limitativ e të njëjës: [erdhën miq – takova miq etj.], kurse dativi nuk mund të realizohej në funksionet e veta pa prani të këtyre përcaktuesve, kuptohet që forma pa mbaresë e emrit në bashkëvajtje me parafjalë do ta kishte vlerën rasore të kallëzores, prandaj, edhe kur përdorej përcaktori paradigmatic e nyja, do ta kishin formën e kallëzores<sup>35</sup>.

Në këtë kohë pa mbaresa rasore kishte përfunduar pra procesi kur parafjalët ua kishin marrë mbaresave të reduktuara rasore aftësinë e shënimit të funksioneve lokative të emrit dhe e kishin ndihmuar heqjen e tërësishme të fleksionit rasor dezincencjal, d.m.th. edhe të rasave “gramatikore” a “abstrakte” (emërore, dhanore, kallëzore), që ishte lehtësuar shumë nga veprimi i theksit dinamik mbi tingujt fundorë.

---

<sup>35</sup> Shih më detajisht në B. Bokshi, *Rruga...*, botimi i dytë, f. 440-43.

Në këtë system me tri rasa, të realizuar në mënyrën e treguar, dhanorja, që në përdorim adnominal realizonte kuptimet e gjinore, e kishte zotërues kuptimin e afrimit, (sipas teorisë së L. Hjelmlevit për rasat)<sup>36</sup> që ia jepte funksioni i kundrinës dhe përbënte termin intensiv, rasën pivot të këtij sistemi. Kallëzorja ishte e vetmja rasë me të cilën shkonin të gjitha parafjalët e kohës, që do të thotë se i toleronte kuptimet e ndryshme të drejtimit që sillnin parafjalët. Ajo pra i kishte të tri kuptimet e drejtimit, por vinte theks mbi kuptimin neutral të drejtimit, mbi kuptimin e pushimit, duke përbërë termin kontradiktor të këtij sistemi rasor. Emërorja, që me funksionin e kryefjalës shpreh kuptim e largimit si kuptim dominant, përbën termin opozitar ekspansiv ndaj dhanores. Tipi i këtij sistemi rasor, që është ndër më të thjeshtit, (më i thjeshtë është ai me dy rasa) duket kështu:

β Dativ

B Nominativ

Γ Akuzativ

## 6. Perfekti analitik i foljeve jokalmtare

Pas krijimit shumë të hershëm të perfektit analitik të diatezës joveprore të foljeve kalimtare, kaloi një kohë relativisht e gjatë deri sa u krijua forma analitike edhe e foljeve jokalmtare me foljen ndihmëse **jam**, në zëvendësim të trajtës sintetike.

Nga ana tipologjike duket se përftimi e formës së këtij perfektit të foljeve jokalmtare do të ketë shkuar edhe në gjuhën shqipe,

<sup>36</sup> Në *La categorie des cas*, Acta Jutlandica, VII, 1935, IX, 1937.

siç ka shkuar në gjuhët romane. Nisja është te foljet deponente, të cilat, kur kaluan në të tashmen nga forma pësore në formë veprorë, e ruajtën formimin e perfektit siç e kishin më parë, d.m.th. formën analitike pësore me foljen **jam**, si p.sh. *est secutus* etj. Kështu u hap rruga që edhe foljet intransitive ta braktisin formën sintetike të perfektit e të kalojnë në perfektin analitik me foljen *jam*: *est venutus*, *est intratus* etj.

Procesin e zëvendësimit të foljes **jam** me foljen **kam** me këto folje intransitive e kanë kryer tërësisht gjuhët romane iberike (spanjishtja e portugalishtja) dhe rumanishtja, ndërsa frëngjishtja e ka ruajtur në njëzet folje

Përdorimi në një pjesë të Kosovës, të Shkodrës e të Malësisë së Madhe i perfektit ananalitik me foljen **jam** të foljeve jokalimtare, që shënojnë lëvizje apo ndryshim të gjendjes, është identik me foljet në gjuhën frënge. Frëngjishtja e vjetër perfektin e foljeve intransitive e kishte me foljen **jam**. Kjo do të thotë se edhe shqipja e pati perfektin analitik të foljeve jokalimtare me foljen **jam** e se e kishte zëvendësuar më vonë me perfektin me foljen **kam**. Kështu gjendja si në të folmet e shënuara është ruajtje e një gjendjeje në fazën e fundit të zëvendësimit që ka ndodhur në tërë pjesën tjetër të shqipës.

## 7. Perfekti analitik vepror

Edhe perfektin analitik vepror me foljen **kam** është më i lashtë se krijimi i mbiemrit të nyjshëm. Edhe kjo e kryer është përfutur si në të gjitha gjuhët e tjera, prandaj s'është nevoja të shpallën këtu proceset e përfutimit të saj.

Duke pasur parasysh se perfektin analitik vepror në gjuhët

evropiane është disa shekuj më i ri se perfektit analitik pësor, edhe për shqipen duhet menduar një distancë të madhe kohore midis tyre. Kështu duket reale të çmojmë që aktivi, përkundër pasivit që doli i kohës paralatine, të jetë krijuar mjaft kohë para përfuturit të mbiemrit të nyjshëm. Këtë perfekt ne e shohim të kohës rreth shekullit të IV të erës së re, sepse, siç kemi shënuar edhe më parë, perfektit analitik vepron i shqipes është më i hershëm se perfektit i tillë i gjuhëve neolatine, filli i krijimit të të cilit është gjithësesi pas këtij shekulli.

Format apofonike të perfektit sintetik vepron të tipit *vol-a*, *mor-a* etj. u bënë pjesë e paradigmës së aoristit në procesin e krijimit të perfektit analitik vepron.

## 8. Paskajorja

Edhe paskajorja **me** + **pjesore** është përfutur para krijimit të mbiemrit të nyjshëm, d.m.th. shumë kohë para se të krijohej forma foljore perifrastike e *tipit me të ardhun – me të ardhur*. Të dy këto forma foljore janë krijuar nën të njëjtat procese transformuese, por në kohë të ndryshme e me kahje të ndryshme funksionale e kuptimore. Moskalimi i formës së tipit *me të ardhun* në paskajore u pengua nga paskajorja **me** + **forma e pjesores**, që ishte krijuar shumë më herët.

Në bazë të njohurive që kemi deri më sot për ndryshimet dialektologjike të shqipes, lashtësia e formës infinitivale para krijimit të nyjës së përparme të mbiemrit, d.m.th. brenda kohës së huazimeve latine na e bën të padryshimtë vlerësimin që kjo formë foljore ishte e tërë shqipes, ashtu siç është edhe privativi **pa** + **pjesore**. Origjina e parafjalës *me* brenda

kësaj forme duhet të kërkohet në relacion me lashtësinë e treguar të këtij infinitivi, që është e pakontestueshme.

Paskajorja **me** + **pjesore** dhe privativi **pa** + **pjesore** janë përftuar, siç kemi shënuar në vep. e cit., nga një fjali relative ndaj emrit të drejtuar nga parafjalët **me** dhe **pa** si p.sh.: [qetësohet me llambë që ndezun asht (= që asht e ndezun); shqetësohet pa llambë që ndezun asht]. Renditja [ndezun asht] dallohet si renditje e sintagmës adjektivale nga renditja [asht ndezun] si perfekt pasiv. Edhe këtu, si në rastin e përfimit të perfektit aktiv, me fshirjen e lidhorit **që** e të këpujës, pjesorja përfaqëson kallëzuesin e emrit me parafjalë: [qetësohet me llambë ndezun – shqetësohet pa llambë ndezun]. Kjo pjesore, që u përftua nga epitetizimi i pjesores atributive, mund të substantivohej duke e nënkuptuar emrin ndaj të cilit ishte përcaktor predikativ: [me / pa ndezun (= me / pa diçka të ndezun)]. Ky substantivim kontekstual, me të cilin nënkuptohej një emër i pashquar (llambë) ishte i mundur, sepse pjesorja vinte prapa parafjalës, d.m.th. prapa një segmenti të sigurt të sintagmës prepozicionale, prandaj s' mund të mos ishte në funksion të emrit. Nga substantivimi kontekstual pjesorja kaloi në emër veprimi për arsyet e treguara në veprën e cituar: [me / pa ndezun (= me / pa të ndezurit). Kjo sintagmë kaloi në infinitiv nga funksioni i saj si plotës i mjetit.

Në përdorim me kallëzues të foljeve *inkohative transitive* me tipar [+ Atributive] kjo sintagmë e instrumentit kaloi në infinitiv: [nisi me granë = me të ngranët, nisi me punue = me të punuarit etj.]. Këtu shihet se, duke u përftuar infinitivi, u bë transformimi funksional nga *sintagma prepozicionale* në *sintagmë nominale kundrinë e drejtë*. Funksioni kundrinor i infinitivit ishte funksion i tij i parë. Paralelisht infinitivi u krijua edhe në relacion me foljet durative si *vazhdoj, vijoj* etj.: [vazhdoi me punue = me të punuarit, vazhdoi të punuarit etj.]. Infinitivi pastaj mori gradualisht edhe funksionet e tjera që i njihen.

## 9. Krijimi i formave analitike të futurit

Futuri sintetik me **\*-siō**, që nuk ishte i gjuhës së lashtë ie., por që e kishin disa gjuhë, ndër të cilat edhe greqishtja e vjetër, dëshmohej se ishte edhe i gjuhës shqipe në formën e pjesores pësore të futurit me **-shëm** < **\*-siō** – **\*mō** apo **-shëmë** < **\*siō-mā** : [i thyeshëm, e thye-shme etj.]<sup>37</sup>. Ky futur po nxirrej nga përdorimi nga një formë analitike.

Është i pasaktë mendimi i N. Joklit, pranuar nga Kr. Sandfeldi e S. Riza që habitortja p.sh. **qenkam** është përfutuar nga përngjitja e një forme të futurit, që paska qenë sipas tij **qenë kam** me pjesën **qenë** në vlerë të një infinitivi (me qenë), d.m.th. me kuptimin **me qenë kam = kam me qenë**. Për pasaktësinë e këtij vlerësimi jemi shprehur në veprën Pjesorja e shqipes (vështrim diakronik).

Shqipja e fazës së dokumentuar si forma të futurit ka format **do + lidhore e tashme** [do të punoj] dhe [kam për të punuar / për të punue] të përdorshme në të dy dialektet dhe formën **kam + paskajore** [kam me punue], që e ka vetëm gegërishtja. Toskërishtja e ka edhe formën [kam të punoj], të përdorshme sporadikisht. Kuptohet se më të reja e që duhen përjashtuar nga mundësia që të jenë krijuar në këtë kohë të lashtë janë [kam për të gatuar / kam për të gatue] dhe [kam të punoj]. Mbeten të trajtohen dy format: [do të punoj] dhe [kam me punue] (me formën përkatëse të pjesores pësore të së kryerës në atë kohë).

Në futurin [do të punoj] forma e ngurosur **do** e foljes **dua** nuk është përfutuar nga funksioni si folje gjysmëndihmëse modale, sepse këtë funksion nuk e ka pasur e as që e ka forma veprorë e foljes **dua**. Prandaj funksioni gjysmëndihmës modal i formës **do** del të jetë përfutuar nga ndikimi i formës **duhet**.

<sup>37</sup> Shih B. Bokshi, *Pjesorja e shqipes – vështrim diakronik*, f. 22-23.

Forma joveprore **duhet**, si formë e vetës së tretë njëjës e foljes **dua**, është bërë pavetore si në bashkëvajtje me lidhoren (duhet të them), ashtu edhe me paskajoren (duhet me thanë), ndërsa në bashkëvajtje me pjesoren ajo është njëvetore në vetën e tretë njëjës (do thanë). Meqë edhe forma veprare **do** vetëm si vetë e tretë e njëjësit dhe vetëm në bashkëvajtje me pjesoren është në funksion të foljes gjysmëndihmëse modale, del e qartë se e tillë është bërë nën ndikimin e formës pjesore **duhet**. Kallëzuesit modalë [duhet thanë / thënë, duhet la / larë etj.] dhe [do thanë / thënë, do la / larë etj.] janë plotësisht sinonimikë. Në të dy rastet pjesorja e ka ruajtur kuptimin e diatezës pjesore (duhet thënë fjala, do thënë fjala etj.). Si formë veprare folja **do** do ta kishte neutralizuar kuptimin pjesor të pjesores, duke e marrë ajo shënimin e diatezës veprare për tërë këtë kallëzues të përbërë modal: [do thënë fjalën, do larë trupin etj.], ashtu siç ka ndodhur me kallëzuesin [ka thanë / thënë] etj., në të cilin folja ndihmëse shënon kuptimin e diatezës veprare (kam thanë fjalën). Ruajtja e kuptimit pjesor u përcoll pra nga forma **duhet** e së njëjtës folje. Kështu del e kuptueshme se forma veprare **do** e vetës së tretë u fut në një kallëzues me pjesoren vetëm si diatetikusht sinonimike me formën **duhet**, sinonimi që e bëri edhe formën **do** gjysmëndihmëse.

Dihet se në gjuhën shqipe folje modale gjysmëndihmëse ka qenë forma veprare e foljes **mund (muj)** dhe forma pjesore e foljes **dua [duhet]** dhe se **do** e **mundem** janë bërë të tilla nën ndikimin e mëvonshëm të të parave. Pjesorja pjesore e së kryerës u seleksionua vetëm nga folja modale që ishte në formën e diatezës pjesore. Ishte pra forma pjesore e vetës së tretë, në të cilën dilte folja modale **duhet** ajo që e bëri të mundur relacionin me pjesoren për të krijuar një kallëzues modal (duhet larë etj.). Folja **mund**, e cila vetëm si formë veprare kishte arritur funksionin e foljes modale gjysmëndihmëse, nuk doli në relacion me pjesoren vetëm për shkak të formës së tillë diatetike. Edhe këtu shihet se, po të kishte qenë forma e pjesores me vlerë të paskajores së hershme sintetike, siç pretendohet nga disa studiues, përdorimi i saj në bashkëvajtje me foljet gjysmëndihmëse nuk do të varej nga forma e tyre diatetike, por do të përdorej

me të dyja, siç përdoret paskajorja e tipit **me + pjesore**: [duhet me ba, mundin me bam (Buzuku), muj me thanë etj.] dhe nuk do të kufizohej në përdorim vetëm me vetën e tretë.

Në bazë të konstatimit se forma **do** u bë më vonë folje gjysmëndihmëse modale nën ndikimin e formës **duhet**, del besojmë e kuptueshme se forma e futurit **do + lidhore** [do të punoj] etj. është krijuar mjaft kohë pas formës [duhet të punoj etj.]. Ky futur analitik nuk mund të ishte zëvendësuesi i parë i futurit të shënuar sintetik me **\*-siö**.

Krijimi i paskajores **me + forma e pjesores**, që është, siç kemi shënuar, më i lashtë se krijimi i nyjës së përparme, d.m.th. në kohë të huazimeve nga latinishtja, funksion të saj të parë e pati funksionin kundrinor, kështu që lidhja e foljes **kam** me këtë formë të paskajores është lidhje me kundrinën e saj [kam me thanë]. Por në këtë lidhje kundrinore nuk do të dilte kuptimi i kohës së ardhme, sepse **kam** me kundrinë [kam me punue] do të kishte kuptimin [kam të punuarit, kam atë që është punuar, pra kuptimin e një veprimi të kryer, të afërt me [kam punuar]. Kuptimi i qëllimit është kuptim që veprimi do të kryhet, prandaj është kuptim që duhet ta kishte paskajorja për të hyrë në relacion me foljen **kam** për të krijuar kohën e ardhme në gjuhën shqipe. Nga sa kemi shënuar në vep. e cit, shihet se paskajorja **me + forma e pjesores** është bërë fjali qëllimore vetëm duke zënë vendin e SN-së në sintagmën prepozicionale (SP) me parafjalën **për**, p.sh. [shkoi për me punue, këndon për me fitue, përpiqet për me u pasunue etj.].

Kështu më parë ishte krijuar shprehja [kam për me punue = kam për qëllim me punue] si futur paraprijës. Me elipsimin e parafjalës **për** u përftua forma e futurit [kam me punue], ku **me punue** erdhi si fjali e varur qëllimore me prani zero të parafjalës **për**.

Meqenëse paskajorja e tipit [me thanë] ishte e tërë shqipes, siç kanë menduar për arsye të ndryshme edhe disa studiues të shqipes e të çështjeve gjuhësore ballkanike, edhe forma e futurit [kam me punue etj.] do të ketë qenë e tërë shqipes. Më vonë do të krijohet edhe futuri i tipit [do të

shkoj], duke formalizuar kuptimin volitiv ndaj kuptimit necesitativ të formës [kam me punue]. Më parë ky opozicion modal do të jetë shprehur me foljen **dua**: [dua të shkoj, do që të shkosh, ai do që të shkojë] për kuptimin e dëshirës. Dhe pikërisht këto kuptime të ndryshme modale të formave [do të punoj] dhe [kam me punue] i kanë mbajtur të përdorshme të dy këto forma të futurit deri sot në gegërishten. Forma e futurit **kam + forma e paskajores** ka dalë nga përdorimi në dialektin e toskërishtes, kur është hequr nga përdorimi paskajorja **me + forma e pjesores** nën presionin e lidhores e duket edhe me ndikimin e greqishtes. A krijoi toskërishtja një formë të futurit të domosdoshmërisë në kundërvënie me formën **do + lidhore** para se të krijohej forma e re e paskajores e tipit [për të punuar] si dhe forma e së ardhmes [kam për të punuar], që e njeh edhe gegërishtja [kam për me punue]? Kjo formë duket të jetë forma **kam + lidhore** që dëshmohet sot te të folmet e arbëreshëve të Italisë e bile edhe me formë të ngurosur të vetës së tretë të foljes **kam** : [u ka të vinj, ti ka të vish, ka të shpimi etj.] si në të folmen e San Marcanos. Kjo formë ndeshet edhe te disa të folme të Bregdetit të Poshtëm në përdorim të rrallë: [kam të dërgoj, kam të thom, ka të thotë etj.]. Këtu ka rëndësi edhe shembulli i vetëm në Anonimin e Elbasanit [ke të helmonesh]<sup>38</sup>. Këta shembuj tregojnë se kjo formë e futurit necesitativ ishte e përdorshme në dialektin toskë. Mungesë e saj në të folmet gege e bëjnë atë të jetë krijuar në kohë më të vona se format [kam me punue] e [do të punoj], që ishin të tërë shqipes.

## 10. Për pjesëzën *të* të lidhores

Siç jemi shprehur edhe në veprën Pjesorja e shqipes, **të** e lidhores

<sup>38</sup> Shih Sh. Demiraj, vep. e cit., f. 837-38.

nuk ishte lidhëz që jepte kuptimin e qëllimit, siç ka pandehur Sandfeldi. Me origjinën e saj përemërore, ajo ishte indiferente ndaj kuptimeve të trashëguara të lidhore së lashtë dhe u bë lidhëz e funksioneve të kufizuara të fjalive të varura të kësaj mënyre. Dhe vetëm për shkak të neutralitetit të tillë, ajo u bë pjesë e pandashme e mënyrës lidhore, d.m.th. u përdor edhe kur lidhorja dilte në funksione të fjalisë së pavarur a kryesore. Format e futurit **do të punoj**, **kam të punoj** dhe format **duhet të punoj** e **mund të punoj** tregojnë se në këtë kohë lidhorja e kishte përftuar pjesëzën **të** në funksione të fjalisë së varur dhe dilte me të vetëm në këto funksione. Në këto forma lidhorja del në funksion të fjalisë kryefjalore e kundrinore. Në kohë më të vona, duket që nga fillimi i periudhës së shek. XIII-XV, pjesëza **të** do të jetë bërë pjesë e pandashme e lidhore, e përdorshme në të gjitha funksionet e saj. Megjithëkëtë te Buzuku e te Matrënga janë disa raste ku pjesëza **të** ende nuk përdoret, sidomos kur është pjesëza mohuese **mos**.

Për përdorimin e futurit pa pjesëzën **të** të lidhore [do punoj etj.] është i drejtë mendimi i Sh. Demirajt se ky tip është më i ri se tipi [do të punoj etj.] e se “do punoj është përftuar nëpërmjet mënjanimet të pjesëzës **të**, e cila në këtë rast ishte bërë ridondante dhe nuk luante më ndonjë rol gramatikor”<sup>39</sup>.

Pjesëza **të** nuk është e krahasueshme as për nga origjina, as për nga kuptimi me lidhëzën **să** të rumanishtes, e cila që nga latinishtja (si) e kishte kuptimin e kushtores dhe vetëm pas shekullit XVI e humbi përdorimin me dëftoren dhe u bë pjesë e pandashme e lidhore, që domethënë se ishte bërë gradualisht neutrale ndaj kuptimeve të lidhore. Pjesëza **të** nuk është e krahasueshme as me lidhëzën **vă** të greqishtes<sup>40</sup>.

<sup>39</sup> Vep. e cit., f. 877.

<sup>40</sup> Shih për kuptimet e për zëvendësimet e saj në *Istoria limbii rumine*, Grup autorësh, 1978, f. 365-66.

## 11. Krijimi i disa formave foljore supletive

Mendohet se në shumicën e rasteve këto folje, që janë të pakta në gjuhën shqipe, “janë të trashëguara nga një fazë e hershme i.e” dhe se “vetë supletivizmi ... është një dukuri arkaike e trashëguar”<sup>41</sup>. Gjithësej janë nëntë folje të tilla, që dalin me tema të ndryshme në të tashmen e në të kryerën e thjeshtë. E kohës së huazimeve latine është folja **vij** ~ **erdha**, sepse **vij** është marrë nga latinishtja **venio**, ndërsa forma e aoristit **erdha** apo **ardha** konsiderohet formë e trashëguar. Kjo folje do të ketë qenë supletive edhe para se të huazohej nga latinishtja forma e së tashmes, kështu që **venio** mund të jetë huazuar si zëvendësuese e një trajtje tjetër supletive me **erdha** a **ardha**.

Për foljet **bie** ~ **rashë** dhe **bie** ~ **pruna** (**prura**), që dalin si folje supletive të trashëguara, diskutohet prejardhja e formës **bie**. Edhe ne e konsiderojmë të drejtë mendimin se **bie** është formë e prezentit, në të cilën kishin arritur dy folje kuptimesh të ndryshme, për origjinën e të cilave nga gjuha indoevropiane është shprehur G. Meyeri. Duket e vështirë të pranohet mendimi se **bie** në të dy kuptimet **rashë** dhe **prura** të jetë e njëjta folje (Ky mendim është shprehur nga Boppi, Pedersen dhe Çabej)<sup>42</sup>. Kalimi i foljes **bie** nga kuptimi i foljes **rashë** në kuptim edhe të foljes **prura**, apo anasjelltas, nuk duket i mundur të jetë arritur nga zgjerimi kuptimor i kësaj forme, d.m.th. nga begatimi i tillë semantik i kësaj folje për t’u bërë pjesë supletive e dy foljeve. Arsyetimi që ka dhënë E. Çabej se këtë begatim kuprimor e mbështet edhe rasti i foljes **sjell** me dy kuptimet e saj: **bie** dhe **godas** nuk është përkatës, për arsye se begatimi kuptimor i kësaj foljeje me këto dy kuptime është i mundur.

<sup>41</sup> Shih Sh. Demiraj, vep. e cit., f. 781.

<sup>42</sup> Shih Sh. Demiraj, vep. e cit. f. 781.

I kësaj kohe duhet të jetë përftimi i formës së aoristit **hangra** / **hëngra**, në relacion me **ha** të së tashmes, e cila konsiderohet formë e trashëguar. Mendohet se forma e aoristit është përftuar nga bashkimi i dy formave supletive **ha + ngr-**, që del **ngranë** / **ngrënë** te pjesorja, prandaj mendohet se forma **ngra** do të ketë qenë formë e së kryerës së thjeshtë. Si është arritur që forma **ha** e së tashmes dhe forma **ngra** e së kryerës së thjeshtë të bashkohen e të formojnë një formë tërësisht të pazakontë të aoristit, përball formës **ha** të ruajtur si prezent?

## 12. Krijimi i formës së diatezës vetvetore

Perfektin analitik jovepror **jam + pjesore**, që ishte në opozicion diatezor me perfektin sintetik vepror, ishte në të njëjtën kohë në opozicion diatezor edhe me aoristin, që kishte vetëm formë të diatezës veprorë. Me krijimin e perfektit analitik vepror **kam + pjesore** po humbte opozicioni i shënuar i perfektit analitik jovepror me aoristin vepror, sepse tani opozicioni diatezor në të kryerën po realizohej me forma analitike, kështu që aoristi po mbetej jashtë këtij opozicioni – pa formë joveprorë. Forma e joveprores së aoristit ishte tani e pamundur të përfitohej me mbaresa. Ne mendojmë se në këtë kohë do të jetë gramatikalizuar perifraza me përemrin vetvetor *\*s<sub>u</sub>em* në funksion kundrinor që përfaqësonte të njëjtin person që ishte edhe subjekt i veprimit, d.m.th. se do të jetë krijuar forma e diatezës vetvetore me pjesëzën **u** (< vë (pa theks) < vé < *\*s<sub>u</sub>ém*) në formën përkatëse dhe është bërë gradualisht edhe shprehëse e kuptimit të diatezës pësore. Formimi i tillë i vetvetores nuk është realizuar vetëm për aoristin, por për të gjitha kohët, sepse perifraza e shënuar me përemrin vetvetor nuk mund të ishte gramatikalizuar

vetëm për një kohë foljore, por do të ishte gjithpërfshirëse, duke kaluar në formë të diatezës vetvetore për të gjitha kohët që kishte shqipja atëherë (Shih vep. e cit, f. 97-105).

Janë disa kohë e mënyra që e kanë pasur vetëm formën joveprore me burim nga vetvetorja me pjesëzën **u**. Të tilla janë: e kryera e thjeshtë (u lava ), e tashmja e dëshirores (u lafsha), e tashmja dhe e pakryera e habitores (u lakam, u lakështa), urdhërorja (lahu, mos u laj)dhe format e pashtjelluara (me u pajtue, për t' u pajtuar, duke u pajtuar, me t'u pajtuar). Në kohët që formën e pësore e formojnë me foljen ndimëse **jam** dalin edhe format e vetvetores në disa të folme si p.sh. [u ka ba / bërë, u kisha ba/ bërë, u patnë bamun, u patën pajtu, u patën idhnu, m' u ka prishë, t' u ka smu etj.], të cilat dëshmojnë se format e vetvetores te këto kohë e mënyra ishin të pranishme krahas formave të pësore. Kështu është gjendja edhe me formën e së pakryerës së dëftores (u lajshta – laheshta etj.). E vetmja formë sintetike që nuk e formoi joveproren me **u** në tërë shqipen është forma e kohës së tashme të dëftores, që do të thotë edhe e lidhores dhe e së ardhmes me **do**.

Arsyet pse në kohët e mënyrët e shënuara, që i kanë pasur format e pësore e të vetvetores, është përgjithësuar forma e pësore edhe në kuptim të vetvetores, ndërsa në kohët dhe mënyrët, që e kishin vetëm formën e vetvetores, kjo është përgjithësuar edhe për kuptimin e pësore, janë dhënë në veprën *Pjesorja e shqipes – vlshttrim diakronik*.

### 13. Gjendja e përemrave vetorë

Në këtë kohë, kur kishte përfunduar procesi i kalimit të zanoreve të tipit ie. në zanore që ka shqipja, trajtat e vetorëve ishin:

Nga nominativi **\*nōs** u përftua forma **na**, ndërsa nga akuzativi **\*nōs** u përftua forma **ne**, e cila e trashëgoi funksionimin edhe për dhanore.

Forma e kallëzores së vetës së dytë shumë **\*vōs**, që ishte bërë formë edhe e dhanores paralelisht me formën **\*nōs**, ka përfunduar në këtë kohë në formën **\*vé** me të njëjtat vlera rasore. Kjo është zëvendësuar shpejt nga forma e emërores **ju**. Ky zëvendësim dhe funksionalizim i emërores edhe për dhanore e kallëzore është bërë para se ta merrte mbaresën **-ve** të dhanores nga emrat (ju-ve). Ky sinkretizëm i plotë rasor është pra i kohës kur ende nuk ishin krijuar mbaresat rasore në tërë sistemin emëror e përemëror e kur në kategorinë e përemrave dëftorë e vetorë ishin ruajtur forma të emërores, dhanores e kallëzores me variacion teme a me tema të ndryshme.

Forma e vetës së parë njëjës në emërore tani do të ketë qenë **u**, përftuar nga forma e shënuar **\*ezu**, siç e ka menduar M. La Piana, ndërsa forma e kallëzores do të ketë qenë **me**, përftuar nga **\*më** e theksuar. Në rasën dhanore do të jetë përftuar forma **\*mon** nga **\*mēni**. Përemri i vetës së dytë tani do të ketë qenë **ti**, përftuar nga **\*tū**, ndërsa forma e dhanores do të ketë qenë **\*tui** dhe e kallëzores **te**, përftuar nga **\*të** e theksuar.

Mund të konstatohet se gjendja e trajtave të patheksuara ka qenë:

Veta e parë njëjës për dhanore e kallëzore **më** u përftua nga dhanorja **\*mōi** dhe nga kallëzorja **\*më**. Veta e dytë njëjës për dhanore e kallëzore **të** u përftua nga dhanorja **\*tōi** dhe nga kallëzorja **\*të**. Nga forma e vetës së parë shumë për dhanore e kallëzore **\*nōs** do të jetë përftuar **\*në**, që u zëvendësua më vonë nga **na**. Nga forma e vetës së dytë shumë për dhanore e kallëzore do të jetë përftuar në këtë kohë forma **\*vë** që do të kalojë në **u** e që do të zëvendësohet nga forma **ju**.

## 14. Krijimi i parafjalës + një shqese *ëntë*

Në grupin nominal pa mbiemër nyja shqese prepozitive e emrit në rasën kallëzore ra në kontakt me parafjalën **ën** dhe u glutinua me të:

ën të pus → ëntë pus.

Kjo përngjitje e nyjës u bë vetëm me parafjalën **ën** për shkak të masës minimale të saj. SP e tillë e sillte emrin:

1. me kuptim konkret:

a) i njohur: [ëntë pus]

b) i panjohur: [ën një pus]

2. me kuptim abstrakt: [ën pus].

Kjo parafjalë u bë komutative, sepse doli me përbërje të ndryshme: **ën** e **ëntë** për kuptimet e ndryshme të konkretizimit që i nevojiteshin emrit.

Kjo formë e parafjalës-nyjë në fazën vijuese qëndroi para emrit edhe kur përdorej mbiemri para tij dhe u bë formë e nyjës së rasës kallëzore: **en të thellë entë pus** etj. duke e nxjerë nga përdorimi formën origjinale të nyjës në kallëzore njëjës të emrave të gjinisë mashkullore e femërore (të) për arsyet e shënuara në veprën Rruga....

Kjo lidhje e parafjalës-nyjë me trajtën e pashquar të emrit me kuptim të konkretizuar do të përcillet edhe te disa parafjalë të tjera të kallëzores. Se si e ndërroi parafjala **en** reksionin duke u bërë parafjalë e rasës rrjedhore është sqaruar në veprat Rruga... dhe *Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike* e do të shënohet edhe në vendin përkatës të këtij punimi.

## 15. Format e përemrit vetvetor e identifikues–përcaktues

Që nga Fr. Boppi është konstatuar se nga përemri vetvetor i gjuhës ie. \*suōm (\*suēm), pasi u thleksua, është përftuar forma **vé**, që nuk është ruajtur si vevtveter, por që dëshmohet në përbërje të përemrit përforcues – identifikues **vé-të**. Këtë formë të përemrit identifikues Boppi me të drejtë e pa të përftuar nga funksioni përforcues identifikues i vetvetorit **vé** ndaj vetor-dëftorit në rasën kallëzore (a)të: **vé (a)të = vetë atë**, ku u bë bashkëngjitja dhe humbja e theksit të elementit të dytë **-të** që buronte edhe nga format e kallëzores së vetor-dëftorit në shumës (a)ta, (a)to (ta > të, to > të)<sup>43</sup>. Kështu **-të**-ja u transformua nga përemri në prapshitesë formuese të përemrit identifikues **vétë**. Boppi, ndërkaq, nuk flet se si përemri vevetor **vé** e mori funksionin e përemrit përcaktues e identifikues.

Ne mendojmë se ky transformim do të jetë bërë nga përdorimi i vetvetorit në frazën që e ka fjalinë kryesore me folje të dialektës veprorë dhe fjalinë e varur – fjali kundrinore dhe përcaktore, d.m.th. në frazat e tipi: [Ai e pa **vé** se kishte mbaruar = 1. Ai e pa veten se kishte mbaruar dhe 2. Ai e pa vetë se kishte mbaruar]. Trajtimi i fjalisë së varur si fali lidhore përcaktuese apo si fjali kundrinore varej nga prania a mosprania e kundrinës së drejtë në fjalinë kryesore. Kështu përdorimi si vetvetor përbënte kundrinën e drejtë dhe fjalia [... se kishte mbaruar] mund të ishte vetëm fjali lidhore përcaktuese: [Ai e pa **vé** (*veten*) të mbaruar]. Por në funksionimin e kësaj fjalie të varur si fjali kundrinore, përdorimi i gjymtyrës **vé** në fjalinë kryesore nuk mund të ishte më në funksion të kundrinës e rrjedhimisht as në funksion të vetvetorit. Bifunksionaliteti i kësaj fjalie të varur në frazën [Ai e pa **vé** se kishte mbaruar] bëri që

<sup>43</sup> Shih Sh. Demiraj, vep. e cit., f. 462.

gjymtyra **vé** të trajtohej si kundrinë, d.m.th. si vetvetor dhe si jo-kundrinë, d.m.th. si ndajshtim i kryefjalës së fjalisë kryesore, d.m.th. si përemër përcaktues. Meqenëse **vé** u bë kështu edhe përemër përcaktues-identifikues me krijimin e formës **vé-të** në mënyrën e treguar, ai mund të ishte tani përforcues jo i përemrit në kallëzore me të cilin u përngjit, po i përemrit në emërore (i kryefjalës): [Ai e pa vetë atë = Ai vetë e pa atë].

Përemri identifikues është bërë emër i pashquar me vlerë të shumësit, me opozicion gjinie e me kuptimin “persona”, “njerëz”, i përdorshëm gjithnjë në bashkëvajtje me numërorë themelorë: [Erdhën dy vetë / veta (femra), pashë 1 tre vetë / tri veta etj.] Në toskërishten gjinia është neutralizuar, kështu që përdoret vetëm forma origjinalisht femërore për të dy gjinitë: [dy veta, dy vetave, dy vetash etj.]. Kjo vlerë morfologjike-kategoriale është përftuar nga shprehjet e tipit: [Erdhën vetë pa u ftuar → Erdhën dy vetë pa u ftuar]. Pas këtij transformimi u krijua edhe forma femërore *veta*. Nga rrjedhorja e këtij funksioni emëror **vetësh** u përftua ndajfolja **veç** (vetësh > vetsh > veç), e ndarë nga bashkëvajtja me numërorin, e përftuar duket nga shprehjet si [u nda vetësh (= prej vetësh, prej njerëzve të tjerë)] e prej këndeje u bë lidhëz. Kuptohet se kjo ndajfolje u përftua shumë më vonë, mbasi janë krijuar mbaresat rasore.

Ky përemër identifikues e përcaktues është bërë edhe ndajfolje e mënyrës **vetëm**. Në ndonjë të folme të toskërishtes e të gegërishtes kjo ndajfolje është pa prapashtesën **-m**: **vetë** (mbeti vetë pa njeri, rri vetë pa askënd etj.). Kjo vlerë ndajfoljore është përftuar nga përdorimi i përemrit identifikues në fjalitë me kallëzues që lejojnë plotësin e mënyrës: [ai mbeti **vetë** pa njeri = ai mbeti vetëm pa njeri, ai rri **vetë** pa askënd = ai rri **vetëm** pa askënd etj.]. Kuptohet se forma **vetë**, që si ndajfolje mënyre ka mbetur në përdorim të kufizuar dialektor, është më e moçme se forma me prapashtesën **-m**, sepse kjo prapashtesë është e mbiemrave të nyjshëm të krijuar nga ndajfoljet: [i vetë-m, e vetë-m-e] si [i afër-m, e afër-m-e, i jash-

të-m, e jashtë-m-e etj.] pas kësaj periudhe. Por, ndërsa ndajfoljet, që formojnë mbiemra të tillë të nyjshëm janë pa prapashtesën mbiemërore **-m** (afër, jashtë etj.), te mbiemri **i vetëm** ndajfoja doli tani me mbaresën **-m: vetëm** dhe formimi i këtij mbiemri kaloi në kategorinë e mbiemrave që përftoheshin drejtpërdrejt nga ndajfoja. Kështu mbiemri **i vetëm**, duke u formuar tani nga ndajfolja **vetëm**, e la formën **vetë** si ndajfolje në përdorim të rralluar dialektor.

Pas kalimit në këtë formë ndajfolja **vetëm** kaloi nga funksioni ndajfoljor në funksion të pjesëzës: [**vetëm** ai e di; Doli **vetëm** në këmishë etj.].

Përemri pronor vetvetor [**i / e vet: i veti, e vetja, të vetët, të vetat**] është përfutur nga përemri identifikues në përdorim përfutur ndaj emrit dhe përemrit vetor-dëftor në rasën gjinore [**i vetë** atij djali, **e vetë** asaj vajze; **i vetë** djalit / vajzës; **i vetë** burrave / grave etj.]. Përemri **vetë**, duke qenë në funksion ndajshpirti ndaj emrit përkatës, përfaqëson të njëjtën vetë që shënonte emri, d.m.th. vetën e tretë. Shihet se forma [**i vet(ë), e vet(ë)** etj.] nuk e përfuttoi vlerën e pronorit nëpërmjet formës së gjinore, të cilën nuk e kishte, por nga ndërtimet e shënuara: [Djali **i vetë** atij / asaj / atyre], kështu që, kur përdorej **vetëm**, nyjën e përparme e kishte një të gjinore së vetorëve, e cila i mban të vetëkuptueshme dhanoret [tij, saj, tyre: atij / asaj, / atyre], apo dhanoren e emrit. Nga kjo një atij i del kuptimi i përkatësisë a i pronësisë: [djali **i vet(ë)**, fatin **e vet(ë)** etj.]. Me këtë kuptim ai u bë përemër pronor vetvetor: [**i veti, e vetja, të vetët, të vetat**]. Shihet se ky përemër pronor vetvetor është krijuar pas përfutimit të njëjës së përparme të gjinore, që domethënë se nuk është krijuar brenda kësaj periudhe.

Mendimi se vetvetori i shqipes ka qenë gjithëvetor si në gjuhët sllave nuk është argumentuar. Edhe në gjuhën e lashtë ie. përemri **\*sye-**, që shërbente si vetvetor, ishte i vetës së tretë. Neve na duket se pronori vetvetor **i, e vet** etj., që përdoret **vetëm** për vetën e tretë [**i tij, i saj, i tyre**], flet se vetvetori i shqipes, që është në

përbërje të këtij pronori, nuk përdorej për dy vetat e para dhe se me këtë përdorim shqipja shkonte në një vijë me latinishten, me gjuhët romane e me greqishten e vjetër.

I kësaj kohe do të jetë edhe përfitim i pjesëzës së diatezës vetvetore. Është pranuar me të drejtë mendimi i Fr. Boppit se pas përfimit të trajtës *vé* nga *\*suōm* (*\*suēm*), *ve* e parheksuar kaloi në *vë* e prej saj u përftua forma *u*, e cila vijoi funksionojë si pjesëz e diatezës vetvetore. Kuptohet se kjo pjesëz është përftuar nga funksioni i saj kundrinor dhe duket e arsyeshme të besohet se kalimi *vë* > *u* do të jetë bërë afërsisht kur u përftua forma *u* e nyjës shquese postpozitive në pocetin e përcaktuar nga S. Riza: [ka-v-i > kav > kau], domethënë pas kohës që po e shënojmë.

Edhe pjesëza *vë* (*u*) do të ketë shënuar fillimisht vetëm vetën e tretë. Kalimi në përdorim edhe me dy vetat e para do të ketë qenë një proces i shkatuar, siç është konstatuar për disa dialekte veriore të italishtes, nga frekuenca e madhe e vetës së tretë si term i pamarkuar. Aglutinimi i pjesëzës *u* me formën foljore të urdhërores tregon se përdorimi edhe me vetat e para është relativisht i lashtë, i kohës kur trejtat e patheksuara të vetorëve ishin vetëm enklitike ndaj urdhërores pohuese dhe ndaj pjesëzës *mos* etj., d.m.th. para shek.VIII, kur nuk ishte krijuar renditja progresive Emër – Mbi-emër. Kështu duhet menduar se *u*-ja (a *vë*-ja), e cila si e patheksuar nuk mund të funksiononte si përemër vetvetor, por vetëm si pjesëz e formës vetvetore të vetës së tretë të foljeve, i zëvendësoi gradualisht trajtat e patheksuara të vetorëve në rasën kallëzore në këtë funksion, d.m.th. u përdor edhe për dy vetat e para (kujto: lat. *lavo* me, *lavas* te, *lavat* se; it. *mi* *lavo*, *ti* *lavi*,; si *lava*; fr. *je* më *lavë*, *tu* te *lave*, *il* se *lave* etj.).

Në vend të formës burimore *vé* të vetvetorit, që nuk u ruajt, shqipja krijoi formën emërore *vetë* – *vetja* (*vehte* – *vehtja*, *vetëhe* – *vetëheja*), që është vetëm në njëjës e që merr mbaresat rasore të emrave të lakimit të tretë. Në funksion të vetvetorit është edhe

forma emërore **vetvete** – **vetvetja**, që ka të njëjtat karakteristika morfologjike si **vete** – **vetja**. Shihet se kjo formë është përftuar nga përngjitja e përemrit përforcues-identifikues **vetë** me formën **vetevetja** si vetvetor. Përngjitja do të jetë bërë në shprehjet e tipit [mund ta shpëtojmë vetë veten etj. : ne vetë mund ta shpëtojmë veten]. Në shembuj të tillë shihet se **vetë** është përforcues i vetorit në rasën emërore (ne) dhe vetvetori i ri është në rasën kallëzore. Formim të tillë të vetvetorit ka krijuar edhe greqishtja e vjetër.

Është çmuar se forma emërore **vehthe** - **vehtja** e prej saj **vete** - **vetja**, rrjedh nga një formë më e vjetër **vetëhe** – **vetëheja**, pas metatezës së tingullit **-h-**. Kjo formë përdoret te autorët e vjetër. Kjo mendohet të jetë përftuar nga përemri identifikues **vetë**, të cilit i është shtuar **-he**, që Fr. Boppi e Dh. Kamarda e kanë konsideruar të prejardhur nga vetvetori **vé**<sup>44</sup>. Ata nuk e sqaruan se si u bë kalimi **-he > ve**.

## Shënim:

Ndryshimi i tingujve fundorë të temave emërore nga theksi dinamik, humbja e mbaresave rasore dhe ndryshimi fonetik i mbaresave të lashta të shumësit po nga ndikimi i theksit dinamik janë procese të filluara para kësaj periudhe e të përfunduara në prag të kontaktit me latinishten. I kësaj kohe është përftimi i mbaresës së gjinisë femërore **-ë** te mbiemrat dhe prapashtesë e seksit femëror te emrat e gjallesave. Krijim i parë mbrenda kësaj periudhe është nyja shquese, siç e tregojnë emrat e ditëve të javës. Pastaj janë krijuar në

<sup>44</sup> Shih Sh. Demiraj, vep. e cit. f. 462.

vijimësi perfekt i foljeve jokalimtare e perfekt i analitik aktiv bashkë me infinitivin me + pjesore, diateza vetvetore dhe futuri analitik etj. Në përputhje me strukturën analitike është bërë e detyrueshme renditja regressive Mbiemër – Emër, Emër përcaktues – Emër i përcaktuar, Subjekt – Verb - Objekt etj.

Format e të kryerave analitike veprorë e të foljeve jokalimtare dhe paskajorja me + pjesore, janë përfutur brenda së njëjtës kohë, d.m.th. para se të krijohej mbiemri i nyjshëm.

Kjo gjendje përbën një tërësi sistemore të protoshqipes së vonë, që është shumë e ndryshme nga gjuhët përreth dhe e afron përnjës strukturë analitike me persishten perëndimore. Ky dallim i madh strukturor me greqishten dhe latinishten tregon se u zhvillua pa ndonjë ndikim të jashtëm dhe se protoshqipja, edhe në këtë kohë të huazimeve të shumta nga latinishtja, e ruajti zhvillimin e pavarur të strukturës së saj morfosintaksore e fonetike.

## II. PERIUDHA E SHEKIJVE VI-VIII

### 1. Gjendja e zanoreve

Në mbarim të kohës së huazimeve nga latinishtja kishte përfunduar përfitim i zanoreve që ka shqipja sot.

Studiuesit e çështjeve të fonetikës historikë të shqipes na thonë se ndërrimi  $\bar{e} > o$  në gjuhën shqipe “duhet të jetë më i hërshën edhe se kontaktet e “nënës” së shqipes me greqishten e vjetër” (Demiraj). “Ky ndryshim është prehistorik, sepse nuk vepronte më në kohën e marrëdhënieve të shqipes me greqishten e vjetër” (Topalli). Ndërrimi  $\bar{e} > o$  është vetëm i shqipes, sepse, siç shihet nga prezentimi i A. Meillet, nuk është zhvilluar në asnjë gjuhë ie. Kalimi  $\bar{a} > o$  ka kapluar huazimet lashtogreke, por jo edhe latine, prandaj është ndërrim pararomak (Çabej e Demiraj). Huazimet latine iu nënshtruan ndryshimit  $\bar{o} > e$ . Nga seria e zanoreve të shkurtra  $\bar{a}$ -ja e greqishtes dhe e latinishtes mbetet **a** në gjuhën shqipe, siç mbetet edhe  $\bar{a}$ -ja e fjalëve të fondit ie. Në huazimet latine në **a** ka përfunduar edhe  $\bar{a}$ -ja. Ndërrimi  $\bar{o} > a$  “nuk është vërtetuar në huazimet nga greqishtja e vjetër dhe nga latinishtja; gjë që e bën “të jetë shfaqur para kontaktit të gjuhës “nënës” të shqipes me gjuhët e lartpërmendura” (Demiraj). Zanorja  $\bar{o}$  “u shndërrua në periudhën parahistorike në **a**. Ky shndërrim “ka prekur edhe gjuhët gjermanike e baltosllave etj.; si rrjedhim, kemi një ndryshim të përbashkët të këtyre gjuhëve, që gjeografikisht kanë qenë pranë njëra-tjetrës në periudhën parahistorike” (Topalli).

Ndërsa kalimin  $\bar{o} > a$ , siç u tha, është ndryshim tepër i

lashtë, kur protoshqipja kishte një afërsi tepër intime me gjermanikishten e baltishten, ndryshimi  $\bar{e} > o$ , si ndryshim vetëm i shqipes, tregon se u krijua kur shqipja ishte larguar nga gjuhët gjermaniko-baltike. A. Meillet shënon se “mosdallimi i  $\bar{a}$ -së dhe i  $\bar{o}$ -së në një pjesë të madhe të gjuhëve tregon se  $\bar{o}$  e indoevropianishtes ishte shumë e hapur”<sup>45</sup>. Ky tipar bëri që  $\bar{o}$  të kalonte mjaft herët në **a** në ato gjuhë. Ai shënon edhe se gjuhët që e kanë barazuar  $\bar{o}$ -në me  $\bar{a}$ , duke kaluar në **a** apo në **o** (sllavishtja) e kanë barazuar edhe  $\bar{o}$ -në me  $\bar{a}$  si **o** në gjermaniken e lituanishten, ndërsa si **a** në sllavishten. Edhe shqipja e ka bërë ndërrimin  $\bar{a} > o$ , por në Ballkan, në kohën e kontaktit të saj me greqishten e vjetër, kështu që ky ndryshim i njëjtë me gjermaniken e baltishten në gjuhën shqipe është i pavarur nga këto gjuhë.

Sipas kësaj shihet se protoshqipja kishte rënë në kontakt me greqishten e vjetër mbasi e kishte kryer ndërrimin  $\bar{e} > o$  dhe ndërrimin  $\bar{o} > a$ , pra kur nuk kishte më **e** të gjatë dhe **o** të shkurtër, kështu që  $\bar{e}$  dhe  $\bar{o}$  të kësaj gjuhe do të shqiptoheshin si **e** dhe si **o**. Atëherë shqipja e kishte ende të pandryshuar **a**-në e gjatë, të cilën në kohën e huazimeve nga greqishtja e vjetër po e kalonte në **o** ( $\bar{a} > o$ ) ende pa rënë në kontakt me latinishten. Kjo është arsyeja që në huazimet nga latinishtja  $\bar{a}$  do të shqiptohet si **a** ashtu si dhe **a**-ja që buroi nga **a**-ja dhe **o**-ja e shkurtër. Në kohën e huazimeve nga latinishtja shqipja e kishte ende **o**-në e gjatë, e cila do të kalojë në **e** ( $\bar{o} > e$ ). Ky ndryshim do të duhej të përmblihte edhe fjalë të huazuara nga greqishtja e vjetër në të njëjtën kohë. Por shembuj të tillë nga greqishtja nuk kemi, që do të thotë se shqipja nuk ka dëshmi të huazimit të fjalëve me  $\bar{o}$  nga kjo gjuhë. Me sa di, kjo çështje ka mbetur e patrajtuar.

Çfarë sistemi i zanoreve në gjuhën shqipe ishte ky i kohës së huazimeve latine? Ishte një **a** e përftuar nga  $\bar{a}$  dhe nga  $\bar{o}$ , një **o** e përftuar më parë nga  $\bar{e}$  e pastaj nga  $\bar{a}$ , që mori edhe huazimet nga greqishtja e vjetër, kishte edhe një **e** (dhe *je*) dhe, përkundër këtyre, kishte edhe një zanore ende me gjatësi të tipit indoevropian, zanoren  $\bar{o}$  që e karaktere-

<sup>45</sup> *Uvod u uporedno proučavanje indoevropskih jezika*, Beograd, 1965, f. 54.

rizonte një shqiptim tepër i përparshëm që do ta transformojë në zanoren e, e cila do ta përfshijë edhe **ō**-në e latinishtes.

Kalimi në kohë të ndryshme i zanoreve të dy serive në zanore që ka shqipja është i papritur e, do të thoshim, i paspjegueshëm. Do të pritej që procesi i kalimit të **ō**-së në **a** të shënonte fillimin e procesit që po e transformonte sistemin me dy seri të zanoreve në një sistem të vetëm me një seri. Ky transformim kishte të bënte me likuidimin e gjatësive të tonit e të rrjedhojave të tyre si zanore më të përparme e më të prapme, më të hapura a më të mbyllura etj., që do të realizohej vetëm nën trysinë e theksit. Kështu asnjë ndryshim i zanoreve të dy serive në zanore të sotme nuk do të mund të ishte kryer para krijimit të theksit dinamik. Të qëndruarit në një kohë të njëjtë të zanoreve që shënonin përfundimin e procesit të anulimit të gjatësive të tonit bashkë me zanore ende të pandryhuara me karakteristikat e zanoreve të gjata e të shkurtra të kohës së tonit përbën diçka të papritur dhe të pakuptueshme për funksionimin e sistemit të zanoreve. Për këtë Dh. Kamarda, cituar edhe nga K. Topalli, ka dhënë këtë arsytim: “ndryshimet e zanoreve nuk mund të përmbli-dhen të gjitha në disa rregulla, dhe, ashtu sikurse ndodh edhe në gjuhët klasike, ka ndryshime që nuk u binden rregullave të përgjithshme”<sup>46</sup>.

Për ndryshimin e hershëm të zanoreve në latinishtë është flakur si i paqëndrueshëm mendimi se atë e ka shkaktuar prania e një theksi nistor i intensitetit, që në prehistori të kësaj gjuhe, që do të thotë se do t’i ishte mbishtuar tonit, të trashëguar nga gjuha ie. Zotëron mendimi se ndryshimet e hershme në sistemin e zanoreve në latinishten i ka shkaktuar “një fenomen më i përgjithshëm: dinamika e fjalës që është pak a shumë e dukshme në të gjitha gjuhët, por që gjuhët italike e ilustrjnë në mënyrë të dallueshme”<sup>47</sup>. Por ndërrimi i zanoreve nga rrethanat prozodike në gjuhën latine është i ndryshëm nga ndërrimi i zanoreve të gjuhës së lashtë ie. në gjuhën shqipe. Kalimi në latinishtë i një zanoreje në një zanore tjetër, sidomos të zanoreve të shkurtra, në këtë kohë të lashtë është bërë

<sup>46</sup> Topalli. *Shndërrime historike në sistemin zanor të gjuhës shqipe*, Tiranë, 2000, f. 56.

<sup>47</sup> P. Monteil, *Éléments de phonétique et de morphologie du latin*, Nathan, 1986, f. 91.

duke u ruajtur gjatësia e tonit. Kështu është bërë kalimi  $\text{ë} > \text{ö}$ ,  $\text{ë} > \text{ĩ}$ ,  $\text{ö} > \text{ũ}$ ,  $\text{ĩ} > \text{ě}$ ,  $\text{ö} > \text{ě}$ ,  $\text{ũ} > \text{õ}$ ,  $\text{ă} > \text{ĩ}$ ,  $\text{ă} > \text{ě}$  etj. Ndryshime të zanoreve nga rrethanat e shënuara janë përfutur edhe në gjuhën shqipe. Të tilla janë ndryshimet  $\text{ũ} > \text{i}$ ,  $\text{y}$ ;  $\text{ě} > \text{e}$ , **je**, **ja**. Nga këto rrethana mund të sqarohen edhe reflekset e ndryshme të sonanteve i.e. në gjuhën shqipe: [r > ir, ri, ur, r e gjatë ar ; l > il, li, l e gjatë > al, ul ; n > e, un, a].

Meqë ndërrimi i zanoreve i.e. në zanore të gjuhës shqipe nuk e ka përfshirë tërë sistemin në një kohë, por është realizuar pjesë-pjesë në kohë të ndryshme edhe para krijimit të theksit dinamik, për ndryshimet  $\text{õ} > \text{a}$  dhe  $\text{ē} > \text{o}$  mund të mendohet një bazë prozodike e kontekstuale e përfutimit. Kjo punë, natyrisht, është e vështirë, sepse shqipja e ka aq të vonë dokumentimin shkrimor dhe i ka aq të paktë shembujt e fjalëve që i dëshmojnë këto ndryshime.

Në këtë fazë të ndryshimeve morfologjike të kohës së përfundimit të huazimeve latine do të kemi parasysh këto zanore që shqipja i ka edhe sot. Zanozja  $\text{ē}$  është krijuar, siç u pa, që në kontaktet e para me latinishten. Në procesin e kalimit nga sistemi i zanoreve me dy seri të gjatësisë së tonit në një system të vetëm pa këto dallime as zanozja  $\text{ũ}$  nuk mund të ishte pjesë e sistemit të ri, kështu që ajo në këtë kohë është transformuar në y e jo më vonë. Sistemi i plotë i zanoreve që ka shqipja sot daton pra që nga kjo kohë.

Duhet menduar, prandaj, se format e përemrave vetorë e dëftorë, format e foljeve etj. kishin arritur të jenë me zanore të shqipes së sotme që nga kjo kohë.

Është pranuar se evolucioni i tri serive të guturaleve i.e. në gjuhën shqipe ka përfunduar para kontaktit të protoshqipes me greqishten e vjetër dhe se po në këtë kohë ishin çaspiruar okluzivet e tilla.

## 2. Krijimi i nyjës së përparme

Nyja shquese ishte pjesë e inventarit të segmentit që e përbënin përcakruesit përemërorë dhe nyja joshquese **një** (në formën përkatëse të kohës):

| A    | M      | E   |
|------|--------|-----|
| i    | thellë | pus |
| (a)i | thellë | pus |
| një  | thellë | pus |

Kur mungonte mbiemri (M), nyja qëndronte para emrit ashtu si dhe përcaktorët e tjerë:

| A    | M | E   |
|------|---|-----|
| i    | # | pus |
| (a)i | # | pus |
| një  | # | pus |

Kur nuk përdorej emri, fjalët e tipit **bujar, fisnik** etj., që ishin bikategoriale mbiemër-emër, funksiononin si emra, d.m.th. zinin vendin e emrit, meqë në funksion të mbiemrit mund të dilnin vetëm në prani të emrit (të fjalës që ishte vetëm emërore):

| A    | M      | E     |
|------|--------|-------|
| i    | fisnik | djalë |
| (a)i | bujar  | djalë |
| një  | trim   | djalë |

dhe

|      |   |        |
|------|---|--------|
| A    | M | E      |
| i    | # | fisnik |
| (a)i | # | bujar  |
| një  | # | trim   |

Me fjalët e tipit **thellë, thënë** etj., që ishin bikategoriale mbiemër – ndajfolje, mbiemër - pjesore (e re), vetëm nyja shquese e mbante të katalizueshëm emrin, kështu që ai ishte i pranishëm me shkallë zero të ekspresionit dhe këto fjalë e zinin edhe tani vendin e mbiemrit:


|   |        |                |
|---|--------|----------------|
| A | M      | E              |
| i | thellë | ∅ (= i thelli) |
| e | thënë  | ∅ (e thëna).   |

Nyja shquese nuk mund të kishte përdorim tjetër përveç përdorimit si segment A i grupit nominal. Duke qëndruar prapa nyjës, fjala e tipit **thënë, lënë** etj. përdorej prapa një segmenti të sigurt të grupit nominal, prandaj mund ta kishte vetëm vlerën e mbiemrit e jo të ndajfoljes a të pjesores. Pjesa tjetër e inventarit të segmentit A (nyja joshquese, përemri dëftor etj.) e realizonte segmentin A vetëm me prani të gjymtyrës nominale (M–E) apo të emrit (E). Pa praninë e emrit ajo e prezantonte tërë grupin nominal si numëror (nyja joshquese), p.sh. [erdhi një etj.], apo si përemër, p.sh.[erdhi (a)i etj.]. Kështu fjalët e tilla (thellë, thënë etj. ), meqë ishin edhe ndajfolje apo pjesore e re, prapa fjalëve të tilla përcaktuese nuk mund të ishin segmente të grupit nominal, d.m.th. nuk mund të ishin në funksion të mbiemrit. Kjo do të thotë se shprehjet si [(a)i thellë, një (< njan) thellë] dhe [(aj)o gjanë, një gjanë] nuk ekzistonin.


Duke kaluar nga [i thellë pus] në [i thellë ∅], nyja kalonte nga fusha opozicionale me inventarin tjetër të segmentit A në fushën pa opozicion me nyjën joshquese e me nyjën zero, meqë këtu ishte e vetme në përdorim. Kështu në [i thellë ∅] nyja shquese edhe e ekspozonte fjalën pasuese si mbiemër, edhe e shprehte kuptimin e

shquar të emrit të nënkuptuar, ndërsa në [i thellë pus] nyja ishte vetëm në funksionin e saj shques, sepse fjalën pasuese e bënte mbiemërore prania e emrit. Nyja këtu ishte në opozicion me njënjën jo-shquese **një** dhe me njënjën **zero**: [një thellë pus] dhe [thellë pus] (= pus i thellë). Duke lëvizur nga funksioni shques në funksionin e mbiemërorizimit të fjalëve bikategoriale të tipit të shënuar (thellë, gjanë etj.), nyja e humbi gradualisht fuqinë shquese. Këtë proces e ndihmoi edhe fakti se emri vinte në të dy rastet në formë të pasquar: [i thellë pus] dhe [i thellë ø], ndërsa kur nuk përdorej mbiemri njënjë e kishte përpara [i pus].


Ky proces shkaktoi që grupi nominal të kalojë në gjymtyrë nominale:



Meqë ky mbiemër e mori në përbërje të tij vetëm njënjën nga segmenti A, inventari tjetër qëndroi edhe më tutje në të njëjtën pozitë, dm.th. vazhdoi të jetë segment i parë i grupit nominal:




Nyja kishte mbetur shquese vetëm në kontakt me emrin në pozitë prepozitive: [i pus, i bujar, i fshatar (= pusi, bujari, fshatari etj.), kështu që GN-ja me një shquese tani kishte këtë përbërje:



GN-ja e plotë me një shqese pra doli me strukturë të ndryshme nga GN-ja me përcaktorë të tjerë [një i mirë djalë - i mirë i djalë] etj. Në GN të plotë pra nyja shqese nuk ishte më në një segment me njëjshqese e me përcaktorët e tjerë. Vetëm kur nuk përdorej mbiemri, përcaktorët dhe nyja joshqese dilnin në të njëjtin segment me njëjshqese: [i pus, një pus, (a)i pus] etj. Ndryshimi në strukturë të GN-së me njëjshqese dhe pa njëjshqese do të qëndrojë deri në shqipen e sotme.

Sistemi me tri rase, që realizohej me format jodezinenciale të dëftorit etj., dhanoren, përveç në funksion të kundrinës së zhdrejtë, e kishte edhe në përdorim adnominal, d.m.th. edhe në funksion të gjinorës që nuk ekzistonte. Në këtë funksion dhanorja ishte segmenti variabil i sintagmës nominale dhe, ashtu si mbiemri, qëndronte midis segmentit A dhe gjymtyrës nominale (M - E):




Duke qenë se, siç thamë, vetëm nyja shquese e mban të nënkuptueshëm emrin, i cili kështu është në shkallë zero të të shprehurit, përdorimi i GN-së dativale prapa saj ia siguronte funksionin adnominal, d.m.th. e paraqiste si segment të sintagmës nominale:

|   |     |        |
|---|-----|--------|
| A | GN  | E      |
| i | saj | ∅      |
| e | tij | ∅ etj. |


Edhe në rastin e GN-së dativale nyja shquese pra kishte një përdorim që nuk e kishin nyja joshquese, dëftori etj.

I njëjti proces, që u zhvillua në përfitim të njëjës së mbiemrit, u zhvillua edhe me përfitim të njëjës para dhanores brenda sintagmës nominale në përdorim adnominal:



(SN + sintagma nominale, SG + sintagma gjenitivale, GN = grupi nominal, A1 = Nyja e gjinore ).

Me njëjën shquese sintagma nominale (SN) tani ishte:



Për më detajisht mund të shikohet vepra *Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike*. Aty është shënuar edhe përftimi i nyjës dysegmentëshe shquese e të përparme: [i të mirë i të djalë] etj.

Këtu u pa edhe ndryshimi në renditje që pësoi nyja shquese në GN të plotë në procesin e përfimit të nyjës së përparme të mbiemrit dhe të gjinores. Tani përdorimi adnominal i dhanores u dallua nga përdorimi adverbial, sepse dhanorja adnominale e bëri të pandarë nyjën e përparme, që domethënë se u krijua forma e gjinores (nyjë + dhanore).

### 3. Sistemi i rasave

Sistemi rasor i kësaj kohe, që u pasurua edhe me një formë rasore – me formën e gjinores, kishte këtë përbërje funksionale (në bazë të teorisë së L. Hjelmlevit për rasat):

Dativi, nominativi dhe akuzativi kishin të njëjtat vlera sistemore si në sistemin e dytë. Krijimi i gjinores nuk i ndryshoi raportet e këtyre rasave. Kështu, dhanorja, që tani nuk e kishte më përdorimin adnominal, shprehte kuptimin e afrimit nga funksioni i kundrinës dhe përbënte kështu termin më intensiv të sistemit, përbënte rasën pivot të këtij sistemi - termin  $\beta$ . Emërorja si në sistemin paraprijës trirasash kuptim dominant e kishte kuptimin e largimit që ia jep funksioni i kryefjalës, përkundër kuptimit të afrimit që ia jep funksioni i kallëzuesit, dhe përbënte kështu termin opozitar B. Gjinatorja, si rasë adnominale, shtrihet në tri fushat e zonës kuptimore të drejtimit. Ajo, përveç përkatësisë, që është kuptim i afrimit, shënon origjinën a prejardhjen, që është kuptim largimi, “subjektin” e segmentit regens – kuptim largimi, “objektin” e të njëjtit segment – kuptim afrimi, cilësorin që është kuptim i të qëndruarit apo i pushimit . Siç

shihet, gjinorja vë theks mbi dy fushat afrim – largim përkundër fushës neutrale të pushimi dhe përbën, prandaj, termin intesiv kontradiktor  $\gamma$  të këtij sistemi. Kallëzorja shpreh të tri kuptimet e drejtimit : afrim, si kundrinë e drejtë e si plotës kallëzuesor i kundrinës, largim, si kundrinë partitive dhe pushim a qëndrim si kallëzore parafjalore. Meqë përdorimi me parafjalë është më i shumtë, kallëzorja vë theks mbi fushën e qëndrimit dhe përbën termin  $\Gamma$  të këtij sistemi:

$\beta$  Dativ

B Nominativ

$\gamma$  Gjenitivi

$\Gamma$  Akuzativi

#### 4. Përftimi i formës foljore të tipit *për të thanë*

Sintagma parafjalore (SP) e tipit **për të thanë** u bë formë foljore nga funksioni i plotësit të qëllimit me foljet jokalimtare të lëvizjes me tipar [+ Atributiv]: [shkoi për të folun, erdhi për të thanë etj.] dhe kaloi në fjali qëllimore në proceset e sqaruara në veprën e cituar për pjesoren. Ky kalim që i mundur të bëhet nga shkaku se paskajorja e vjetër e tipit **me thanë** nuk dilte në këtë funksion.

Kjo formë e pashtjelluar e foljes është përfuar nga fjalia komplektive me kallëzues në lidhore të së kryerës, p.sh. [ai shkoi për që llamba të jetë ndezun/]. Lidhorja në këtë formë shpreh kuptimin e një veprimi që mund të kryhet pas veprimit në fjalinë kryesore, siç e kërkon edhe fjalia qëllimore. Nga ky përdorim u përftua nominalizimi i pjesores: [shkoi për të ndezun të llambës etj. (me gjinore në formën që e kishte në atë kohë).

Format e nominalizuara të pjesores [të ndëzuan etj.] ishin emra abstraktë të veprimit të gjinisë asnjane dhe gjinorja, që u përftua nga emërorja si kryefjalë e fjalisë së varur e që mund të pësonte veprimin, është gjinore objektive, prandaj, në procesin e kalimit në fjali qëllimore, ajo u transformua në kundrinë të drejtë: [shkoi për të ndëzuan lambën]. Kështu u kalua nga heteroprosopia në homoprosopi. Nga kjo shihet se kallëzuesi i fjalisë së varur si emër abstrakt i veprimit është përftuar nga pjesorja e foljeve kalimtare. Me pjesoret nga foljet jokalimtare ruhet heteroprosopia edhe pas nominalizimit të pjesores, p.sh. [Ajo u kujdes për që djali të jetë fjetun → Ajo u kujdes për të fjetun të djalit] etj. Meqë gjinorja këtu mund të ishte vetëm gjinore subjektive, me kalimin e kësaj SP-je në formë të pahtjelluar foljore, kjo gjinore transformohet në emërore si kryefjalë e fjalisë së varur qëllimore: [Ajo u kujdes për të fjetun djali] etj.

Krijimi i emrit prejpjesor abstrakt brenda SP-së me parafjalën **për** si nominalizim i drejtpërdrejtë i pjesores mund të përftohej vetëm pse nyja e përparme ishte një shqese, ashtu siç ishte edhe në sintagmën nga e cila përftohet forma e përcjellores [tue / duke pritun] etj. Kjo pozitë prepozitive e njëjës shqese flet për një lashtësi mjaft të madhe të përfimit të kësaj forme foljore në tërë shqipen.

Nga shënimi i kuptimit të qëllimit kjo formë e pashtjelluar ka pasur mundësi t'i merrte të gjitha kuptimet që ka paskajorja në përgjithësi, ashtu siç i ka marrë paskajorja e gjuhëve të tjera. Meqë kjo formë në të dy dialektet ka funksione njësoj të kufizuara rreth kuptimit të qëllimit, na është imponuar të përfundojmë se edhe në toskërishte zgjerimin e funksioneve të kësaj forme infinitivale e ka penguar prania e dikurshme e paskajores më të lashtë të tipit **me + formë e pjesores**, kështu që përjashtimi nga përdorimi i kësaj paskajoreje në toskërishten do të jetë relativisht i vonë. M. La Piana për arsye të tjera ka shprehur mendimin se kjo paskajore është zhdukur para se të vinin arbëreshët në Itali.

Shprehja **për të thane**, si formë e pashtjelluar foljore ka mbetur me pjesë të dallueshme si SP, për arsye se parafjala **për** nuk

ka kaluar në pjesëz si parafjala **me** në **me thanë** dhe segmenti pasues ka mbetur i identifikueshëm si emër veprimi i nyjshëm prej-pjesor, kështu që si SP kjo formë e pashtjelluar foljore nuk mund të kalonte në funksione të një SN-je, d.m.th. në funksion të kryefjalës, të kundrinës etj. as në toskërishte edhe kur nuk ishte më paskajorja e vjetër e përbashkët. Si SP ajo nuk mund të përftohej nga transformimi infinitival i fjalisë kompleteve, si përftohej paskajorja **me + forma e pjesores**<sup>48</sup>. Kështu kjo trajtë foljore me strukturë të SP-së **për të thane** etj. nuk mund të zëvendësohej nga fjalia lidhore.

Me funksionin burimor të shprehjes së qëllimit kjo formë foljore e pashtjelluar konsiderohet me të drejtë si formë e paskajores me funksione shumë të kufizuara. Kjo formë përdoret edhe me foljet **jam, kam** dhe **bëhet, mbetet** duke dalë në funksion të kallëzuesit, përftuar nga funksioni i përcaktuesit: (Bogdani): [ajo punë ishte për të çmuem ← Ajo punë ishte punë për ta çmuem etj.]. Kjo del edhe në përdorim me foljet **bëhet** e **mbetet**. Në shembujt e përdorimit me foljen **kam** si p.sh. (Bogdani): [qish ke për të bam, bane çpejt, (te Pedersen): [Kushdo që ka për të shkruar kartë ..., le të shkruajë etj.], kjo formë ka dalë në funksion të kallëzuesit nga funksioni i saj burimor si fjali qëllimore. Këtë e vërteton edhe përdorimi pas parafjalës **për** në disa të folme të gegërishtes si p.sh.: [vajzat i kish për me u martue; kush ka për me marrë gjak etj.]. Nga këta shembuj shihet se SP-ja me **për** ka hyrë në proces të kalimit në SN me funksion kundrinor, duke dalë kështu në fushën e distributionit të infinitivit [me + pjesore]: *ka për të thane* = *ka me thane*, për të përfunduar edhe kjo në një kallëzues të përbërë. Nga ky funksion i dy formave të pashtjelluara janë krijuar format analitike përkatëse të futurit.


Për funksionet e kryefjalës e të kundrinës të formës me **për** është thënë me të drejtë se janë funksione tepër të kufizuara e jashtë një përdorimi të natyrshëm.

<sup>48</sup> Shih veprën B. Bokshi, *Pjesorja e shqipes - vështrim diakronik*.

## 6. Përftimi i formës së përcjellores

Siç kemi konstatuar në veprën *Pjesorja e shqipes (vështrim diakronik)*, parafjala, që seleksionohet nga rasa emërore, dilte me dy variante kontekstuale **tu** dhe **tuk**. Varianti **tuk** përdorej kur segmenti pasues i sintagmës parafjalore fillonte me zanore, ndërsa varianti **tu** - kur ky segment fillonte me bashkëtingëllore. Segmenti **e** para pjesores ishte një e gjinisë femërore në rasën emërore, që do të seleksiononte variantin **tuk** të parafjalës, me të cilën u përngjijt dhe formoi pjesëzën **tuke** të përcjellores. Varianti **tue** i pjesëzës tregon se **tu** u bë variant i lirë me variantin **tuk** të parafjalës pra se të kalonte në pjesëz. Kështu pjesëzat **tue** dhe **tuke (duke)** ishin që në krijim variante të lira dhe se edhe varianti **tuke** ishte i tërë shqipes. Nga variante të lira ato u bënë variante dialektore të pjesëzës së përcjellores. Variantet e shumta të pjesëzave të përcjellores në të dy dialektet shihet se janë përftuar nga variantet **tue** e **tuke**, prandaj nuk mund të dëshmojnë për poligjenezë të pjesëzës së përcjellores, siç ka menduar M. Gabinski<sup>49</sup>.


Rindërtimi i fazës së parë drejt përfimit të përcjellores do të duhej të respektonte vlerën primare të **tu / tuk** si ndajfolje vendi, d.m.th. si SP të fjalisë amë:



Kjo ndajfolje del me të njëjtën përbërje edhe si parafjalë, d.m.th. edhe në prani të SN-së. Në vend të kësaj SN-jë (sintagme

<sup>49</sup> Shih M. Gabinski, *Pojavlenie i utrata pervičnego albanskogo infinitiva*, Leningrad, 1970.

nominale) do të mund të hynte një fjali komplete e prirë nga për-emri lidhor **që**, të cilin, për shkak të kuptimit të nevojshëm vendor, e zëvendëson lidhëza përemërore **ku**, që është formë e përemrit **që**:



Me nominalizimin e kësaj fjalie komplete bëhet shlyerja e lidhëzës pronominale **ku** dhe e foljes **jam** dhe pjesorja kalon, përmes një transformimi afiksial, në këtë rast me afiks zero, në emër abstrakt të veprimit në trajtë të shquar: [Ai asht tu e këputun (= e këputuna, të këputunit) e degëve]. Emri i tillë ishte me një shquese për arsyet e treguar në veprën e shënuar. Transformimi infinitival i kësaj fjalie komplete nuk ishte i mundur për shkak të heteroprosopisë, të kryefjalëve të ndryshme të fjalisë kryesore (ai) e të fjalisë së varur (degët).

Kryefjala e fjalisë komplete duhej ta kishte tiparin [+ Vend], ashtu siç e kishte edhe ndajfolja e parafjala: [tu ku degët janë këputun] etj. Me nominalizimin [tu e këputun e degëve] kjo parafjalë u gjet para një një emri abstrakt të veprimit që nuk mund ta kishte tiparin [+ Vend]. Kjo mospërputhje e tiparit me emrin e tillë pasues ia çënoi kuptimin vendor kësaj parafjale e, për pasojë, edhe funksionin parafjalor, duke u hapur kështu rruga që ajo të kalonte në pjesëz të një forme foljore që po krijohet. Këtë proces e ndihmoi edhe emri abstrakt prejpjesor, i cili, duke qenë në rasën emërore e pa kuptim vendor, s' mund ta përballonte funksionin e varur të rasës emërore si SN e SP-së. Ai e ruajti lidhjen formale me këtë parafjalë që po transformohej vetëm pse pati mundësi të hynte menjëherë në procesin e transformimit në funksion foljor.

Me nominalizimin e fjalisë komplete: [Ai asht tu e këputun e degëve], mbeti vetëm kryefjala e fjalisë kryesore, kështu që nga kuptimi: [Ai është aty ku degët janë këputur], d.m.th. te vendi ku ishte kryer veprimi mbi një subjekt tjetër, u kalua në kuptimin:

[Ai është aty ku kryhet veprimi i këputjes së degëve] (Ai asht tu e këputun e degëve). Subjekti i fjalië bazë, si i vetëm, tani ishte i pranishëm në veprimin që shënonte emri i tillë abstrakt, gjë që hapi rrugë për të kaluar në kuptimin [Ai është duke këputur] — në veprim e sipër, në realizim të veprimit që shënon emri abstrakt. Kështu kishte përfunduar procesi i krijimit të përcjellores, domethënë se SP-ja atributive me foljen **jam** si këpujë kishte kaluar në përbërje të kallëzuesit , i cili, kur pjesorja është e foljeve transitive, kërkon kundrinën e drejtë: [Ai asht / qe / ishte etj. tue këputun degë / degët] etj.

Në procesin e kalimit të emrit prej pjesor të veprimit në shënues të aktit të veprimit që kryen kryefjala, nyja shquese e përparme nuk mund të funksiononte më si e tillë, prandaj u bë enklitike ndaj parafjalës në transformim **tu / tuk**, u bë pjesë e pandashme e saj ende pa u përngjitur.

Pjesorja në përbërje të përcjellores do të qëndrojë e identifikueshme si pjesore, që domethënë se do të pësojë ndryshimet që pësoi pjesorja në përgjithësi, ndonëse ajo këtu nuk ishte më në funksion të saj si pjesore; ajo këtu është në funksion të një teme foljore dhe pjesëza si afiks e bën aktualizimin e kësaj teme si formë foljore.

Çështja e nominalizimit të pjesores si emër i gjinisë femërore me nyjën e përparme shquese **e** të emërores është shtjelluar në veprën e cituar.

Këtu duhet shënuar se përcjellorja u krijua shumë kohë para se të krijohet sintagma parafjalore e rasës emërore me parafjalën **tu, te, ke** etj.: [tu shtëpia etj.], kur nyja shquese qëndronte para emrit a fjalës së emërorizuar. Përftimi i formës së përcjellores, siç u pa, tregon se parafjala **tu** e **tuk** në këtë kohë nuk arriti të sistemohej si parafjalë e rasës emërore. Ajo u bë parafjalë e rasës emërore me trajtën e shquar të emrit kur nyja kishte kohë që dilte e aglutinuar me emrin, siç e ka sqaruar Pedersen.

## 7. Rënia e *-n-së* në rrokjen fundore të theksuar *-on*

Rënia e *-n-së* nga rrokja fundore e theksuar *-on* e emrave dhe e pjesores pësore të së kryerës: [kron > kro, përron > përro etj.; shkon > shko etj.], ashtu si dhe tek emrat e huazuar nga latinishtja, p.sh [cotoneus → këton > kton > fton > fto, draconem → drakon > drako (dragua) etj.], është kryer para aglutinimit të nyjës shquese, sepse nyja i gjeti këto fjalë me përfundim në *-o*: [kro-i, përro-i, fto-i, drago-i] etj. dhe nuk e lejoi zhvillimin e mëvonshëm të kësaj *-o-je* në diftong *-uo*, *-ua*, *-ue*, që u përtua kur emrat e shënuar nuk ishin të shquar.

N. Jokli në punimin *Mbi historinë e diftongjeve ua, ue të shqipes* është shprehur se rënia e *-n-së* nga *-on* është realizuar thellë brenda huazimeve latine dhe se po në këtë kohë është aglutinuar nyja shquese në gjuhën shqipe. Edhe në veprat Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes (1980), Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike (1984) dhe Pjesorja e shqipes - vështrimi diakronik (1998), e kishim pranuar vlerësimin se kjo *-n* ka rënë brenda kohës së huazimeve latine, por në përfundim të tyre. Ndërkaq, ky përcaktim has në momente që e bëjnë të paarsyetueshëm:

Kur thuhet se *-n* ka rënë nga përfundimi *-on* edhe në huazimet nga latinishtja, pranohet se këto huazime hynë në gjuhën shqipe me fundorin *-on* (cotton-eus → \*këton, dracon-em → drakon etj.) pa përjashtim. Kjo do të thotë se edhe fjalët nga fomdi ie. në gjuhën shqipe në këtë kohë ishin ende me *-on* (\*peron nga \*per-rën etj.). Rënia e kësaj *-n-je* pra mund të jetë vetëm e kohës pas huazimeve latine, d.m.th. e periudhës pasuese postromake të shqipes, e periudhës së shek. VI–VIII. Ky fakt e përforcon më tej mendimin tonë se prapangjitja e nyjës shquese është bërë pas këtyre huazimeve.

Nga kjo del i paqëndrueshëm mendimi i Joklit që edhe faza e tretë **ōu** e zhvillimit është e kohës romake e që ka zgjatur deri në shek. X. Duhet konstatuar se

forma pa **-n**, e krijuar pas huazimeve latine, qëndroi pa u diftonguar deri në prapavendosje të nyjës shquese, përftuar brenda fazes së shek. VI-VIII, para fillimit të procesit të rotacizmit, të cilin e shkatoi edhe nyja e aglutinuar.

Për mendime të tjera si për kohën e prapavendosje së nyjës shquese, ashtu edhe për kohën e rënies së **-n**-së nga **-on** i theksuar shih *Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike*.

## 8 Zhvillimi i formës së pjesores pësore të së kryerës

Prapashtesa **-n** e pjesores pësore të së kryerës rrjedh nga forma mashkullore e kësaj pjesoreje në gjuhën e lashtë ie.: *\*-nōs > -n-θ* (për gjininë femërore *\*-nā > -n-ē*). Forma mashkullore u bë gradualisht formë e vetme në përdorim foljor të kësaj pjesoreje. Në përdorim mbiemëror u ruajt opozicioni në gjini, i shprehur me *-θ ~ -ē (-n-θ ~ -n-ē)*.

Kur ra **-n**-ja nga përfundimi i kësaj pjesoreje në **-on** të theksuar si dhe tek emrat, përdorimi foljor dhe forma mashkullore në funksion mbiemëror përfunduan në **-o**: [ka puno, i puno ~ e puno-në etj.]. Kjo pjesore qëndroi kështu pa prapashtesë dytësore për një kohë të gjatë që nga përfundimi i huazimeve latine e deri në përfundim të rotacizmit. Pjesorja me **-n** prapa zanoreve të tjera në këtë kohë nuk e kishte bjerrë ende kërë tingull fundor (i pren, i lan, i thyen etj.). Atë e gjeti pa rënë prapavendosja e nyjës shquese edhe

tek emrat e së njëjtës temë: [pen-i, fren-i, mullin-i, zan-i etj.] dhe mbaresa rasore: [një peni, një freni, një mullini etj.].

Në përdorim mbiemëror opozicioni i gjinisë tani shprehej me: mashk. **-ø** ~ fem. **-në**: [i puno ~ e puno-në etj.]. Mbaresa e gjinisë femërore nuk mund të bëhej prapashtesë e pjesores në përdorim foljor. Kjo pjesore, e ndërtuar mbi tëmën në konsonant: [i , e lagën; i, e rrjepën; i , e pjekën; i, e veshën etj. (apo i, e lagun; i, e pjekun etj.), i takonte temës emërore, që i takonin edhe emrat: [pjepën, krahën, lakën, mështekën etj.], ashtu si dhe emrat e mbiemrat në sonantin **-r** :[votër, motër, lepër, vjehër, vepër etj.], që ishte (dhe është) neutrale në gjini. Për këtë arsye mbiemrat e nyjshëm të kësaj pjesoreje (i, e djegun, i, e, terun etj.) nuk kishin mbaresë gjinie, ashtu siç nuk kanë edhe mbiemrat joprejpjesorë të kësaj teme: [i,e bukur, i, e lumtun, i, e vorfun etj.] .

Në zhvillimin e sistemit të temave emërore, kjo temë doli me **-ë** fundore: [emënë, lakënë, pjepënë, krahënë etj.; i, e lagënë; i, e pjekënë; i, e lodhënë etj. (apo i, e lagunë etj.), duke e ruajtur neutralitetin në gjini. Mbasi **-ë**-ja këtu nuk ishte mbaresë gjinie, por tingull fundor i temës, nuk mund të zëvendësohej nga mbaresa e re e gjinisë femërore **-e**<sup>50</sup>. Kuptohet se kalimi i temës nga [lagën (lagun)] në [lagënë (lagunë)] përmbledh edhe pjesoren në përdorim foljor. Kështu kjo pjesore pësore e së kryerës e kësaj teme formohej tani jo me prapashtesën **-n**, po me prapashtesën **-në**.

Koha e krijimit të kësaj teme me **-ë** fundore është pas rënies së **-n**-së në pjesoren me **-on** (\*punon > \*puno etj.) dhe para rënies së kësaj prapashtese nga pjesorja e temës në zanore të tjera e në grup zanoresh: [lan, thyen, pin, pren etj.], që domethënë edhe para përfundimit të rotacizmit e para diftongimit të **-o**-së.

Në kohën kur u krijua prapashtesa **-në** në tipin e shënuar të temës së pjesores, ishte kjo gjendje e formës së pjesores pësore të

<sup>50</sup> Përdorimi si në një pjesë të Kosovës: i lagën ~ e lagën-e është inovacion.

së kryerës:

si folje: si mbiemër

lagë-në, hapë-në (lagu-në etj.) - i, e lagë-në, i, e hapë-në (i, e lagu-në)

thann, vjeln i thann ~ e thann-ë, i vjeln ~ e vjeln-ë

shko, puno etj. i shko ~ e shko-në, i puno ~ e puno-në

pren, thyen i pren ~ e pren-ë, i thyen ~ e thyen-ë etj.

Këto ndryshime, që sollën prapashtesa të reja të pjesores **-o** dhe **-në** në përdorim foljor, shkaktuan çrregullim edhe në përdorim mbiemëror të kësaj pjesoreje. Këto ndryshime do të bëjnë presion për një sistemim të ri të formimit të kësaj pjesoreje e të formës mashkullore e femërore në përdorim mbiemëror. Këto ndryshime do të trajtohen në pjesën përkatëse të këtij punimi.

## 9. Gjendja e sistemit të temave emërore

Siç kemi shënuar, përveç katër tipave të temave emërore, që kishte shqipja në kohën e kontaktit me latinishten, nga greqishtja e vjetër e nga gjuha latina u imponuan edhe dy tema: tema proparoksitone [femënë, retënë, mokënë, letërë etj.] e emrave të gjinisë femërore dhe tema paroksitone në konsonant e në sonante, përpos **-n**, **-r**: [pellëg, farmëk, kanëp, qelëq, kallëm, mrekëll, kumëll, shembëll etj.] e emrave të gjinisë mashkullore e asnjane.

Këta dy tipa të temave emërore nuk e shkaktuan ndryshimin e sistemit vetëm me praninë e tyre, por edhe me disa procese që nxitën:

1. Ndërsa emrat që përfundonin në bashkëtingëllore mbetën në këtë tip në numër të kufizuar, sepse me ndryshime fonetike kaluan me kohë në tipin oksiton [shelg, pellg, qelq etj.], që ishte tip aktiv i trashëguar, ata që përfundonin me sonantet e shënuara u treguan rezistentë në strukturën e tyre. Ne mendojmë se ky tip teme i emrave të gjinisë mashkullore e asnjansë në këtë kohë do të kalojë në tip të temës me emra të të tri gjinive, duke u bashkuar me emrat paroksitonë në **-n**, **-r** në një temë, në temën e re paroksitone me të gjitha bashkëtingëlloret sonantike. Ky neutralizim në gjini i kësaj teme me sonantet e shënuara u arrit përmes kalimit të disa neutrave në gjininë femërore si kumbëll (← *κακόμαλον*) etj. si dhe me kalimin e disa emrave femërorë nga tema paroksitone në **-ë** në temën paroksitone në sonant: [pezme (← *πεισμα*) → pezëm, meglë (← *lat. mëgla*) → mjegëll]. Kalimi i këtyre emrave në tip neutral të temës është reagim i sistemit ndaj një strukture të huaj, siç ishte tema e shënuar, të cilën në këtë mënyrë e kufizoi në një numër të vogël emrash.

2. Tipi i temës paroksitone në bashkëtingëllore si [farmëk, pellëg etj.], pranë tipit oksiton në konsonant si [gjak, shtog, zog etj.] dhe tipi si [femënë etj.] pranë tipit si [ranë, anë etj.] si tipa të një gjinie, shkaktuan humbjen e fuqisë dalluese të vendit të theksit, duke e goditur sistemin e temave emërore të kësaj kohe në njërin nga elementet tipizuese të këtij sistemi. Ky dobësim e lejoi zgjerimin e temës njërrrokëshe në zanore (mi, dhe etj.) me emra me më shumë rrokje: [qersh, shtëpi, rrëfe etj.], duke e ndihmuar rënien e **-n**-së nga përfundimi **-on** të temës: [përo, drago, këto (> kto > fto etj.).

Emrat si [femënë etj.] ndikuan që në këtë kohë të dalin me **-ë** fundore së pari edhe emrat e gjinisë femërore të temës paroksitone në **-n**, **-r**: [lakënë, vepërë, motërë, votërë etj.] e pastaj edhe emrat e gjinisë mashkullore e asnjansë të kësaj teme: [pjepënë, emënë, dimënë, lepurë etj.], duke u ruajtur kështu neutraliteti në gjini i kësaj teme. Kuptohet se kështu dilnin edhe emrat me sonante të tjera, mbasi ishi futur në të njëjtën temë me emrat paroksitonë në sonantet **-n**, **-r**: [kumbëllë, vjehërrë, pezëmë, vegëlë, i, e vogëlë, i, e bukurë etj.]. (Shih *Rruga...*, f. 170-72).

## 10. Zhvillimet në mbaresat e numrit

### a) Metafonia dhe palatalizimi

Siç dihet, mbaresa **\*-i** e shumësit të emrave të gjinisë mashkullore të temës oksitone në bashkëtingëllore: [plak, mëzat, kunat etj.] më parë e ka shkaktuar matafoninë e pastaj palatalizimin e bashkëtingëlloreve që mund të palatalizoheshin. Në procesin e shkrirjes graduale në tingullin që po e palatalizonte **-i**-ja e dobësoi karakterin e saj vokalik, duke kaluar në **-j** (j), d.m.th. duke e përjashtuar përdorimin e **-i**-së edhe prapa bashkëtingëlloreve të tjera: [kunet-j, qytet-j, gjeth-j, lis-j etj.]. Në procesin e përfundimit të palatalizimit kjo mbaresë (i) u shkri e nuk qëndroi si mbaresë shumësi as në rastet me bashkëtingëllore të papalatalizueshme.

Kjo mbaresë e trashëguar (**-ǫ-i > -i**) e ka shkaktuar metafoninë e palatalizimin para prapangjijtes së nyjës shquese, sepse nyja **-i** (pen-i etj.) nuk e shkaktoi palatalizimin e metafoninë, por e shkaktoi rotacizmin (per-i etj. ). Kjo mbaresë e shumësit dhe përfundimi i përdorimit të saj është i kohës para fillimit të procesit të rotacizmit.

Mbaresa **-i** la një ndryshim të ndieshëm në sistemin e mbaresave të numrit. Duke shkaktuar në mjaft emra ndryshimin e përbërjes fonetike të temës në shumës, përballë temës së pandryshuar në njëjës: [plak ~ pleq, mullin ~ mullinj, \*adh ~ edh, \*qutat ~ qytet etj.], shënoi një depërtim tjetër më të efektshëm të mbaresës brenda në temë. Kjo mënyrë e dallimit të elementeve të numrit, që del edhe në shembujt vetëm me metafoini: [desh, kunet, mëzet etj.] mbeti e qëndrueshme që nga krijimi e deri sot.

Përdorimi i mbaresës **-e** mbi formën e palatalizuar të shumësit si në shembujt [pyje, harqe, yje etj.] është i vonshëm. Të vona janë edhe

mbaresat e emrave me unifikim të temës sipas shumësit: [derra, gjethe, qytete. bredha, gjela etj.], që domethënë se pas shkrires së mbaresës **-i** (**-j**)ishin pa mbaresa: [\*adh ~ \*edh, \*darr ~ derr, \*gath ~ gjeth, \*gal ~ gjel etj.]. Emrat që nuk pësuan metafori e palatalizim në vend të mbaresës **-i**, që nuk ishte më, morën mbaresat **-ë** ose **-e**<sup>51</sup>.

Të kësaj kohe janë edhe metaforia e palatalizimi te format foljore. Metaforia **a ~ e** shfaqet në vetën e parë e të dytë njëjës të kohës së tashme të dëftores te një numër i vogël i foljeve si: [marr ~ merr, dal ~ del, rrah ~ rreh, jap ~ jep, vras ~ vret, bërtas ~ bërtet, flas ~ flet, ngas ~ nget etj.]. Në këto veta realizohet edhe metaforia shumë e kufizuar **o ~ e**: [njoh ~ njeh, shoh ~ sheh].

Nga studiuesit e këtij procesi ka dalë e padyshimtë se të dy këto metafori i ka shkaktuar zanorja **-i**, qoftë në përbërje të mbaresave **-is**, **-it**, qoftë si zanore atematike.

Palatalizimi te foljet është kryer në vetën e parë njëjës të kohës së tashme të dëftores. Palatalizimin **-n > -nj** e shkaktoi elementi i parë i mbaresës **-iō** (**jō**): (**ban-iō > banj** etj. ). Mendohet se edhe në vetën e parë e të tretë shumë palatalizimi është shkaktuar nga një **-i** (**-j**). Format e tjera me **-nj-** konsiderohen të përfutuara analogjikisht.

E njëjta mbaresë (\*io) e ka shkatuar në të njëjtën kohë edhe ndërrimin e **-t-së** së temës foljore në **-s** (<**-tjo** < **-tjo**) në vetën e parë njëjës të kohës së tashme: [shes ~ shet, pres ~ prët, zbres ~ zbret, flas ~ flet, vras ~ vret etj.].

Edhe te foljet është kryer palatalizimi i **-k-së** dhe **-g-së** së temës në **-q** e **-gj**. Me këtë palatalizim dalin format e vetës së dytë shumë të kohës së tashme të dëftores në diatezën veprorë: [pjek ~ piq-ni, djeg ~ digj-ni etj.] dhe në të tri vetat njëjës e shumë të kohës së tashme e të pakryer në diatezën joveprorë: [piq-em, piq-esh, piq-et, piq-emi, piq-eni, piq-en, digj-em, digj-esh, digj-et etj.; piq-esha..., piq-eshim..., digj-esha, digj-ej, digj-

<sup>51</sup> Shih B. Bokshi, Rruga..., f. 206- 12.

eshim etj.], si dhe në aorist: [poqa, dogja etj.]. Nuk është konstatuar se cila ishte forma e palatalizuar që u përftua nga mbaresa **i** (**j**)e që ndikoi pastaj që të shtrihej analogjikisht te format e tjera. Demiraj me të drejtë nuk pajtohet me mendimin se në vetën e tretë njëjës të aoristit (poqa, dogja, vdiqa etj.) palatalizimin ta ketë shkaktuar mbaresë e re **-i**.

### **b) Krijimi i mbaresës -ënë, -ërë të shumësit**

Kjo mbaresë e shumësit është përftuar në tre emra gjallesash: [mbret, prift, dreq]. Këta emra të huazuar hynë në gjuhën shqipe me format ëmbëratër < lat. *imperator*, priftër < lat. *presbyter*, drakën < greq. e vj. *δράκων*. Këta janë emra të temës paraksitone që përfundonte në **-r**, **-n**, ashtu si emrat [lepër, vepër, pjepën, dimën etj.]. Këta emra shumësin e kishin me **-ë**: [ëmbratër-ë, priftër-ë, dreqën-ë], si të gjithë emrat e kësaj teme. Pas kalimit të temës paroksitone me **-n**, **-r** në temë proparoksitone në **-ë**: [emënë, pjepënë, lakënë, lepërë, vepërë, dimënë etj.], kjo mbaresë u bë pjesë e temës. Për ta dalluar shumësin nga njëjësi u përdor mbaresë **-e**: [sing. *lakënë* ~ plur. *lakënë-e*, sing. *pjepënë* ~ plur. *pjepënë-e*, sing. *vepërë*~ plur. *vepërë-e* etj.] Kjo **-e**, si mbaresë shumësi origjinalisht femërore, nuk mund të përdorej me këta emra, që ishin të dalluar si emra të gjallësave të seksit mashkullor, prandaj këta kaluan në temën oksitone në konsonant që ishte temë tipike e emrave të gjinisë mashkullore: [mbërat, prift, drak], me ç'rast përfundimi **-ërë**, **-ënë** mori vlerën e mbaresës së shumësit: [sing. mbërat ~ plur. mbërat-ërë, sing. prift ~ plur. prift-ërë, sing. drak~plur.drak-ënë].

Kjo paradigmë **zero** ~ **-ërë**, **-ënë** ishte e tërë shqipes. Më vonë në gegërishten mbaresë **-ërë** u interpretua si e rotacizuar, prandaj

kaloi në **-ënë**: [mbret-ënë, priftë-në], ndërsa në toskërishten mbaresa **-ënë** u interpretua si e gegërishtes, prandaj u bë **-ërë**: [dreq-ërë].

Format metafonike të emrave [mbret, dreq] flasin se ishte krijuar edhe një formë paralele e shumësit në kohën kur ishte ende mbaresa **-i** e shumësit. Kështu përveç me shumësin [mbratërë, drakënë, priftërë] njëjësit [mbërat, drak, prift] hynë në relacion edhe me mbaresën **-i** të shumësit që ishte e vetme për emrat mashkullorë të temës oksitone në bashkëtingëllore:

sing. [mbërat] ~ plur. [mbërat-i]

[ prift ]                      [ prift-i ]

[drak]                              [drak-i]

Këtu u bë metafonizimi i zanores së theksuar **-a** > **-e** dhe palatalizimi **-k** > **-q**: [mbëret, dreq]. Emri prift, që nuk pësoi ndryshime fonetike nga mbaresa **-i**, nuk mund të qëndronte pa mbaresë shumësi, prandaj vijoi të marrë mbaresën **-ërë**: [sing. prift ~ plur. prift-ërë]. Mbasi unifikimi i temës sipas shumësit nuk mund të bëhej pa u përfutur një mbaresë hiperkarakterizuese e shumësit mbi formën e metafonizuar e të palatalizuar, me këta emra u përdor mbaresa alternative **-ërë**, **-ënë**: [sing. mbrat ~ plur. mbret-ërë, sing. drak ~ plur. dreq-ënë]. Në periudhën pasuese bëhet unifikimi i temës: [sing. mbëret ~ plur. mbëret-ërë, sing. dreq ~ plur. dreq-ënë] dhe mbaresa **-ërë**, **-ënë** mbeti rishtas e vetmja mbaresë shumësi e këtyre emrave.

Kjo mbaresë, që pas rotacizmit u bë dialektore -ërë për toskërishten e -ënë për gegërishten, e zgjeroi përdorimin edhe me disa emra të tjerë si: [përingë, princërë – prindënë, princënë] dhe në përdorim hiperkarakterizue me emra të tjerë: [at ~ etënë - etërë, kec (←kac) ~ kecënë - kecërë etj.]. Mbasi mbaresa -ënë, -ërë është origjinalisht e lidhur me emra të gjallësive, përdorimi me emrat e

jogjallesave: [shtrat ~ shtretënë - shtretëre, \*brash ~ breshënë – breshëre, \*thak ~ thekënë thekëre etj.] është edhe më i vonshëm<sup>52</sup>.

### c) Zgjerimi i përdorimit të mbaresës -e

Mbaresa e shumësit -e: [sing. -ë ~ plur. -e: nus-ë ~ nus-e, e rem-ë ~ të rem-e] etj. e zgjeroi përdorimin te mbiemrat dhe te emrat e temës paroksite në -ë, që ishin sinkretikë në numër: [plakë, kunatë etj.] dhe me të gjithë emrat e temës proparoksite në sonantet -n, -r: [femënë, emënë, dimënë, mokënë, motëre, vepëre, lepëre, pjepënë, lakënë, frashënë etj.] e në sonantet e tjera: [i, e vogëlë, vegëlë, pezëmë, kumbëllë] etj., që nuk e dallonin numrin me mbaresë, mbasi mbaresa -ë sapo ishte bërë pjesë e temës.

Ky zgjerim i përdorimit të mbaresës -e pati arsye të bëhej së pari te mbiemrat e nyjshëm të temave në -ë: [i, e, të kotë; i, e, të thatë; i, e, të mirë; i, e, të gjatë; i, e, të lagunë, i, e, të vogëlë, i, e, të bukurë etj.]. Meqë -ë ishte këtu tingull fundor i temës, kuptimin e elementeve të gjinisë e të numrit e realizonin format e nyjës së përparme me zanore ende të reduktuara në -ë në shumës: [sing. i, e mirë ~ plur. \*ta, \*to mirë etj.]. Kur po reduktohej zanorja e nyjës (plur. \*ta > të, \*to > të), po humbte komutacioni në gjini i tipit të shënuar të mbiemrave në numrin shumës, përkundër gjendjes në numrin njëjës, ku nyja e dallonte gjininë (i, e). Kështu nga [sing. i, e, \*ta mirë ~ plur. \*ta, \*to mirë] po kalohej në [sing. **i, e, të mirë** ~ plur. **të mirë**] për të tri gjinitë. Nën presionin e numrit njëjës e të gjendjes së mëparme duhej të sigurohej dallimi në gjini edhe

<sup>52</sup> Në shembujt e fundit mbaresa -ënë (-ërë) e ka pësuar singularizimin.

në numrin shumë. Kështu e vetnja mundësi ishte që të përdorej mbaresa për gjininë femërore të shumësit.

Kjo ishte mbaresa **-e** e shumësit të emrave të gjinisë femërore si [sing. delm-ë ~ plur. delm-e, sing. nus-ë ~ plur. nus-e etj.] dhe të mbiemrave që e dallonin gjininë me mbaresa në njëjës e në shumë: [(mashk. i rem)fem. sing. e rem-ë ~ plur. të rem-e etj.]. Mbaresa **-e** ishte e vetnja që mund të përdorej, sepse ajo ishte e vetnja që si grup elementesh shprehte kuptimin e numrit shumë e të gjinisë femërore. Te mbiemrat e shënuar që **-ë-në** e kishin tingull fundor të temës (i,e, të kotë; i, e, të mirë etj.), mbaresa **-e** nuk mund të vinte në vend të kësaj **-ë-je**, por do t'i shtoj. Me shtimin e saj mbiemri e dalloi gjininë: në njëjës me format e nyjës [i kotë ~ e kotë etj.], në shumë me mbarsë: mashk. zero ~ fem. **-e**: [të kotë+ø ~ të kotë+e etj.]. Këtu u krijua më vonë mbaresa e shumësit **-a**: [e kotë ~ të kota etj.].

Mbaresa **-e** në këtë kohë kalon në përdorim me emra të kësaj teme, që ishin të gjinisë femërore të gjallesave [plakë, kunatë, zogë etj.], që **-ë-në** e kishin sufiks feminativ në opozicion me emrat me sufiksin zero të seksit mashkullor: [plak, kunat, zog etj.]. Ky komutacion gjinie dhe mungesa e mbarsës së numrit ishin pikat analogjike që e shkaktuan kalimin e paradigmes **zero ~ -e** nga mbiemrat e shënuar te këta emra si dhe tek emrat që dilnin edhe me sufiksa të tjerë feminativë, siç e tregojnë format e tyre me mbarsën **-a** (përftuar më vonë nga **-ë + -e**): [plaka, kunata, zoga] dhe [princesha, ulkonja, arusha etj.]. Edhe emrat si [rosë, bibë, patë etj.], po qenë fjalë të shqipes së kësaj kohe, do të dalin që atëherë në solidaritet me paradigmen e numrit sing. **-ø** ~ plur. **-e**: [bibë-ø ~ \*bibë-e, patë-ø ~ \*patë-e etj.], sepse **-ë** e tyre është po ashtu sufiks feminativ në relacion jo me sufiksin zero të emrit të gjallesës së seksit mashkullor, por me sufiksat **-ak** (ros-ak), **-ok** (pat-ok), **-an** (bib-an) etj. Kuptohet se emrat e gjallesave të seksit femëror, që opozicionin e seksit e shprehnin me tema të ndryshme si [lopë ~ ka, pelë ~ kalë, pulë ~ gjel etj.], nuk patën arsye të dilnin në shumë të femërores me mbarsën **-e**. Mbaresa **-a** tek emrat si [pela, pula etj.] është më e vonshme, e përftuar

nga zgjerimi i përdorimit të kësaj mbarese e jo e përfutur nga **-ë + e > -a** brenda këtyre emrave.

Tek emrat e temës proparoksitone me **-ë** pas sonanteve **-n+ë, -r+ë** përdorimi i mbaresës **-e** në shumës do të jetë realizuar së pari tek emrat e gjinisë femërore: [plur. lakënë-e / femënë-e / motërë-e / vepërë-e / shemërëe etj.], por, meqë tema ishte neutrale në gjini, formimi i shumësit u unifikua për tërë tipin, siç ishte edhe kur **-ë** ishte mbarese e shumësit. Kështu mbarese **-e** u përdor edhe me emrat e gjinisë mashkullore e asnjane të kësaj teme: [plur. Pjepënë-e / emënë-e / krahënë-e / shemërë-e / hekurë-e etj.]. Mbarese **-e** u përdor edhe tek emrat me sonante e tjerat, kur tema u bë proparoksitone me **-ë**: [plur. gogëlë-e / vegëlë-e / kokërrë-e / mjekërrë-e, / mjegëllë-e / shembullë-e etj.]. Edhe te këta emra, që, siç kemi shënuar, ishin të gjinisë mashkullore, mbaresën e shumësit **-e** e morën jo vetëm ata që kishin kaluar në gjininë femërore, por edhe ata që kishin mbetur të gjinisë mashkullore e asnjane. Emrat e kësaj teme e patën shumësin me mbaresën **-ë**, e cila u bë pjesë e temës si te emrat e temës në sonantet **-n, -r**, kështu që format me palatalizim të disa emrave: [shekuj, dishepuj, tranguj, tempuj, shembuj] e ndonjë tjetër, duke mos e pasë pasur shumësin me **-i**, dolën me këto forma në kohë më të vona nën ndikime analogjike, ashtu si dhe ndonjë emër mashkullor i temës në **-r**: [lepuj, flamuj].

Ende pa u përfuar mbarese **-a** nga **-ë-e** në shumësin e këtyre emrave dhe ende pa u krijuar tema e re emërore proksitone në **-e** nga singularizimi i shumësit: [sing. nus-ë ~ plur. nus-e → sing.- plur. nuse etj.], mbarese e shumësit **-e** e zgjeroi përdorimin, duke shënuar edhe shumësin e disa emrave të gjinisë mashkullore si [vende, fise, katunde etj.]. Përdorimi edhe me emra të gjinisë mashkullore të temës neutrale në gjini: [pjepënee, drapënee, frashërëe, emënee, dimënee etj.] e bëri edhe mbaresën **-e** neutrale në gjini dhe mundësoi që të shënojë edhe shumësin e disa emrave të gjinisë mashkullore të temës oksitone në bashkëtingëllore që nuk e kishin pësuar metafoninë e palataliziminnga mbarese **-i**.

Përveç mbaresës **-e**, në vend të mbaresës **-i**, që s' ishte më, me emrat mashkullorë e kësaj teme u përdor edhe mbaresa **-ë**.

Fjalët bikategoriale emër-mbiemër morën mbaresën **-ë** të shumësit, e cila në kohën e mbaresës **-i** ishte mbaresë e shumësit të emrave të gjinisë asnjansë të kësaj teme: [mashk.shumës:bles-ë,bas-ë, das-ë, punëtorë, fshatarë, fisnikë etj.]. Përdorimi i **-e-së** do të shënonte gjallesa të seksit femëror në shumës (base, dase, punëtore, fisnike etj.). Edhe mbiemrat e nyjshëm të këtij tipi, që e patën shumësin me **-i**, morën mbaresën **-ë** në vend të saj: [sing. i rem ~ plur. të rem-ë, sing. i mjelm ~ plur. të mjelm-ë, sing. i majm ~ plur. të majm-ë etj.]. Emrat e gjallësive të seksit mashkullor, që nuk ishin edhe fjalë mbiemërore, pa opozicion seksi (bilbil, krimb etj.), me opozicion të shprehur me tema të ndryshme (nip ~ mbesë etj.), me variacion të sufiksit (luan ~ luan-eshë, dren ~ dren-ushë etj.) e morën mbaresën e vetme të mundshme **-ë**: [bilbil-ë, nip-ë, luan-ë, gomar-ë etj.].

Mbaresën **-e** në vend të mbaresës **-i** e morën emrat mashkullorë të jofrymorëve të kësaj teme: [send-e, mure, supe, varre, fise, kuvende etj.]. Jo vetëm pse si emra jofrymorësh nuk e njihnin opozicionin e seksit, d.m.th. nuk kishin forma korresponduese femërore, por edhe pse emrat femërorë të jogjallësive të temës paroksite në **-ë** në këtë kohë ishin pa mbaresë të numrit: [sing.-plur punë / udhë / vorbë / dardhë etj.].


### c) Krijimi i paradigmave **-o ~ -nj** dhe **-o ~ -inj**

Me rënien e **-n-së** së temës në **-on** të theksuar ishte krijuar edhe paradigma sing. **-o** ~ plur. **-nj** (< \***-n-i**): [thon ~ thonj > \*tho ~ thonj, përron ~ përronj > \*përro ~ përronj etj.]. Numri tani nuk shënohej me jopalatal / palatal po me mbaresë zero / palatalizim i **-n-së**.

Duket e padyshimtë se në këtë kohë pas shuarjes së mbaresës **-i** të shumësit, d.m.th. pas përfundimit të palatalizimit, forma me parapshtesën e kolektivit **-inj** (<\*-inio)kishte kaluar në formë të shumësit matematikor, d.m.th. ishte bërë mbaresë shumësi: [shkëmb ~ shkëmb-inj, shtrap ~ shtërp-inj, \*ar ~ ar-inj, \*kall ~ kall-inj] etj.

## 11. Aglutinimi i nyjës shquese

Nga renditja e segmenteve të grupit nominal (GN) pas krijimit të nyjës së përparme të mbiemrit : [i thellë i pus, i mirë i punëtor, bujar i djalë, i thellë i ø] nyja shquese u aglutinua me mbiemrin: [i thelli pus, i miri punëtor, bujari djalë, i thelli]. Me këtë aglutinim u shkaktua ndryshimi i vendit të funksivitetit dhe përbërja e tij nga F - Art. E në F - M Art:



Meqë nyja shquese ishte tani e lidhur me segmentin e parë dhe e mbante të katalizueshëm emrin (i thelli ø) si segment të dytë të GN-së, kuptohet se F ishte segmenti konstant i kësaj klase (GN) dhe E mbeti funksionalisht segment variabil. Tani që nyja shquese e humbi përdorimin para emrit në një klasë me të (F - Art. E) kur duhej kuptimi i

konkretizuar Emri në GN pa M do të zëjë vend brenda konstantës F, që do të thotë se do të dalë në vend të Mbiemrit me nyjë të aglutinuar: [pusi]. Ky përdorim u bë i mundshëm gradualisht nga mbiemrat e panyjshëm (mbiemra-emra) në GN të plotë: [bujari djalë etj.] Kur nuk përdorej Emri, këto fjalë mund të ishin edhe mbiemra të substantivuar edhe emra të konkretizuar: [bujari, trimi etj.]. Kështu edhe fjala që ishte vetëm emër (pus) mund të përdorej me nyjë të aglutinuar në rast të kuptimit të konkretizuar e në mungesë të Mbiemrit.

Mundësia e segmentit të parë F për të dalë si M + Art. [i thelli etj.], apo si E + Art.. [pus-i, bujar-i] etj. shkaktoi që segmenti i dytë i GN-së të jetë ose E ose M: [i thelli pus, pusi i thellë, bujari djalë, djali bujar, i miri punëtor; punëtori i mirë etj.]. Në funksivin F - E + Art. emri si konstante semantike ishte segment i konstantes funksionale (F) të GN-së, prandaj kjo pozitë e Emrit u bë renditje e zakonshme: [pusi i thellë etj.], ndërsa renditja M + Art. E : [i thelli pus]— renditje e lejueshme.

Segmentet e GN-së janë në renditje të detyrueshme, sepse F-ja është gjithnjë segment i parë, meqë në të është edhe nyja shquese. Që nga kjo kohë e deri në ditët tona shqipja nuk ka pasur si të mos e ketë të detyrueshme këtë renditje, kështu që F-ja nuk mund të dalë në vend të dytë (pus i thelli, apo i thellë pusi). Kuptohet se renditja Emër - Mbiemër u bë renditje e zakonshme edhe në GN pa nyjë shquese: [një / ai pus i thellë etj.].

Kjo renditje e Emrit dhe e Mbiemrit në GN do të reflektohet edhe në renditjen e segmenteve të sintagmës nominale (SN) ku gjinorja do të dalë pas gjymtyrës nominale (MN). Nga [ai i lagjes pus i thellë , ai i saj pus i thellë] u kalua në [ai pus i thellë i lagjes, ai pus i thellë i saj] etj.

Nyja u aglutinua pasi ishin reduktuar në -ë zanoret e nyjave në shumës: [\*ta > të, \*to > të, \*tyn > të, \*tan > të]. Paradigma rasore e nyjës në prag të aglutinimit ishte:

| sing. |   | Plur.   |
|-------|---|---|
| Nom.  | i mirë i litar<br>e mirë e lopë                     | të mirë të litarë<br>të mirëe të lopë                   |
| Gen.  | i, e   të mirë i të litar<br>i, e   së mirë së lopë | i, e   të mirë e të litarë<br>i, e   të mirëe e të lopë |
| Dat.  | të mirë i të litar<br>së mirë së lopë               | të mirë e të litarë<br>të mirëe e të lopë               |
| Akuz. | të mirë ëntë litar<br>të mirë ëntë lopë             | të mirë të litarë<br>të mirëe të lopë                   |

(Forma të *mirëe* është formë e shumësit të mbiemrit të gjinisë femërore ende pa u përfunduar **-ëe** > **-a**)<sup>53</sup>.

Përngjitja e nyjës është bërë pas shkrirjes së mbaresës së shumësit **\*-i**, d.m.th. pas përfundimit të formave metafonike e të palatalizuara në shumës, meqë nyja **-i** nuk e shkatoi metafoninë e palatalizimin, por rotacizmin. Aglutinimi i nyjës u bë edhe pas rënies së **-n**-së nga tema me përfundim në **-on** të theksuar: [kro-i, përro-i, fto-i etj.] dhe para rënies të emrat e tipit: [pen-i, fren-i, mullin-i etj.] si dhe të pjesorja e tipit (ka) lan edhe brenda mbiemrit të nyjshëm: [i lan-i, i pren-i, i thyen-i etj.]. Këto tregojnë se përngjitja e nyjës është bërë pas përfundimit të huazimeve latine e para përfundimit të rotacizmit, që mendojmë të jetë i shek. VIII. Kështu si kohë relative për prapamgjitjen e nyjës del shek. VII.

<sup>53</sup> Sqarimet e përfundimit të disa formave të kësaj paradigme si nyja dysegmentëshe e gjinore dhe e dhanore të mashkullorët e në shumës, nyja njësegmentëshe **së** në gjinore të njëjësit të emrave të gjinisë femërore dhe forma **ntë** e kallëzores njëjës e emrave të gjinisë mashkullore e femërore mund të shihen në veprën *Rruga*.

## 12. Rendi i fjalëve

Aglutinmi i nyjës shquese prapa mbiemrit solli ndryshimin e renditjes së segmenteve të gjymtyrës nominale nga një renditje regressive Mbiemër - Emër në renditje progresive Emër – Mbiemër , që u bë renditje e zakonshme. Renditja e parë mbeti renditje e lejueshme. Kjo renditje e re progresive u përftua edhe në segmentet e sintagmës nominale (SN), në të cilën sintagma gjenitivale (SG) nga renditja para emrit të përcaktuar prej saj kaloi në renditjen pas këtij emri : nga [i fqiut djalë] u përftua [djalë i fqiut etj.]. Renditja e segmenteve të frazës Subjekt – Verb – Objekt do të vijojë të qëndrojë tani jo më si renditje e detyrueshme, por si renditje e zakonshme, për shkak se renditjen regressive brenda saj Verb – Objekt nuk e kundërshton ritmi oksiton, mbasi format kundrinore, “duke qenë të theksuara mund ta përfundojnë masën ritmike”<sup>54</sup>. Ky ritëm nuk e ka kundërshtuar as topikën parandejtuese të përcaktorëve para emrit [ky djalë etj.], e cila vijon të jetë e detyrueshme.

Renditja progresive ishte në përputhje me kërkesat e ritmit kryesisht oksiton, që ishte bërë zotërues në kuadër të temave emërore.

Nën kërkesat e ritmit kryesisht oksiton u ndihmua qëndrimi i trajtëve të patheksuara kundrinore në pozicion proklitik ndaj foljes kallëzues, për shkak se “ritmi oksiton i obligon elementet atone që të jenë në brendi të grupit”<sup>55</sup>

<sup>54</sup> Shih Ch. Bally, *Linguistique générale et linguistique française*, Bern, 1965.

<sup>55</sup> Shih Ch. Bally, vep. e cit).

### 13. Krijimi i përemrit pyetës cili dhe lidhor i cili

Mendohet se gjuha e lashtë ie. nuk do të ketë pasur përemra lidhorë, kështu që gjuhët ie. i kanë krijuar nga përemrat anaforikë a nga përemrat pyetës e të pacaktuar. Në gjuhën shqipe përemër i mirëfilltë lidhor, që është zëvendësues i të gjitha vetave, është përemri **që**, për prejardhjen e të cilit neve na duket i pranueshëm mendimi i G. Meyerit<sup>56</sup>, mbështetur edhe nga W. Meyer-Lübke (Shih Sh. Demiraj, vep. e cit., f. 512), se është huazim i përemrit lidhor të latinishtes **qui**. Se a kishte krijuar protoshqipja përemër lidhor para këtij huazimi është e pamundur të pohohet.

Për përemri **që**, që nuk është edhe pyetës, sepse nuk vjen edhe nga përemri pyetës i latinishtes **quis** e nuk është asimiluar me të si në frëngjishten e vjetër e në rumanishten, përjashtohet mundësia që të jetë i një origjine me përemrin pyetës **ç’ (çë)**. Përemri **që**, që është pa fleksion, është neutral ndaj dallimit të gjallesave e jogjallesave. Ai mund të dalë në funksion të çdo gjymtyre të fjalisë që përbën sintagmën nominale. Ky përemër del edhe në funksion të sintagës parafjalore me parafjalë të nënkuptuara, si rrethor i kohës, i vendit, i mënyrës etj. Meqë ky përemër e përjashton lidhjen me parafjalë, përdorimin e tij si SP shqipja e eviton duke përdorur përemrin e ri lidhor **i cili** me parafjalët përkatëse :

[Vajta në ditën që duhej vajtur → në të cilën duhej vajtur; me ata që rri ti → me të cilët rri ti; për atë që më flet ti → për të cilin më flet ti etj.].

Ai mënjanohet edhe në funksion të kundrinës së zhdrejtë: [Është njeri që s’ i rrihet pa folur → të cilit s’ i rrihet pa folur etj.].

Nëpërmjet kuptimit të rrethorëve, veçanërisht të plotësit të

<sup>56</sup> Në *Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache*, 1891, f. 227 e vijim.

qëllimit, që merr fjalë lidhore, mund të bëhet anulimi i funksionit anaforik e bashkë me të edhe i funksionit translativ të lidhorit **që**, i cili kalon kështu në një lidhëz të thjeshtë që u prin fjalive kompletive të kuptimeve të ndryshme. Për këtë arsye nuk mund të bëhet fjalë për prejardhje të ndryshme të përemrit lidhor **që** dhe lidhëzës **që**.

Përemri pyetës **si** është burimisht përemër pyetës për çfarësi a cilësi, që do të thotë se kishte edhe përdorim adnominal, se ishte edhe mbiemër përemëror. Si i tillë ai ka pasur, përveç formës mashkullore **si**, edhe formën femërore **so**. Forma mashkullore e këtij përemri pyetës është bërë edhe ndajfolje përemërore e mënyrës **si** (si unë, si ti etj.) dhe lidhëz mënyrore e kohore si shprehje e mungesës së nevojës për opozicion gjinië. Nëpërmjet fjalive të zhdrejta pyetëse ky përemër e përftoi kuptimin **i tillë, e tillë**: [është si mish = mish i tillë, është so bukë = bukë e tillë etj.]. Si përemër pyetës për çfarësi mund të përdorej pa emrin dhe atëherë nuk kishte pse të mos mbetej në përdorim vetëm forma **si**.

H. Pedersen i fjalën pyetëse-lidhore **si** (si je? si ti, si ai etj.) e ka parë të prejardhur nga **\*k<sup>h</sup>ei**<sup>57</sup>. Duke i konsideruar të njëjtit përemër edhe format **si, so** (me kuptimin: i tillë, e tillë.), nisur nga kjo etimologji e gjuhëtarit danez, prejardhja e formës **si** në të gjitha funksionet do të jetë nga përemri pyetës ie. **\*k<sup>h</sup>is** apo **\*k<sup>h</sup>ei** dhe **so nga \*k<sup>h</sup>eiā** opo **\*k<sup>h</sup>iā**. Përemrin **si** dhe lidhëzën **si** G. Meyeri i pa të një origjine me përemrin dëftor **si** në **si-vjet**. Hipoteza e L. Tesnière-it se të përemri pyetës i latinishtes **quis** kemi të bëjmë me gjurmë të një translativi të lashtë e të një anaforiku të vjetër **que-is**<sup>58</sup>, na shtyn të mendojmë se edhe përemri pyetës **si** mund të jetë refleks i trajtës **\*k<sup>h</sup>e-is** me elementin e dytë **is** si përemër anaforik i protoshqipes që dha përemri (**a**)**i** të shqipes së sotme.

Pedersen i ka diktuar se përemrit pyetës **cili?** në origjinë “nuk

<sup>57</sup> Në *Die Gutturale im Albanesischen*, KZ 36, f. 317 – nga përkthimi shqip i A. Dhrimos.

<sup>58</sup> në *Éléments de syntaxe structurale*, Paris, 1969, f. 121.

është tjetër veçse një **si** e lakuar” dhe se tingulli **c-** është përftuar nga **ts-** me **të** si një të përparme. Ai nuk e ka përcaktuar se ç’ rasë e përemrit **si** ishte ajo nga e cila u përftua forma **cili**. Mbasi është menduar me një të përparme, kuptohet se kjo ishte gjinorja e re e shqipes. Me këtë është përcaktuar edhe koha e fillimit të procesit të përfutimit të formave **cili**, **cila** e **i cili**, e **cila** pas krijimit të njëjës së përparme të gjinore. Nyja, që ishte paradigmatiche, shënonte rasën, gjininë dhe numrin e emrit që përcaktohej nga kjo gjinore. Mbasi **su** kishte mbetur pa fleksion rasor, funksionin e gjinore ia jepte kontakti me njëjën. Meqë nyja e gjinore shënonte gjininë e emrit të përcaktuar nga kjo gjinore: [**i** si miell? e si bukë? = miell i ç’ lloji? bukë e ç’ lloji? etj.] e meqë këtu përemri **si** nuk ishte në një gjymtyrë nominale me emrin, dilte vetëm në formën e gjiisë mashkullore.

Nga [**i** sij mish? e sij bukë?] me kuptimin: i ç’ lloji mish? e ç’ lloji bukë? u përftua gradualisht përemri pyetës : [**i** siji mish? e sija bukë? me kuptimin e sotëm: **cili mish? cila bukë?** Ky ndryshim i kuptimit u arrit paralelisht me ndryshimin e funksionit nga gjinorja ndaj emrit të përcaktuar, në mbiemër brenda grupit nominal me këtë emër dhe u përdor pastaj edhe me emra që nuk shënonin lëndë: [**i** siji djalë? e sija vajzë? të sijët djem? të sijat vajza? etj.]. Kur kaloi në mbiemër, ai mori të gjitha format rasore që i merte mbiemri i vendosur para emrit pas aglutinimit të njëjës: [**i** siji djalë?, të sijit djalë? etj.].

Duke kaluar nga përemër pyetës për cilësi a çfarësi në përemër pyetës për sende konkrete e për frymorë, ky përemër mund të dilte vetëm në trajtë të shquar, pa komutacion me njëjën zero, me njëjën **një** a me përcaktues përemërorë dhe, natyrisht, mund të dilte edhe si mbiemër i substantivuar, që e mban të katalizueshëm emrin: [**i** siji? e sija? etj. = cili? cila ? etj.]. Renditja me emrin është detyrimisht parandejtuese. Kjo flet se gjinorja e këtij përemri si dhe funksioni mbiemëror u përfatuan në këtë renditje regressive.

Nga përdorimi në fjalitë pyetëse të zhdrejta përemri pyetës **si**, **so** u bë, siç thamë, përemër dëftor në funksion mbiemëror me

kuptimin [i tillë, e tillë etj.]: [si mish = mish i tillë, so bukë = bukë e tillë etj.]. Ky përemër dëftor u bë gradualisht edhe përemër lidhor:

Pranë [si mish = mish i tillë] ishte krijuar edhe [i si mish = mishi i tillë, e si lëkurë = lëkura e tillë] me një shqese. Me kohë ky mbiemër u bë i nyjshëm dhe nyja shqese tani qëndronte para emrit e prapa mbiemri në GN-në e plotë: [i mirë i mish etj.], d.m.th. edhe [i si i mish] dhe pastaj edhe [i siji mish, e sija bukë etj.] Me një shqese postpozitive ai mund të funksiononte si mbiemër i substantivuar: [i siji, e sija, të sijët, të sijat etj.].

Në njëjës in e mashkullores u përftua si me përemrin pyetës forma [i silli] nga [i siji lloj]. Ai kaloi në përemër lidhor vetëm nga përdorimi si i substantivuar me një shqese si shprehëse të kuptimit anaforik me të cilin rekomandohet emri i caktuar, ndaj të cilit fiton edhe një nuansë të kuptimit translativ. Kështu ai ishte liruar nga bashkëvjajtja me emrin në një grup nominal.

Me një paraqitje të shkurtuar të fazave të relativizimit, d.m.th. të përfutimit të fjalisë relative ndajshtimore a përcaktuese, nisur nga struktura e thellë, mund të shihet transformimi funksional e kategoriale i këtij përemri dëftor të cilësisë në përemër lidhor:

Nga [Dua një dhomë që është e sija = e tilla] që ka dritë] me fshirje të lidhorit **që** e të këpujës **është** përftohet → [Dua një dhomë e sija ka dritë (= e cila ka dritë). etj.


Kështu u krijua një formë homofone përemërore që kishte funksionin e përemrit pyetës e lidhor.

Siç u pa, përemri lidhor në gjuhën shqipe nuk është përfutur nga përemri pyetës + nyja shqese, siç është përfutur në disa gjuhë, sepse edhe përemri pyetës cili? cila? etj. nuk përdoret pa një shqese që nga krijimi. Përemri lidhor **i cili**, **e cila** figuron i krijuar nga përemri pyetës **cili? cila?** vetëm pasi ky i dyti u bë i panyjshëm<sup>59</sup>.

<sup>59</sup> Shih zhvillimet më tërësisht në veprën B. Bokshi, *Për vetorët e shqipes*, 2004.

## 14. Krijimi i mbaresave rasore

Ne shënuam se renditja e natyrshme e përbërësve të grupit nomina (GN) Emër — Mbiemër u përftua pas aglutinimit të nyjës shquese (pusi i thellë etj.), renditje që ishte realizuar edhe në GN pa nyjë shquese, por me përcaktorë të tjerë [[[a)i pusi i thellë etj.]. Në këtë renditje në sintagmën gjenitivale përftohet mbaresa rasore që e ka shqipja edhe sot:



Forma dysegmentëshe e nyjës së mbiemrit, e krijuar në renditjen e mëparme Mbiemër - Emër: [i, e, të, së (kë)tij i të mirë pus etj.], kaloi edhe në këtë renditje.

Mbiemri i nyjshëm e kishte formën gjenitivale të nyjës si shprehje të akordimit me vlerën gjenitivale të emrit. Duke mos qenë në ballë të GN-së, nyja e mbiemrit i kishte të fiksuara të dy segmentet e saj, ndërsa para përemrit limitativ në formën e dhanores nyja ishte paradigmatiche, sepse prezantonte funksionet e emrit që përcaktohej nga gjinorja (litari i këtij pusi i të thellë, litarit të këtij pusi i të thellë etj.). Nyja e gjinores (segmenti A)shkaktonte që GN e plotë të kundrohej si dativale: [(kë)tij pusi i të thellë, (kë)saj

fushë e së gjanë, (kë)tyn pleq e të mirë, (kë)tyn nuse e të mirëe (> mira) etj.]. Ky trajtim datival i grupit të plotë nominal në sintagmën gjenitivale (SG) shkaktoi që kufiri midis Emrit e Mbiemrit të bjerë në mes dy elementeve të njëjës së mbiemrit: [i, e, të, së | (kë)tij pus i | të thellë; i, e, të, së | (kë)saj fushë e | së gjanë; i, e, të, së | (kë)tyn pleq e | të mirë; i, e, të, së | (kë)tyn nuse e | të miëe etj.]. Kështu elementi i parë i njëjës dysegmentëshe të mbiemrit brenda sintagmës gjenitivale i takoi sferës së Emrit, duke u bërë element enklitik i tij : [i, e, të, së | (kë)tij pus-i | të thellë; i, e, të, së | (kë)saj motër-e | së mire; i, e, të, së | (kë)tyn pleq-e | të mirë; i, e, të, së | këtyn nuse-e | të mirëe etj.]. Nga kjo gjendje u bë aglutinimi i saj me emrin dhe u krijua kështu mbaresa rasore për dhanoren në përdorim adnominal.

Pas krijimit të mbaresës rasore, grupi nominal (GN) datival i sintagmës gjenitivale (SG) u bë i ndryshëm nga grupi nominal datival në përdorim kundrinor:

|                |                                   |
|----------------|-----------------------------------|
| GN (SG)        | [i, e (kë)tij pus-i të thellë]    |
| GN (kundrinë)  | [(kë)tij pus të thellë]           |
| GN (SG)        | [i, e (kë)saj motër-e së mirë]    |
| GN (Jkundrinë) | [(kë)saj motër së mirë]           |
| GN (SG)        | [i, e (kë)tyn(e) pleq-e të mirë]  |
| GN (kundrinë)  | [(kë)tyn(e) pleq të mirë]         |
| GN (SG)        | [i, e (kë)tyn(e) nuse-e të mirëe] |
| GN (kundrinë)  | [këtyne) nuse të mirëe].          |

(Format e shumësit të mbiemrit **të mirëe** etj. të kësaj kohe janë para kalimit -ëe >a).

Kështu GN-ja daivale pa mbiemër del tani me dy variante: njëra me mbaresë rasore, tjetra pa mbaresë. Natyrisht varianti me mbaresë: [(kë)tij pusi etj.] ishte më ekspresiv se ai pa mbaresë :

[(kë)tij pus etj.], prandaj mbaresa u përdor edhe në dhanore jashtë sintagmës gjenitivale.

Kur u krijua mbaresa rasore si më sipër, përdorimi i saj nuk varej më nga mbiemri i nyjshëm, prandaj pas emrit më mbaresë mund të vinte edhe mbiemri i panyjshëm nga i cili nuk u krijua mbaresa: [(kë)tij djali trim etj.].

Mbasi pranë renditjes së zakonshme Përcaktor - Emër - Mbiemër (kë)tij pusi të thellë) përdorej edhe renditja e lejueshme Përcaktor - Mbiemër - Emër (kë)tij të thelli pus, në grupin nominal pa emër, mbiemri nuk mund të qëndronte segment i fundit [këtij të mirë apo këtij trim etj.] pa mbaresë rasore, por do të trajtohej si  $A_1 - M - \emptyset$  që do të thotë se edhe mbiemri do të dalë me mbaresë rasore të dhanores: [këtij të thelli, këtij trimi etj.]. Lidhja e Mbiemrit me mbaresën u bë përmes fjalëve bikategoriale emër-mbiemër. Fjala e tillë doli me mbaresë në funksion emëror në renditjen  $A_1 - E - M$ : [këtij trimi të rrallë] dhe kishte mundësi të funksiononte edhe si mbiemër: [këtij trimi djalë etj.]. Kështu në vend të këtij mbiemri të panyjshëm mund të përdorej edhe mbiemri i nyjshëm: [këtij të thelli pus etj.]. Nyja e mbiemrit edhe në dhanore të sintagmës gjenitivale ishte tani njësegmentëshe: [i.e këtij pusi të thellë], prandaj e tillë do të jetë edhe në renditjen e lejueshme [i, e këtij të thelli pus etj.].

Përdorimi i mbaresës rasore prapa segmentit të parë të gjymtyrës nominale Emër - Mbiemër apo Mbiemër - Emër dhe mungesa e saj në segmentin e dytë, pa marë parasysh a është E apo M, është rrjedhojë e mënyrës së përfimit të mbaresës, siç u tregua. Prandaj nuk mund të bëhet fjalë për rënie të mëvoshme të mbaresës rasore në segmentin e mbramë të grupit nominal.

Në mungesë të përcaktorëve e të nyjës shquese u krijua relacioni i dy emrave tërësisht të pashquar: i emrit të përcaktuar dhe i emrit përcaktues në gjinore: [(hëngra) mish viç i të mirë → (hëngra) mish viç-i të mirë, (është) lëkurë lopë e së mirë → (është) lëkurë lopë-e së mirë etj.] dhe pastaj edhe pa mbiemrin: [mish viçi, lëkurë lope etj.]. Kjo formë, që

është vetëm e gjinore së pacaktuar e jo edhe e dhanores, e realizueshme vetëm me prani të emrit të përcaktuar, gradualisht do të pasurohet me kuptimet e shumta si rasë adnominale, si gjinore dhe do të fitojë edhe kuptimin e gjinore ablativale e do të dalë edhe në përdorim adverbial si rrjedhore.

Përveç formës së dhanores brenda gjinore dhe jashtë saj, në shumës u krijua edhe një mbaresë që do të transformohet në **-sh**. Ajo u përftua si vijon:

Në vend që të përdorej forma dativale tërësisht e papërcaktuar si në numrin njëjës: [grumbull qenëve të egjër, tufë luleve të mira etj.] në shumës ishte krijuar sintagma nominale : [(pashë) një grumbull qenë **si** të egjër, (pashë) një grumbull lopë **so** të mira etj.] me kutim partitiv të emrit të dytë të ndjekur nga **si**, **so**. Ishte për-emri (a)**si**, (a)**so** me kuptimin i, e tillë: [grumbull qenë të tillë, tufë lule të tilla etj.], që ia jepte kuptimin partitiv emrit përcaktues ndaj emrit të parë. Këta përemra, edhe kur u bënë të patheksuar, mbetën në përdorim për t'ia shprehur në kontinuitet të njëjtin kuptim emrit paraprijës.

Përdorimi i përemrit **si**, **so** nuk varej nga prania e mbiemrit, kështu që Emri përcaktues në këtë sintagmë nominale, mbasi e përjash-tonte lidhjen me nyjën shquese e me përcaktorë të tjerë, nuk kishte kurr-farë shenjash me të cilët do të shprehte kuptimin partitiv, prandaj, edhe i pashoqëruar me mbiemrin, e mori me vetë segmentin që ia siguronte këtë kuptim; [(mora) tufë lule **so** # , (pashë) njerëz **si** # etj.], i cili ishte enklitik dhe u përngjiti me emrin në të njëjtën kohë kur u përngjiti edhe pjesa e nyjës dysegmentëshe për t'u bërë mbaresë rasore: [një tufë luleso të mira, një grumbull qenësi të egjër etj.]. Këto segmente të përngjitura kaluan me kohë në **-sh**: [tufë lulesh, grumbull qenësh etj.].

Nga kuptimi partitiv kjo formë mori edhe kuptimet e tjera të gjinore si atë të gjinore së prejardhjes e të gjinore ablativale, për

të dalë edhe në përdorim si rasë e rrjedhores<sup>60</sup>.

Meqë përdorimi i përemrit **si**, **so** në sintagmën gjenitivale tërësisht të pashquar nuk e lejoi procesin e krijimit të mbaresës **-e** të kësaj rase nga nyja e mbiemrit, dhanorja tërësisht e pashquar [luleve, qenëve etj.] nuk doli në shumës në funksion të gjinore së pashquar. Krahas kësaj edhe emri tërësisht i pashquar në njëjës [(mish) viçi, (lëkurë) lope etj.] e kishte interpretimin si formë e gjinore. Kjo është arsyeja pse dhanorja mbeti pa përdorim të formës tërësisht të pashquar në shumës e në njëjës, mbeti e vetmja rasë e sistemit rasor të kohës që e përjashtonte formën me një zero.

Mbaresa **-e** e dhanores në shumës për të tri gjinitë: [(kë)tyne miq-e (të mire etj.) dhe mbaresa **-i** në njëjës për gjininë mashkullore e asnjane : [(kë)tij pus-i, (të thellë), (kë)tij vesh-i (të gjatë) etj.] ishte i njëjtë me elementin e parë të njëjës shquese dysegmentëshe, në shumës **-e-të**: [trima-v-e-të djem, miq-e-të, gra-v-e-të], në njëjës **-i-të**: [lis-i-të, vesh-i-të etj.]. Kështu elementi i parë i njëjës shquese do të trajtohet si mbaresë rasore, që do të thotë se nyja shquese në këto raste i shtohet mbaresës rasore: [miqe-të, pusi-të, veshi-të etj.].

Siç kemi shënuar, forma e njëjës në dhanoren njëjës të emrave të gjinisë femërore ishte njësegmentëshë **-së**: [lopë-së etj.], kështu që mbaresa rasore **-e**: [(kë)saj lop-e etj.] nuk mund të ishte edhe në trajtën e shquar të emrit të gjinisë femërore.

Mbaresat e shënuara rasore janë përfutuar, siç shihet, më vonë se aglutinimi i njëjës shquese, sepse dolën nga renditja e re E — M , që u krijua si renditje e natyrshme vetëm pasi u aglutinua nyja shquese. Koha relative e krijimit të këtyre mbaresave rasore të shqipës përcaktohet nga këto fakte: 1. Ato e gjetën ende pa rënë **-n**-në e temës së emrave mashkullorë të tipit [pen, mullin, syn, fren etj. -

<sup>60</sup> Arsyetimet pse vetëm në këtë pozitë **-si**, **-so** kaluan në **-sh** e jo edhe në format e theksuara (a)**si**, (a)**so** e në formën e njëjës së dhanore së gjinisë femërore njëjës **së** janë në veprën B. Bokshi, *Rruga...*, f. 360-61 — botimi i dytë.

(kë)tij pen-i, (kë)tij mullin-i, (kë)tij fren-i etj.] ashtu si nyja shquese. 2. Edhe mbaresat rasore u përfatuan para se të përfundonte rotacizmi, sepse edhe ato e shkatuan: [(kë)tij peri, (kë)tij mulliri etj.]. Duke pasur parasysh edhe faktin se si në lakimin e shquar, ashtu edhe në lakimin e pashquar u përdorën të njëjtët tinguj antihiatizues e të njëjtat mënyrë të aglutinimit, shihet se koha e përfutimit të mbaresave është mjaft e afërt me kohën e aglutinimit të nyjës shquese, pra gjithashtu deri në shek. VIII, kur rotacizmi pushoi së vepruari.

Krijimi i mbaresës rasore shënon një ndryshim kualitativ të fleksionit nominal të shqipes, meqë kështu emri fitoi në përbërje të tij një element fleksiv rasor pas gjithë asaj periudhe të gjatë, që nga kontakti i shqipes me latinishten, kur kishte mbetur monemë e varur funksionalisht. Krijimi i mbaresave rasore shënon përfundimin e rrugës së bartjes së shenjave rasore nga përemri dëftor-anaforik tek emri. Kjo rrugë fillon me krijimin e nyjës shquese nga dëftori, d.m.th. pikërisht atëherë kur nuk ishte më mbaresa e vjetër rasore dhe vijon me transformimin e saj në një të përparme, për të përfunduar në mbaresë rasore.

Tipi i sistemit rasor ishte po ai që ishte edhe më parë, sepse segmenti që u bë mbaresë ishte i pranishëm si segment i papërngjitur.

Paradigma e mbaresave ishte me dy invariante rasore: sing. mashk. nom.-akuz. **-ø** ~ gen.-dativ **-i**, fem. nom.-akuz. **-ø** ~ gen.-dat. **-e**, plur. nom.-akuz. **-ø** ~ gjen.-dat. **-e**. Gjijnorja e shumësit del edhe me variantet mbaresore **-si**, **-so**, që do të përfundojnë në **-sh** nga shekulli X. Ajo si tërësisht e pashquar realizonte vetëm një pjesë të kuptimeve të gjinorës së shquar a gjysmë të shquar

Kjo paradigmë e mbaresave rasore shënonte vetëm opozicionin midis termave intensivë gjinore-dhanore dhe termave eks-tensivë emërore-kallëzore.

## 15. Amalgamimi dhe tingujt antihiatizues

Si me aglutininimin e nyjës shquese, si me segmentin e nyjës së përparme të mbiemrit që u bë mbaresë, përdoren të njëjtit tinguj antihiatizues v e j: **-v-** në shumës e në njëjtesin e gjinisë mashkullore e asnjandëse, **-j-** në njëjtesin e gjinisë femërore:

Nyja Mbaresa

**-v-**: [shokë-v-etë (kë)tyne shokë-v-e]

[shoqe-v-etë] (kë)tyne shoqe-v-e]

[ka-v-i (> kau)]

[ka-v-it (> kaut) (kë)tij ka-v-i (> kau)]

**-j-**: [be-j-e (→ be j-a) (kë)saj be-j-e]

[lule-j-e (→ lule-j-a) (kë)saj lule-j-e]

Kjo tregon se mbaresa rasore është përftuar brenda një kohe relativisht të shkurtër pas aglutinimit të nyjës shquese, kur në rrethana të njëjta fonetike ishin në përdorim të njëjtat mjete e mënyrë të aglutinimit.

Nga kjo fazë, kur kishim në emërore [ka-v- i], në dhanore [ka-v- itë] dhe [njëj ka-v-i] u përftua më vonë i njëjti rezultat **-u**: [kau, kaut, një kau]. Kjo **u** më vonë kaloi në përdorim edhe me emrat në **-k**, **-g** : [mik-u, mikut, një mik-u, zog-u, zogut, një zog-u etj.].

Për mosbarazimin e emërores së shquar njëjës të emrave të gjinisë femërore [punë + e > puna] dhe dhanores së shquar [punë+ e → pune] ne jemi shprehur se, mbasi dativin me **-i** e me **-e** nuk e pengoi homonimia me emëroren e shquar (njëj topi : topi , njëj feje: feje), as në rastin e temës paroksite në **-ë** si **punë** etj. homonimia nuk do të ishte pengesë për të përfunduar të dy format të barabarta, prandaj rezultati i

ndryshëm do të ketë qenë pasojë e distancës kohore midis përngjitjes së nyjës shquese e përngjitjes së elementit nyjor që u bë mbaresë rasore. Ne kemi menduar këtë zhvillim:

Elementi *e*, që do të bëhej mbaresë, ishte ende i paaglutinuar, kur *e* e nyjës shquese ishte aglutinuar dhe kishte krijuar formën e emërores së shquar: \*-*ëe* (punëe). Elementi që do të bëhej mbaresë si segment i veçantë kishte një shqiptim të shkëputur nga vokali fundor i temës së emrit, ndërsa nyja shquese dhe -*ë* e temës kishin shqiptim të lidhur si dy zanore brenda fjalës (-*ëe*). Shqiptimi i shkëputur do të shkaktojë elezionin e tingullit fundor -*ë* të temës në procesin e përfutimit të mbaresës rasore:

nyja në emërore: [e mirëe punë – punëe e mirë]

mbaresa në dhanore [njëj pun' e së mirë → njëj pune së mirë] etj.

Pas kësaj faze emërorja e shquar kaloi në [e mira punë] dhe [puna e mirë etj.]

Tek emrat femërorë të temës në zanore të theksuar trajta e pashquar e dhanores njëjës doli, siç u pa, e barabartë me trajtën e shquar të emërores njëjës:

Emërore e shquar - \*kala-j-e

Dhanore e pashquar - (njëj) kala-j-e etj..

Format e ndryshme që kemi sot: [kalaja - një kalaje] nuk janë rezultat i nevojës për të dalluar funksionet e ndryshme të tyre. Kalimi i formës së nyjës në rasën emërore nga -*j-e* në -*j-a* : beje → beja është kryer nën ndikimin analogjik të formës me nyjën -*a* tek emtrat si [pun-a etj. : [lopëe - beje → lopa - beje → lopa - beja]. I njëjti proces u zhvillua edhe me emrat e temës në zanoren e patheksuar -*e* : [dele-je → dele-j-a etj.]. Emrat e temave me zanore të tjera të patheksuara , që u krijuan më vonë, për analogji me emrat e shënuar dolën në emërore të njëjësit me nyjën -*a*: [trikoja, balloja etj.].

Trajtim i gjithanshëm i problematikës së përdorimi të tingujve antihiatizues tek emrat e mbiemrat është bërë në veprën Rruga.

Duhet të jetë i së njëjtës kohë përdorimi i tingujve antihiatizues edhe në sistemin foljor. Tingulli **-v-** përdoret në format njëjës të aoristit asigmatik të të dy diatezave: [la-v-a, la-v-e, la-v-i (> lau); u la-v-a, u la-v-e etj.]. Tingulli **-j-** përdoret në mënyrën urdhërore në përngjitje të trajtave të patheksuara të vetorëve të vetës së tretë: [drejto-j-e, la-j-i, thua-j-u etj.]. Te foljet edhe tingulli **-h-** përdoret si antihiatizues brenda trajtave joveprore të së tashmes, të së pakryerës e të urdhërores: [la-h-em, la-h-esh, la-h-et, la-h-emi, la-h-eni, la-h-en: la-h-esha, la-h-eshe, la-h-ej, la-h-eshim, la-h-eshit, la-h-eshin etj.; la-hu, largo-h-u, fshi-h-u etj.].

Përdorimin e njëkohshëm të tingullit antihiatizues **-v-** tek emrat e te foljet duket se e vërteton edhe përfundimi i trajtës **-vi** në **-u**: [la-vi > lau etj.], ashtu si dhe [ka-vi > kau, një ka-vi > një ka-u, ka-vi-të > ka-u-të etj.], siç ka konstatuar S. Riza<sup>61</sup>.

Tingulli antihiatizues **-h-** është më i hershëm se faza shkrimore e shqipes, por duket se nuk është i së njëjtës kohë me tingujt **-v-** e **-j-**. H. Pedersen nuk e trajton tingullin **-h-** si antihiatizues. Ai ka konsideruar se **-v-** është më i lashtë se tingulli **-j-** në funksion kundër hiatit<sup>62</sup>.

Për temën tonë nuk ka pse të shënohen përdorimet e tjera të këtyre tingujve antihiatizues në formën e fjalëve e në rrethana të sand-hit.

Se si u përftua vlera e këtyre tingujve si antihiatitues nuk shprehet Pedersen. Ato janë shënuar nga Sh. Demiraj<sup>63, 64</sup>.

<sup>61</sup> Vepra 3, f. 171 dhe *Emrat në shqipe...*, Tiranë, 1965, f. 26.

<sup>62</sup> Shih H. Pedersen, *Studime për gjuhën shqipe*, Prishtinë, 2003, f. 15 -23.

<sup>63</sup> *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996, f. 227 dhe

<sup>64</sup> K. Topalli, *Fonetika historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 399-401.

## 16. Krijimi i mbaresës së shumësit -a dhe i nyjës shquese -a

Në vijim të zhvillimeve të mbaresave të numrit, krijohet po në këtë periudhë mbaresa e shumësit **-a**

Kjo mbaresë u përftua nga krais i **-ë-së** së temës dhe i mbaresës **-e** të shumësit:

a) Te mbiemrat e nyjshëm të temës paroksitone në **-ë**:

[plur. fem. të lënë+e > të lëna, të mirë+e > të mira etj.]

b) Te mbiemrat e nyjshëm të temës neutrale në gjini si dhe te të gjithë emrat e kësaj teme:

[plur. të bukurë+e > të bukura, të lagunë+e > të laguna, të vogëlë+e > të vogëla; emënë+e > emëna, pjepënë+e > pjepëna, motërë+e > motëra, gogëlë+e > gogëla, kumbullë+e > kumbulla, dasëmë+e > dasëma, kodërë+e > kodëra etj.].

c) Te emrat e mbiemrat e nyjshëm të temës proparoksitone në konsonat+ë:

[plur. të dobëtë-e > të dobëta, të cekëtë+e > të cekëta; dorëzë+e > dorëza, petëkë+e > petëka etj.] dhe

ç) Te emrat e gjallesave të seksit femëror që nuk ishin edhe mbiemra:

[plur plakë+e > plaka, kunatë+e > kunata, arushë+e > arusha, princeshë+e > princesha, ulkonjë+e > ulkonja etj.].

Pas kësaj të gjithë emrat femërorë të prejardhur me sufiksa në **-ë** dalin në shumës me **-a**: [bubullima, ushtima, kthesa, mbaresa, kafshata, gjykata, urata, egërsina, lëvozhga, kodrina, shkretina, fletushka, hardhuca, kullota, mushkonja etj.].

Në të njëjtën kohë do të ketë dalë me **-a** edhe forma e shquar e emërores njëjës të gjinisë femërore të temave në **-ë** : [punëe > puna, lakënëe > lakëna, motëree > motëra, gogëlëe > gogëla etj.] e të mbiemrat e këtyre temave: [e miëe > e mira, e bukurëe > e bukura etj.].

## 17. Krijimi i formës së dëshirores

Duke u nisur nga përdorimi i tingujve antihiatizues, përftimi i formës së dëshirores duhet të jetë i kohës së krijimit të lakimit të shquar e të pashquar, ku përdoret tingulli **-v-** si antihiatizues, ashtu siç është përdorur edhe në formën nga e cila do të përftohej forma e dëshirores.

Neve na duket i pranueshëm mendimi se ndërtimi fillimor është bërë vetëm mbi formën e së kryerës së thjeshtë e me mbarësën e vetës së dytë njëjës **-sh** të lidhores: [shko-v-e]: [shkov-sh > shkofsh], [hape] : [hap-sh]. Përftimi i tillë i formës së dëshirores nga kontaminimi i formës së aoristit e të konjuktivit, me të cilat mund të shprehej edhe kuptimi i dëshirores, është mundësia më e bazuar. Kjo formë, përftuar origjinalisht nga veta e dytë e njëjsit, është konsoliduar me krijimin e paradigmës së plotë vetore.

Ndërtimin e dëshirores nga një aorist i lidhores e kanë parë të mundshëm Fr. Boppi e Dh. Kamarda. Edhe për H. Pedersenin kjo formë foljore bazohet tek aoristi i lidhores. Mendimi i Pedersenit se aoristi i lidhores “është ndërtuar sipas gjedhës së lidhores së tashme”<sup>65</sup>, lë të kuptohet se optativi i tillë në gjuhën shqipe u krijua në kohën kur e tashmja e lidhores kishte hyrë në masë mjaft të ndieshme në fushën funksionale të aoristit të lidhores, që ishte

<sup>65</sup> Në *Tekste shqipe* brenda veprës *Studime për gjuhën shqipe*, Prishtinë, 2003, f. 168.

ngushtuar atëherë, mbase, vetëm në funksion të dëshirores që po formohej si mënyrë e veçantë. Ndikimi i prezentit të lidhores për të bartur mbaresën e vetës së dytë **-sh**: [të rrosh] në mënyrën dëshirore që po formohej është bërë në fjalinë e pavarur, kur nuk përdorej ende pjesëza e paravendosur e lidhores **të**, që është me origjinë nga një lidhëz nënrenditëse.

Duhet pranuar se në këtë kohë, në të cilën e vendosëm përfitim të kësaj mënyre foljore për shkak të tingujve antihiatizues, nuk ishte kryer kalimi i mbaresës së vetës së dytë të lidhores (dikur edhe të dëftores) **-\*si** > **-sh**, meqë është çmuar se **-sh** përftohet nga shek. X.

## 18. Mbaresa e vetës së tretë njëjës e aoristit

Para se të përftohej mbaresa vetore e vetës së tretë **-i**: [shko-i, punoi] e prej saj edhe **-u**: [lau (< la-v-i), thau (< tha-v-i)] e pastaj edhe [preku, lagu etj.], veta e tretë njëjës e kësaj kohe dilte me mbaresë zero, siç e vërtetojnë format e vetvetores [u la, u lodh, u prek, u lag etj.] si forma të përfutuara nga trajta veprorë me pjesëzën **u**, ashtu si dhe format e aoristit sigmatik [tha, pa etj.]. Kjo mbaresë zero, sipas Pedersenit<sup>66</sup>, del pas formës së vetës së tretë njëjës të indoevropianishtes me **-e**.

Ky gjuhëtar ka besuar se kjo mbaresë “...nuk është tjetër veçse një përemër i prapangjitur, i cili është identik me nyjën” dhe se “vendi i përemrit subjekt mbas foljes është në shqipen i rregullt”<sup>67</sup>. Këtë prejar-

<sup>66</sup> *Kontribut për historinë e gjuhës shqipe, në Studime për gjuhën shqipe*, Prishtinë, 2003, f.20.

<sup>67</sup> *Die Gutturale im Albanesischen*, KZ 36 - përkthim i Ali Dhimos.

dhje nuk e panë të saktë A. Desnickaja e Sh. Demiraj. Ky mendim i Pedersenit edhe neve na duket i paqëndrueshëm:

1. Përemri dëftor, që ka shqipja, vetëm në funksion të dëftorit anaforik e në përdorim adnominal prepozitiv u bë fjalë e pafjalësuar, d.m.th. kaloi në një shquese në kohën e huazimeve të para nga latinishtja. Kjo nyjë, që u krijua e ekziston vetëm në prani të emrit e në shërbim të tij si përcaktues anaforik, nuk do të mund të kalonte në asnjë funksion tjetër, pra as në funksion të një formanti foljor enklitik.

2. Trajta kryefjalore e këtij përemri nuk mund të ishte segment dallues i formave homofone të kohëve të ndryshme në vetën e tretë. Ai do ta kishte funksionin dallues të vetës së tretë nga veta e parë dhe e dytë brenda një kohe foljore. Në të kryerën e thjeshtë, ndërkaq, përdorimi i tillë i domosdoshëm nuk ishte i nevojshëm, sepse veta e tretë ishte e dallueshme nga dy vetat e para edhe në kohën kur doli me mbaresë zero, si në diatezën veprorë, ashtu edhe në diatezën joveprorë dhe si në aoristin sigmatik, ashtu edhe në aoristin asigmatik.

3. Etimologjia e Pedersenit kundërshtohet edhe nga fakti se në pozitë pas foljes nuk do të ishte vetëm përemri i gjinisë mashkullore, por edhe ai i gjinisë femërore e asnjansë, kështu që në procesin e aglutinimit e pas tij do të kishim trashëguar mbaresa të ndryshme varësisht nga gjinia e kryefjalës<sup>68</sup>.

Këto variante të mbaresës vetore A. Desnickaja i pa të përftuara nga tingulli **-i** si tingull epitetik, që e fuqizon dhe e përforcon formën e foljes<sup>69</sup>. Si tingull epitetik zanorja **-i** ishte përdorur edhe jashtë vetës së tretë njëjës të së kryerës së thjeshtë, kështu që e bën të bazuar mendimin e Desnickajas për një origjinë të tillë të kësaj mbarese të aoristit. Përdorimin a mospërdorimin e kësaj mbarese

<sup>68</sup> Në veprën B. Bokshi, *Për vectorët e shqipes*, f. 20-21 konstatohet si i përealizueshëm virilizimi, d.m.th. përgjithësimi i formës mashkullore.

<sup>69</sup> Në A.V. Desnickaja, *Proishozhdenii nekotoryh elementov albanskoj fleksii*, Balkansko ezykoznanie 3, Sofia, 1976.

Desnickaja e lidhi edhe me nevojën për barazim “të strukturës rrokjesore” të formave joveprore e veprore të vetës së tretë<sup>70</sup>.

Shembujt si [shko-i, puno-i, kalo-i etj.] tregojnë se mbaresa **-i** u përftua kur nuk ishte diftonguar ende zanorja e theksuar e temës **-o**, ndërsa shembujt si [bëri, zuri, pruri etj.] tregojnë se kjo mbaresë u përftua para se të përfundonte procesi i rotacizmit. Përdorimi i tingullit antihiatizues **-v-** [la-v-a, la-v-e, pre-v-a, pre-v-e, puno-v-a, puno-v-e etj.] i bën këto mbaresa të jenë të përfuara afër kohës kur ishte përmgjitur nyja shquese e kur ishin krijuan mbaresat rasore, mbasi u përdor i njëjti tingull antihiatizues. Shembujt e aoristit sigmatik, në të cilin nuk përdoret tingulli antihiatizues, e nxjerrin më të hershme jo vetëm mbaresën **-ë** të vetës së parë të njëjësit, por edhe mbaresën e vetës së dytë **-e**: [ti pa-e, ti tha-e, ti ra-e etj.].

Tingull antihiatizues kanë marrë edhe format e vetës së tretë njëjës : [la-v-i > lav > lau, pa-v-i > pav > pau, pre-v-i > prev > preu (si ka-v-i > kav > kau, dhe-v-i > dhev > dheu etj.). Ky variant kontekstual **-u** i mbaresës së vetës së tretë kaloi pastaj në përdorim edhe me temat në bashkëtingëlloret **-k**, **-g** si tek emrat. Pa tingull antihiatizues në vetën e tretë dolën foljet e temës në **-o**: [shkoi, punoi etj.], për arsye se bashkimi i këtyre zanoreve nuk formonte diftong në këtë kohë (si tek emrat ftoi, kroi etj.).

## 19. Për kohën e veprimit të rotacizmit

Rotacizmi në toskërishte ka filluar të veprojë pas rënies së tingullit **-n** nga tema oksitone e emrave me përfundim në **-on** :

<sup>70</sup> Për më detajisht shih Desnickaja, Vep. e cit., f. 20-25.

[kron , përron, fton etj.], pas përngjitjes së nyjës shquese dhe pas krijimit të mbaresës rasore, sepse këto elemente fleksive nuk e gjetën **-n-në** e emrave të shënuar: [kro-i, një kro-i, përro-i, një përro-i, fto-i, një fto-i etj.], ndërsa **-n-në** prapa zanoreve të tjera e gjetën pa rënë: [pen-i, një pen-i, fren-i, një fren-i, syn-i, një syn-i etj.]. Pas kësaj gjendjeje fillon procesi i rotacizimit të **-n-së** së këtyre formave, për shkak të pozitës së saj midis zanores së temës dhe nyjës shquese a mbaresës rasore.

Meqë edhe nga nyja shquese edhe nga mbaresa rasore u përftua rotacizmi: [peri, një peri, syri, një syri etj.], duket e sigurt që ky proces ka filluar në të dy rastet në të njëjtën kohë, d.m.th. pas përfimit të mbaresës rasore. Kuptohet se kjo vlen edhe për rastet e tjera, në të cilat **-n-ja** ndodhej në pozitë intervokalike si p.sh.: [ranë, tërshanë, gërshanë etj.].

Rotacizimin e **-n-së** e ka shkaktuar edhe mbaresa **-i** e vetës së tretë njëjës të aoristit, që do të thotë se format bëri, pruri etj. u përfuan mbas kohës së përdorimit të kësaj mbaresë të re që erdhi në vend të mbaresës zero.

Rotacizmi ka përfunduar në shek. VIII, siç jemi shprehur më parë, kështu që fillimet e tij del të kenë qenë të përafërta me këtë shekull, d.m.th. më së largu në përfundim të shek. VII.

## **Shënim:**

Në këtë periudhë nga fillimi i shekullit të gjashtë deri në fund të shekullit të tetë, siç u pa, ndodhën ndryshime thelbësore në strukturën e sistemit nominal të shqipes. Edhe kjo është periudhë e një strukturimi tërësisht të veçantë nga gjuhët e tjera simotra, koha e lëvizjeve sistemore që e theksuan individualitetin e saj në sistemet nominale. Kjo tregon se këto zhvillime u bënë edhe në këtë kohë pa ndikim të jashtëm, pa ndikim të gjuhëve në kontakt.

Ndryshimi kryesor që u bë në këtë periudhë është krijimi i njëjës së përparme të mbiemrit e të gjinores. Përftimi i kësaj nyje pa efekt shques në një kategori mbiemrash e në dhanoren e përdorur në funksion ndajemëror shkaktoi zhvendosjen e njëjës shquese pra-pa mbiemrit në grupin e plotë nominal: Mbiemër - Njëjës shquese + Emër, ku u bë edhe aglutinimi i saj me mbiemrin dhe u krijua renditja e zakonshme Emër + njëjës – Mbiemër. Kjo renditje shkaktoi krijimin e mbaresave rasore, duke e kthyer strukturën e shqipes në strukturë sintetike - analitike nga struktura e plotë analitike që e pati që nga koha e kontakteve të para me latinishten. Kështu agjensi i këtij ndryshimi të madh strukturor të shqipes është përftimi i njëjës së përparme.

### III. ZVILLIMET NË SHEKUJT IX - XII

#### 1. Gjymtyra nominale me përemrin si, so

Ne shënuam se **si, so** ishin origjinalisht forma të një përemri pyetës, i cili nëpërmjet fjalive pyetëse të tërthorta kaloi në përemër dëftor me kuptim [i tillë, e tillë]. Këtë kuptim ky përemër e përftoi pas aglutinimit të nyjës shquese dhe funksionoi si mbiemër në të gjitha gjymtyrat nominale (MN):

SN (attributive) [(është) si viç, so lopë]

[(janë)si viça, so lopë]

[(duket)si viç, so lopë]

[(quhet) si viç, so lopë]

SN (partitive) [(bleva)si mish, so bukë]

SN (SP) [ën | si pus / so shpellë / si pusa / so shpella]

[për | si shok / so motër / si shokë / so motra]

[me | si mik / so mikeshë / si miq / so mikësja].

Në këto përdorime gjymtyra nominale me **si, so** e përjashtonte përdorimin e emrit me përcaktorë.

Si mbiemër përemëror **si, so** [= i tillë, e tillë] hyri në gjymtyrën nominale (MN) nëpërmjet përdorimit pleonastik: [mora so – mora molla – mora so molla] edhe ndaj MN–së së plotë: [mora të mira molla – mora

so të mira molla (= mora të tilla të mira molla ).Kjo është gjendja kur ky mbiemër përemëror ishte sinkretik në rasa.

Kur u krijuan mbaresat rasore emri në këto gjymtyra nominale (MN) doli me mbaresë rasore zero, sepse e kishte vlerën e rasave emërore e kallëzore. Përemri [si, so] doli tani në vend të përcaktuesit të emrit, pasi qëndronte para emrit me mbresë : [si pusø, so delmeø etj. siç ishte edhe prapa përemrit [ky pusø, kjo delmeø etj.]. Por ky kalim i premrit [si, so] nga mbiemri në përcaktues u shpreh vetëm në rrafsh të shenjave, sepse ai e ruajti kuptimin [i tillë , e tillë], që domethënë se emri mbeti edhe më tutje i pakonkretizuar.

Emri në gjinore doli me mbaresë materiale: [(mish) viçi / lope, (tufë) delesh / lulesh etj.] dhe kaloi si SP ablativale me parafjalë zero: [largohu lope / viçi / lopësh, / viçash etj.]. Kështu u krijua edhe një MN e tillë ku do të përdoret edhe përemri **si, so** : [largohu (kë)si viçi / (kë)so lope / (kë)si viçash / (kë)so lopësh etj.] me kuptim: [prej | viçi të tillë / lope së tillë/ viçash të tillë/ lopësh të tilla]. Nga [ik si viçi / so lope] kjo formë e rrjedhore u kalua edhe në gjinoren e pashquar : [mish si viçi / so lope, lëkurë si viçash / so lopësh etj.].

Ky mbiemër përemëror, i përdorur në shumës edhe në MN-në partitive: [tufë lulesh – tufë so lulesh, grumbull viçash – grumbull si viçash etj.] doli i lidhur me formën e rrjedhore së emrit jashtë kuptimit ablatival, kështu që u çel rruga të dalë edhe brenda sintagmës verbale e të sintagmës parafjalore partitive: [janë si viçash, so mollësh, bleva so mollësh, pashë si burrash etj. (= lopë të tilla, burra të tillë etj. Tani gjymtyra nominale me [si, so] realizonte funksionin e rasës emërore e kallëzore, duke nxjerrë jashtë përdorimit formën me mbaresë zero.Kjo do të thotë se neutraliteti në rasë që kishte përemri **si, so** kaloi në neutralitet të formës ablativale të emrit. Kështu sikurse [si, so] që dilnin në vlerën e çdo rase të SN-së që mund të prezentohej nga MN-ja, ashtu doli tani edhe [si viçi, si mielli, so lope, si viçash,so lopësh etj.]. Ajo nuk mund të dilte në vlerë të rasës dhanore, mbasi emri në dhanore nuk mund të ishte tërësisht i pashquar, d.m.th. me një zero.

## 2. Krijimi i sintagmave parafjalore

### a. Krijimi i SP-së ablativale

Në paradigmen e mbaresave rasore u krijuan vetëm forma për rasat e quajtura “gramatikore”: emërore, gjinore, dhanore e kallëzore e jo edhe për ndonjë nga rasat “lokativale”, që do të thotë se nuk u krijua formë e veçantë as për rasën rrjedhore. Kuptimi i rrjedhores realizohej nga rasa kallëzore me parafjalët prej e ën, sepse kjo ishte ende e vetmja rasë që dilte në relacion me parafjalët e kohës, të cilat shënonin kuptimet e plotësve të ndryshëm rrethorë.

Siç kemi shënuar, vlerën e rrjedhores do ta marrin format tërësisht të pashquara, të pakonkretizuara të gjinores në njëjës e në shumës: [mish **viçi** – lëkurë **lope**, grumbull **viçash**, kope **delesh** etj.]. Duke u nisur nga kuptimi primar partitiv (në shumës) e kualifikativ (në njëjës) këto forma u pasuruan me kuptimet e shumta të gjinores dhe morën edhe kuptimin e prejardhjes e të origjinës e pastaj edhe të gjinores ablativale. Nga ky kuptim kjo formë e gjinores kaloi në përdorim adverbial, d.m.th. mori funksionin e një sintagme parafjalore (SP) me parafjalë zero: [u nda / shokësh, shoqesh etj., i dam prindi, doli feje, me dam renë vjehre etj.], u bë rasë rrjedhore.

Parafjalët e para të rrjedhores janë parafjalët **ën** dhe **prej**. Me krijimin e rrjedhores si sintagmë parafjalore pa parafjalë nuk mund të qëndronte më SP-ja me SN akuzativale e me parafjalën **prej**: [doli \*prej shtëpinë, doli \*prej shtëpi, u largua \*prej shokët, u largua \*prej këta shokë, u nda \*prej shokë etj.], që shprehte kuptimin e rrjedhores përmes parafjalës. SP ablativale me parafjalë zero dhe parafjala **prej** ishin të barabarta në anën kuptimore, prandaj kjo parafjalë do të seleksionohej tani nga kjo SP ablativale.

Relacioni i tyre sintaksor ishte relacion seleksioni, në të cilin SP pa parafjalë ishte segmenti konstant, ndërsa parafjala **prej** - variabil, i përdorshëm në funksion distinktiv për të penguar çdo konfuzion.

Parafjala **ën**, kur përdorej me akuzativin e kishte kuptimin vendor si parafjala e sotme **në** (siç e tregon lidhja e saj me parafjalën latine *en* > *in* e greke *εν*). Në bashkëvajtje me njëjën shquese prepozitive të emrit, kur nuk përdorej mbiemri, kjo parafjalë, siç shënuam, u aglutinua me këtë njëjë në formë të kallëzores: [ën të pus → ëntë pus] dhe u bë edhe formë e njëjës shquese në kallëzore të njëjësit Varianti **ën** mbeti në përdorim me trajtën e pashquar të emrit dhe gradualisht u përjashtua nga përdorimi me kallëzoren dhe kaloi në përdorim me rrjedhoren, duke u bërë sinonimike me parafjalën **prej**, siç dëshmohet te Buzuku<sup>71</sup>.

Sintagma parafjalore e rrjedhores, që u përftua nga gjinorja tërësisht e pashquar, si plotës rrethanor kërkonte që emri brenda saj të ketë edhe kuptimin e shquar. Kështu në funksion të rrjedhores nyja zero fiton edhe funksionin e njëjës shquese. Këtë vlerë të dyfishtë nyja zero nuk mund ta kishte në përdorim adnominal. Aty nyja zero do të vazhdojë të shënojë vetëm kuptimin abstrakt, sepse për kuptimin konkret e kishte formën e shquar të gjinorës: mish i viçit, mish i lopes etj. Nga burimi i tillë kuptohet pse rrjedhorja nuk ka trajtë të shquar, d.m.th. nuk ka trajtë me njëjës shquese. Format : [prej fejet, prej lisit, lisashit etj, e kanë -t(ë)-në njëjës të aglutinuar mekanikisht, d.m.th. pa efekt konkretizimi.

### ***b. Krijimi i SP-së dativale***

Pas aglutinimit të njëjës shquese e pas krijimit të mbaresave

<sup>71</sup> Se si u bë ky kalim shih B. Bokshi, Vep. e cit. f. 382- 86.

rasore emri në dhanore, që, në përdorim adverbial ishte vetëm kundrinë e zhdrejtë, filloi ngadalë të dalë edhe në funksione të sintagmës parafjalore pa parafjalë e pastaj edhe me parafjalë përkatëse.

Në kuadër të foljeve me tipar [+ Transitiv] ka folje që e seleksionojnë kundrinën e drejtë, por jo edhe kundrinën e zhdrejtë. Folje të tilla janë foljet transitive që e kanë tiparin tjetër [- Atributiv]. Transformimi i parë i dhanores kundrinore në SP u përftua nga përdorimi i saj me folje të tilla, për arsye të një lidhjeje analogjike që e shkakton tipari i përbashkët [+ Transitiv] midis foljes me tipar [+ Atributiv] dhe foljes me tipar [- Atributiv]. Kështu nga:

1. [i dërgova letër Pjetrit]

[i hapa derën mikut]

u bë e mundur të kalohej në:

2. [i dëgjova zërin mikut]

[i hëngra bukën Pjetrit]

[i përgatita ushqimin djalit].

Me foljet e dyta (dëgjova, hëngra, përgatita), që janë folje kalimtare, por që e kanë tiparin [- Atributiv] dhanorja nuk është në funksion të kundrinës së zhdrejtë si me foljet në shembujt e parë (dërgova, hapa) që e kanë tiparin [+ Atributiv], që e seleksionojnë edhe kundrinën e zhdrejtë. Në shembujt e dytë dhanorja e ka funksionin e plotësit të pronës, d.m.th. funksionin e një sintagme parafjalore pa parafjalë. Nga ky plotës përftohet lehtë edhe plotësi etik a i dobisë: [Pjetrit i u kthye djali nga ushtria, Pjetrit iu arratis djali etj.]. Përdorimi i plotësit të pronës dhe i plotësit etik a i dobisë, si SP që janë, nuk varet nga tiparet [ $\pm$  Transitive] të foljeve. Ato mund të përdoren pra edhe me folje jokalimtare: [Palit i shkoi djali ushtar; Palit i vdiq kunati; Palit i ra gripi etj.].

Emri në dhanore si kundrinë e zhdrejtë u transformua edhe në plotës rrethanor kur e kishte tiparin [+ Vend] apo [+ Kohë], siç është paraqitur në vep. e cituar (f. 389- 91).

Si SP dativale ajo do të dalë pa u shoqëruar nga trajta e shkurtër e përemrit vetëm kur emri i saj shënon një hapësirë nëpër të cilën bëhet lëvizja që shënon folja: [shkoi / fushës, pyjeve; eci rrugës, malit etj.]. Me emra të tjerë, që tregojnë pikën e përfundimit të veprimit të foljeve, do të ruhet lidhja formale kundrinore: [i shkoi shtëpisë afër, i doli lumit matanë] etj.

Kalimi i ndajfoljeve të vendit në funksion të parafjalëve me dhanoren u bë i mundur kur u krijua kuptimi “lokativ” i kësaj rase, d.m.th. kur u bë SP pa parafjalë. Si ndajfolje vendi këto përbëjnë SP pa SN (sintagmë nominale). Dike kaluar në parafjalë, kuptimi vendor i tyre do të perceptohet tani në relacion me Emrin në dhanore, në vend të SN –së së tyre të nënkuptueshme kur janë ndajfolje. Kështu nga:

|         |   |                         |
|---------|---|-------------------------|
| [shkova | } | larg, afër, jashtë etj. |
| [rri    |   |                         |

u kalua në:

|         |   |                    |   |             |
|---------|---|--------------------|---|-------------|
| [shkova | } | larg, afër, jashtë | { | shtëpisë    |
| [rri    |   |                    |   | qytetit     |
|         |   |                    | } | pyllit etj. |

SP e tillë me parafjalë ishte tani një mundësi e re për të pasivizuar përdorimin formal kundrinor të SP-së dativale pa parafjalë.

Nga sa u shënuar për përfitim të SP-së nga SN-ja dativale kundrinë e zhdrejtë del se kjo SP pati mundësi të kishte strukturë të dyfishtë : 1. pa parafjalë, në rastet e emrave që përnbanin kuptimin e hapësirës dhe në rastet me prani të trajtës së shkurtër të përemrit dhe 2. me parafjalë, kur emri shënon cakun e veprimit të foljes.

SN e dhanores, duke u bërë SP, seleksionohet nga foljet me tipar [± Transitiv] dhe duhet të realizonte edhe kuptimin abstrakt të emrit, sepse si SP ishte e liruar nga raporti kundrinor me foljen, që kërkonte realizimin e kuptimit konkret me prani të njëjës shquese

(djalit, vajzës, djemvet, vajzavet) a të përcaktorëve përemërorë (këtij djali, kësaj vajze, këtyne djemve, këtyne vajzave) dhe gjysmë të shquar me prani të njëjës joshquese **një** etj. Meqë SP e dhanores u përftua nga dhanorja kundrinë e zhdrejtë, nuk pati si të dalë forma me mbaresë zero, kështu që kuptimin abstrakt të emrit në këtë SP do ta realizojë forma me një shquese, e cila kështu do të dalë me dy kuptime të polarizuara: me kuptimin konkret si një shquese dhe me kuptimin abstrakt si një zero. Kjo vlerë e dyfishtë e njëjës shquese në dativin e sintagmës patafjalore ka mbetur edhe sot.

Në rastin e disa emrave me tipar [+ Kohë] kundrina dativale kalon në SP [**dimrit** ditët janë të shkurtëra, **verës** këtu bën shumë vapë etj.], nëpër të njëjtën rrugë si në rastin e emrave me tipar [+ Vend]: [eci fushës, kaloi kodrave etj.]

Kur u krijua SP dativale, u krijua edhe SP akuzativale pa para-fjalë nga funksioni i kundrinës së drejtë. Në këtë kalim, që është i kufizuar vetëm te disa emra me tipar [+ Kohë]: [shkova / natën, ditën, një natë, një ditë] shihet se kallëzorja ishte vetëm SP pa para-fjalë. Shembujt si [për natë, për ditë, për herë, me natë etj.] morën vlerën e plotësit të kohës nga vlera e mëparme e plotësit të rrethanës.

### 3. Sistemi rasor

Rrjedhorja ishte rasa pivot e sistemi të rasave në këtë kohë, sepse shënonte kuptimin e një fushe të zonës semantike të drejtimit, kuptimin e largimit nga një pikë pa drejtimit, prandaj përbënte termin **a** të sistemit.

Krijimi i rrjedhores në mënyrën e treguar shkaktoi që kallëzorja të lirohet nga kuptim i largimit, të cilin më parë e realizonte si SP me pa-

rafjalët **prej** e **en** (prej + kallëzore = largim). Duke kaluar këto parafjalë në reksion me rrjedhoren, kallëzorja si SN e SP-së mbeti të toleronte tani vetëm bashkëvajtjen me parafjalët që shprehin kuptimin e afrimit e të të qëndruarit. SI kundrinë e drejtë shprehte si më parë kuptimin e afrimit e si kundrinë partitive [hëngra mish, bleva qengja etj.] - kuptimin e largimit. Në këto rrethana kallëzorja vinte theks mbi kuptimin e afrimit përkundër kuptimit të të qëndruarit, prandaj përbënte termin ekstensiv B të sistemit.

Emërorja vinte theksi mbi kuptimin e largimit që ia shkatonte funksioni i saj kryesor, funksioni i kryefjalë, prandaj përbënte termin  $\beta$ .

Lëvizja e dhanores në drejtim të zgjerimit të saj funksional nëpër rrugën e treguar është shprehje e sistemit të ri të rasave që po përfitohej në planin kuptimor. Procesi i krijimit të rrjedhores si rasa më intensive mundësoi që në të njëjtën kohë të kryhej procesi i ekstensionimit të dhanores, që qe rasa pivot e sistemit të mëparmë. Si kundrinë e zhdrejtë dhanorja shënonte një kuptim afrimi e si SP shprehte kuptimin e një alativi: [shkoi / afër, para, pas shtëpisë etj.] të kryqëzuar me kuptimin e të qëndruarit: [është / rri / afër, para, pas shtëpisë etj.]. Kështu dhanorja përbënte termin opozitar ekstensiv A të këtij sistemi.

Gjinorja, që nuk dilte më me një zero, sepse ajo tani kundrohej si rrjedhore adnominale, shprehte prapë kuptimet e tri fushave të drejtimit, duke vënë theks mbi fushën e afrimit e të largimit përkundër fushës së qëndrimit. Kështu gjinorja shënonte termin  $\gamma$  si në sistemin e kaluar.

Ky sistem duket si më poshtë:

*a* Ablativ

A Dativ

$\beta$  Nominativ

B Akuzativ

$\gamma$  Genitiv

Sipas kësaj shihet se ky sistem shënon një ndryshim të madh të sistemit të rasave, bazuar në rrafshin kuptimor. Ndërsa në sistemet e mëparme, që nga humbja e mbaresave rasore të tipit të gjuhës së lashtë IE e deri në sistemin para këtij u bënë ndryshime të mjeteve e të lëvizjes së tyre në varg, në këtë sistem u bënë ndryshime funksionale, përkatësisht kuptimore të formave ekzistuese si rezultat i krijimit të mbaresës rasore. Në sintagmatikë ndryshimi më i madh shprehet në përbërjen e SP-së. Kjo klasë, përveç SN-së akuzativale kishte tani në përbërje të saj edhe SN-në ablativale e dativale (SN nominativale do të hyjë më vonë). Dy të fundit dalin edhe si SP pa parafjalë, kështu që relacioni i tyre me parafjalët ishte relacion seleksioni, kurse SN akuzativale (si dhe SP nominativale më vonë), që nuk del si SP pa parafjalë (përveç në rastin tepër të kufizuar me emrat e tiparit [+ Kohë]), është në relacion solidariteti me parafjalët përkatëse.

#### 4. Humbja e pronorëve të vjetër

Përemrat vetorë në rasat e varura dhe pronorët në gjuhën ie. ndërtoheshin nga një rrënjë e përbashkët. Pronori tërë paradigmen rasore e kishte të ndërtuar mbi një rrënjë. Kuptimet rasore shpreheshin me anë të mbaresave. Pas humbjes së fleksionit dezincencial rasor në gjuhën shqipe, pronori mbeti pa forma të diferencuara rasore. Meqë i njëjti proces ndodhi edhe me përemrat vetorë, rasat e varura në këtë kohë u unifikuan, duke mbetur opozicioni i tyre vetëm me nominativin që kishte tjetër temë a vokal të theksuar (khs. unë : mua, ti : ty)dhe me format **me**, **te**.

Kështu përemri pronor në emërore njëjës, prona njëjës [\*mēnōs] do të kishte kaluar në këtë kohë në formën [\*mon]. Me të njëjtat forma doli edhe vetori në dhanore: \*mon (< mēn) dhe në kallëzore \*mon (< mēn < mēnōm). Pronori i vetës së dytë njëjës, prona njëjës do të ketë qenë në emëroren njëjës mashk. [\*tuiōs (fem. tuiā )] e do të ketë kaluar në mashk.[tui > ty (fem. tuiē > tui > ty), ashtu si dhe dhanorja e vetorit përkatës [tui > ty]. Pronori i vetës së parë shumë do ta ketë pasur këtë zhvillim: prona njëjës: emërore [\*nōōs > \*nōs] në kohën që po e shqyrtojmë do të ketë qenë [ne], kështu që nuk do të dallohej nga vetori përkatës [na, ne] (emërore \*nōs > na, kallëzore \*nōs > ne).

Me barazimin e formave të pronorit me formën e dhanores së vetorit (a edhe të kallëzores), realizuar me modifikim të temës, forma e përbashkët nuk mund ta kishte më kuptimin e pronorit. Duke dalë i barabartë me vectorin, pronori i kishte humbur elemente që shprehnin pronën, prandaj ai tani nuk mund të funksiononte si pronor. Në procesin e humbjes së pronorëve të vjetër po krijohet lokucioni përemëror pronor nga relacioni i dëftorit me vectorin në rasën dhanore, në krijim të pronorëve me segmente të përngjitura.

Unifikimi i formave të pronorit e të vetorit si më sipër është bërë pas kalimit të zanoreve të tipit ie. në zanore të shqipes. Kjo do të thotë se është bërë menjëherë pas përfundimit të huazimeve latine. Pronorët e rinj me përngjitje të segmenteve përbërëse [jonë, tanë, tonë etj.] janë krijuar pas përfundimit të rotacizmit, kështu që në kohën deri në krijim të tyre kuptimin e posesivitetit do ta kenë realizuar format e trashëguara të pronorëve të mi, të tu, forma e gjinore së vectorëve me dominim të lokucionit përemëror pronor të përbërë nga përemri dëftor në çfarëdo rase e përemri vector në rasën dhanore: [í mon, í ty, ó ty (jot), ta ne, to ju etj. me të dy përemrat të theksuar.

## 6. Krijimi i pronorëve të rinj

a) Nga gjinorja e vetës së tretë të përemrave vetorë: [i,e,të,së / tij, saj, tyre], nëpërmjet mbiemërorizimit të saj u përftua rasia emërore e përemrit pronor: [i tiji, e tija, i saji, e saja, i tyre, e tyre] që në kohën e aglutinimit të nyjës shquese. Pjesa [tij, saj, tyre], si dhanore e vetorit, shënon pronarin, ndërsa nyja e gjinores jep kuptimin e pronës bashkë me emrin. Formë të gjinores kanë edhe përemrat vetorë të vetës së parë e të dytë: [i, e, të, së | mua / ty / neve / juve]. Gjinorja e tyre nuk u adjektiviuua e nuk kaloi në pronor, sepse gradualisht në rrugë tjetër u krijuan pronorët [im, yt, jonë, juaj].

b) Me krijimin e mbiemrit të nyjshëm u bënë të nyjshëm edhe mbiemrat pronorë *mi, tu*: [të mi, të mia, të tu, të tua].

Format [mi, tu] janë mbetje të vetme të pronorëve të vjetër, që dilnin vetëm në përdorim si mbiemra në bashkëvajtje me emrin, siç dilnin mbiemrat më të mëdha defektive (keq, mirë etj.) dhe u bënë të nyjshëm në një kohë me ta. Këta mbajnë një kuptim të shumësit të pronës, prandaj seleksionohen vetëm nga emri në numrin shumë.

Me emrat e vjetër të farefisit këta mbiemra pronorë mbetën në lidhje e në renditje të moçme : [të mi / të tu vëllezër, të mi / të tu motra etj.]. Meqë ishte një intensitet i theksuar i përdorimit të dy segmenteve bashkë (M - E) nuk u lejua të përdorej nyja shquese para emrit për t' u përngjitur me mbiemrin si në raste të tjera. Grupi i tillë nominal me emra farefisi pa një shquese ishte bërë jashtësistemor, me lidhje të veçantë të mbiemrit e të emrit. Ky grup nominal mbeti pa u përmbledhur në zhvillimet që pësonin grupet nominale (GN) me emra të tjerë. Pas reduktimit të zanores së nyjës e pas krijimit të mbaresës rasore, emri i vjetër i farefisit, vetëm në bashkëvajtje me këta mbiemra pronorë doli alternativisht

edhe me mbaresë rasore : [të mi vëllëzërve, të mi motrave etj., në kundërshtim me GN-të e tjera ku segmenti i dytë është pa mbaresë rasore.

c) Pronorët me pjesë të përngjitura [im, em(e), yt, jot(e), ynë, jonë, juaj, yj, tanë, tonë etj.] elementin e dytë e kanë në formë të fiksuar, ndërsa elementin e parë e kanë paradigmatic si grup elementesh të numrit, të rasës e të gjinisë. Kuptimi i numrit njëjës të vetës së parë e të dytë është në solidaritet me kuptimin e numrit njëjës të pronës : [im, yt, em(e), jot(e)], kështu që forma të përngjitura të këtyre përemrave me kuptim të pronës në numrin shumëz nuk janë formuar, pasi shqipja i ruajti format e pronorit origjinal [mi, tu].

Këta përemra janë përftuar nga bashkimi i përemrit dëftor dhe përemrit vetor në rasën dhanore: [í mon → im, í ty → yt, ó ty → jot(e), ó ne → jonë, tá ne → tanë, tó ne → ton(a) etj.]. Disa nga këta përemra e kanë ndryshuar formën burimore nën ndikimet e paradigmes rasore.

Kuptohet se dëftori e vetori ishin të theksuar. Kuptimi i pronësisë, që dilte nga raporti i dy përemrave, të cilët rekomandonin pronën e pronarin, ishte element koheziv që i dha vlerën e një lokucioni përemëror pronor, siç ka vlerësuar Fr. Boppi, pranuar edhe nga Dh. Kamarda. Ky lokucion do ta pësonte gradualisht adaptimin fonetik në drejtim të përngjitjes, prandaj vetori, që zinte vendin e dytë, e humbi shkallë-shkallë theksimin dhe e pësoi reduktimin a rënien e zanores. Huambja graduale e theksimit të elementit të dytë të këtij lokucioni kishte filluar në kohën kur ende ishte renditja regresive e sigmenteve të ndryshme sintagmatike, renditje që lejonte theksimin e elementit të parë, dëm.th. para se të aglutinohej nyja shquese, që shkaktoi krijimin e renditjes progressive, ku do të theksohej segmenti i dytë.

Konglutinimi i pjesëve të këtyre përemrave është bërë pas përfundimit të rotacizmit (khs. tanë, tonë, ynë, jonë etj.). Përemri pronor **juoj** është përftuar nga **jo-ju** > **joj** > **juoj**, ashtu si dhe **tuaj** nga **to-ju**, **suaj** nga **so-ju**. Nga kjo del se konglutinimi i pjesëve përbërëse të pronorëve është bërë para diftongimit të **-o-së**. Kështu

koha më e hershme e formimit të pronorëve të tillë është shekulli IX si shekull i parë pa veprim të rotacizmit.

Forma e përemrit pronor vetvetor [i / e vet, i veti, e veta, të vetët, të vetat] është përfutur nga përemri identifikues **vetë** në përdorim përfortues ndaj emrit dhe përemrit vetor-dëftor në rasën gjinore: [i vetë atij djali, e vetë asaj vajze, i vetë atyre burrave / grave; i vetë atij / asaj / atyre; i vetë djalit / vajzës, i vet burravet / gravet etj.].

Përemri **vetë**, duke qenë pa fleksion e në funksion ndajshtimor ndaj emrit, rekomandonte të njëjtin vetë që shënonte emri (vetën e tretë) e jo edhe vetë tjetër .

## 6. Rënia e -n-së prapa zanoreve përveç -o-së tek emrat e te pjesorja

Rënia e tingullit fundor **-n** prapa zanoreve, përveç **-o-së**, te emrat e temës oksitone është bërë pas krijimit të mbaresave rasore, sepse edhe ato e gjetën pa rënë: [një peni, një freni, një mullini, një syni, një dryni etj.]. Ajo ra nga emërorja e kallëzorja mbasi këtu mbarësa ishte zero<sup>72</sup>. Rënia e **-n-së** në këto rasa është kryer para përfundimit të rotacizmit që e shkaktuan edhe nyja shquese edhe mbarësa rasore: [peri] dhe [një peri etj.].

Kuptohet se **-n** ka rënë në këtë kohë edhe nga pjesorja pësore e së kryerës: [ka thyen > ka thye, ka pan > ka pa, ka pren > ka pre, ka pin > ka pi etj.]. E tillë ishte tani edhe forma mashkullore e mbiemrit prejpjesor: [i thye ~ e thye-në, i la ~ e la-në, i pre ~ e pre-në etj.]. Kjo pjesore në zanore

<sup>72</sup> Ky tingull fundor i temës u ruajt nga nyja shquese edhe në tasën emërore.

e në diftong qëndroi pa prapashtesë dytësore para përfundimit të rotacizimit, që domethënë se ishte e tërë shqipes dhe vijoi të qëndrojë e tillë deri pas diftongimit të **-o-së**, që konsiderohet të jetë kryer aty nga shekulli X. Brenda kësaj kohe në disa të folme të gegërishtes u përlligj forma pa prapashtesë e kësaj pjesoreje dhe vazhdoi edhe pas diftongimit të **-o-së** e deri në ditët tona.

Pas kalimit të **-o-së** së theksuar fundore në dyzanorësh **-uo**, forma femërore e mbiemrit [i shkua ~ e shko-në / e shko-rë] nuk mund të qëndronte e sajuar mbi fundorin **-o**. Forma femërore, brenda së cilës nuk mund të bëhej diftongimi, e ruajti opozicionin e gjinisë me formën mashkullore, duke u formuar mbi të njëjtën temë që ishte edhe e pjesores në përdorim foljor: [ka shkua; i shkua ~ e shkua-në / e shkuorë etj.].

Mbaresa **-në** e gjinisë femërore e mbiemrit prejpjesor në zanore e në diftong, që ishte e pashembullt si mbaresë gjinie, do t'i nënshtrohet presionit të prapashtesës **-në** të pjesores paroksite: [lagë-në, pjekë-në etj.] që, siç kemi parë, ishte tëmë neutrale në gjini. [i, e lagënë, i, e djegënë etj. (apo i, e lagunë, i, e pjekunë etj.), për t'u neutralizuar në gjini edhe ajo në përdorim mbiemëror: [i, e prenë, i, e thyenë, i, e lanë, i, e punuonë etj.] dhe në toskërishte: [i, e prerë, i, e thyerë, i, e larë, i, e punuorë etj.]. Neutralizimi i mbaresës së gjinisë femërore te mbiemri prejpjesor i tipit [i thann ~ e thannë → i, e thannë, i vjeln ~ e vjelnë → i, e vjelnë etj.] u bë në të njëjtën kohë.

Gjendja e formave të pjesores pësore të së kryerës pas diftongimit të **-o-së** ishte:

|                    |                             |
|--------------------|-----------------------------|
| Në përdorim foljor | Në përdorim mbiemëror       |
| lagunë / lagurë    | i, e lagunë / i, e lagurë   |
| thannë / thënnë    | i, e thannë / i, e thënnë   |
| vjelnë             | i, e vjelnë                 |
| punuo              | i, e punuonë / i, e punuorë |
| la                 | i, e lanë / i, e larë       |
| pre                | i, e prenë / i, e prerë     |
| thye               | i, e thyenë / i, e thyerë   |

Në këtë kohë, siç shihet, ishin dy mënyra të formimit të mbiemrit nga pjesorja:

1. drejtpërdrejt nga pjesorja: [lagunë / lagurë – i, e lagunë / i, e lagurë, thanë / thënë – i, e thanë / i, e thënë, vjelnë – i, e vjelnë etj.];

2. nga pjesorja + prapashtesa: [la – i, e la-në / i, e la-rë, pre – i, e pre-në / i, e pre-rë, thye – i, e thyenë / i, e thyer-ë, shkuo – i, e shkuo-në / i, e shkuo-rë etj.].

Toskërishtja shkoi në drejtim të përgjithësimit të tipit të parë, duke e futur prapashtesën **-rë** edhe në pëtdorim foljor: [pre → prerë, thye → thyerë, shkuo → shkuorë etj. - ka prerë, ka thyerë, ka shkuorë etj.].

Nisur nga shembujt e Buzukut: [blenë, hinë, lanë, përenë etj.], të Budit : [hinë, nginë, përziënë, lenë etj.] e të Bogdanit: [raan, baanë etj.] mund të konstatohet se edhe një pjesë e gegërishtes, që e kishte krijuar mbiemrin prejpjesor me prapashtesën **-në**: [i, e përenë, i, e pinë, i, e thyenë, i, e lanë etj.] e kishte përcjellë këtë prapashtesë edhe në pjesore nën të njëjtin proces të unifikimit të formës së pjesores në të dy përdorimet si toskërishtja. Pjesa tjetër e gegërishtes nuk e kaloi këtë prapashtesë në pjesoren e funksionit foljor, sepse në të dominoi kriteri i dallimit të trupit të mbiemrit nga pjesorja, d.m.th. formimi i mbiemrit nga pjesorja + prapashtesë, siç është gjendja e pjesores me temë në zanore: [(ka)pre - i, e prenë, (ka)le - i, e lenë etj.]. Pastaj u bë përgjithësimi i këtij dallimi edhe te tema në sonante: [(ka) thanë - i e than-unë, (ka) vjelë - i, e vjel-unë]. Kjo gjendje është edhe në të folmet e shënuara të Kosovës: [(ka) thonë - i thonën, (ka)lonë - i lonën, (ka) marrë - i marrën, (ka) vjelë - i vjelën etj.]. Edhe në disa të folme të tjera ka formime të tilla si të Gazuli: [të thanun], të Hafiz Ali Ulqinaku: [t xanun, t marrun etj.]. Në këto të folme mbiemri i temës në konsonant do të interpretohet gradualisht jo si i përfutur drejtpërdrejt nga pjesorja, por nga pjesorja + unë: [(ka) lagunë (a lagënë) - i, e lagunë (a lagënë) → (ka) lagë - i, e lagunë (a lagë-në) etj.]. Po ta kishte unifikuar e tërë gegërishtja pjesoren me trupin e mbiemrit në **-në**, nuk do të ishte shkurtuar kjo pjesore, siç nuk u

shkurtua në toskërishten. Kuptohet se ky shkurtim është shumë i vonshëm, larg kohës që po bëjmë këtë shqyrtim të pjesores. Shembujt te Buzuku [shëndoshë, shqyt], te Budi [mërzit, ardh, përmys], te Bogdani [pasë, mbëledhë, dredhë, mujtë] tregojnë se ky proces kishte filluar në ndonjë të folme të gegërishtes ku trajta e shkurtuar kishte nisur të bëhej variant i lirë me trajtën e plotë. Shembujt e Bogdanit si [për të shëndoshë, për të ardhë, për të përmbledhë, për të mbledhë] tregojnë se në kohën e tij ky proces ishte mjaft i avancuar, mbasi forma e shkurtuar kishte depërtuar edhe te mbiemri i substantivuar brenda formës foljore analitike.

## 7. Krijimi i formës së mënyrës habitore

Format e pjesores mbrenda habitores flasin se mënyra habitore është krijuar në kohën kur ishte kjo gjendje e pjesores pësore të së kryerës në përdorim foljor:

1. shkuo-kisha, pre-kisha, la-kisha, thye-kisha etj.
2. thanë-kisha, thënë-kisha, mbjellë-kisha, vjelë-kisha etj.
3. hapunë-kisha, hapurë-kisha, djegunë-kisha, djegurë-kisha etj.<sup>73</sup>

kemi përfunduar se forma e parë e habitores ishte forma e së pakryerës, krijuar nga forma e përmbysur e më se të kryerës së dëftores, e cila kishte mundësi të përfntonte kuptim modal në mënyrën e treguar në këtë vepër. Format e tjera janë krijuar nga kërkesat e sistemit kohor brenda habitores).

<sup>73</sup> Në veprën B. Bokshi, *Pjesorja e shqipes (Vështrim diakronik)*.

Rënia e **-n-së** nga përfundimi **-on** i pjesores pësore të së kryerës dhe nga tema në zanore të tjera më vonë, ishte e përgjithshme për tërë shqipen. Në pjesoren me temë në likuide e ne nazalin **-n** ishte bërë asimilimi i formantit [than-në > thanë (thënë), lan-në > lanë / lënë, vjel-në > vjelë etj.]. Vetëm pjesorja e temës në bashkëtingëllore kishte mbetur e pandryshuar (lagunë a lagënë, / lagurë a lagërë). Format në disa të folme të toskërishtes: [djegër-kam, hypër-kam etj.] i konsiderojmë dëshmi se formimi i habitores e gjeti këtë formë të plotë të kësaj pjesoreje.

Kjo gjendje e formave të pjesores pësore të së kryerës në përdorim foljor e përcakton kohën e përfutimit të habitores para kalimit të formanteve **-m**, **-në**, **-rë** e **-të** nga pjesorja në funksion mbiemëror në pjesoren në funksion foljor.

Meqë krijimi i habitores e ka gjetur pjesoren përkatëse me diftongim të **-o-së** në **-uo** (shkuo, punuo etj.), koha e përfutimit të kësaj mënyre del të jetë pas kohës së krijimit të pronorëve të shënuar, d.m.th. aty kah shekulli X e pas tij brenda periudhës që po e shqyrtojmë.

Pjesorja, duke qenë pjesa e theksuar e shprehjes habitore, e ka ruajtur identifikimin e saj si pjesore edhe kur folja **kisha** ishte bërë enklitike ndaj saj. Pjesorja e habitores nuk do ta përciellë ndryshimin e formës së pjesores në përdorime të tjera vetëm pas përfutimit të përngjitjes së pjesëve përbërëse të habitores, sepse atëherë pjesorja e kishte humbur kuptimin kohor që e kishte në përbërje të kohëve analitike, duke e ruajtur vetëm kuptimin leksikor, që domethënë se e mori funksiononin e një teme foljore formuese të habitores, me foljen ndihmëse **kisha** të transformuar në prapashtesë të habitores e në mbaresë vetore, kohore dhe të numrit. Ndryshimet e formës së pjesores, që janë bërë brenda habitores, janë: rënia e fundores **-ë**: *lënëkish > lënkësh, thënëkish > thënkësh, vjelëkish > vjelkësh* etj. dhe në disa të folme edhe reduktimi i **-u-së** në **-ë**: [hapunkish > hapënkësh, hapurkish > hapërkësh etj.]. Më vonë kjo pjesore u shkurtua në [hap-kam, hap-kësha etj.] nën ndikimin

analogjik të formave të tjera të pjesoreve brenda habitores që ishin me prapashtesë zero. Meqë këto ndeshen te Buzuku: [dash-kishnjë, njoh-kishtë *etj.*], domethënë se ky shkurtim është bërë para kohës së tij, por duket se nuk është kryer në të gjitha të folmet në një kohë, siç e dëshmojnë format e disa të folmeve të toskërishtes: [*djegër –kam, hyper-kam etj.*]. Ky shkurtim i pjesores me **-unë /-urë** (apo **-ënë /-ërë**) në habitore është bërë para shkurtimit që do të bëhet më vonë në gegërishte te pjesorja e formave analitike: [*kam lagë, kam terë, kam pritë etj.*], *pas kohës së shkrimrarëve tanë të vjetër të Veriut.*

## 8. Krijimi i parashtesave deiktike

Parashtesat deiktike **kë-**, **a-**, për origjinën e të cilave flasin G. Meyeri e H. Pedersenin jo dhe aq bindshëm<sup>74</sup>, i ka marrë dëftori pas kohës së krijimit të përemrave pronorë me segmente të konglutinuara, nga të cilët i pari ka qenë përemër dëftorë: [ta-në, to-në, i-m, ti-në sa-në *etj.*]. Meqë këta përemra janë përfuar pas procesit të rotacizmit, kuptohet se parashtesat deiktike janë shtuar pas kësaj kohe.

Pa këto parashtesa sot dalin pronorët e vetës së tretë: [i tiji, i saji *etj.*], trajtat e vetorit e të dëftorit me parafjalë [me ta, mbi to, prej tyre, pas tyre *etj.*], përemri [i tillë] i përfuar nga [i tij lloji], forma ablativale e dëftorit *sij*, *soje*, *sish*, *sosh* e ndajfoljet [sot, sonte, sivjet] .

Përemri dëftor i shqipes së sotme pa elemente deiktike ishte bërë edhe përemër vetor në periudhën në protoshqipen e hershme, siç kemi shënuar, duke e zëvendësuar përemrin e lashtë vetor [\*is,

<sup>74</sup> Shih B. Bokshi, *Për vetorët e shqipes*, f. 66.

\*iā (\*eiā), \*id] në këtë funksion. Përftimi i vonshëm i këtyre parashtesave deiktike tregon se shqipja deri atëherë ka pasur edhe një dëftor tjetër në opozicion deiktik me të, por cili ka qenë ai përemër është i papërcaktueshëm për ne.

Duke dalë nga përdorimi dëftori tjetër, përemri i sotëm po neutralizohet deiktikisht, gjë që i përshtatej funksionit të tij si vetor, ndërsa si dëftor po i merrte gradualisht parashtesat deiktike **kë-**, **a-**.

Përemri dëftor me parashtesën deiktike **a-** hyri në funksion edhe të vetorit, duke e nxjerrë nga përdorimi formën pa këtë parashtesë. Kjo nuk ndodh në gjuhët ku dëftori ka përftuar elemente deiktike (shih në latinishte, frëngjishte, italishten etj.). Arsyeet pse në këtë përdorim nuk janë pëtfshirë edhe trajtat e vetorit me parafjalë janë shënuar në veprën *Për vetorët e shqipes*, Prishtinë, 2004.

Në mjaft të folme të gegërishtes funksionin demonstrativ e deiktik të dëftorit e ka dobësuar përdorimi i formës me **a-** si vetor, prandaj ai është përforcuar me pjesëzat dëftuese: [qe] (që, qi, çe, çë) apo [nji]: [qeky, qekjo, qëky, qëkjo, qiki, qikjo, çeky, çekjo, çëky, çëkjo; njiky, njikjo; qaj, qajo, çaj, çajo; njaj, njajo; qata, qato, çata, çato; njata, njato]. Në numrin shumë të mungon elementi **kë-** për shkak të vështirësisë së qëndrimit të grupit **kt** në mes të fjalës te këto të folme pas rënies së **-ë-së**: [njita, njito, qeta, qeto, çëta, çëto]. Përdorimin e dikurshëm të këtyre parashresave edhe me elementin deiktik **kë-** në shumë e vërteton fakti se format e përforcuara mbi parashtesat **a-** e **kë-** mbetën të dallueshme: [çata ~ çëta, çato ~ çëto, njata ~ njita, njato ~ njito]. Në të folmen e Grykës së Madhe të Dibrës përdoret forma **qikto** që dëshmon se elementi **kë** është përdorur edhe në shumë.

## 9. Unifikimi i temës emërore sipas formës së shumësit

Unifikimi më i moçëm i temës në bazë të shumësit është bërë tek emrat asnjanes me temë në **-l**. Ky tingull kaloi në **-ll-** për shkak të pozitës intervokalike që kishte në shumës: [asnj. sing. \*hal ~ plur. halë → sing. \*hal ~ plur. \*hallë → sing. hall ~ plur. hall-ë]. Ky nivelizim është më i moçëm se rënia e mbaresës **-i** të shumësit të mashkullorëve të temës oksitone në konsonant (kujto: sing. \*hall ~ plur. halli > hej etj.). Ky unifikim i përfshiu të gjithë emrat e tilë të gjinisë asnjanes me **-l** jopalatale pa asnjë përrjashtim.

Mbasi si mbaresa të para që u përdorën në shumësin e metafonizuar qenë mbaresat **-ënë,-ërë** e pas tyre edhe mbaresa **-inj**, nivelizimi i kësaj kohe është bërë tek emrat me këto mbaresa të shumësit:

- \*drak ~ dreqënë → dreq ~ dreqënë;
- \*ëmbrat ~ ëmbretërë → ëmbret ~ ëmbretërë;
- \*brash ~ breshënë → \*bresh ~ breshënë (breshërë);
- \*thalp ~ thelpinj → thelp ~ thelpinj;
- \*shtrap ~ shtrepinj → shtrep ~ shtrepinj (shtërpinj) etj.

Më i vonshëm që nivelizimi i temës sipas shumësit tek emrat që pranë metafonisë i kishin edhe mbaresat **-a, -e** :

- (\*darr ~ plur. \*derr) \*darr ~ derra → derr ~ derra;
- (\*gal ~ plur. \*gjel) \*gal ~ gjela → gjel ~ gjela;
- (\*adh ~ plur. \*edh) \*adh ~ edha → edh ~ edha etj.;
- (\*halm ~ plur. \*helm) \*halm ~ helme → helm ~ helme;
- (\*gath ~ \*gjeth) \*gath ~ gjethe → gjeth ~ gjethe etj.

Emrat që dalin në shumës me metafoini e palatalizim e

pësuan unifikimin e temës vetëm pjesërisht, d.m.th. në zanoren e metafonizuar:

\*hall ~ hej → hell ~ hej; \*pan ~ penj → pen ~ penj etj.

duke u barazuar me emrat e parë, d.m.th. me emrat me palatalizim në shumës, kështu që **-e**-ja e gjeti të kryer këtë unifikim të pjesshëm [hell ~ heje].

## 10. Zgjerimi i përdorimit të mbaresë së shumësit **-a**

Mbaresa **-a** e shumësit të emrave të gjinisë mashkullore të temës oksitone në konsonant [plepa, lisa, plisa, derra, burra, çuna, gjela *etj.*], ka kaluar këtu pasi ishte krijuar në temën paroksite në sonante, e cila ishte neutrale në gjini, që domethënë se doli e përdorshme edhe me emra të gjinisë mashkullore: [pjepëna, drapëna, lepëra, emëna, krahëna, egjëra, shembëlla](nga pjepënë-e, drapënë-e etj.). Kështu, pas paradigmës sing. -ë ~ plur. **-a** [sing. drapën-ë ~ plur. drapën-a etj.] u krijua paradigma e re e numrit sing. **-ø** ~ plur. **-a**: [sing. plep-ø ~ plur. plep-a etj.]. Përdorimi i kësaj paradigme me emrat mashkullorë të temës së shënuar që i kufizuar nga raportet sistemore të mëparme të paradigmatve. Paradigma **-ø** ~ **-a** u përdor edhe me emrat e gjallesave që nuk ishin edhe mbiemërorë dhe që nuk e shprehnin opozicionin e seksit me sufiks feminativ:

Pa komutacion seksi

sing. [krimb] ~ plur. [krimb-ë → krimb-a]

[korb] ~ [korb-ë → korb-a]

[skifter] ~ [skifter-ë → skifter-a]

[qengj] ~ [qengj-ë → qengj-a]

Me opozicion seksi nga ndryshimi i temësi

sing. [burr] ~ plur. [burr-ë → burr-a] (gra)

[nip] ~ [nip-ë] → nip-a] (mbesa)

[çun] ~ [çun-ë] → çun-a (çupa)

Siç shihet, paradigma sing. **-ø** ~ plur. **-ë** u zëvendësua nga paradigma sing. **-ø** ~ plur. **-a** vetëm kur zero nuk ishte edhe mbaresë e gjinisë mashkullore dhe sufiks i seksit mashkullor. Kështu emrat [\*dren ~ dren-ë, punëtor ~ punëtor-ë, fshatar ~ fshatar-ë, fisnik ~ fisnik-ë, gomar ~ gomar-ë], nuk mund të dilnin me mbaresën **-a** në shumës, sepse te këta emra ajo shënonte shumësin e gjallesave femërore, në opozicion me sufiksiv feminativ **-ë** në numrin njëjës : [sing. kunat-ë ~ plur. kunat-a, sing. plak-ë ~ plur. plak-a etj.] e me **-ë** të sufiksive feminativë: [sing. arushë ~ plur. arusha, sing. ulkonjë ~ plur. ulkonja etj.] Krahas zëvendësimit të shënuar të paradigmeve sing. **-ø** ~ plur. **-ë** paradigma sing. **-ø** ~ plur. **-a** u përdor edhe me emrat pa mbaresë numri, por me ndryshim teme:

[sing. \*darr ~ plur. \*derr → sing. derr ~ plur. derr-a]

[sing. \*dam ~ plur. dem → sing. dem ~ plur. dem-a]

[sing. \*adh ~ plur. edh → sing. edh ~ plur. edh-a] etj.

Këtu mbaresa **-a** e shumësit bëri të mundur nivelizimin e temës sipas shumësit. Edhe tek emrat e tillë përdorimi i mbaresës **-a** që i kufizuar mbrenda të njëjtit profil të emrave që ishin pa ndryshim teme.

Meqë te fjalët bikategoriale emër-mbiemër paradigma **-ø** ~ **-a** nuk doli e përdorshme, kuptohet se edhe emrat e jogjallesave, që janë formuar me të njëjtët sufiks, mbetën me paradigme **-ø** ~ **-ë** si më parë: [blozar ~ blozar-ë, lakror ~ lakror-ë, trups ~ trups-ë, cfingor ~ cfingor-ë, koftor ~ koftor-ë, taftar ~ taftar-ë etj.], ashtu si

dhe emrat e huazuar në këtë kohë, d.m.th. pas huazimeve latine: [altar ~ altar-ë, vapor ~ vapor-ë, pancir ~ *pancir-ë*] e deri në ditët e sotme: [hambar ~ hambar-ë, zingjir ~ zingjir-ë, bylezik ~ bylezik-ë etj.]

Emrat e tipit [*za, shulla*], që kaluan në gjininë mashkullore nga gjinia asnjënëse, me mbaresën e shumësit **-na** (za ~ za-na, zë ~ zë-ra) tregojnë se **-a**-ja ishte seleksionuar në vend të **-ë**-së para se të binte **-n**-ja e temës në emërore e kallëzore njëjës (zan ~ zan-a). Paralelisht me këtë mbaresë u krijua edhe mbaresa **-në** tek emrat që e ruajtën gjininë asnjënëse, p.sh.: [fre ~ fre-në (< fren ~ fren-ë), bri ~ bri-në (< brin ~ brin-ë)] etj. si dhe tek emrat e gjallesave si [dre ~ dre-në (< dren ~ dren-ë)] etj. Kështu këta emra i takuan temës në zanore të theksuar pas rënies së fundorit **-n**. Paradigma sing. **-ø** ~ plur. **-na** e zgjeroi pastaj përdorimin brenda kësaj teme oksitone, duke dalë edhe me emra që kaluan nga asnjësi në gjininë femërore si p.sh.: [*gja ~ gja-në* (< gjan ~ gjan-a), godi ~ godi-na, ndodhi ~ ndodhina etj.].

## 11. Krijimi i trajtave të patheksuara kundrinore të shumësit

Ne shënuam se variantet e njëjësit **i** për dhanore dhe **e** për kallëzore janë krijuar që në kohën e përemrit vetor **\*is, \*eia, \*id**, para se të zëvendësohej nga përemri i ri vetor i vetës së tretë që e ka shqipja edhe sot.

Me të drejtë është vlerësuar se varianti i lidhur i dhanores shumë **u** nuk mund të jetë refleksi i një forme përkatëse të përemrit të lashtë vetor, sepse ai nuk e kishte krijuar as këtë trajtë, as trajtën

e kallzores shumë **i**. Kjo **u** me këtë vlerë të rasës e të numrit është përftuar nga një **u** që kishte tjetër funksion.

Duke qenë se **u** e vetës së tretë shumë në fazën e shqipes së dokumentuar është e dhanores e jo edhe e kallëzores, origjina e saj nuk mund të jetë nga **u** (**ju**) e vetës së dytë shumë, që është e këtyre dy rasave. E vetmja mundësi mbetet që ajo të jetë përftuar nga pjesëza **u** e vetëvetores.

Forma e vetvetores seleksionon kundrinën e zhdrejtë, e cila mund të ishte edhe forma e dhanores së vetorit të theksuar të vetës së tretë shumë: [e ai tue u përgjegjunë atyne...; e Jezu u afruo atyne etj.] Në këtë kontekst **u**-ja realizonte edhe funksionin e pjesës së edhe funksionin e trajtës së patheksuar të dhanores, në këtë kohë kur shqipja po hynte në procesin e kompletimit të serisë së varianteve të lidhura kundrinore, kur duhej të krijohej edhe varianti i patheksuar i dhanores shumë që nuk ekzistonte<sup>75</sup>. Kështu **u**-ja mund të përdorej edhe jashtë formës së vetvetores duke realizuar vetëm funksionin e saj kundrinor: [u tha atyre, u bërtit djemve] etj.

Varianti **i** i kallëzores shumë është përftuar nga varianti **i** i dhanores njëjës. Ky funksionalizim i **i**-së së dhanores së njëjësit edhe për kallëzoren e shumësit u bë në flalitë me kallëzues nga foljet kalimtare që kanë si tipar kontekstual praninë e dy kundrinave, në rastin tonë, të kundrinës së zhdrejtë në njëjës e të kundrinës së drejtë në shumë, si në shembujt e nxjerrë nga Meshari i Buzukut:

[... e kanë me i kthym veshët të drejtësë; ... e i dëftoi (Krishtit – shënimi im) të gjithë regjënitë e shekullit; ... e ata i binjinë enëtë (asaj – unë), e ajo përndaj vojtë; ... e duortë e saj i ndeni ati qi pat nevojë etj.]<sup>76</sup>.

<sup>75</sup> Te Buzuku trajta **u** e dhanores shumë të vetës së tretë ishte krijuar shumë kohë më parë, por prania e **u**-së së vetvetores, duke qenë homonime me të, nuk e lejon përdorimin e trajtës së dhanores.

<sup>76</sup> Shembujt nga Buzuku shërbejnë vetëm si model, sepse shumë kohë më parë shqipja e kishte krijuar edhe variantin **i** të kallëzores shumë, procesin e përfutimit

Nga shembuj të tillë me dy kundrina mund të kalohej në shembuj kur kundrina e zhdrejtë në njëjës ishte e nënkuptueshme e pastaj edhe kur mungonte dhe **i**-ja në bazë të një inercie mbetj në përdorim, duke fituar tani edhe vlerën e variantit të ri të kallëzores shumë:

[... e kanë me i kthjem veshët (së drejtës) → ... e kanë me i kthjem veshët (dikah); ... e ata i binjinë enëtë (asaj) → ... e ata i binjinë enëtë (diku) etj.].

Kjo vlerë do të jetë përftuar edhe në fjalitë ku dhanorja nuk ishte në funksion të kundrinës, por ishte në funksion të plotësisë të përkatësisë, që mund të zëvendësohej nga një gjinore posesive a nga një përemër pronor, p.sh.: [E qentë vinjinë e i lëpinjinë varët atij → E qentë vihjinë e i lëpinjinë varët e tij etj.], duke mbetur **i**-ja e dhanores edhe në rastin e dytë, për shkak të ekuivalencës kuptimore të këtyre fjalive. Në këtë përdorim inercie përbërja e re e fjalisë nuk mund ta pranonte si formë të dhanores, por do ta trajtonte si variant të kallëzores shumë, si anticipues a si rimarrës të kundrinës së drejtë, tani kur nevoja për ta krijuar edhe këtë variant ishte bërë e domosdoshme nën presionin për të kompletuar serinë e varianteve të lidhura.

Për origjinën e variantit të lidhur **na** me funksion të dhanores e të kallëzores janë shprehur mendime të ndryshme dhe çështja ka mbetur e hapur. Ne shënuam se që në kohën e tonit, ekzistonte varianti aton **\*nō-** (me **o** të gjatë e të shkurtër) në funksione të dhanores e të kallëzores dhe se në kohën e theksit, si i patheksuar, përfundoi në **në**, që nuk është dëshmuar, dhe u zëvendësua nga forma **na**.

Mundësinë që variant i patheksuar **na** të jetë përftuar nga përngjitja e formës burimore **në** me trajtën e patheksuar të kallëzores së vetës së tretë njëjës **në + e > na** e përjashtojnë trajtat **ma**, **ta**, të cilat nuk janë transformuar në shënuesë të një kundrine të vetme.

Brenda sistemit të varianteve të lidhura **\*në** ka qenë e identifikueshme si variant i dhanore-kallëzores së vetës së parë shumë, aq sa janë **më** e **të** të vetave përkatëse të numrit njëjës. Vërtet se **\*në** ishte homofone me **në-në** e kushtores: [në duhet të shkojmë etj.], por, meqë ky konfuzion shfaqej në raste të kufizuara, zëvendësimi i saj nga forma **na** nuk ishte i nevojshëm. Zëvendësimi do të jetë imponuar nga një proces sintaksor, i cili trajtën e emërores **ná** do ta ketë funksionalizuar edhe si variant të lidhur kundrinor.

Mundësinë e kalimit të formës së theksuar të emërores **ná** në variant të patheksuar të dhanores ne e kemi parë te fjalitë me foljen modale gjysmëndihmëse **duhet**, të ndjekur nga lidhorja e në gegërishten edhe nga paskajorja, si p.sh. [Na\_duhet të shkojmë (me shkue) etj.]. Kjo fjali në radhë të parë e ka kuptimin që përftohet nga kryefjala **na** e nga kallëzuesi **duhet të shkojmë (me shkue)**, por në të njëjtën kohë e ka edhe kuptimin që arrihet me interpretim të **duhet** si kallëzues, d.m.th. si folje jomodale, me ç' rast lidhorja (a paskajorja) merr funksionin e kryefjalës dhe **na** – funksionin e kundrinës së zhdrejtë: [Na duhet (neve) të shkojmë (me shkue)]. Kështu forma e patheksuar **na** funksionoi së pari si formë e kundrinës së zhdrejtë e më vonë edhe si formë e kundrinës së drejtë, funksione që i kishte edhe trajta e zëvendësuar **në**.

Forma e emërores **na** nuk mund të përdorej në bashkëvajtje me variantin e patheksuar të dhanores **në**: [**\*na** në duhet të shkojmë etj.], prandaj mund të kalonte edhe në funksion të variantit **në** e të përdorej në vend të tij si i patheksuar. Përftimi i variantit të lidhur **na** nga forma e theksuar nëpërmjet frazës së tipit të shënuar mbështetet edhe në faktin që në kohë të vona e njëjta frazë ka lënë mundësi që variant i thksuar i dhanores: [neve duhet të shkojmë] del në funksion të rasës emërore = na duhet të shkojmë].

Varianti i patheksuar **na** është më i lashtë se format e përngjitura **ma**, **ta** për faktin se ajo e zëvendësoi variantin **në** para se **\*në** + e të kalonte në **\*na**.

Forma e theksuar e vetës së dytë shumë **ju** nuk mund të kalonte në trajtë të patheksuar kundrinore në rrugën e treguar për formën **na**, sepse, siç është shënuar, ajo dilte në funksion të të gjitha rasave ekzistuese pa mbaresa rasore, d.m.th. dilte si e theksuar edhe në funksion të dhanores dhe atëherë ishte në bashkëvajtje me variantin e lidhur të dhanores **u**: [ju u duhet të shkoni (me shkue) etj.], kështu që përdorimi i variantit **u** e identifikonte atë si formë të theksuar në funksion të dhanores. Pa bashkëvajtje me variantin **u** në kontekstin e shënuar ajo do të realizonte vetëm funksionin e kryefjalës: [Ju duhet të shkoni (me shkue)]. Forma **ju** do të bëhet variant i patheksuar e dhanores dhe i kallëzores në periudhën pas autorëve tanë të vjetër e për arsye të tjera.

## 12. Zhvillimi i pjesoreve

Pjesorja pësore e së tashmes, që dilte me prapashtesën **-m**, u bë sinonimike me pjesoren pësore të së kryerës (me **-n**) në përdorim mbiemëror. Ndryshimi i kuptimit të kësaj pjesoreje, që tregonte edhe njëkohësi, është mundësuar edhe nën presionin e pjesores pësore të së ardhmes me **-shëm**. Meqenëse **bim** ~ **bim-ë** (**i bim** ~ **e bim-ë**) kishin kuptimin: ai që bin, ajo që bin në kohë të tashme a kurdo qoftë dhe **i bishëm** ~ **e bishm-ë** (= **e bishm-e**): ai që do të bijë, ajo që do të bijë, pra që mund të bijë në të ardhmen kurdo qoftë, është për të përfunduar se kuptimi i njëkohësisë me të ardhmen, që nga e tashmja, u mor nga pjesorja pësore e së ardhmes me **-shëm**, ndërsa kuptimi i njëkohësisë me të shkuarën e solli barazimin e kuptimit të kësaj pjesoreje me pjesoren pësore të së kryerës me **-n**. Diçka e ngjajshme është zhvilluar në latinishten ku “Participi pasiv i perfektit ishte, që në latinishten klasike, kategori

shumë produktive, që tentonte të përmblihte vlerat e formave të tjera të participit, me përjashtim të atij të futurit <sup>77</sup>.

Në përdorim foljor pjesorja me **-m**, duke mos pasur mundësi të hynte në përbërje të kohëve preteritale me **jam** e **kam** për shkak të kuptimit, kishte mbetur në funksion të fjalisë relative, që ia siguronte kuptimi i saj sintagmatik: **bim** – që bin, **frymë** – që fryn, **mjelm** – që milet etj. Në përdorim adnominal kjo pjesore u bë mbiemër i nyjshëm. Kalimi i trupit të këtij mbiemri me **-m** në përdorim foljor si pjesore e re: [asht lam — ka lam etj.] tregon se sinonimia me mbiemrin e nyjshëm nga pjesorja në **-n** (i,e lanë) kishte përfunduar, sepse, po ta kishte ruajtur kuptimin e pjesores pësore të së tashmes, nuk do të mund të dilte në këtë funksion preterital.

Gjendja në të folme të ndryshme tregon se kalimi i kuptimit të pjesores me **-m** në kuptimin e pjesores pësore të së kryerës nuk është bërë në një kohë. Toskërishtja, e cila pas neutralizimit në gjini të mbaresës **-rë** te mbiemri: [i, e bërë, i,e larë etj.], e kaloi këtë formant edhe në përdorim foljor si pjesore e re: [është / ka bërë, është / ka larë etj.], e ruajti në përdorim mbiemëror edhe formimin me prapashtesën **-m** po me këtë tip teme. Kjo ruajtje vetëm në funksion mbiemëror në tërë toskërishten tregon se ajo, në kohën e këtij procesi, ende i kishte në kuptime të ndryshme këto pjesore, d.m.th. se pjesorja më **-m** e kishte ende kuptimin e saj primar. Sinonimia e mëparshme do të kishte shkaktuar brenda toskërishtes dallime seleksionimi të njërës a tjetrës prapashtesë për të formuan pjesoren e re, siç ndodhi në një pjesë të gegërishtes. Kriteri i preferuar i toskërishtes për të unifikuar pjesoren me trupin e mbiemrit prejpjesor do të respektohej edhe me përdorimin e prapashtesës **-m**.

Gjendja në Rrafshin e Dukagjinit, në Drenicë, në Moravën e

<sup>77</sup> *Istoria limbii române* - Grup autorësh, București, 1978, f. 332.

Epërme dhe në të folmen e Hasit na shtyn të mendojmë se mbiemri i nyjshëm me prapashtesën **-m** kishte kaluar në kuptim të mbiemrit me **-në** vetëm pasi ishte përfutur forma neutrale në gjini: [i, e prenë etj. (nga i pre ~ e pre-në)], për arsye se një sinonimi më e hershme do ta shkaktonte zotërimin e formës me **-m** : [i prem ~ e prem-ë (më vonë e prem-e), siç ka ndodhur në të folme të tjera të gegërishtes, mbasi kjo formë ishte e përshtatshme për ta nxjerrë jashtë përdorimit formën e parregullt të gjinisë në [i pre ~ e pre-në] Në këto të folme pra kalimi i pjesores me **-m** në kuptim të pjesores pësore të së kryerës u arrit kur forma femërore e mbiemrit **-në** u neuztalizua në gjini dhe doli edhe për gjininë mashkullore: [i, e prenë etj.].

Në këto të folme gradualisht doli nga përdorimi si variant i lirë forma me **-m** , duke mbetur vetëm forma me **-në** si vijuese e pandërprerë e pjesores pësore të së kryerës. Por këtu forma me **-në** e mbiemrit nuk kaloi edhe në përdorim foljor si pjesore e re, për arsye se do të ruhej dallimi i formës së pjesores nga forma e mbiemrit prejpjesor: [(kam) la etj. - i, e lanë etj.] .Siç shënuam më lart, pak shembuj të Buzukut, të Budit e të Bogdanit tregojnë se në një pjesë të gegërishtes veriore formanti **-në** kishte kaluar edhe në formim të pjesores së re.

Në të folmet ku sinonimia e këtyre dy pjesoreve u arrit kur nuk ishte unifikuar ende në gjini prapashtesa **-në**, forma me **-m**: [i prem ~ e prem-ë] e përjashtoi nga përdorimi formën e parregullt të gjinisë: [i pre ~ e pre-në etj.] dhe forma e saj e gjinisë mashkullore kaloi edhe në përdorim foljor si pjesore e re:[ka prem etj.]. Në disa të folme të tjera të gegërishtes u ruajt në përdorim forma mashkullore e mbiemrit në zanore: [i da, i ble, i thy, i vra etj.], siç ishte edhe në përdorim foljor, ndërsa forma femërore doli me **-me**: [e dame, e ble-me, e thy-me, e vra-me etj.]. Ky formim i përzier nga format e dy pjesoreve është përfutur pas kohës kur ishin të dy format e këtyre pjesoreve [i pre ~ e pre-në] dhe [i prem ~ e prem-e]

ende me dallim në kuptim. Kur mbiemri me **-m** kaloi në kuptim të mbiemrit nga pjesorja pësore e së kryerës, u realizua një ndikim i dyanshëm formal: për gjininë mashkullore u përgjithësua forma me mbaresë **zero** nga pjesorja e së kryerës që e ruajti kuptimin e saj, ndërsa për gjininë femërore u mor forma e mbiemrit nga pjesorja me **-m**: [i pre ~ e pre-me etj.]. Kjo formë është përftuar pas zëvendësimit të mbaresës së femërores **-ë** me mbaresën e re **-e** në [i prem ~ e prem-ë → e prem-e], sepse në [i pre ~ e pre-më] **-ë**-ja nuk do të ishte mbaresë gjinie, por pjesë e mbaresës **-më**, prandaj nuk do të mund të zëvendësohej nga mbaresa e re **-e**.

Në disa të folme të gegërisë forma femërore me **-me** u bë e përdorshme edhe për mbiemrat nga pjesorja me temë në bashkëtingëllore që gjithkund është neutrale në gjini. Kështu në Luzhnicë të Dibrës, në qytetin e Dibrës e në të folmet e Arnitit e të Mirditës janë trajtat: [i këput-un ~ e këput-me, i armatos-un ~ e armatos-me, i qeth-un ~ e qeth-me, i cof-un ~ e cuf-me etj.], në të cilat prapashtesa **-un** ka dalë mbaresë e gjinisë mashkullore në relacion me mbaresën **-me** të gjinisë femërore. Në disa të folme të tjera në këtë tip teme është përgjithësuar prapashtesa **-m** si p.sh. në të folmen e Tetovës ku ka vetëm [i pjekëm, i ardhëm, i shajtëm, i gjegëm etj.] dhe në të folmen e Arbëneshit të Zarës: [i dashum, i dehum, i psum etj.].

Prapashtesa **-shëm** që në distribucion ekuivalent me të gjithë tipat e temës në përdorim mbiemëror. Dallimi kuptimor në të ciën është mbështetur ekuivalenca gjer në ditët tona flet se prapashtesa **-shëm** mund të ishte vetëm prapashtesë e participit pasiv të futurit, i cili në këtë kohë e humbi funksionin foljor, për të mbetur vetëm në përdorim mbiemëror e, lidhur me këtë, edhe në përdorim ndajfoljor. Kjo pjesore pësore e së ardhmes ka dalë në funksion të ndajfoljes së mënyrës dhe është ndajfoljësuar [flet kuptueshëm, rri gëzueshëm, rri mendueshëm, u zgjua trembshëm etj.]. Në këtë funksion ajo doli para se në funksion të mbiemrit të bëhej e nyjshme. Si mbiemër i tillë ajo doli në të gjitha funksionet që i

kishte si pjesore, duke ruajtur vetëm funksionin e plotësit të mënyrës, në të cilin si mbiemër nuk mund të dilte. Kuptohet se ndajfoljëzimi ka përmbledhur vetëm pjesoret e foljeve me tipare që e mundësonin këtë kalim.

Trupi i mbiemrave me **-shëm**, që nuk është edhe ndajfolje, tregon se prapashtesa **-shëm** nuk ishte prapashtesë ndajfoljore, por ishte sufiks i participit të shënuar që u bë prapashtesë mbiemërore. Si e tillë kjo prapashtesë përdoret për të formuar mbiemra nga ndajfoljet, mbiemrat dhe emrat. (Shih *Pjesorja e shqipes – vështrim diakronik*), Prishtinë, 1998, f. 76-80).

Në këtë kohë në gjuhën shqipe kishte mbetur pra në përdorim vetëm pjesorja pësore e së kryerës, që kishte përmbledhur në kuptimin e saj edhe pjesoren pësore të së tashmes, e cila ka mbetur e dëshmuar edhe në format e leksikalizuara: [bimë, frymë, mjelm, shkelm, pështymë] e ndonjë tjetër. Forma e pjesores veprorë të së tashmes ishte bërë: mashk. -tj (< \*-ntiö) > -s, fem. -tjë (< \*-ntiā) > -së . Kjo kishte dalë më herët nga sistemi i pjesoreve, duke kaluar në emër vepruesi: [lypës, shitës, mbjellës, korrës, çelës etj.], disa prej të cilëve u bënë edhe emra veglash: [shtypës, fshisë, çelës, kapësë, grisë etj.]. Edhe pjesorja veprorë e së kryerës me formantin **-lë** kishte kaluar në emër veprimi, që është ruajtur me këtë formant në shembuj të Çamërishtes: [vajtëlë, mbledhëlë] e të Gjirokastrës: [lejlë]. Kjo prapashtesë ka kaluar në **-je** në tërë shqipen: [vajtje, mbledhje, lindje, vdekje etj.]. Këtu shihet se nominalizimin e ka pësuar vetëm forma femërore e kësaj pjesoreje, prandaj nuk ka emra veprimi të gjinisë mashkullore.

### 13. Krijimi i zanoreve mbështetëse

Zanoret e vjetra mbështetëse **-o**, **-e** në sistemin foljor të gjuhës së lashtë ie. nuk janë ruajtur, d.m.th. nuk janë transformuar në zanore të shqipes, meqë pas krijimit të theksit dinamik, kanë qenë të patheksuara. Përmes reduktimeve të hershme ato do të jenë zhdukur në kohën e kontakteve të para me latinishten, kur ishte krijuar sistemi i shënuar i temave emërore. Më vonë shqipja ka krijuar zanore të reja mbështetëse **ë**, **i**, **u**.

Si zanore më e lashtë mbështetëse konsiderohet zanorja **-i**, sepse kjo ka kaluar edhe në mbaresë vetore në vetën e dytë shumës të kohës së tashme: [shkoni, bëni, kapni etj.], pas rënies së mbaresës së vjetër vetore (\*-te > të). Pastaj kjo mbaresë ka kaluar edhe në vetën e dytë shumës të mënyrën dëshirore: [hapshi, punofshi etj.]. Përdorimi i kësaj zanoreje në raste të tjera është më i ri se përdorimi i zanores mbështetëse **-ë**, si të format e vetës së tretë shumës të kohës së tashme (te Buzuku) [banj-ë-në, lus-ë-në, njoh-ë-në etj.] e në vetën e parë [banj-ë-më etj.], (Matrënga): [pres-ë-më, bënj-ë-më, vdes-ë-më etj.], (Budi): [jes-ë-në, ndimonj-ë-në etj.], të cilat më vonë dalin me **-i**: [lus-i-n, njoh-i-n, pres-i-m, vdes-i-m etj.]. Me zanoren mbështetëse **-ë** dalin edhe trajtat dialektore të çamërishtes e të labërishtes : [:dal-ë-m, dal-ë-n, marr-ë-m, marr-ë-n etj.] si dhe trajtat e së pakryerës [jesh-ë-m (< jeshmë), jesh-ë-t (< jeshtë) etj.]. Por zanorja **-i** nuk e ka zëvendësuar zanoren **-ë** në format e shumësit të aoristit p.sh.: [hap-ë-m(ë) < hap-më, hap-ë-t(ë) < hap-të, hap-ë-n(ë) < hap-në etj.].

Në trajtimin e zanoreve mbështetëse kanë mbetur disa çështje të pasqaruara: paraqitja e zanores **-i** edhe si më e vjetër edhe si më e re, zëvendësimi dhe moszëvendësimi i zanores **-ë** nga

zanorja **-i-**, rënia e mbaresës së vjetër të vetës së dytë shumës **\*-te** para zanores mbështetëse **-i-** e jo edhe prapa zanores **-ë-**.

Rënia e mbaresës **\*-te** para zanores mbështetëse **-i-** mund të mendohet se është bërë për arsye se të dyja bashkë jepnin informim redondant të vetës së dytë shumës, informim që mund ta jepte edhe vetëm zanorja mbështetëse **-i-**, e cila, prandaj, në këtë proces u bë mbaresë vetore. Zanorja **-ë-** para mbaresës **\*-te** në formën **-të** në trajtat e aoristit: [hap-ë-t(ë), kap-ë-t(ë), prek-ë-t(ë) etj.] nuk mund ta shënonte vetën, prandaj para saj nuk ra mbaresa e vjetër vetore. Mendohet, ndërkaq, se edhe zanorja **-ë** nga një zanore mbështetëse ka kaluar në mbaresë vetore. E tillë mbahet mbaresa e vetës së tretë njëjës e lidhore: [të laj-ë, të vrapoj-ë, të bjer-ë etj.], që është përdorur si zanore mbështetëse me foljet në bashkëtingëllore para mbaresës së lashtë **-t**. Me rëniën e kësaj mbaresë zanorja **-ë** doli mbaresë vetore dhe u përgjithësua për vetën e tretë të lidhore të të tëra foljeve. Këtu ky transformim funksional i kësaj zanoreje u mundësua nga mungesa e homofonisë me trajta të tjera në të njëjtën paradigme foljore.

Duke e konsideruar zanoren **-i** - si zanore mbështetëse më të lashtë, pranohet që ajo në një kohë ka qenë zanore e vetme në këtë funksion. Në këtë rast do të duhej menduar se zanorja **-i-** kishte përdorim të kufizuar e kjo na shpie te mendimi se është përdorur në vetën e dytë shumës të kohës së tashme të dëftores te foljet e Mi – konjugacionit, që kishin mbetur në numër tepër të kufizuar (mbase që atëherë në tri-katër folje). Duke u bërë mbaresë vetore, e zgjeruar më vonë me **-n-**: [jeni, keni, thoni (< thoi etj.)], nuk pati si të përdorej më si zanore mbështetëse. Kështu u krijua mundësia që zanorja **-ë-** të plotësonte nevojën e re për zanore mbështetëse si te shembujt: [patëm (< patmë), patët (< pattë), patën (< patnë) etj.].

Zëvendësimi i zanores **-ë-** nga zanorja **-i-** është bërë në radhë të parë te format e vetës së parë e të tretë shumës të kohës së tashme të dëftores për të shmangur homofoninë me trajtat e së kryerës së thjeshtë: [kap-

ë-më, qesh-ë-më, kap-ë-në, qesh-ë-në → kap-i-m(ë), qesh-i-m(ë), hap-i-n(ë), qesh-i-n(ë) etj.] nën një ndikim, siç është thënë, analogjik të formës së vetës së dytë shumës: [qeshni, prekni etj.]. Mendohet se ky ndikim është realizuar edhe te format e së pakryerës. Zëvendësimi i zanores **-ë** nga zanorja **-i**, d.m.th. përdorimi i ri i zanores **-i** si zanore mbështetëse është bërë fillimisht nën presionin e nevojës për të shmangur homominë e shënuar dhe është zgjeruar pastaj edhe për dallime më të qarta të vetave, që arrihen më tepër me zanoren **-i** se me zanoren **-ë**.

Si duhet kuptuar krijimi i formave homofone të vetës së parë e të tretë shumës të kohës së tashme e të kohës së kryer të thjeshtë? Neve na imponohet mendimi se zanorja mbështetëse **-ë**, që u përdor në të kryerën e thjeshtë: [heq-ë-më, heq-ë-në, qesh-ë-më, qesh-ë-në etj.] u përdor edhe në të tashmen e mënyrës lidhore: [të heq-ë-më, të qesh-ë-më, të heq-ë-në, të qesh-ë-në etj.], sepse homofonia nuk shkaktonte konfuzion, mbasi dallimin e kuptimit e bënte prania a mosprania e pjesëzës **të** të lidhores. Duke qenë se këto trajta të së tashmes së lidhores formohen nga forma e së tashmes së mënyrës dëftore, format me zanoren mbështetëse **-ë** nuk kishtin si të mos dilnin edhe si forma të së tashmes së dëftores: [(tash) heq-ë-më, qesh-ë-më, heq-ë-në, qesh-ë-në etj.], plotësisht homofone me ato të së kryerës së thjeshtë. Dallimi i kuptimit kohor mund të bëhej me fjalë të ndyshme kohore a nga konteksti dallues kohor. Zëvendësimi i zanores **-ë** nga zanorja **-i** në të tashmen e dëftores solli pastaj edhe zëvendësimin në mënyrën lidhore për të ruajtur formimin e lidhores nga dëftorja. Format e lidhores e të dëftores homofone me format e aoristit me zanoren **-ë** do të jenë pëftuar para se zanorja **-i** të rikthehej si zanore mbështetëse.

Ne kemi shënuar (në veprën *Rruga...*, f. 201 e më parë në punimin *Zhvillimi i strukturës së temave emërore të shqipës* (Gjurmime albanologjike, I, 1971) se tema në sonantet **-n**, **-r** ishte pasuruar edhe me disa emra të temës në zanoren **-ō**, para së cilës ishin dy bashkëtingëllore me **-r** në vend të dytë. Kur kishte rënë **-ō**-ja, këta emra hynë në temën paroksitone në sonantet e shënuara, duke u përdorur zanorja mbështetëse

**-ë-** midis dy bashkëtingëlloreve, d.m.th. para sonantit **-r** si në shembujt: [kulshed-ë-r (← lat. chersydr-us, gr. chersydr-os), ballad-ë-r (← gr. barathr-on, lat. barathr-um), okër (← ώκρ—ος), qandër (← centr-um) etj.]. Kështu shihet se si u përftua zanorja mbështetëse **-ë-**, vendosur në vend të zanores **-ë-** të temës paroksite në sonantet **-ër**, **-ën** (motër, vepër etj.). Krijimi i kësaj zanoreje mbështetëse tek emrat e shënuar është i kohës së kontakteve të shqipes me latinishten. Përdorimi i saj te trajtat e shënuara foljore duket të jetë shumë më i vonshëm.

Ne kemi konstatuar se pjesorja e temës në bashkëtingëllore ka përfunduar me **-ë-n(ë)** e jo me **-u-n(ë)**: [(I,e) lag-ë-n(ë), (Ii,e) pjek-ë-n(ë)etj.], sepse i ka takuar temës në sonantet **-n**, **-r**, para të cilave ishte zanorja **-ë-**: [krahën, dimën, pjepën, motër, vepër etj.]<sup>78</sup>. Kjo do të thotë se zanorja **-u-** këtu e zëvendësoi më vonë zanoren **-ë-** si në shembujt: [(i,e) vorfën (← orfan-us), pluhër (← pulver-em), lepër (← lepor) etj.] e në shembuj të tjerë.

Po si u bë zanorja **u** zanore mbështetëse? Neve na duket se e vetmja mundësi e përfutimit të saj është nga një ndikim analogjik i disa emrave joprejpjesorë të temës në sonantin **-ll** në huazimet latine si [shekull (← secul-um), mrekuull (← miracul-um) etj.], të cilët përjashtimisht vetëm zanorja e patheksuar **-u-** do të ketë qëndruar e pareduktuar në **-ë**. Nga këta emra ajo do të ketë kaluar në përdorim të emrat e të njëjtit tip në vend të zanore **-ë** të temës: [kumbëll, (< kakumel-on) → kumbull, shembëll (← exepl-um) → shembull etj.], në të cilët shihet se burimisht është përfutur zanorja **-ë-** nga reduktimi i zanoreve të ndryshme të patheksuara. Ne nuk dimë të sqarojmë se përse u përdor zanorja **-u-** në vend të zanores **-ë-** të disa emra të tjerë që shënuam (pluhur etj.), por mund të themi se ky ndikim për t'u përdorur zanorja **-u-** edhe në pjesoren e shënuar do të jetë përkrahur në radhë të parë nga temat participore në konsonantet **-k**, **-g**: [lag-u-në, prek-u-në etj. – ag-u-rë, prek-u-rë etj.] si në taste të tjera.

<sup>78</sup> Shih arsyetimet në veprën B. Bokshi, *Pjesorja e shqipes – vështrim diakronik*, f. 58.

Zanorja mbështetëse **-i-** përdoret me emrat e shquar, që në shumës përfundojnë me dy bashkëtingëllore: [turq-i-t, tërfurq-i-t etj.] dhe në rrjedhoren e shumësit me një të shtuar mekanikisht: [trimash-i-t, burrash-i-t] etj.

Shembujt [bani, thoni, pritënë, qeshënë etj.], tregojnë se zanoret mbështetëse **-i-**, **-ë-** këtu janë përdorur pas përfundimit të rotacizmi, ndërsa tek emrat zanorja mbështetëse **-ë-** është, siç u tha, e kohës së huazimeve të para nga latinishtja. E një vjetërsie të madhe do të jetë edhe funksionalizimi i zanores **i** si zanore mbështetëse në kohën kur përdorej mbaresa **\*-te**. Ka mbetur pa u diktuar se si është përfutur ky funksion e kësaj zanoreje. Zanorja **-u-** në pjesoren me temë në bashkëtingëllore (hapunë etj.) është e kohës para përfundimit të rotacizmit.

## 14. Dalja nga përdorimi i paskajores me + forma e pjesores në toskërishte

Koha kur në toskërishte ka dalë nga përdorimi paskajorja **me + forma e pjesores**, që ishte e tërë shqipes, mund të përcaktohet lidhur me kohën e mospërdorimit të paskajores në gjuhët ballkanike. Është shënuar se në bullgarishte e në maqedonishte gjurmët e para të mënjanimin të paskajores shfaqen në shekullin XI. Mendohet se në kohë të përafërt ky proces është zhvilluar edhe në gjuhën rumune, në të cilën, porse, ajo ka mbetur në përdorim shumë të reduktuar. Duket e arsyeshme të mendohet se edhe në dialektin e toskërishtes ky proces të ketë filluar rreth kësaj kohe e të ketë përfunduar aty kah shek. XIII.

Në gjuhën e folur të arbëreshëve të Italisë, siç na dëshmon F. Altimari<sup>79</sup>, gjenden gjurmë të paskajores **me + pjesore** gramatike të ngurosura. Nga kjo mund të përfundohet se kjo paskajore bashkë me formën e saj në funksion të fjalisë qëllimore **për me + pjesore** në kohën e emigrimit masiv të popullatës shqiptare në Itali kishte mbetur reliktove në toskëri mjaft kohë përpara kësaj shpërnguljeje.

Paskajorja **me + forma e pjesores**, që është përftuar para se të krijohej nyja e përparme e mbiemrit, nuk mund të trajtohej më si SP, për shkak se segmenti pasues – pjesorja, duke qenë pa nyjë, nuk mund ta kishte më vlerën e emrit prejpjesor abstrakt që nga koha kur u krijua nyja shquese, që domethënë se edhe parafjala kishte kaluar në pjesëz - në afiks të paskajores. Kjo formë, që ka ndjekur zhvillimin e formës së pjesores në kontinuitet, ka shërbyer që atëherë si temë foljore e infinitivit. Paskajorja e tillë ishte e barabartë me një paskajore sintetike. Ajo kështu dilte në të gjitha funksionet e Sintagmës nominale (SN).

Për këtë arsye kjo paskajore mund ta zëvendësohej nga fjalia lidhore në të gjitha funksionet: [filloi me mbjellë → filloi të mbjellë; vazhdoi me marrë → vazhdoi të marrë; duhet me vjelë → duhet të vjelim, përpiqet me e marrë → përpiqet ta marrë, erdhi me e zënë → erdhi ta zërë, e la me prituri → e la të presë] etj. Kjo sqaron se pse lidhorja mund ta përjashtonte nga përdorimi infinitivin e tipirt **me + forma e pjesores** në toskërishten, ndihmuar edhe nga ndikimi i greqishtes. Themi nga ndikimi i greqishtes, mbasi në gegërishte, duke qenë jashtë këtij ndikimi, përdorim i kësaj paskajoreje mbeti i pacenuar në tërë begatinë e saj funksionale.

Tipi **për të thanë / thënë** edhe si formë e pashtjelluar foljore ka mbetur në funksion të SP-së, pa arritur të kalojë në funksion të një SN-je,

<sup>79</sup> *Gjurmë të paskajoreve të shqipes në arbërishten e Italisë: përjasje diakronike, në materialet e botuara të Konferencës shkencore Çështje të studimeve diakronike të shqipes*, Prishtinë, 2009.

domethënë në funksion të kryefjalës, të kundrinës etj. as në toskërishten edhe kur nuk ishte në përdorim paskajorja e parë. Kjo formë infinitivale shpreh kuptimin e qëllimit nëpërmjet parafjalës **për**, që domethënë se edhe në përbërje të këtij infinitivi me funksion të fjalisë qëllimore funksionon si parafjalë. Edhe segmenti pasues kuptohet si emër veprimi (prejppjesor) në trajtë të pashquar, gjë që shihet edhe nga përdorimet si: [kjo nuse për të pamë s'eka shoqen etj.]. Kështu lidhja nuk mund ta zëvendësonte formën **për të thane / thënë**, prandaj kjo formë foljore mbeti në përdorim edhe në dialektin e toskërishtes.

Edhe në formën e pashtjelluar të tipit **me të thane / thënë**, që është po ashtu e tërë shqipes, dallohet kuptimi parafjalor i segmentit **me** si dhe kuptimi i gjymtyrës pasuese si emër abstrakt prejppjesor i nyjshëm. Parafjala **me** nuk e seleksionon lidhoren. Kjo formë foljore ka mbetur fjali kohore e futur në vend të një SP-je dhe si e tillë nuk del sinonimike me lidhoren, por me dëftoren të prirë nga lidhësa të caktuara kohore si p.sh.: [me të mbaruar mësimet, shkova të loz → posa i mbarova mësimet...; me të ram në pazar, ka bumullue → posa ra në pazar...; me ta parë nga larg, njerëzit ndërronin udhë → posa e shihnin nga larg... etj.]. Në këto përdorime, që janë kryesore, kjo formë e pashtjelluar, duke mos qenë në fushën distributive të lidhores, nuk kishte si të dilte jashtë përdorimit nga preferenca e të shprehurit me lidhore. Përdorimi i kësaj forme foljore në homonimi me lidhoren e prirë nga lidhëzat **sa, sapo, posa**, kur folja e fjalisë drejtuese është në kohën e ardhme, në urdhërore, apo në të tashmen e lidhores, si p.sh.: me të parë ty, do të derdhet të të hajë → posa të të shohë; me të parë varrin e djalit, do të më mallkoç → posa ta shohësh... etj. mbetet të konsiderohen zgjerime të vonshme të funksionit të saj.

## Shënim:

Brenda kësaj periudhe procesi më i rëndësishëm i ndryshimeve është krijimi sintagmave prepozicionale të rrjedhore e të dhanore e pas tyre edhe kalimi i kufizuar i kallëzores në SP kohore. Këto formime shkaktuan një ndryshim të madh të sistemi të rasave në planin kuptimor, duke shënuar kalimin nga një sistem me orientim pozitiv me dhanoren si rasë pivot në një sistem me orientim negativ me rrjedhoren si rasë më intensive të sistemit rasor me pesë rasa. Për zhvillimin e sistemit përemëror është i rëndësishëm begatimi me përemra të rinj pronorë pas humbjes së të vjetërve. Edhe sistemit foljor iu shtua forma e mënyrës habitore. Një thellim i ndryshimeve dialektore u bë me heqjen nga përdorimi të paskajores me + pjesore në toskërishte.

Përcaktimi i ndryshimit morfologjik, me të cilin përfundon kjo periudhë, është më i vështirë se për periudhat e tjera. Ne kemi vlerësuar se krijimi i sistemit të ri të temave emërore nuk mund vendoset brenda kësaj periudhe, por do të jetë dukuri me të cilën fillon periudha e shek. XIII-XV. Rënia e tingullit fundor **-n** të temës emërore oksitone dhe të pjesores pësore të së kryerës, siç u pa, nuk mund të ketë ndodhur pas përfundimit të periudhës së shek. IX-XII, ashtu si dhe diftongimi i o-së fundore të temës emërore (to > tfuo, kro > kruo, drago > draguo etj.).



## IV. ZHVILLIMET NË SHEKUJT XIII-XV

### 1. Krijimi i sistemit të ri të temave emërore

Ne shënuam se në kohën e krijimit të theksit të gjitha zanoret e theksuara ishin të gjata, ndërsa të patheksuarat – të shkurtra.

Unitetin e tillë të kuantitetit të zanoreve të theksuara e kishin luhatur rrethanat e ndryshme fonetike, në të cilat ndodheshin këto zanore, kështu që nën ndikimin e tingujve në kontakt apo të llojit të rrokjes u krijuan tri shkallët e gjatësisë së tyre.

Kuantiteti i ndryshëm i zanoreve u zhvillua brenda sistemit të mëparmë (në sistemin C – Shih *Rruga...*), por kur ai u lidh në mënyrë diferencuese me tipat e temave, u krijua sistemi i ri i temave emërore (sistemi D - Shih *Rruga...*) në kohën që po shqyrtojmë.

Dallimet në gjatësi u shkaktuan për arsye se gjatësia u ruajt në disa rrethana fonetike, ndërsa në disa të tjera u bë shkurtimi, duke u pëftuar shkalla e mesme dhe shkalla e shkurtër e gjatësisë.

Si gjatësi e ruajtur që nga krijimi i theksit dinamik del gjatësia e zanores në tipin e temave emërore njërrrokëshe në zanore: [mi, thi, dhe, ka etj.]. Kjo gjatësi u ruajt deri në kohën tonë, për arsye se, duke qenë në fund të fjalës, zanorja e theksuar që e liruar nga ndikimi i tingujve pasues që mund ta shkurtonin. Zanorja në rrokje të hapur në mes të fjalës nuk ishte pa ndikim të bashkëtingëlloreve të rrokjes pasuese, prandaj në të u bë gradualisht kalimi nga shkalla e

gjatësisë në shkallën e mesme, gjersa arriti të bëhej gjatësi e tipit të kësaj rrokjeje, që do të thotë edhe e tipit të temës paroksitone në *-ë*: [bukë, tokë, lugë, lopë, pelë etj.] e të temës paroksitone në sonant : [motër, femën, lakën, emën, pezëm, shekull etj.]. Shkurtimi i zanores së theksuar u bë në rrokjen e mbyllur nga ndikimi i bashkëtingëllores ndjekëse brenda rrokjes. Kjo është dukuri e përgjithshme, në të cilën gjatësia shpërdahet midis zanores e bashkëtingëllores e shkaktohet shkurtimi i gjatësisë së zanores. Kështu tipi i temës oksitone në bashkëtingëllore (gjak, top, trup, shkop, gjoks etj.) tani e kishte të shkurtër gjatësinë e zanores për shkak të rrokjes së mbyllur.

Por lidhja e shënuar e rrokjes së mbyllur me shkallën e shkurtër të gjatësisë së zanores së theksuar është kundërshtuar që në fillim të këtij procesi nga sonantet, para të cilëve është ruajtur gjatësia burimore e theksit. Kështu të gjithë emrat oksitonë në sonant në këtë kohë e kishin të gjatë zanoren e theksuar: [pën, mullin, frën, kapröll, dālm, mäll, ār, ltër, vënër, taftār, gārdh, gjīnd, hyll, qiëll, ērr, māl, hēlm, fill, tūrp, bīr etj.]. Shkurtimi i gjatësisë në rrokje të mbyllur fundore është kundërshtuar edhe nga gjatësia kompensatore, e shkaktuar nga rënia e tingujve: [kūt < kubët, dēt < debët, mjëk < mjedëk etj.].

Meqë kuantiteti i ndryshëm i gjatësisë u bë pjesë e tipit të temës, huazimet e kësaj kohe, huazimet postromake, do të integrohen në gjuhën shqipe duke respektuar këtë kualitet të ri të temave të shqipes. Kjo ndryshon nga mënyra e integritit të emrave të latinishtes e të greqishtes së vjetër. Ndërsa emrat e këtyre gjuhëve e ruajtën gjininë e tyre femërore kur e kishin modelin me *-ā*, ose kur i takonin temës neutral në gjini, në sistemin e ri të temave emërore emrat do ta ruajnë gjininë origjinale femërore jo vetëm kur modeli përfundonte me *-a*, por edhe me zanore të tjera, sepse secili vokal fundor e siguron kuantitetin e mesëm të zanores. Kështu emrat femërorë të modelit në zanore: [trāve, sūlū, kósorū, kóstī etj.] do të mbesin femërorë: [travë – trevë, shallë, kosherë, koskë etj.], duke e kaluar zanoren e modelit në *-ë* të temës femërore të shqipes. Emrat e gjinisë femërore në konsonant të gjuhëve huazuese të kësaj kohe

me zanore fundore të theksuar a të patheksuar nuk integrohen në temën e gjinisë femërore, për shkak se bashkëtingëllorja fundore imponon shqiptimin e shkurtër të zanores paraprijëse. Ata pra integrohen në temën oksitone mashkullore në konsonant, duke mos e ruajtur gjininë e tyre femërore: femërorët [kóst, városh etj.] → mashkullorë [koc, varósh etj.].

Kur vokali i penultimës së modelit për arsye të veçanta interpretohet si zanore e gjatë a e mesme tek emrat e gjinisë mashkullore, pasi kjo gjatësi nuk përkon me gjatësinë e zanores që kërkon tipi i temës mashkullore oksitone në konsonant, bëhet integrimi i tyre në temën paroksite në -ë, që e ka këtë gjatësi të zanores dhe emrat e tillë janë në gjuhën shqipe emra të gjinisë femërore: mashkullorë: [biglietto, bilardo, piatto, scirocco etj.] → femërorë: [biletë, bilardë, pjatë, shirokë etj.]. Sado që vokalet para geminateve janë të shkurtra, shqiptimi i tyre në gjuhët huazuese është i tillë që bën të imitohen në replikë si të gjata e të mesme, duke e humbur geminacionin e ajo gjatësi ruhet në temën paroksite në -ë. Shqiptimi i penultimës si e gjatë a si e mesme shkaktohet edhe nga ndonjë sonant pas zanores, siç është rasti me emrin biglardo → bilardë, gjatësi e shkaktuar po ashtu nga respektimi i normave të shqipes në kohën e integritit. Përkundrazi, kur kuantiteti i zanores fundore nuk është i përcaktuar si më sipër, emrat mashkullorë me zanore fundore të patheksuar, integrohen si emra mashkullorë brenda temës emërore oksitone në konsonant: [grüstü, bandído, αγάτης, κρεββάτι, portego, brégü, kásničĭ, kóvčegü, kókoši etj.] → mashkullorë: [grusht, bandidh, argat, krevat, porteg, breg, kasnec, kofçeg, kokosh etj.]. Ky integrim është mundësuar nga fakti se interpretimi si zanore e shkurtër e zanores së parafundit të modelit, që e kërkon tema mashkullore e shqipes, e siguron interpretimi i zanores fundore si zanore zero.

Këto huazime tregojnë se tema femërore në -e (lule, dele etj.), që u krijua bashkë me këtë system të ri të temave emërore, qe pasive në këtë kohë dhe në të nuk u integruan emrat e huazuar nga gjuhët përkatëse. Ky tip u pasurua me emra të shumtë përmes procesit të

singularizimit të shumësit dhe përmes mbiemërorizimit të emrave gjenerikë: [but – bute, poç – poçe, simit – simite, kok – koqe etj.].

Përveç temës oksitone mashkullore në bashkëtingëllore (gjak, top, shkop, etj.) dhe temës paroksite kryesisht femërore në zënoren *-ë* (punë, shkumë, pelë etj.) këto huazime e nxjerrin tip produktiv edhe temën në zanore të theksuar, në të cilën integrohen emra kryesisht nga frëngjishtja` e turqishtja: [orendíe ,sellí, gonía, monía, nesí etj. → [orendí, selí, goní, moní, nesí etj.]. Këto tregojnë po ashtu se tipi proparoksiton me *-ë* prapa sonantit (femënë, shëkullë, motërë, pezëmë etj.) ishte temë mjaft pasive që në fillim të këtij sistemi. Në të është integruar një numër i kufizuar emrash nga më të vjetrit të kësaj periudhe : [alëmë ← *άλεμα*, erëmë ← *έρεμος*, lëmshënë ← *limósina*, klógërë ← *καλόγερα*,], ndërsa emra të tjerë si [τραντάφιλον, zákonũ, sókolũ, *χάραμα*, óborũ, lédina etj.] u takuan temave të tjera: [trandofil, zákón, sokól, harómë, dbórr, ledínë etj.]. Këto huazime tregojnë se vendi i theksit të origjinalit nuk është respektuar as në modelin paroksiton në konsonant: [kónčegũ, vrábĩcĩ, kókošĩ, kásnĩcĩ etj.], të cilët do të duhej të ishin integruar në temën paroksite në bashkëtingëllore (mátëk, vrábëc, kókësh etj.). Ata u pranuan me theksim në zanoren që e kërkonin temat produktive të sistemit të temave të shqipes: [kofcék, vrabéc, kokósh, kasnéc etj.]. Vendi i theksit të modelit mund të respektohej vetëm po qe se përputhej me vendin që kërkonte njëri nga tipat aktivë të temave: me zanore të theksuar fundore (mi, rrëfe etj.), oksitone në bashkëtingëllore (trim, gjak etj.) dhe paroksite në *-ë* (punë etj.) e pjesërisht në fillim të këtij sistemi edhe në temën proparoksite në *-ë* (lëmshënë etj.).

## 2. Krijimi i temës emërore paroksitone në -e

Tema paroksitone në **-e**, që përmbledh vetëm emra të gjinisë femërore, u përftua nga singularizimi i formës së shumësit që dilte me **-e**: [sing. nus-ë ~ plur. nus-e etj.]. Paradigma sing. **-ë** ~ plur. **-e** u takonte fjalëve emër-mbiemër: [sing. pres-ë ~ plur. pres-e, sing. fshatar-ë ~ fshatar-e etj.]. Emrat që nuk ishin edhe mbiemërorë e seleksiononin paradigmen e numrit: sing. **-ë** ~ plur. **-a**: [sing. kunat-ë ~ plur. kunat-a, sing. ulkonj-ë ~ plur. ulkonj-a, sing. arush-ë ~ plur. arush-a etj.].

Paradigmat sing. **-ë** ~ plur. **-a** dhe sing. **-ë** ~ plur. **-e** me elementin e parbashkët **-ë** të njëjësit hynin në konfuzion të përzgjedhjes së mbaresës së shumësit **-a** apo **-e**. Zgjidhja u bë duke u singularizuar forma e shumësit me **-e**: [sing. nus-ë ~ plur. nus-e → sing. – plur. nuse, sing. delm-ë ~ plur. delm-e → sing. – plur. delme, sing. pres-ë ~ plur. pres-e → sing.-plur. prese, sing. fshatar-ë ~ plur. fshatar-e → sing.-plur. fshatare etj.].

Kështu tek emrat bikategorialë emër-mbiemër u krijua një temë e re paroksitone, që do të jetë e analizueshme në temë oksitone në bashkëtingëllore +e, në të cilën **-e**-ja do të jetë sufiks feminativ në opozicion me zeron që shënonte seksin mashkullor: mashk. [pres-∅ ~ fem. pres-e, mashk. fshatar-∅ ~ fem. fshatar-e etj.].

Shpejt pas kësaj filloi përdorimi mbiemëror me emra gjenerikë dhe emërorëzimi i këtyre mbiemrave: [arë elbore: elbore, shtëpi faltore: faltore, odë nusërore: nusërore, bukë simite: simite etj.] si dhe leksikalizimi i nomina agentis: [grykëse, varëse, prese etj.], kështu që tema në **-e** përmbloodhi edhe emra të jogjallësave, ku **-e**-ja këtu e humbi vlerën e saj si sufiks, duke kaluar në tingull fundor të temës.

Kjo temë, si temë tipike femërore, u krijua kur tema paroksitone në **-ë** nuk mbeti temë e gjinisë femërore, por u bë neutrale në

gjini, duke pranuar edhe emra të gjinisë mashkullore si [burrë, djalë, atë etj.] pranë emrave femërorë: [punë, nënë, bukë etj.].

Në këtë kohë tingulli fundor **-e** i kësaj teme u bë mbaresë e gjinisë femërore te mbiemrat që në gjininë mëshkullore i takonin temës oksitone në bashkëtingëllore: [i keq – e keq-e, i madh – e madh-e, i kuq – e kuq-e, fshatar – fshatar-e, trim – trim-e etj.], duke e zëvendësuar mbarsën e vjetër **-ë**, që dilte si mbaresë e gjinisë femërore kur tema paroksitone në **-ë** ishte vetëm e emrave të gjinisë femërore: [i kuq ~ e kuq-ë, i madh ~ e madh-ë, fshatar ~ fshatar-ë, trim ~ trim-ë etj.].

### 3. Singularizimi i formës së shumësit

Singularizimi i parë i shumësit është, siç shënuam, krijimi i temës paroksitone në **-e**: [nuse, delme, reme, prese, punëtore etj.], që është vetëm e emrave të gjinisë femërore.

Shembujt tregojnë se singularizimi është rezultat procesesh të ndryshme, si kur përmblihet i tërë tipi i temës (rasti i temës në **-e**), ashtu edhe kur përmblihen vetëm disa emra të një tipi.

Singularizimi i shumësit me mbarsën **-e** të emrave të jofrymëve të gjinisë mashkullore nuk e përmbledh tërë tipin. Singularizimi është bërë tek emrat si : [sing. \*lul ~ plur. lule → sing.-plur lule; sing. \*vall ~ plur. valle → sing.-plur. valle etj.]. Në të njëjtën kohë u singularizua edhe shumësi me mbarsat **-ënë**, **-ërë** pas unifikimit të temës: [sing. \*bresh ~ plur. breshënë (-ërë) → sing.-plur. breshënë (-ërë); sing. \*thek ~ plur. thekënë (-ërë) → sing.-plur. thekënë (-ërë) etj.]. Këto singularizime i kanë pësuar vetëm emrat, shumësi i të cilëve mund të interpretohej me kuptim të një kolektivi: [lule, valle etj.] dhe ata, shumësi

i të cilëve mund të interpretohej si njëjës që tregon shumësi të paanalizueshme në pjesë të barabarta përbërëse: [breshënë (-ërë), thekënë (-ërë) etj.]. Ndërsa të parët u bënë sinkretikë në numër: [sing.-plur. lule etj.], të dytët ishin tani vetëm në numrin njëjës: [breshën, thekën etj.], sepse ishin emra lëndorë që njohin vetëm numrin njëjës (singularia tantum). Këta emra janë të vjetër në gjuhën shqipe, disa bile edhe të fondit autokton, prandaj mundësinë për interpretim të tillë të shumësit e patën që me kohë. Është vokali i metafonizuar ai që këtë singularizim e nxjerr më të ri. Mbaresa e shumësit **-ënë, -ërë** kaloi në pjesë të temës: [breshërë, thekërë etj.], sepse ekzistonte tema emërore me përfundim në **-ënë, -ërë** :[pjepënë, motërë etj.].

Ka edhe shembuj të tjerë të singularizimit, por ata janë shembuj në përdorim të kufizuar dialektor.

## 4 Aglutinimi mekanik i nyjës

### a) Në SN akuzative të SP-së

Pas fazës së krijimit të parafjalës–nyjë **ëntë**, me të cilën përdoreshin emrat pa nyjë shquese me kuptim të konkretizuar e abstrakt dhe pas përgjithësimit të kësaj dukurie edhe me parafjalë të tjera të kallëzores, u bë aglutinimi mekanik i nyjës në Sintagmën parafjalore me emrin në rasën kallëzore.

Ne e kemi konsideruar të drejtë mendimin e H. Pedersenit që në këtë rast kemi të bëjmë me shtim mekanik të nyjës **të** mbi emrin në

kallëzoren e pashquar me parafjalë<sup>80</sup>. Sh. Demiraj e përcakttoi mënyrën e përfimit të kësaj përngjitjeje, duke e parë të dalë nga “anticipimi i nyjës së përparme në togfjalësha të tipit [ndë dorë të djathtë, ndë prak të derës], prej ku s’ ishte vështirë të kalohej në tipin e ri [ndë dorët të djathtë, ndë prakt të derës].”<sup>81</sup> Përngjitja mekanike e nyjës nënkupton ruajtjen e të njëjtut kuptim të shquarësisë që kishte emri edhe para përngjitjes. Kështu nyja **të**, që erdhi në vend të nyjës zero, do të shprehë kuptimin konkret e abstrakt të emrit si nyja zero më parë.

Forma me **-t(ë)** u përftua mekanikisht edhe në numrin shumës: [me grat(ë) të mira etj.], d.m.th. se edhe këtu shprehte kuptimin konkret e abstrakt si nyja zero: [më gra të mira etj.].

Kjo formë nuk u krijua në tërë shqipen. Forma me një zero me dykuptimet e shënuara ekzistoi vijimisht në disa të folme. Ajo del e përdorur edhe te Buzuku krahas formës dominante me **-t(ë)**. Kështu është i saktë konstatimi i Pedersenit se forma [ndë dorët] doli “vetëm në disa nga dialektet”<sup>82</sup>.

### **b) Në sintagmën gjenitivele (SG)**

Përngjitja mekanike e nyjës **të** në formën e rrjedhore [lopet së mirë], e vlerësuar si e tillë nga H. Pedersenit<sup>83</sup> me të drejtë, është bërë në sintagmën gjenitivele (SG), siç e kemi trajtuar në veprën Rruga...

Meqë nyja **të** do t’i përngjitej një emri të gjinisë femërore,

<sup>80</sup> në *Kontribut për historinë e gjuhës shqipe*, BUSHT SSHSH, 3, 1959, f. 233.

<sup>81</sup> *Morfologjia historike e gjuhës shqipe* (pjesa I), Tiranë, 1973, f. 97.

<sup>82</sup> Po aty.

<sup>83</sup> *Albanesische Texte mit Glossar*, f. 9.

ajo do të ishte një e përparme e rasës kallëzore, që d.m.th. se mbiemri ishte në rasën kallëzore, prandaj ky mbiemër nuk ishte i lidhur në një gjymtyrë nominale me këtë emër, sepse **lope** nuk është formë e kallëzores. Ky mbiemër i takon një emri tjetër në të njëjtin grup nominal që ishte po në këtë rasë. Pasi ngjitja mekanike e nënkupton kontaktin e drejtpërdrejtë të emrit të gjinisë femërore (lope) me këtë mbiemër, sintagma nominale ku u bë përngjitja mekanike e nyjës del plotësisht e përcaktuar. Kjo ishte SN me këtë përbërje:

[(bleva) mish | lope | të mirë] (= mish të mirë lope )

[(bleva) lëkurë | lope | të mirë] (= lëkurë të mirë lope ).

Këtu shihet se mbiemri [të mirë] i takon gjymtyrës nominale me emrat *mish* e *lëkurë*. Në rastin kur mbiemri do të ishte në një gjymtyrë nominale me emrin *lopë* (d.m.th. si epitete i tij), atëherë ai do të ishte me nyjën **së** që është e së njëjtës rasë si emri *lope* dhe e së njëjtës gjini:

[(bleva) mish lope së mirë]

[(bleva) lëkurë lope së mirë]

Kur u bë ngjitja mekanike e nyjës nga rasti i parë: [mish | lope | të mirë → mish lopet(ë) të mirë], atëherë edhe mbiemri i emrit të dytë u përdor pas formës së re **lopët**: [mish lopët së mirë, lëkurë lopët së mirë]. Meqë kemi të bëjmë me ngjitje mekanike të nyjës së përparme të mbiemrit, kuptohet se trajta **lopët**: [mish lopët së mirë] është njësoj e pashquar, siç ishte trajta pa këtë një [mish lope së mirë] etj.

Nyja e prapme e emrave të gjinisë mashkullore në sintagmën gjegjorative e në rrjedhoren e njëjtesit: [viçit së mirë] nuk mund të ketë burim tjetër, sepse ngjitja mekanike e nyjës së përparme të mbiemrit në rasën kallëzore nuk mund të kishte arsye të veçantë që të përngjitej vetëm me emrin e gjinisë femërore, prandaj edhe me emrin e gjinisë mashkullore përngjitja u bë në të njëjtën sintagmë: [(bleva) mish viçi të mirë → mish viçit(ë) të mirë]. Nyja e përngjitur edhe këtu nuk shënonte kuptim të

konkretizuar të emrit. Nyja **-të** e mbiemrit të gjinisë mashkullore ishte sinkretike në rasa, sepse dilte edhe në rasën dhanore, prandaj mbiemri nuk ishte mundësi t'i dallonte vlerat e veta si mbiemër i emrit të parë [mish të mirë], apo i emrit të dytë [viçi të mirë].

Kur u krijua paralelisht [mish lopet(ë) së mirë], identiteti i nyjës së përngjitur **-t(ë)** [viçi-t(ë), lope-t](ë) hapi rrugë për përdorimin e nyjës së përpërme **së** edhe me emrat e gjinisë mashkullore [nish | viçit të mirë → [mish | viçit së mirë], me ç' rast u përftua vlera e mbiemrit si mbiemër i emrit të dytë [viçit]. Barazimi i të dy nyjave shënon neutralizimin në gjini edhe të nyjës së përparme **së** [lopet së mirë – viçit së mirë], që qe vetëm e gjinisë femërore. Ky neutralizim në gjini solli ndryshimin e funksionit të kësaj nyje: ndërsa kur shënonte gjininë femërore nyja **së** shënonte edhe rasën dhanore në opozicion me nyjën **të** : [lopës së mirë – viçit të mirë], tani ajo nuk shënon më dhanoren. Si formë e veçantë, e përdorshme vetëm kur sintagma gjenitivale (SG) prezantohej nga gjymtyra nominale pa nyjë shquese e përcaktorë të tjerë [(mish) viçit së mirë], ajo kaloi edhe në përdorim adverbial si formë e rrjedhores [larguhu viçit së tërbuar] si [largohu lopet së tërbuar etj.].

Edhe rrjedhorja e shumësit [trimash-i-t, grash-i-t] është përftuar në të njëjtën sintagmë nga përngjitja e mekanike e nyjës **të** të mbiemrit në kallëzore e me ndërhyrje të zanores **-i-**. Kuptohet se nyja e përparme **së** e mbiemrit [trimashit së tush, grashit së mira etj.] nuk mund të jetë formë e nyjës në shumës. Ajo është e njëjta **së** e njëjësit, e cila kaloi e u përdor edhe në shumës në të njëjtat funksione të gjymtyrës nominale në SG e në SP ablativale.

Nyja e përngjitur në njëjës e në shumës, që erdhi, siç u pa, në vend të nyjës zero, do të realizojë të njëjtin kuptim shquarësie si nyja zero: brenda sintagmës gjenitivale kjo **-t(ë)** do të funksionojë si nyjë zero, domethënë do të shpreh vetëm kuptimin e pashquar të emrit, për arsye se këtu forma e shquar realizohet me gjinore të shquar: [mish i viçit, lëkurë e lopës, tufë e luleve(t), grumbull i viçave(t) etj.], dërsa në përdorim si SP e rrjedhores forma me **-t(ë)** do të shpreh kuptimin e shquar e të pashquar,

meqë rrjedhorja nuk kishte formë të shquar, d.m.th. formë me një shquese.

Nyja **së** mbeti në përdorim edhe kur nuk u përdor më nyja e prapangjitur si në njëjës ashtu edhe në shumës : [viçi së mirë, lope së mirë, trimash së fortë, grash së mira etj.]. Këto forma nuk kanë mundur të krijoheshin pa qenë aglutinuar nyja **-t(ë)** në mënyrën e treguar. Mbasi në të gjitha të folmet del qoftë me ngjitje mekanike të njëjës, qoftë pa të, domethënë se ishte e tërë shqipes.

## 5. Krijimi sintagmës parafjalore të rasës emërore

SP e rasës emërore formohet me parafjalët: [te / tek (tekë, nde, ndek, ne, nek, ke ), tu / tuk, kah / nga (kaha, ka, nka, na, ngaha]. Sipas H. Pedersenit, këto fjalë kanë qenë dëftorë lidhorë, që kaluan më parë në ndajfolje përemërore e pastaj në parafjalë që u seleksionuan nga rasa emërore. Sipas këtij studiuesi “*te prifti* në të vërtetë do të thotë “ku prifti (d.m.th. është)” ...nga shtëpia është pra në të vërtetë “prej atje ku shtëpia (d.m.th është)”<sup>84</sup>. Edhe W. Cimochowski shpreh të njëjtin mendim për [tu shpija (e) eme], që “në origjinë shënon: aty, ku (është) shtëpia ime”<sup>85</sup>. Kjo vlen për të gjitha parafjalët e variantet e tyre që shkojnë me emëroren.

Lidhja e këtyre parafjalëve vetëm me emëroren e shquar [kah / nga / te / tu shtëpia] flet se është krijuar nga funksioni i kryefjalor i emrit në kohën pas përfimit të njëjës shquese **-a** (< -ë +e).

<sup>84</sup> Kontribut për historinë e gjuhës shqipe, BUSHT SSHSH, 3, 1959.

<sup>85</sup> *Le dialecte de Dushmani*, f. 198.

Parafjalët e kësaj SP-je shprehin kuptim vendor. Parafjalët **te / tek** dhe **tu** janë sinonimike dhe gërshetojnë kuptimin e afrimit e të të qëndruarit: [shkoi te shtëpia / tu shtëpia; rri te shtëpia / tu shtëpia etj.], duke e përjashtuar kuptimin e largimit.

Parafjala **kah** dhe forma **nka** e kësaj parafjale, që del te Matrënga e tek arbëreshët e Italisë, flet se forma **nga** e toskërishtes dhe e gegërishtes jugore ka një burim me parafjalën **kah**. Meqë kuptimi i alativit dhe i prosekutivit është kuptimi i parafjalës **kah**, mbetet të mendohet se këto kanë qenë kuptimet burimore të kësaj parafjale, kështu që kuptimi i largimit, që morën format **nka** (që nga Matrënga) e **nga** në toskërishte është kuptim më i ri, i cili ka mundur të përfohet nga përdorimi i kësaj parafjale në funksion të prosekutivit, që mban në reciprocitet kuptimin e afrimit e të largimit. Me këtë rast u bë dallim dialektor në kuptimin e kësaj parafjale e si pasojë dolën dy parafjalë të ndryshme dialektore **kah** dhe **nga**. Gegërishtja në vend të parafjalës **nga** me këtë kuptim e ka përdorur vijimisht parafjalën **prej**. Përdorim të përbashkët parafjalët **kah** e **nga** e kanë kuptimin e prosekutivit: [kah / nga len dielli; kah / nga del shpirti, kah / nga shkohet në atë vend; po dal kah / nga pazari; erdha kah / nga shtëpia etj.]. Kuptimet që shpreh parafjala **nga** janë shënuar nga A. Xhuvani në punimin *Parafjalët*<sup>86</sup>. Ky autor ka konstatuar se “*parafjala prej*, me gjithë sypërin’ e saj në gegërishtet, përdoret edhe në toskërishte baras nga kuptimi me parafjalën **nga**”<sup>87</sup>.

Lidhur me këtë parafjalë mbesin disa çështje për t’u sqaruar:

a) A ishte formuar sintagma parafjalore e emërores kur parafjala **nka - nga** e kishte përftuar kuptimin e largimit apo atëherë nuk e kishte përftuar ende këtë kuptim? Si ndajfolje përemërore nuk mund të kenë qenë të tri format e parafjalës **kah** (nka, nga), por vetëm njëra, më e vjetra, ajo pa tingull përforues **n-**, d.m.th. forma

<sup>86</sup> *Vepra I, Tiranë, 1980.*

<sup>87</sup> *Vep. e cit., f. 306.*

**kah** pa kuptim latgimi. Kjo do të thotë se edhe forma **nka** e ka ruajtur lidhjen me rasën emërore edhe pas përfimit të kuptimit të largimit, pasi kishte qenë në këtë lidhje që nga koha kur ende nuk e kishte këtë kuptim.

b) Si duhet kuptuar faktin se parafjala në formën **kah** nuk e përftoi kuptimin e largimit nga përdorimi si prosekutive, ndërsa forma e saj **nka** (> **nga**) e përftoi? Formën **nka** nuk e pati gegërishtja, ndërsa forma **kah**, që e konsideruam si formë të parë e të përgjithshme të shqipes, nuk dëshmohej në toskërishte<sup>88</sup>. Po ashtu nuk është dëshmuar se a e pati forma **nka** kuptimin e njëjtë me formën **kah**. A do të thotë kjo se, mbasi forma **kah** në gegërishte nuk u përforcua me tingullin **n-** (nkah), nuk doli edhe në kuptim të largimit? Kështu kjo e orienton kureshtjen tonë kah përcaktimi i funksionit kuptimor të këtij elementi përforcues.

## 6. Kalimi i përemrit (a)sí, (a)só në invariant ablatival të dëftorit

Të gjitha SP-të e kësaj kohe e kishin të neutralizuar një shqese me një zero. Në SP të emërores e të dhanores nyja shqese shprehte edhe kuptimin abstrakt të nyjës zero: [te shtëpia, kah shtëpia, afër shtëpisë, pranë pusit / lumenjvet etj.], në SP akuzative nyja zero si dhe nyja e shtuar mekanikisht shprehte edhe kuptimin e nyjës shqese. Në të gjitha SP-të edhe njëra edhe tjetra nyjë me kuptim të sinkretizuar si më sipër qëndronin në opozicion me një joshqese **një a disa**. Vetëm në SP ablativale

<sup>88</sup> Përdorimin e parafjalës **nga** në gegërishten jugore e konsiderojmë të përfutur nën ndikimin e toskërishtes.

nuk ekzistonte ky opozicion, sepse nuk përdorej nyja joshquese e përcaktorët e tjerë dëftorë, meqë kjo SP u përftua nga gjymtyra nominale që është e përbërë vetëm nga emri e mbiemri pa asnjë përcaktor: [prej lope së mirë, prej viçi së shëndoshë, prej grash së mira, prej burrash së mirë etj.]. Kuptohet se edhe SP e rrjedhore do të barazohej me SP-të e tjera, duke dalë me përbërës të njëjtë, meqë funksioni i SP-së i toleron të tri kuptimet e nyjës (shquese, joshquese dhe zero). Rruga e zhvillimit të SP-së ablativale ishte e tillë që do të krijonte relacionin e seleksionit me përcaktuesit e emrit mbrenda SN-së së saj.

Ky proces u realizua së pari me transformimin kategorial të përemrit mbiemëror [si, so, asi, aso – kësi, këso], që, siç pamë, e përgjithësoi lidhjen e tij me formën ablativale të emrit dhe u vendos formalisht në vend të përcaktorit të emrit: [asi viçi] - ashtu si: [një viçi etj.]. Transformimi u shpreh me kalimin e tij nga përemri dëftor që rekomandonte cilësinë (asi viçi = viç i tillë etj.) në përemër limitativ, d.m.th. në përemër dëftor që rekomandon emrin. Duke e pësuar këtë transformim ai do të bëhet pjesë e paradigmës së përemrit dëftor:

Largohu [(a)si viçi : prej viçi të tillë → prej atij viçi]

[(a)so lope : prej lope së tillë → prej asaj lope]

[(a)si viçash : prej viçash të tillë → prej atyre viçave]

[(a)so lopësh : prej lopësh të tilla → prej atyre lopëve] etj.

Funksioni i SN-së atributive të sintagmës verbale (SV) ishte funksion që realizohej nga gjymtyra nominale (që nuk kishte përcaktues apo që ishte me një zero). Emri ishte këtu gjithnjë në kuptim të pakonkretizuar, prandaj përemri **asi**, **aso** – **kësi**, **këso** nuk mund ta kishte kuptimin konkretizues si variant i paradigmës së dëftorit, por do të qëndrojë në kuptimin e tij të mëparmë edhe pse forma e emrit ishte ablativale: [bleva aso lulesh, bleva asi mishi etj.] ku përemri mbeti me kuptimin: [i tillë, e tillë], që është ruajtur edhe

sot në të folmet geqe. Këtë kuptim e ruajti dhe në përbërje të SG-së: [mish asi viçi, aso lope] = mish viçi të tillë / lope së tillë etj.

Si formë e dëftorit në rrjedhore, ky përemër nuk mund të përdorej vetëm, d.m.th. pa bashkëvjajtje me emrin, sepse përdorej, siç u tha, edhe në rastet kur realizonte kuptimin: [i , e atillë,– i , e këtillë]. Kështu, prej asi, prej aso etj. nuk mund të realizonte sintagmën parafjalore të rrjedhores. Që të dalë në këtë funksion do të marrë mbaresa rasore përkatëse: [ik sij / soje / sish / sosh - asij, asoje, asish, asosh - kësij, kësoje, kësish, kësosh].

## **7. Trajtat e patheksuara të vetorëve në funksione jokundrinore**

Me kallëzues që zgjerohen me dy kundrina, kundrina e zhdrejtë është emër me tipar [+ human] apo [+ gjallesë], ndërsa kundrina e drejtë është emër me tipar [– gjallesë]. Kjo është arsyeja që variantet kundrinore të vetorëve të dy vetave të para, si zëvendësuese të vetave, me kallëzues të foljeve të tilla dalin vetëm në funksion të kundrinës së zhdrejtë. Variantet e vetës së tretë, si zëvendësuese të emrave me tipar [± gjallesë] me këta kallëzues mund të dalin në funksione të të dy kundrinave.

Kur forma e dhanores përdoret me foljet me tipare [+ Transitiv] e [- Atributiv], që nuk e lejojnë kundrinën e zhdrejtë, del në funksion të plotësit të pronësisë a të përkatësisë: [ia dëgjova zërin mikut, ia përgatiti gjellën djalit, ma prishi qejfin etj.] dhe është e këmbyeshme me një përemër pronor : [ma / ta / na e / jua / ia / ua qortoi djalin – e qortoi djalin tim / tënd / tanë / tuaj / e tij / e saj / e tyre],

ndërsa kur janë në bashkëvajtje me emrin në dhanore, emri kalon në formën e gjinore si plotës i pronësisë a i përkatësisë: [ia pashë djalin Petritit – e pashë djalin e Petritit, ia dëgjova zërin vajzës – e dëgjova zërin e vajzës etj.].

Dhanorja mund të dalë në funksion të plotësit të dobisë: [iu vërsul kallasë, iu suall shtëpisë] apo edhe në funksion të një SP-je : [i doli pyllit matanë etj.]. Zgjerim i plotësit të pronës a të përkatësisë është plotësi etik i realizuar nga dhanorja në vetën e parë njëjës **më** e shumës **na**: [na e vranë Luigjin – e vranë Luigjin tonë, na i thanë tradhtar Luigjit – i thanë tradhtar Luigjit tonë etj.].

Forma e dhanores së vetës së dytë njëjës **të** përdoret edhe me kuptim të neutralizuar vektor : [E t’ u bë baltë e madhe; E t’ ia nisi një shi i rreptë etj.]. Vlera e tillë gjithëvetore e këtij varianti të vetës së dytë është përftuar nga dhanorja e pronësisë a e përkatësisë: [E t’ u bë ty baltë e madhe para shtëpisë – e u bë baltë e madhe para shtëpisë sate etj.], në të cilën dalin edhe format e vetave të tjera: [e na u bë baltë e madhe para shtëpisë etj.]. Nëpërmjet një inercie kjo formë mbeti në përdorim edhe kur nuk shënonte përkatësi: [E t’ u bë baltë e madhe në atë vend]. Përdorimi në kuptim gjithëvetor i **të-së** edhe si kallëzore: [Atëherë zë e të mundon një brengë...; Kur s’ donte të të fyente, ajo.... etj.] nuk rrjedh nga ndonjë kuptim përkatësie, që s’ mund ta kishte rasa kallëzore, por nga frekuenca e madhe e përdorimit të **të-së** si dhanore, që, duke qenë edhe formë e kallëzores, shkaktoi edhe përdorimin gjithëvetor në funksion të kallëzores.

Variantet e lidhura të dhanores përdoren edhe në funksion të “kryefjalës logjike,” siç kemi shënuar në vep. e cit., f. 81. Ato dalin edhe në një përdorim të veçantë në relacion me kallëzues të disa foljeve kalimtare në diatezën vetvetore, të cilat shënojnë një proces largimi, përjashtimi a shqitjeje: [largomu; mos na u ndani; i shmanget takimit me të; nuk i ndaheshin armikut etj.]. Këtu dhanorja është në funksion të një plotësi të rrethanës: [largohu prej meje /

nga unë; mos u ndani prej nesh / nga ne; shmanget prej takimit / nga takimi me të; nuk ndaheshin prej armikut / nga armiku etj.]. Kjo dhanore e varianteve të lidhura sinonimike me rrjedhoren e varianteve të lira realizohet edhe në bashkëvajtje me emrat: [iu shmang rrezikut; i latgohet së keqes; nuk mund t' u ndahet punëve; nuk iu shkoq kësaj pune etj.].

Në ndërkohë në përdorim jashtëkundrinor ka dalë edhe varianti i lidhur i vetës së tretë njëjës në rasën kallëzore në përbërje të shprehjeve idiomatike si p.sh. [ia nisi këngës, ia punoi plakut, vajzat ia plasën vajit, ia thoshte bilbili, ia mbathi , si t'ia bëj kësaj pune etj.]. Kjo formë e kallëzores ka dalë në këtë përförim jokundrinor nga përdorimi me foljet që e kërkojnë zgjerimin me kundrinë të drejtë dhe ka qëndruar e përdorshme edhe pas ndryshimeve kuptimore që ka pësuar folja kallëzues, d.m.th. pasi ka fituar tipare kontekstuale që e përjashtojnë kundrinën, duke e funksionalizuar kështu si pjesë të shprehjeve idiomatike, të cilat M. Totoni i ka shënuar në të gjithë tipat e nën tipat e mundshëm<sup>89</sup>.

Kështu në procesin e lëvizjeve funksionale të rasave dhanorja kishte kaluar nga një term intensiv pivot të sistemit rasor, që ia kishte siguruar funksioni i kundrinës së zhdrejtë, në një term eks-tensiv, që do të thotë se përveç kuptimit të afrimit që e arrinte nga funksioni i kundrinës së zhdrejtë, u begatua edhe me kuptimin e të qëndruarit e të largimit në dimensionin semantik të drejtimit të sistemit rasor. Siç u pa, funksionet e shënuara të dhanores u përfatuan gradualisht nga funksioni i saj kundrinor, prandaj në to janë të përdorshme variantet e lidhura të vetorëve. Vetëm në funksionet e plotësit prosekutiv [kalova arave; ra borë maleve etj.] dhe të plotësit të kufizuar të kohës [dimrit; verës, këtij dimri, kësaj vere, këtyre ditëve etj.] nuk përdoren këto variante, por nuk mund të thuhet se edhe këto funksione nuk u përfatuan nga funksioni i dhanores kundrinore.

---

<sup>89</sup> B. Bokshi, *Për vetorët e shqipes*, fë 84-87.

## 8. Zgjerimi i funksioneve të SP-ve

Në këtë kohë është bërë një depërtim i SP-ve në funksionet e njëra tjetrës, gjë që shënon një lëvizje drejt risistemimit të rasave në tërësi. Raste të tilla, që nuk janë të gjitha të një peshe për sistemin rasor, janë:

1. Parafjala **kah**, që kishte kuptimin e alativit (afrim) e të prosekutivit, në variantin e saj të toskërishtes **nka** (> **nga**) e kishte kuptimin e largimit. Me kuptimin e prosekutivit: [shkova | kah kopshti / kah pylli / kah arat etj.] SP me këtë parafjalë e me SN të emërores doli të thuash sinonimike me SP-në akuzativale me parafjalën **nëpër**: [nëpër mal, nëpër fusha etj.] dhe me SP-në dativale pa parafjalë (me parafjalë zero): [shkova fushave / maleve / pyllit etj.]. Kuptimi i alativit i kësaj parafjale do të ndikonte që kuptimi i prosekutivit të përmbante edhe kuptimin e largimit: [ika kah arat = prosekutiv (nëpër ara) dhe = largim (prej arave)]. Kuptohet se përdorimi në kuptim alativi, prosekutivi e ablativi varet nga tiparet e foljes e të emrit.

SP e nominativit me kuptimin e largimit nga parafjala **nka** – **nga** doli sinonimike me SP-në ablativale me parafjalët **prej** dhe **ën** dhe pa parafjalë, kështu që u krijua mundësia e seleksionimit të njërës a tjetrës SP për të shprehur të njëjtin kuptim të drejtimit.

2. SP dativale pa parafjalë në kuptim të prosekutivit: [shkoi fushës / rrugës / fushavet / kodravet etj.] mund të kalonte në kuptimin e zonës semantike të largimit: [u largua fushavet etj.] = nëpër fusha → u latgua prej fushave etj., [iku arave] = nëpër ara → iku prej arave etj. Kështu SP-ja e dhanores doli sinonimike edhe me SP-në e rrejdhores: [u largua arash, fushash etj. apo [prej arash, prej fushash etj.]. Edhe SP dativale pa parafjalë që kishte kuptim alativi

e pa u shkëputur formalisht nga lidhja kundrinore me foljen [iu afrova shtëpisë / lumit / shoqes etj.] mund të merrte lehtë edhe kuptimin e ilativit varësisht nga kuptimi i foljes: [iu largova rrezikut / shoqes / anmikut etj.], duke dalë edhe këtu sinonimike me rrjedhoren: [u largova egërsine(t) / rreziqesh(it) etj.].

Edhe parafjalët **pas** dhe **para** [pas shtëpisë, para shtëpisë] krijuan reksion të dyfishtë, pasi tani ishin të përdorshme edhe me rrjedhoren: [pas dite, para kohe, pas kodre, para sysh, pas shokësh etj.], sepse kuptimi i koherencës që shprehnin këto parafjalë, mund të perceptohej si distancë vendore për të shprehur kuptimin e largimit nga një vend që shënonte emri në rrjedhore.

Ndajfolja **larg** e ndonjë tjetër si **(për)tej**, që e përfatuan vlerën e parafjalës me dhanoren si ndajfoljet e tjera, u bënë të seleksionueshme edhe nga rrjedhorja, për shkak të akordimit në rrafshin kuptimor: [shkoi / iku larg: shkoi / iku shtëpie(t) → shkoi / iku larg shtëpie(t)] etj. Kështu u krijua gjendja kur SP e dhanores dhe SP e rrjedhores me këto parafjalë mund të dilnin të seleksionueshme nga e njëjta folje: [shkoi | larg / pas / para shtëpisë; shkoi | larg / pas / para shtëpie(t) : rri | larg / para / pas shtëpisë; rri | larg / para / pas shtëpie(t) etj.] .

3. Parafjala **për**, si të gjitha parafjalët e mirëfillta, përbënte SP me SN të kallëzores. Reksioni i saj i kufizuar me rrjedhoren u përftua nga gërshetimi i një pjese të nenit kuptimor që ishte arritur në SP me *për + SN akuzativale* dhe *në SP ablativale pa parafjalë*. Në këtë fazë të dy këto SP dalin në pak raste sinonimike, prandaj parafjala **për** u seleksionua edhe nga SP e rrjedhores pa parafjalë.

Kuptimet sinonimike të këtyre dy SP-ve ishin:

a) kuptimi i vendit : e lidhi për dardhë; e shkrepri për gur : ra borë malesh; foli së nalti etj.

b) Kuptimi i kufizimit: sqardhi për shtat asht ...; për detë e për tokë: e kanë lidhë duersh e kamsh; i smut gjymtyrësh etj.

c) Kuptimin e kohës : për ditë; për herë; për disa mot: Këshëndjelash, së shpejti, së gjalli, së rish etj.

Nga krahasimi i këtyre përdorimeve të të dy SP-ve del i arsyetuar përdorim i parafjalës **për** edhe me rrjedhoren: [e lidhi për dardhe; e kapi për dore; foli për së nalti; e përplasi për toke; e kapi për flokësh; për së gjalli; për së shpejti etj.].

Shembujt e shënuar, në të cilët SP ablativale pa parafjalë e me parafjalën **për** kishte filluar të realizonte edhe kuptimin e prosekutivit e të të qëndruarit, si dhe përdorimet me parafjalët **para** dhe **pas** (ënmbas), ku SP e rrjedhores dilte edhe në kuptim të afritit, tregojnë se rrjedhorja kishte filluar të mos shënonte më termin më intesiv të sistemit rasor.

Gjendja e shënuar e SP-ve që e përgjithshme për tërë shqipen. Kjo gjendje tregon se kishte filluar një lëvizje drejt ndryshimit të sistemit të rasave, të cilin dy dialektet do ta zhvillojnë në drejtime të ndryshme deri në fazën brenda shqipes së dokumentuar.

## 9. Gjendja e sistemit rasor

Sistemi rasor që e shënuam si sistem paraprijës la mundësi zhvillimesh divergjente të sistemit. Sintagmat parafjalore që, përveç rrjedhores, kishin brenda edhe emëroren, dhanoren e kallëzoren, dilnin, siç u pa, edhe në fusha të njëjta të dimensionit të drejtimit, d.m.th. se në atë pjesë të funksionit të tyre ishin variante të lira sinonimike.

“*Meshari*” i Buzukut dhe “*E mësuame e krështerë*” e Matrëngës si dhe gjuha e autorëve të mëvonshëm tregojnë se të dy dialektet e shqipes kishin marrë kahje të ndryshme në zhvillimin e sistemit rasor para shek. XVI, duke krijuar dy sisteme të rasave në rrafshin kuptimor. Gegërishtja dhe toskërishtja kishin favorizuar SP të ndryshme për të shprehur kuptime të njëjta.

Gegërishtja e përforcoi përdorimin e SP-së ablativale me parafjalën **prej**<sup>90</sup>, duke e lënë parafjalën **kah** pa e përfutur kuptimin e largimit në SP-në e nominativit, por duke ia intesifikuar përdorimin në kuptim të afrimit përmes funksioneve të alativit e të prosekutivit. Parafjala **kah** me kuptim largimi në gegërishte mbeti e përdorshme shumë sporadikisht. Përmes zëvendësimit të SP-së së rrallë **kah + emërore** me SP-në **prej + rrjedhore** në kuptim largimi, parafjala **prej** doli gradualisht edhe në kuptime të tjera të parafjalës **kah** dhe arriti të marrë kështu edhe kuptimin e afrimit, siç e tregon edhe gjuha e Bizukut: [e se ma do me klen prej dreqit se prej Krishtit; e si u ba prej nate; ata sytë e tu të përmishërieshim prej nesh kthe; ktheu prej meje, o Zot; e u kthye prej gruojet; mos e kthe faqenë tande ën meje etj.], pa e përjashtuar përdorimin e SP-së së emërores me parafjalë **kaha, kah** në kuptim afrimi etj. Mospërdorimi i kësaj parafjale te Buzuku po ashtu nuk e shpreh gjendjen e gegërishtes së kohës. Të qenët e **kah** si ndajfolje te “*Meshari*”: [kah vjen këta qi e ama e Tinëzot vjen tek u?] na duket se e përjashton mundësinë që të mos ketë qenë edhe parafjalë paralelisht me **te – tek**. Është konstatuar se parafjala **prej** në toskërishten nuk e kishte e nuk e ka kuptimin e afrimit<sup>91</sup>. Vlera e shënuar antonimike e parafjalëve **prej, ën** në gegërishte shënon ekstensivim të rasës rrjedhore në tërësi.

Toskërishtja kishte shkuar duke e zgjeruar përdorimin e SP-së nominativale me parafjalën **nka** (nga) në fushën e takimit me

<sup>90</sup> Te Buzuku edhe me parafjalën **ën**, me të cilën thuaj se e kishte përjashtuar përdorimin pa parafjalë, çka nuk mund të ketë qenë realitet i shqipes para shekullit të tij e as realitet i kohës së tij. Parafjalën **ën** ai e përdor edhe jashtë kuptimit të largimit.

<sup>91</sup> A. Xhuvani, *Vepra I*.

rrjedhoren, duke ia reduktuar kësaj përdorimin, por pa e përjashtuar nga paradigma rasore, siç shihet e përdorur pa parafjalë edhe në tekstin e Marëngës : [u ngre së vdekurëshit; pirosmotë dhënë së tjerësh; se s' është njeri nesh që mkatë s' ka; u anastris mortjet etj.] Reduktimi i përdorimit të SP-së ablativale në toskërishte e shpreh edhe fakti që Matrënga nuk e ka parafjalën **prej**, e cila nuk mund të mos ishte e tërë shqipes, sepse është e trashëguar si parafjalë nga gjuha e lashtë ie. Ajo, siç ka shënuar A. Xhuvani, edhe në toskërishten përdorej baraz me parafjalën **nga, nka**.

Edhe në rastet kur SP e dhanores doli me kuptim të largimit dhe u krijua kështu mundësia e seleksionimit të SP-së ablativale a të SP-së dativale me parafjalë a pa parafjalë, toskërishtja zgjodhi sintagmën dativale dhe e zgjeroi përdorimin e saj edhe jashtë rasteve të shënuara të këtij kuptimi, duke e zbritur në minimum përdorimin e SP-së ablativale, duke e lënë përdorimi n e saj vetëm kur dhanorja me parafjalë zero do të shkaktonte konfuzion, për shkak të mundësisë së interpretimit të saj në kuptim të afrimit, siç e tregon edhe teksti i Mtrëngës. Në fushat ku disa parafjalë përdoren me dhanoren e me rrjedhoren, rrjedhorja hyri në sinonimi me dhanoren edhe në kuptim të e afrimit e të qëndrimit. Kuptohet se edhe këtu toskërishtja e intensifikoi përdorimin e dhanores, ndërsa gegërishtja të rrjedhores.

Kështu në kohën që po shqyrtojmë toskërishtja e kishte lënë rrjedhoren term intensiv **a** si në sistemin që parapriu e që ishte i të dy dialekteve. Dhanorja si SP e kishte përforcuar neutralitetin ndaj tri fushave të drejtimit, ndërsa jashtë SP-së qëndronte si dhe më parë në gërshetim të fushave të pushimit e të afrimit. Toskërishtja pra e kishte lënë dhanoren edhe më tutje term ekstensiv **A** të sistemit.

Emërorja, që me parafjalën **nka** (nga) e kishte kuptimin e largimit pranë kuptimit të afrimit e të pushimit, vinte theks mbi kuptimin e largimit edhe me funksionin e saj të parë si kryefjalë, duke mos lëvizur nga termi intensiv beta ( $\beta$ ) i sistemit rasor.

Kallëzorja mbeti po ajo që ishte në sistemin paraprijës të rasave dhe, meqë rrjedhorja ishte edhe tani termi alfa ( $\alpha$ ), ajo do të qëndronte në të njëjtin korrelacion, duke përbërë termin opozitar B. Gjinatorja nuk kishte pësuar asnjë zgjerim të përdorimit në rrafshin kuptimor. Meqenëse rasat e tjera kishin ruajtur të njëjtat relacione midis tyre, gjinatorja vijoi të qëndronte termi gama ( $\gamma$ ) e këtij sistemi.

Kështu toskërishtja e kësaj kohe para fazës së shqipes së dokumentuar e edhe brenda fillimit të kësaj faze e ruajti tipin e sistemit paraprijës që qe i përbashkët për tërë shqipen:

a Ablativi

A Dativi

$\beta$  Nomnativi

B Akuzativi

$\gamma$  Gjenitivi

Gegërishtja e kësaj kohe del ta ketë përftuar këtë sistem rasor që shtrihet deri në kohën e Buzukut e të Veriorëve të tjerë:

Dhanorja kishte mbetur me kuptim të afrimit si kundrinë e zhdrejtë, kurse si SP e përjashtonte kuptimin e largimit, kështu që ajo ishte tani termi më intensiv i sistemit rasor të gegërishtes.

Rjedhorja, që me disa parafjalë shprehte edhe kuptimin e afrimit e të të qëndruarit, por që e zotëronte më shumë fushën e largimit, ishte termi më ekstensiv i sistemit rasor, termi opozitar A<sup>92</sup>.

Kallëzorja kishte mbetur me të njëjtat karakteristika: si kundrinë e drejtë shprehte kuptim afrimi, si kundrinë partitive – kuptim largimi e me parafjalë dilte në fushat e afrimit e të të qëndruarit, duke vënë theks mbi fushën pozitive të drejtimit, që do të

<sup>92</sup> Në “Meshar” ka raste të përdorimit të rrjedhore nën ndikimin e latinishtes a të italishtes, siç ka shënuar S. Riza, p.sh.: [më dhimbetë ën këso turme = kjo turmë; e kush mund nginjë këta ën buke = me bukë; ke kujdes ën shumë kafshësh = për shumë kafshë etj.

thotë se në relacion me dhanoren si rasë pivot e sistemit, përbënte termin intensiv beta ( $\beta$ ).

Emërorja përbënte termin opozitar B të këtij sistemi, sepse si SP dilte në fushën e afrimit e të pushimit, ndërsa si kryefjalë kuptimine e largimit e kishte dominant, prandaj emërorja ishte term i tillë opozitar.

Gjinorja as në këtë sistem rasor të gegërishtes nuk kishte pësuar ndryshim funksioni e kuptimi dhe mbeti term kontradiktor gama ( $\gamma$ ).

Kështu gegërishtja e kishte transformuar sistemin rasor nga një sistem me orientim negativ (me rrjedhoren si rasë pivot që shënonte largim) në një sistem me orientim pozitiv (me dhanoren si rasë pivot të sistemit që shënonte afrim):

a Dativi

A Ablativi

$\beta$  Akuzativi

B Nominativi

$\beta$  Gjenitivi

## 10. Format e përngjitura kundrinore të vetorëve

Ndryshimet fonetike e analogjike të shkaktuara nga bashkimi i dy varianteve të patheksuara kundrinore tregojnë se përdorimi i tyre ishte bërë i zakonshëm mjaft kohë para fazës së dokumentuar të shqipes, sidomos kur varianti i kundrinës së drejtë ishte në numrin njëjës.

Renditja e këtyre varianteve të përngjitura: kundrina e zhdrejtë + kundrina e drejtë, është renditje që, siç kemi shënuar, ishte imponuar që në kohën e ritmit gjysmë bariton si renditje regressive e segmenteve të ndryshme të klasave sintagmatike. Ne shënuam se atëherë variante atone kundrinore të vetës së tretë ishin vetëm ato të numrit njëjës - për dhanore (i)dhe për kallëzore (e).

A mund të konsiderohet që përngjitja **më+e**, **të+e** e të jetë e njëkohshme me përngjitjen e nyjës shquese në emërore njëjës: **fushë+e** e të mbaresës së numrit shumës **e**: **disa fushëe** me përfitim të përbashkët të krasisit **-ë+e > -a** : **fusha** : **ma, ta** , apo duhet të mendohet se kalimi **-ë+e > -a** është proces që ka zgjatur e se **ma, ta** janë përftuar më vonë. Mendojmë se reale është kjo e dyta. Duke marrë parasysh se **ma, ta, ia** etj. dalin të kristalizuara te autorët e vjetër e në të gjitha të folmet në të dy dialektet, na duket reale që përftimi i tyre të vendoset në periudhën para shqipes së shkruar (shek. XIII-XV).

Me përfitimën e formave **ma, ta** nga **më+e, të+e** varianti **e** i kallëzores u transformua në **-a** dhe i ruajti të njëjtat vlera morfologjike. Duke qenë homoelementare me variantin **e**, varianti **-a** mund të pësonte zgjerim analogjik vetëm në rastet kur përfaqësonte variantin **e** si në **ma, ta**: **i + e > ia, u + e > ua** e jo edhe në rastet kur varianti i kallëzores ishte **i** i shumësit.

Meqenëse për këtë arsye format **m'i, t'i** nuk u përfshinë nga ndryshimi analogjik për të kaluar në **ma, ta**, jashtë këtij ndikimi do të kenë mbetur edhe përngjitjet **i + i** dhe **u + i**. Kuptohet, prandaj, se format **ia** për **i + i** dhe **ua** për **u + i** nuk mund të jenë përftuar nga ndonjë ndikim analogjik i formave **ia** dhe **ua** me kallëzore të njëjësit (**i + e** u + e), por do të jenë zgjerime të përdorimit të **ia, ua** edhe për kundrinën e drejtë në shumës: [ja dhashë librin – ia dhashë librat; ua dhashë librin – ua dhashë librat] etj., duke e bërë **-a**-në neutrale në numër, d.m.th. variant kontekstual për e të njëjësit e për i të shumësit.

Trajta e kufizuar dialektore **jau** përdoret për **jua** dhe **ua**. Kjo

formë ka dalë nga bashkimi i formës **ja** me variantin e vetës së dytë e të tretë shumës **u**. **Ja** (= **ia**) shënon edhe këtu kundrinën e zhdrejtë në njëjës **i** dhe kundrinën e drejtë njëjës **e** dhe shumës **i**: [ja çon kaprrrollin Mujës – ja çojnë të dyja Mujës] etj. Forma **ja** u përdor edhe kur kundrina e zhdrejtë ishte në shumës, kështu që asaj iu përngjit varianti **u** që ishte homofon për vetën e dytë e të tretë shumës të kundrinës së zhdrejtë: **ja** + **u** → **jau**. Kështu **ja** e humbi kuptimin e kundrinës së zhdrejtë njëjës dhe mbeti variant i **-a-së**, shënuese vetëm e kundrinës së drejtë për të dy numrat. Forma **jau** del kështu e vetmja formë që ka renditje të kundërt të varianteve kundrinore të patheksuara: kundrinë e drejtë + kundrinë e zhdrejtë. Kuptohet se kjo renditje është e re.

Në përngjitjen e variantit të dhanores **i** me pjesëzën **u** të formave foljore vetvetore pjesët përbërëse pësojnë disa ndryshime funksionale, por ato ndodhin pas autorëve tanë të vjetër<sup>93</sup>.

Varianti i kundrinës së zhdrejtë shumës **u**, që shënonte vetën e dytë (juve) dhe të tretë (atyre), nuk përdorej para pjesëzës **u** për shkak të kakofonisë që do të shkaktonte homofonia me të. Ky variant i dhanores ishte këtu i nënkuptueshëm, që domethënë se pjesëza **u** e shprehte edhe praninë e tij.

## 11. Përftimi i mbaresës **-i** të vetës së dytë shumës në dëftore e në urdhërore

Në mjaft të folme të toskërishtes e të gegërishtes në vend të mbaresës së vetës së dytë shumës **-e-ni** përdoret mbaresa **-i** për të tashmen joveprore të dëftores dhe për vetvetoren e urdhërores: [ju lahi,

<sup>93</sup> Shih B. Bokshi, vep. e cit., f. 164-65.

rriti etj.] për [ju laheni, rriteni etj.] dhe për [ju lahuni, rrituni etj.]. Kjo përdoret edhe nga autorët tanë të vjetër. Te Buzuku kjo formë është e rregullt për urdhëroren e për lidhoren : [ngrihi përma; ruhi; mos çuditi; përtërihi; mos dehi etj.], për lidhoren: [duhet të mbahi; e ju të dliri; ju të duhi; të mos zemërkeqi etj.]. Lloji i diskursit nuk ka lejuar të shfaqet edhe forma e përkatëse e së tashmes së dëftores, por nuk ka dyshim se ajo ishte si forma e lidhores pa pjesëzën **të**. Difuzioni mjaft i gjerë nëpër të folme të dy dialekteve deri edhe në arbërishte dhe rregullsia e përdorimit në gjuhën e Buzukut, flasin se mbaresa **-i** me këto vlera morfologjike ishte përfutur para fazës shkrimore të shqipes, por nuk mund të thuhet se qe e përgjithshme për tërë shqipen.

J. Gjinari dhe Gj. Shkurtaç e konsiderojnë arkaike këtë mbaresë, më të moçme se mbaresën **-(h)eni**<sup>94</sup>. Kuptimi jovepror i mbresës **-i** nuk mund të sqarohet pa e parë të përfutur nga një formë përkatëse të joveprores. Prandaj ajo nga studiues të tjerë me të drejtë konsiderohet e përfutur nga sinkopimi i mbaresës **-(h)eni**. Të kësaj origjine e konsiderojmë edhe ne<sup>95</sup>.

Në disa të folme të gegërishtes forma e sinkopuar përdoret paralelisht me formën me **-ni** pa elementin **-e-** të diatezës, p.sh.: [lahi / lahni, lodhi / lodhni, çethi / çethni, vriti / vritni etj.]. Kjo formë me **-ni**, që te foljet në bashkëtingëllore është barazuar me formën e veprores, duket se duhet trajtuar si formë të ndërmjetme drejt kalimit te forma në **-i** : [laheni > lahni > lahi; lodheni > lodhni > lodhi etj.]. Ky barazim i formës joveprore me vepronën do të jetë bërë nën ndikimin e trajtave: [lahni, rrxohni, ftohni etj.]. Në disa të folme të toskërishtes, si në të folmen e Bregdetit të Poshtëm sinkopimin e ka pësuar edhe forma veprore, e cila përdoret në alternativë me formën e plotë: [mbliidhi, dilli, tirri, ndilli, hai, doi, thoi etj. – mbliidhni, dilni, tirni, hani, doni etj.]. Kjo haset edhe te Buzuku: [e ju të nxiri jashtë të vjetëritë...; Merri e hani; ju të sillti mend mortënë; e askana

<sup>94</sup> *Dialektologjia*, Tiranë, 1977, f. 368.

<sup>95</sup> Shih *Për vetorët e shqipes*, f. 35-39.

mos nfali për udhë; ju merri ...ditunitë etj.]. Nga kjo shihet se procesi fonetik i sinkopimit e ka kapluar mbaresën -ni > -i pavarësisht nga diateza e vetës së dytë shumës e dëftores: [lahe-ni – la-ni etj.].

Në veprën *e cituar* kemi konstatuar se sinkopimi në të folmet e toskërishtes është më i lashtë se në të folmet e gegërishtes.

Është e qartë se mbaresa -i nuk mund të jetë përfuar nga sinkopimi i formës së urdhërores me ndërkalje të pjesëzës **u** të vetvetores [lahuni, rrituni etj.], sepse trajtat e sinkopuara te Buzuku janë të rregullta, ndërsa ato me ndërhyrje të **u**-së nuk janë fare të përdorshme, sepse janë krijuar pas kohës së tij e të autorëve të tjerë të vjetër.

Mendimi se format [laheni, rriteni etj.] janë përdorur edhe për diatezën vetvetore të urdhërores nuk mund të jetë i saktë, sepse mënyra urdhërore e përjashton diatezën pësore, kështu që ajo e kishte vetëm formën e veprorës e të vetvetores të sajuar nga veprorja dhe pjesëza **u**. Forma e vetvetores në urdhërore nuk kishte pse të përfonte edhe kuptimin e diatezës pësore, siç e përftoi në të kryerën e thjeshtë. Në mënyrat e tjera, në të cilat duhej të shpreheshin të dy diatezat (pësore e vetvetore), siç është edhe e tashmja e dëftores, forma e pësorës erdhi gradualisht e u bë shënuese e të dy diatezave joveprorë, duke e lënë jashtë përdorimit formën e diatezës vetvetore me pjesëzën **u**. Forma e vetvetores mbeti në urdhërore, mbasi nuk ishte e përdorshme forma e diatezës pësore : [laheni, rriteni etj.]. Për këto arsye<sup>96</sup> është i pasaktë mendimi se forma e sinkopuar [lahi, rriti etj.] është përfuar nga forma [daheni, rriteni etj.] në funksion të urdhërores për ta dalluar nga e njëjta formë e së tashmes së dëftores<sup>97</sup>.

Mund të thuhet pra se format [laheni, rriteni etj.] u sinkopuan në [lahi, rriti etj.] duke qenë vetëm forma të së tashmes joveprorë të dëftores dhe u përdorën pastaj edhe për urdhëroren. Këtë e vërteton edhe gjendja në disa të folme, në të cilat forma e sinkopuar e urdhërores prohibitive është në përdorim alternativ me formën burimore si p.sh. në të folmen e Gjakovës

<sup>96</sup> Shih edhe arsye të tjera në Bokshi, *Për vetorët e shqipës*, f. 38-39.

<sup>97</sup> Shih Sh. Demiraj, *vep. e cit.* f. 862 e vijim.

e në disa të folme të tjera të Kosovës: [mos dahi] dhe [mos u dani], [mos vrahi] dhe [mos u vrani], [mos çohi] dhe [mos u çoni] etj., ndërsa në urdhëroren pohuese ato janë forma të vetme: [dahi, vrahi, çohi etj.]. Këtu shihet se forma e sinkopuar e së tashmes së dëftores nuk ka arritur ende ta zëvendësojë tërësisht formën e vjetër të urdhërores në këto të folme.

Zgjerimi i përdorimit të kësaj forme edhe si urdhërore vetvetore u bë në të folmet e caktuara nën ndikimin e formës veprorë që ishte bifunksionale për të tashmen e dëftores e për urdhëroren që në kohë të hershme (khs. punoni, pritni, lani, hapni etj.) dhe vetëm tani që ajo, si formë e sinkopuar, ishte jashtë boshtit paradigmatic të formave të së tashmes joveprorë të dëftores. Forma joveprorë e njëjësit [lahesh, rritesh etj.], që ishte brenda këtij boshti, nuk u përdor edhe si formë e urdhërores vetvetore, ashtu siç nuk u përdor edhe forma e shumësit [laheni, rriteni etj.].

## 12. Reduktimi i emrave të gjinisë asnjane

Zvogëlimi i numrit të emrave të gjinisë asnjane në gjuhën shqipe është shkaktuar nga ngushtimi gradual i sferave semantike që e lejonin. Është thënë se gjuha jonë nuk e respektoi gjininë asnjane të emrave të huazuar që nga shek. V i erës së re, që do të thotë se neutri që në këtë kohë nuk ishte kategori aktive. Nga kjo kohë duhet menduar një kalim intensiv të emrave asnjane në gjininë mashkullore e femërore. Mbasi ky kalim është i lidhur me ngushtimin e përmendur në rrafshin semantik, duhet pranuar se kishte ndodhur në secilin sistem të temave emërore. Kjo lëvizje e gjinisë është bërë brenda mundësive që ka lejuar sistemi përkatës i temave. Kështu në sistemin me katër tema në kohën e huazimeve nga latinishtja e greqishtja

e vjetër asnjësisht kanë kaluar në një të tjetër gjini sipas mundësive që ka lejuar tipi i temës së cilës i kanë takuar: nëse i takuan tipit neutral në gjini – tipit paroksiton në sonantet **-n**, **-r**, kaluan edhe në një të tjetër gjini. Kështu [asnj. lakën (← λαχανov) → fem. lakën, asnj. drapën (← δραπανov) → mashk. drapën, asnj. timën (← tegmen) → mashk. timën, asnj. qandër (← centrum) → fem. qendër etj.]. Në tipat e polarizuar në gjini është lejuar kalimi vetëm në një të tjetër gjini: në temën mashkullore oksitone në bashkëtingëllore – në gjinië mashkullore, ndërsa në temën e gjinisë femërore paroksitone në **-ë** – në gjininë femërore: [asnj. mullin (← molinum) → mashk. mullin, asnj. liqen (← λικανov) → mashk. liqen, asnj. shkamb (← scamnum) → mashk. shkamb, asnj. gaz (← gadium) → mashk. gaz, asnj. prash (← πρασov) → mashk. \*prash, asnj. shpellë (← σπελαιov) → fem. shpellë etj.]. Në sistemin e temave emërore të kësaj kohe, përveç si në sistemin e mëparm, kjo lëvizje e asnjësisht realizohet edhe me kalim të emrit nga një tip i temës në tipin tjetër. Kjo bëhet edhe për shkak të gjatësisë së vokalit të theksuar, kështu që kemi kalimin nga tema oksitone në sonant në temën paroksitone në **-ë**: [asnj. parëmënd (← paramentum) → fem. Parmendë, asnj. mollën (← μολov) → fem. mollë, asnj. pëm (← pomum) → fem. pemë] etj.

Pas kësaj lëvizjeje, duke iu afruar sistemit të temave emërore të shqipës së dokumentuar (sistemi D/2), është edhe kalimi i asnjësisht të temës paroksitone në **-ë** në mashkullore pa kaluar në temën përkatëse mashkullore, mbasi kjo temë ishte bërë neutrale në gjini: [asnj. ballë → mashk. ballë, asnj. mjaltë → mashk. a fem. mjaltë, asnj. gjalpë → mashk. gjalpë, asnj. ujë → mashk. ujë, asnj. brumë → mashk. brumë etj.].

### 13. Ambigjenia

Kalimi i disa emrave mashkullorë të jogjallesave në gjininë femërore në numrin shumës duket se ka filluar të realizohet në fazën e fundit të kësaj periudhe, mbasi paraqitet i zhvilluar te autorët tanë të vjetër të Veriut. Në dialektin e toskërishtes kjo është zhvilluar më vonë. Sh. Demiraj ka shënuar se “Dukuria në shqyrtim është përhapur prej kohësh, megjithëse me luhatje, edhe në të folmet e dialektit jugor. Për këtë dëshmojnë qartë krijimet popullore dhe studimet dialektore që janë botuar gjatë këtyre dy shekujve të fundit. Kjo dukuri haset dendur edhe në biblën e përkthyer nën drejtimin e Grigor Gjirokastritit. Kurse në të folmet arbëreshe të Italisë e të Greqisë kjo dukuri haset më rrallë e me luhatje”<sup>98</sup>.

Në shqipen e sotme ndërrimi i gjimisë në shumësin me mbaresën **-e** [këto | male / qytete, brigje / mendime / vende etj.] është i përgjithësuar, ndërsa ndërrimi i gjinisë së emrave që dalin në shumës me mbaresën **-ra** nuk është aq i përgjithësuar në toskërisht e aq më pak me mbaresën korresponduese **-na** në të folmet e gegërishtes. Këto forma me **-ra**: [djathëra të kripura, ujëra të ftofta, leshra të dredhura, vajra të ndyshme, mallra të mira, fshatra të reja etj.] janë të përfishirë në normë të shqipes standarde, por në përgjithësi nuk duken aq të natyrshme, prandaj duhet hequr nga përdorimi.

Emrat mashkullorë të gjallesave, mbasi nuk dalin me mbaresën **-e** në shumës, nuk kanë si të kalojnë në gjininë femërore. Megjithëkëtë në raste tepër të rralla, që dalin në shumës me **-e**, e ndërrojnë gjininë: [personalitete të shquara, personazhe positive, insekte helmuese] e ndonjë tjetër.

Kalimi i mbaresës së shumësit **-e**, origjinalisht e disa emrave të gjallesave të gjinisë femërore, në përdorim me emrat e shë-

<sup>98</sup> Vep. e cit., f. 207.

nuar të jogjallesave të gjinisë mashkullore u bë nën presionin e sistemit të mbaresave të numrit, siç kemi shënuar edhe në këtë punim dhe kur kjo mbaresë u neutralizua në gjini, prandaj mundi të kalonte në përdorim me emra të tillë të gjinisë mashkullore. Në këtë përdorim ajo u bë femërorizuese nën dikimin e emrave të gjinisë femërore të temës në **-e**, që e kishte njëjësin një me shumësin: [*nuse, dele, lule, shoqe* etj.]. Në këtë relacion mbaresa **-e** e shumësit të emrave mashkulorë nuk mund rë mos shkaktonte gradualisht kalimin e këtyre emrave në gjininë femërore në shumës, duke e ruajtur gjininë mashkullore në njëjës.

#### 14. Krijimi i formës së lidhore-habitores

E ashtuquajtura mënyrë lidhore-habitore është formuar nga format e habitores të prira nga pjesëza **të** e lidhores.

Në *Gramatikën e gjuhës shqipe I* (të ASHSH-së, Tiranë, 1995, f. 294) është shënuar se “Këto forma hasen rrallë dhe kryesisht në kohën e pakryer dhe në më se të kryerën: [të qenkështa, të qenkështje etj. ; të paskështa qenë, të paskështje qenë etj.]” dhe se këto janë forma të vetme të kësaj mënyre.

Është e qartë se format e lidhore-habitores janë krijuar pasi ishte formuar forma e habitores dhe, meqë dalin edhe te Buzuku, kohën e formimit e kemi vendosur në periudhën parabuzukjane .

Kjo formë nuk e shpreh kuptimin e habitores. Ajo është sinonimike me kuptimin kushtor të kohës më se të kryerë të lidhores: **të lakështa** = të kisha larë etj. Si u bë që në vend të më se të kryerës **kisha la** a **kisha larë** të përdorej **lakisha** pas pjesëzës së lidhores?

Prania e pjesëzës **të** të lidhore e ka bërë të trajtueshme formën e habitores si formë të lidhore, si formë të përmbysur të më se të kryerës. E kjo ka qenë e mundur në kohën kur në habitore ishin të dallueshme format e pjesores e të foljes **kisha** para se të pësonin ndryshime fonetike. Krijimi vetëm i formës së pakryer të lidhore-habitores e vërteton mendimin tonë se forma burimore e habitores është e pakryera<sup>99</sup>.

Mungesa e nevojës për ta përdorur këtë formë në vend të më se të kryerës së lidhore e ka bërë tepër të rrallë përdorimin e saj.

## 15. Përftimi i vlerës foljore të sintagmës së tipit *me të thanë*

Kjo sintagmë parafjalore u përftua pas krijimit të nyjës së përparme të mbiemrit. Mbiemri i tillë prejpjesor përmes substantivimit kontekstual p.sh.: [me të thanë] (= me atë që është e thanë), kaloi në emër abstrakt. Me foljet që e kanë tiparin sintagmatik [+ Atributiv], siç janë p.sh. [punoj, rri, qëndroj, pres, flas, dëgjoj etj.] e me emrat e veprimit (e të cilësisë) që e zbulojnë tiparin [+ Mënyrë], parafjala **me** shpalon tiparin e saj [+ Mënyrë] dhe sintagma e tillë parafjalore bëhet plotës mënyre: [pyeti me të qeshun, punon me të drojtun etj.]. Këtë funksion e ka marrë edhe SP-ja me + emër prejmbiemëror i nyjshëm i cilësisë, p. sh. [me të egër, me të keq, me të mirë, me të nxehtë, me të shpejtë etj.]. Nën të njëjtat kushtet këtë funksion e ka marrë edhe SP me parafjalën **pa** : [pa të keq, pa të drejtë, pa të ngopun etj..].

Emrat e veprimit, që e kishin tiparin [+ Kohë] e që janë nga foljet inkohative a terminative njëvetore si [të ngrysurit, të aguarit,

<sup>99</sup> Shih për habitoren në pjesën përkatëse të këtij punimi dhe në vep. e cit., f. 106-18.

të gdhirit, të përnduarit] e ndonjë tjetër, bënë që parafjala **me** të nxjerrë kuptimin inesivo-koherent, që e ka burimin te kuptimi sociativ e instrumental, kuptim me të cilin tipari [+ Kohë] i emrit të tillë të veprimit është vënë në relacion komitativ me tiparet [+ Veprim] e [- Durativ] të foljes: [Çohet / është çuar / u çua / zgjohet / vjen / erdhi / niset etj. | me të gdhirë / me të ngrysur / me të përnduar / me të aguar etj.], d.m.th.: *çohet bashkë me të gdhirit etj.*, në një kohë me veprimin *e të gdhirit etj.*, *kur po gdhihej / ngrysej / agonte / perëndonte etj.*, kur po kryheh një veprim që nuk ishte i kryefjalës së fjalisë kryesore.

Emrat e shënuar pavetorë të veprimit nuk linin mundësi që bashkë me parafjalën **me** të përbënin SP të mënyrës. Në anën tjetër heteroprosopia nuk lejoi që kjo SP të bëhej plotës kohe. Ajo u bë drejtpërdrejt fjali kohore. Ndërkaq, me emra të tjerë të veprimit, që kuptimin kohor e shprehin me prani të agensit në rasën gjinore (me gjinore subjektive), SP-ja me **me** është plotës kohe p.sh.: [u zgjua me të lindur të diellit, filloi punën me të zbardhur të *ditës* etj.]. SP-ja kohore është zgjeruar pastaj edhe në rastet kur emri i pashquar i veprimit, ndjekur nga agensi heteroprosopik në gjinore, nuk shënon ndonjë proces të caktuar kohor. SP-ja si plotës kohe kalon në fjali kohore duke e kthyer agensin në formë të kryefjalës gramatikore, p.sh.: [*me të ikur kali* (← të kalit), hodhi sytë në ujë; *me të ardhur ai* (← të tij) në shtëpi, filloi me ra *shi* etj.].

Sintagma e tipit **me të thanë** është përsëritje e sintagmës së tipit **me thanë** në kohën kur ishte krijuar nyja e përparme e mbiemrit, që domethënë se nominalizimin tani e pësoi mbiemri prejpjesor i nyjshëm. Kuptimi i ndryshëm që kanë infinitivi **me thanë** dhe forma e pashtjelluar kohore **me të thanë** tregon se rrethanat kontekstuale të tyre, kur ishin sintagma prepozicionale identike, por të kohëve të ndryshme, nuk ishin të njëjta.

Siç u pa, SP-ja e tipit **me të thane**, varësisht nga tiparet e këtij emri abstrakt të veprimit [+ Mënyrë] e [+ Kohë] si dhe nga

tiparet e foljes kollëzues, doli në funksione të plotësit të mjetit, të mënyrës e të kohës. Këto funksione që e mundur të realizoheshin nga shkaku se parafjala **me** prej kuptimit të instrumentit mund të zbulonte kuptimin e mënyrës dhe kuptimin inesivo – koherent, d.m.th. edhe komitativ. Vetëm nga funksioni i plotësit të kohës kjo SP pati mundësi të kalonte në fjali kohore, d.m.th. në trajtë foljore të pashtjelluar. Kuptimi komitativ i parafjalës **me** do ta shdërronte edhe SP-në me + pjesore (me thanë) në fjali kohore. Infinitivi u përftua në rrethana që ia impononin parafjalës **me** realizimin e kuptimit të instrumentalit. Kështu funksioni zanafillës i SP-së me + pjesore për të kaluar drejtpërdrejt në infinitiv ka qenë funksioni i plotësit të mjetit. Forma e re e SP-së [me të thanë etj.] mori zhvillimin e shënuar e nuk u bë paskajore, sepse paskajorja ishte krijuar shumë më parë në tërë shqipen. Kjo mund të zhvillohej kah funksionët që nuk i kishte marrë infinitivi.

Pas kësaj dalin të papritura përdorimet e emrit të nyjshëm të veprimit në trajtë të shquar në fjalitë kohore si në një pjesë të gegërishtes: [me të hymen në shtëpi etj.], ashtu si edhe në tekstet e Th. Mitkos: [me të ardhurit, ajo përshëndeti të kunetërit; me të vaturit ndë shtat’udhët, daroviti atje plakën etj.]. Nuk ka dyshim se shprehjet me trajta të shquara të emrit (me të ramen në qytet, me të ardhurit etj.) janë më të reja se ato me emra në trajtë të shquar (me të ardhun etj.). Mbasi trajta e shquar nuk pati mundësi të përfitohej në fjalinë kohore e në SP-në e plotësit të kohës, duhet menduar se ajo u fut këtu në përorim me parafjalën **me**, mbasi e kishte përftuar kuptimin e një trajte foljore në rrethana të tjera sintagmatike pa lidhje me parafjalën **me**, siç do të sqarohet në temën pasuese.

Meqë forma foljore e tipit **me të thanë**, që nuk del te autorët tanë të vjetër e as te arbëreshët e Italisë, përdoret si në të folmet jugore, me gjurmë edhe në të folmet arbëreshe të Greqisë, ashtu edhe në të folmet veriore të shqipes, koha e përftimit të saj është para fazës së shqipes së shkruar.

## 16. Krijimi i formave foljore të tipit **nji të ardhun, të çelunit, të çelmen**

Në këtë kohë është përfutur edhe forma e tipit **një të ardhun/ një të ardhur** me funksion të fjalisë kohore. Në një pjesë të gegërishtes në vend të emrit abstrakt të gjinisë asnjane përdoret emri abstrakt i gjinisë femërore: [ni t' hyme, ni t' thanme etj.] apo [ni t' thonne, ni t' kapne] *etj.*

Mbasi kemi të bëjmë me formë të kallëzores gjysmë të shquar, funksioni burimor i këtij emri ka qenë funksioni i kundrinës së drejtë me kallëzuesin bani/bëri në formë të së kryerës së thjeshtë: [një të ikun bani: një të ikur bëri etj.]. Shprehja pa këtë kallëzues: [një të ngritun, një të ikun etj.] u krijua pas fazës së ngurosjes së tërë shprehjes, siç është sqaruar në veprën Pjesorja e shqipes - vështrim diakronik (f. 148-9). Në argumentimet e Sh. Demirajt del e besueshme jo vetëm se kjo formë është përfutur në gjuhën shqipe pa ndikim të jashtëm, por edhe se trajtat e këtij tipi në maqedonishte e në arumanishte janë krijuar nën ndikimin e shqipes<sup>100</sup>.

Ne jemi shprehur<sup>101</sup> se procesi i transformimit funksional të emrit të shquar prejpesor në vlerën e një kallëzuesi foljor të fjalisë kohore si në shembujt: [të çelunit dera, të dalunit drita, të marrit mjeku djalin, të thënë këta etj.] dhe në shembujt me emra të gjinisë femërore [t' dalmen drita, t' ardhmen Trina, t' ikmen ai, të kënduemen telegramin etj.] është zhvilluar duke u nisur nga fjalia parakohore e tipit: [si / posa / mbasi e kreu të kënduarit / të kënduemit etj.]. Kallëzuesin e kësaj fjalie kohore e përbëjnë foljet transitive në të kryerën e thjeshtë me tipar [+ Terminativ] si: [kreu, mbaroi, përfundoi]. Në bashkëvajtje me kallëzues të tillë nyja shquese ia shkaktonte një nuansë konkretësie emrit abstrakt të veprimit, që ishte në

<sup>100</sup> Vep. e cit., f. 991-2.

<sup>101</sup> Në veprën e cituar f. 150.

funksion të kundrinës së drejtë, duke e përgatitur fazën për të kaluar në hipostazë si veprim i kryer, i cili, si i tillë, e përjashton nga përdorimi foljen në të kryerën e thjeshtë. Kështu emri i shquar në rasën kallëzore mori vlerën e formës vetore të kallëzuesit që është i markuar “vetëm nga rrethi sintagmatik”, jashtë të cilit e humb këtë vlerë. Ai pra e mban të njëjtin relacion me fjalinë kryesore si dhe fjalia e varur kohore me përbërjen që u përcaktua.

## Shënim:

Krijimi i sistemit të ri të temave me kualitet të ri tri shkallët e gjatësisë së zanores së theksuar është i rëndësishëm për përcaktimin e kahjes së ndryshimeve brenda këtij sistemi deri në ditët tona dhe për ndryshimet në adaptimin e huazimeve të kohës. Ky sistem i ri lejoi krijimin e temës së re femërore paroksite në -e që u përftua përmes singularizimit të shumësit. I rëndësishëm për këtë periudhë është edhe begatimi i paradigmës së dëftorit me formë të rrjedhore (si, so, asi, aso, kësi, këso – me kuptim prej atij /asaj / atyre / këtij / kësaj / këtyre). Mbi të gjitha procesi më i rëndësishëm është zhvillim i ndryshëm i sistemit rasor në baza dialektore: toskërishtja e ruajti sistemin e mëparshëm të përbashkët, ndërsa gegërishtja krijoi sistem të ri që u realizua në rrafshin kuptimor. Ky dallim sistemesh rasore del edhe në kohën brenda autorëve tanë të vjetër.

Të gjitha këto ndryshime të kësaj periudhe, ashtu si dhe të periudhave të mëparme, janë edhe në gjuhën e autorëve tanë të vjetër, d.m.th. do të qëndrojnë edhe në periudhën e shekujve XVI-XVIII. Nga kjo kuptohet se ndryshimet e reja morfosintaksore do të përftoheshin pas kësaj periudhe, siç thuhet, brenda dy-tre shekujve të

fundit, disa nga të cilat nisin që te autorët e vjetër. Kuptohet se do të shënohen vetëm ato që janë të tërë shqipes, apo të tërë gegërishtes e të toskërishtes pa shënuar ndryshimet në të folmet e ndryshme, çka nuk është e nevojshme për temën tone.

## V. ZVILLIMET NË SHEKUJT XVI -XX

### **1. Për emrat femërorë të temës oksitone në bashkëtingëllore**

Në tekstet e autorëve tanë të vjetër Veriorë janë të gjinisë femërore disa emra të fondit autokton që i takojnë temës oksitone në bashkëtingëllore: [djep, end, et, lot, gjeth, nder, mner, kiem] e nga disa huazime latine të deklinacionit të tretë: [gjind, kurt, vërtyt, kryq, short, mort, rjet, shëndet, qytet, pushtet, vullnet, pyll e ligj].

Të gjithë studiuesit kanë konstatuar se shqipja nuk i ka ruajtur emrat femërorë të temës konsonantike indoevropiane, por i ka kthyer që me kohë në emra të gjinisë mashkullore pa e sqaruar arsyen e këtij procesi. Ne kemi shënuar se emrat e temës konsonantike të sistemit ie. Bashkë me ata të temave në **-i**, **-u**, që ishin edhe femërorë, kanë kaluar në temën në **-o**, kur ishte tipizuar si temë e emrave të gjinisë mashkullore dhe mbetën të kësaj gjinie edhe kur nga kjo temë mashkullore ra zanoerja tematike **-o**. Edhe emrat e shënuar të latinishtes u inkuadruan në temën oksitone në bashkëtingëllore, që vijonte të ishte e emrave të gjinisë mashkullore e asnjansë në gjuhën shqipe. Nga kjo shihet se gjinia femërore e këtyre emrave të autorët e vjetër Veriorë është sekondare, e krijuar në një kohë tepër të afërt me kohën e Buzukut në një proces të zhvilluar vetëm në gegërishten veriore, duket, në radhë të parë në gegërishten veriperëndimore, ku në ndonjë anë të saj përdoren edhe sot. Ne jemi shprehur<sup>102</sup> se kalimi i këtyre emrave në gjininë femërore është bërë nën ndikimin e emrave të njëjtë të latinishtes që janë të gjinisë femërore përmes përdorimit

---

102 *Bokshi, Ndryshimi i strukturës së temave emërore të shqipes*, Gj.albanologjike, SSHF, 1971/1.

në tekstet fetare kishtare dhe, për analogji me ta, janë bërë të gjinisë femërore edhe emrat e shënuar të burimit autokton nëpër të njëjtin përdorim.

Vetëm E. Çabej në *Shumësi i singularizuar* është shprehur se “shqipja, ashtu si ka ruajtur neutrat latinë si të tillë, edhe femërorët e kësaj kategorie nuk i ka kthyer në mashkullorë, sikundër mendonin Meyeri, Meyer-Lübke, Jokli e të tjerë dijetarë...”. Këtë vlerësim të Çabejt e kundërshton në radhë të parë metafoia e emrave të tillë si *shëndet, pushtet, vullnet* etj., te të cilët kalimi **a > e** është shkaktuar nga mbaresa e vjetër e shumësit **-i**, që ishte vetëm e emrave të gjinisë mashkullore të kësaj teme, kështu që kalimi i tyre në gjininë femërore shihet se është bërë pas formës së metafonizuar, d.m.th. pasi kishin qenë të gjinisë mashkullore deri atëherë. Përveç kësaj, këtë vlerësim e kundërshton edhe mungesa e një lakimi të veçantë e të papërzier të këtyre emrave: [emërore - një qytet – qytetja, gjinore-dhanore-rjedhore - njëj qytetje etj.] Tingulli **-j-** s’ kishte pse të përdorej, mbasi këtu nuk është përfuar nga funksioni antihiatizues, por ka ardhur si **-je, -ja** nga emrat femërorë të temës në **-e**, siç ka konstatuar S. Riza në *Emrat në shqipe* si ndikim analogjik i gjinisë. S. Riza, pasi shënon se “në sistemin lakor të gjuhës shqipe, emrat në bashkëtingëllore janë rregullisht të gjithë të gjinisë mashkullore...”, vlerëson me të drejtë se “emrat femërorë në bashkëtingëllore përbëjnë një cenim strukture e për pasojë një çfaqje anomale”. Dhe vërtet, po të ishin të trashëguar si të tillë, lakimi i tyre do të kishte vijuar rregullësinë në sistemin e lakimit të shqipes e nuk do të përbënte kurrësi një lakim anomal jashtësistemor.

## 2. Dalja nga përdorimi i formës së kallëzores parafjalore

Është konstatuar se trajta e kallëzores parafjalore [ndë dorët të djathtë, ndë prakt të derës] ka nisur të zëvendësohet sporadikisht që te Buzuku nga trajta primare e kallëzore me një zero [ndë dorë të djathtë, ndë prak të derës] dhe me një shquese [*ndë dorën e djathtë, ndë pragun (a pragnë) e derës*] dhe në shumës [me gratë të mira → me gra të mira] dhe [*me gratë e mira*].

Forma e shquar e emrit në kallëzore jashtë sintagmës parafjalore hyri në SP duke e ruajtur fuqinë konkretizuese, prandaj ky depërtim i saj është depërtim i sintagmës nominale të kallëzores kundrinore me raportet opozitare të nyjave që i njihte ajo. Kështu pranë formës me një shquese e me kuptim të konkretizuar, përdorej edhe forma me një zero me kuptim abstrakt:

(pashë) pusnë (a pusin) e thellë : ndë pusnë (a pusin) e thellë

pus të thellë : ndë pus të thellë

një pus të thellë : ndë një pus të thellë.

Zëvendësimi i shënuar i formës parafjalore të kallëzores me aglutinim mekanik të nyjës nuk e likuidoi përdorimin e kallëzores parafjalore me trajtë të pashquar e me kuptim të konkretizuar: [ndë shtëpi, ndë kopësht etj.]. Forma e zëvendësuar, që nuk ishte e tërë shqipes, u përdor edhe nga disa Rilindas, pas të cilëve u mënjantuan tërësisht.

### 3. Heqja nga përdorimi i variantit -e të dhanores shumë

Variantet kontekstuale të mbaresës së dhanores shumë -e, -ve kanë pasur përdorim të rregullt të gjithë autorët tanë të vjetër. Përgjithësimi i variantit -ve për të gjithë emrat në dhanore të shumës, pra përdorimi i saj edhe në vend të variantit -e (për emrat që dilnin në shumë me bashkëngjellor : turq-e-t, qen-e-t, miq-e-t etj.) u bë më herët në gegërishte se në toskërishte, në të cilën të dy variantet ishin ende të përdorshme edhe në kohën e Sami Frashërit. Përdorimi i të dyjave paraqitet i rregullt në çamërishte.

Autorët e vjetër gegë e prishin përdorimin e rregullt të këtyre varianteve në rastet e shumës me **-ënë**, **-unë** e **-të**, duke përdorur variantin **-e** në vend të variantit **-ve** [priftën-e-t, *të vdekun-e-t, të verbët-e etj.*]. Në bazë të kësaj do të duhej pritur që ky të ishte fillimi i zotërimit të variantit **-e** mbi variantin **-ve**. Kjo nuk ndodhi, sepse, sipas S. Rizës<sup>103</sup> përdorimi i mbaresës **-e** në këta shembuj me theks tejparafundor është bërë nga shkak se **-ë**-ja fundore nga pikëpamja morfologjike është vështruar “si një zanore jo e plotvlerëshme”, që do të thotë se është bërë interpretimi si të mos ishte zanorja **-ë** e shumës, respektivisht si të ishin shembuj me shumë në bashkëtingëllore. Ndërkaq, zotërimi i variantit **-ve** deri në përjashtim të variantit **-e** edhe në këta shembuj flet se edhe “prej pikëpamjes morfologjike” zanorja **-ë** qenka bërë “e plotvlerëshme”. Përgjithësimi i variantit **-ve** do të jetë bërë për shkak të qartësisë më të madhe.

<sup>103</sup> Vepra 3, f. 73.

#### 4. Rënia e nyjës së shtuar mekanikisht në rasën rrjedhore

Format e rrjedhores me përngjitje mekanike të nyjës në njëjës e në shumës: [*lopet së mirë, viçit së mirë, lopëshit së mira, viçashit së mirë* etj.] qenë forma të përfuara si gjinore tërësisht të pashquara e të përdorura në tërë shqipen.

Buzuku e ka trajtën pa ngjitje mekanike të nyjës në përdorim adnominal në njëjës e në shumës: [shtëpi ën tregu; dy rrasa ën guri; e gjemba ën palmësh e gjemba ën dëlline; një pergullë ën drui; shpirt ën kshilli e ën fuqie; me vargonj ën hekuri etj.]. Kjo do të thotë se në këtë përdorim ishte kthyer forma pa përngjitje të nyjës. Në funksion të rrjedhores forma pa përngjitje mekanike të nyjës në njëjës e në shumës përdoret kur shoqërohet nga ndonjë fjalë përcaktuese, p.sh.: [anso bisedësh; ën këso turme; ën shumë kafshësh; ën këso ngringje; ën shumë gluhësh etj.]. Praninë e dikurshme të nyjës së aglutinuar mekanikisht në gjuhën e tij e vërtetojnë edhe shembujt pa këtë nyjë: [ën lisi së bukurë; ën së vjelash; ën së mbjellash etj.], sepse prania e nyjës së përparme në formën **së** të neutralizuar në gjini e rrjedhimisht edhe në rasë, e ekspozon praninë e dikurshme të nyjës së përngjitur mekanikisht, mbasi u krijua, siç kemi parë, pas këtij aglutinimi të nyjës.

Forma e gjinores tërësisht e pashquar: [mish **lope**, mish **viçi**, lëkurë **lope**, lëkurë **viçi**, tufë **lulesh**, kope **viçash** etj.] kaloi në përdorim adverbial dhe aty funksionoi si rasë rrjedhore me kuptim të pashquar e të shquar, ashtu si dhe forma me ngjitje mekanike të nyjës. Te Buzuku pas krijimit edhe të formës së rrjedhores së dëftorit **aso**, **këso**, **asi**, **kësi** del mjaft i avansuar procesi i dallimit formal të kuptimit e shquar – e pashquar, që i kishte të pandara nyja e përgjitur mekanikisht në funksion adverbial. Në këtë proces forma me nyjën **-t(ë)** mori vlerën e formës së shquar. d.m.th. kjo **-t(ë)** u trajtua si nyjë shquese në njëjës e në shumës, ndërsa për

kuptim të pashquar u rikthye forma pa këtë nyjë. Procesi i kalimit në nyjë shquese nuk ishte kryer plotësisht, sepse ka shumë shembuj që trajtat me **-t(ë)** të përgjitur nuk shënojnë kuptim të shquar, ashtu si dhe disa raste ku trajta pa këtë nyjë nuk ka kuptim të pakonkretizuar: [ën gjithë farëshit – ën gjithë farësh, ën gjithë anëshit etj.]

Te Matrënga janë pak shembuj të rrjedhore: [kle zënë shpirtit shejt, u ngre së vdekurëshit, së këqiashit, s ishtë njeri nesh, u anastis mortjet, gjithë së këqiashit, mënatet, të ruhesh mishit, shumë llojesh hire, dhuratiljë urteje, lloismo i kshilli, vabek shpirti, janë qëruarë zemëre, me kurorët glembash, prierë lëtirejet]. Edhe nga këta pak shembuj shihet se edhe te Matrënga ishte kryer procesi i funksionalizimit të formës me **-t(ë)** si formë e shquar, ndërsa pa këtë nyjë – si formë e pashquar.

Edhe te Budi përdorimi i formës pa nyjë të përngjitur në funksion adnominal: [dorë nieriu; ditë feste; hir mendie e zemre etj.] tregon se ishte kaluar në trajtim të formës me nyjë të përgjitur si formë të shquar. Por edhe te Budi shihet se këto forma nuk ishin konsoliduar në të shprehurit e kuptimeve të ndryshme, siç e tregojnë shembujt: [jashtë friket e tmerje cë tinëzot; pjesë ën cish urdhënit e ligje cë tinëzot; jashtë famullie cë tij; jashtë famullie cë vet; en duorshi cuoj etj.].

Bardhi, po ashtu, përdorimin adnominal të kësaj forme e ka pa nyjën e përngjitur: [pjesë shekulli etj.], ashtu si dhe përdorimin adverbial: [anso shtëpie; e ngarkonjëne feje etj.]. Shihet se edhe te ky autor ishte dalluar forma e shquar nga forma e pashquar: [ën giuhet së lëtime; u ndash kolegjet së Zonjëse, fisit sine e ën doret sonë; ën timit ikën; prej së dashunit së tinë zot e së shintit atë; ën mbas mizashit; n cë sijashit disa; ende deleshit së njefunash ha ujku etj.].

E njëjta gjendje është edhe te Bogdani: 1.[dorë nierëzish; xehe ari, argjendi; avull ujënash, bërrakash ...; dorë avulli; nd' atë

pjesë dheu etj.]. 2. [këso koheje zu fill; t'ish njëj kalepi; mbas disa fjalësh; kjenë gjithë njëj giuhe etj.]. 3. [Prej urtëshit; giuhëshit; prej dheut sine; prej detit; prej gurëshit e prej lisashit; iku prej Trojet etj.]. 4. [prej profetësh; prej veti; ën deti; ën teje etj.]. 5. [me xanë librash o letërarësh; po del së tiu doret; kje dveshunë regjënijet; krijoi hyji ujënash zojtë e peshqit; të dëlirë fajesh e mkatesh etj.].

Edhe te Bogdani shihen shembuj të përdorimeve të pasakta të trajtave të shquara e të pashquara: [prej gurëshit e prej lisashit; prej veti; prej urtëshit; giueshit; prej profetësh; ujënash, bërrakash e viseshit etj.]. Ai ka përdorur edhe formën me nyjë të aglutinuar në funksion adnominal: [mëshigëza zorrëshit] etj. Kjo gjendje tregon se në kohën e tij ende nuk ishte konsoliduar trajtimi i formës me nyjë të aglutinuar mekanikisht si formë e shquar e rrjedhore.

Është konstatuar se rrjedhorja me nyjë të shtuar mekanikisht, që erdhi e funksionoi si rrjedhore e shquar "që përpara Rilindjes e tëhu është zhdukur krejt nga që të dy variantet e gjuhës s'onë letrare"<sup>104</sup>. Kjo shihet edhe në Shkronjëtoen e Sami Frashërit, ku nuk është shënuar rrjedhorja e shquar e të dy numrave, por është shënuar si e përdorshme vetëm trajta e pashquar. Këtu duhet përmendur edhe mendimi i Kristoforidhit se si trajta e pashquar, ashtu edhe trajta e shquar janë me kuptim të pashquar. Nga kjo mund të përfundohet se edhe pse ishin në përdorim të dy trajtat, ato nuk kishin arritur në disa të folme të funksionojnë as në kohën e Kristoforidhit si trajta të shquara e të pashquara.

Arsyen e mospërdorimit të formës me nyjën **-t(ë)** në njëjës e në shumës S. Riza e ka parë te "shkëmbyeshmëria e rrjedhore me dhanore", d.m.th. nga zëvendësimi i rrjedhore së shquar nga dhanorja e shquar. Proceset e këtij zëvendësimi Riza i ka sqaruar në veprën *Emrat në shqipe* (f. 62-53).

Zëvendësimi i trajtës së shquar të rrjedhore nga trajta e shquar e

<sup>104</sup> S. Riza, *Emrat*, Vepra 3, f. 56.

dhanores u përcoll edhe me ndërrimin e reksionit të parafjalës **prej**, e cila, në rastin e kuptimit të konkretizuar nuk kishte si të mos shkonte me trajtën e shquar të dhanores, meqë nuk ekzistonte më trajtra e shquar e rrjedhores. Nga kjo kalohet në përdorim të parafjalës **prej** edhe me dhanoren me nyjën joshquese e me përcaktorë të tjerë. Kjo parafjalë mbeti në përdorim me rrjedhoren tërësisht të pashquar: [prej shokësh, prej shoqesh, prej kohësh, prej zemre, prej rranje, prej stani, prej së thati etj.].

Arsyeja e përcaktuar nga S. Riza ka ekzistuar që në kohën kur trajta me përngjitje mekanike të nyjës u trajtua si formë e shquar e rrjedhores dhe kur si pasojë e kësaj u rishfaq edhe forma pa këtë nyjë si formë e pashquar, d.m.th. edhe para kohës së autorëve tanë të vjetër.

Në zhvillimet e sistemit rasor në rrafshin e kuptimit, d.m.th. në lëvizjet e funksioneve të rasave, dhanorja edhe në dialektin e gegërishtes do të pasurohet edhe me kuptimin e largimit. Kështu shihet se që të bëhej zëvendësimi me dhanore do të duhej që dhanorja dhe rrjedhorja të futeshin në funksione që iu sigurojnë të njëjtat dimensione të drejtimit.

Në kohën e Buzukut dhe të autorëve të tjerë të Veriu, siç kemi shënuar, rrjedhorja ishte rasa më ekstensive, duke pasë arritur të shënonte me parafjalë edhe kuptimin e afrimit e të të qëndruarit. Pas kohës së këtyre autorëve edhe në gegërishten dhanorja si SP pa parafjalë shënon kupimin e afrimit e të largimit në lidhje reciproke. Kështu funksionet e tyre në fushën e afrimit, të qëndrimit e të largimit bënë që ato të seleksionohen si variante sinonimike. Nga kjo kuptohet se zëvendësimi i formës së rrjedhores nga dhanorja edhe në rastet kur dilnin me forma të ndryshme si [grues(ë), djemvet(ë), vajzavet(ë) : gruejet, djemshit, vajzashit] nuk u bë për shkak se po humbte përdorimi i formës së rrjedhores, por për shkak të mundësisë së trajtimit sinonimik të kuptimit në dimensionin e drejtimit. Ne mendojmë pra se jo vetëm trajtat e njëjta të dhanores e

të rrjedhore (prej një djali, : një djali, prej një vajze : një vajze, prej djalit : djalit ), por edhe ato që nuk ishin të njëjta, d.m.th. të gjitha trajtat e shquara e gjysmë të shquara të rrjedhore u zëvendësuan nga format e dhanores për arsye të lëvizjes së këtyre dy rasave në fushën kuptimore të njëra tjetrës, d.m.th. kur u bënë të këmbyeshme në të njëjtin kuptim të drejtimit. Format e rrjedhore që ishin me një zero, që dilnin në përdorim adnominal: [mish viçi, mish lope, tufë lulësh, grumbull njerëzish, fjalë burrash, punë grash etj.] e në përdorim adverbial pa parafjalë e me parafjalë: [doli menç, afër mendsh, para sysh, i ra mësysh, brez pas brezi etj.] nuk mund të zëvendësoheshin nga forma të dhanores, sepse dhanorja nuk kishte forma me një zero, nuk kishte formë tërësisht të pashqur. Disa shembuj reliktorë tregojnë se ka mbetur pa u zëvendësuar edhe ndonjë formë me shtim mekanik të njëjës si: [hiqu sherrit, erdhi heret (rrjedhore e emrit herë), krejt < krejet (krye), doli dipit] e ndonjë tjetër. Pa u zëvendësuar mbetën edhe përemrat vectorë: [afër / larg, / pranë / sipër / prej etj. | meje / teje / nesh / jysh].

## 5. Zhvillimi i sistemit rasor

Në zhvillimin e tyre të dy dialektet do ta ndryshojnë sistemin rasor duke dalë me një sistem unik në pjesën më të madhe të të folmeve të tyre.

Rasa rrjedhore, që në sistemin rasor të toskërishten në kohën e Matrëngës ishte rasa më intensive me kuptim të fushës së largimit, ndërsa në gegërishten e Buzukut e të Veriorëve të tjerë ishte rasa më ekstensive, me kuptimet e tri fushave të drejtimit, u zëvendësua nga forma e dhanores, siç u shënuar. Në shqipen e

sotme mbeti forma e pashquar e rrjedhore në përdorim adnominal: [mish viçi, lëkurë lope, tufë lulësh, fjallë burrash etj.], tani e interpretueshme si formë tërësisht e pashquar e gjinore dhe në përdorim adverbial me parafjalë e pa parafjalë si në shembujt e shënuar më lart. Si formë e pashquar ajo mbeti në përdorim edhe me përemrat vetorë: [prej | meje / teje / nesh / jush]. Jashtë përdorimit të zakonshëm mbeti forma e rrjedhore së përemrit dëftor: [sij, soje, sish, sosh], që u zëvendësua nga forma e dhanore me parafjalë: [prej tij, prej saj, prej tyre]. Kjo do të thotë se rrjedhorja mbeti në përdorim të kufizuar “si një çfaqje kryesisht reliktove”, siç ka vlerësuar S. Riza, d.m.th. jashtë sistemit rasor të shqipes së sotme<sup>105</sup>. Kështu sistemi rasor i shqipes mbeti me një rasë më pak. Kjo reflektohet me krijim të raporteve të tjera korrelacionale të rasave të mbetura, që janë të njëjta për të dy dialektet.

Dhanorja edhe në gegërishten deri në kohën e sotme u bë, siç ishte në toskërishten e kohës së Matrëngës, rasa më ekstensive e sitemit rasor. Ajo funksionon tani edhe në gegërishten në të tri fushat e drejtimit: si SN kundrinë – fushën e afrimit, si SP pa parafjalë - kuptimin e afrimit e të largimit, me parafjalë – kuptimin e afrimit e të qëndrimit e me parafjalën **prej** – kuptimin e largimit. Kështu ajo arriti të përdorej në të njëjtat fusha të dimensionit të drejtimit, në të cilat dilte edhe rrjedhorja në këtë dialekt. Ndërsa mbetja reliktove e formave të rrjedhore në gegërishte u shkaktua nga barazimi i shprehjes me dhanore e me rrjedhore, në toskërishte ajo u shkaktua nga ngushtimi i tepërt i përdorimit të rrjedhore edhe në kuptim të largimit nën zotërimin e përdorimit të SP-së së emërores me parafjalën **nga**. Si SP dativi është indiferent ndaj kuptimit të fushave opozitare, sepse i toleron të tri kuptimet që sjellin parafjalët dhe vë theks në rend të parë mbi fushën neutrale të drejtimit, mbi kuptimin e afrimit e të të qëndruarit përkundër

<sup>105</sup> *Vepra 3*, f. 54.

kuptimit të largimit. Dativi mbetet pra të çmohet si term  $\Gamma$  i këtij sistemi të rasave.

Në sistemin e sotëm të rasave për tërë shqipen Akuzativi nuk pësoi ndonjë ndryshim në funksion që nga shkrimet e para në të dy dialektet. Me mungesë të Ablativit dhe me ekstensivim të SP-së dativale, Akuzativi del rasë pivot e sisemit katërgjymtyrësh, sepse, duke e pasur kuptimin e afrimit si kundrinë e drejtë, kuptimin e largimit si kundrinë partitive, ndërsa si SP nuk e kishte më kuptimin e largimit, mbasi parafjala **prej** kaloi në reksion me Ablativin kur u krijua kjo formë rasore. Akuzativi si SP mbeti pra të toleronte edhe më tej relacionin me parafjalë që shprehnin kuptimin e afrimit e të të qëndruarit. Kështu kjo rasë si më parë vë theks në mënyrë më të qartë se rasat e tjera mbi një kuptim të zonës semantike të drejtimit, vë theks mbi fushën e afrimit, përkundër asaj të qëndrimit e të largimit, prandaj përbën termin intensive  $\beta$  të këtij sistemi rasor dhe e përcakton orientimi pozitiv të tij.

Nominativi me kuptimin e largimit si kryefjalë e si SP me parafjalën **nga** e me kuptimin e afrimit si atribut e si SP me parafjalën **te / tek** vë theks si më parë në fushën e largimit, prandaj zë vendin e termit të kundërt **B** të sistemit.

Gjenitivi nuk pësoi ndonjë zgjerim a përkufizim funksional. Edhe pse forma e dikurshme ablativale në përdorim adnominal kishte mbetur tani variant i gjinorës, prezantimi i fushave të drejtimit mbeti i njëjtë, duke vënë theks në fushën e afrimit e të largimit, përkundër fushës neutrale, prandaj vijoi të shënojë termin kontradiktor  $\gamma$  të sistemit.

Kështu sistemi i rasave të shqipes së sotme është:

$\beta$  Akuzativ

B Nominativi

$\gamma$  Gjenitivi

$\Gamma$  Dativ

## 6. Kalimi i parafjalës *ëndë, ndë në në*

Ne shënuam se nyja shquese u aglutinua me parafjalën **ën** në kohën kur ishte para emrit në grupin nominal pa mbiemër e kur kjo parafjalë ishte me kuptim vendor si **εv** e greqishtes dhe **in** (< **en**) e latinishtes. Kjo parafjala+nyjë **ëntë** u bë edhe formë e nyjës së kallëzores njëjës të emrave mashkullorë e femërorë në numrin njëjës. Në veprat e autorëve të vjetër ishte **ëndë, ndë**, ndërsa si formë e nyjës kishte kaluar në **-në**.

H. Pedersen i është shprehur se **-në** e kallëzores së shquar njëjës është përfutur nga përngjitja e fotmës së nyjës në rasën kallëzore me mbaresën e vjetër të kallëzores **-om-tom, -am-tam**, duke u zhvilluar nëpër fazat **-mt > -nt > -nd > -n**.<sup>106</sup> Të tjerët ia shtuan edhe fazën **-nn** (< **-nd**). Pastaj u pranua edhe mendimi i M. La Pianës se dy fazat e para **-mt > -nt** janë shumë të lashta e doemos paralatine, ndërsa fazën e tretë e konsideroi të kohës së huazimeve të para nga latinishtja<sup>107</sup>. I konsideroi paralatine, sepse besohet se grupi **-nt** i latinishtes nuk ka përfunduar në **-n-** në gjuhën shqipe, por ka mbetur **-nd** në bazë të shembujve si mentem → mend, paramentum → parmendë, cantare → këndoj etj. Duke e konsideruar të saktë etimologjinë e Pedersenit, M. La Piana erdhi në përfundim se aglutinimi i nyjës shquese me emrin paraprijës në gjuhën shqipe është bërë para huazimeve latine.

Paqëndrueshmëria e mendiimit të shprehur për grupin **-nt** del nga pasaktësia për kohën e aglutinimit të nyjës, që nuk ka si të jetë i kohës para kontakteve të protoshqipes me latinishten. Faktet gjuhësore e nxjerrin procesin e aglutinimit në kohën para përfundimit të rotacizmit, d.m.th. pak para shekullit VIII, siç kemi shënuar

<sup>106</sup> *Kontribut për hist. e gj. shqipe*, Studime rreth hist. së gj. shqipe, Tiranë, 1973, f. 243.

<sup>107</sup> *Studi linguistici albanesi, I*, Palermo, 1939, f. 129-30.

më lart<sup>108</sup>. S. Riza e ka kundërshtuar mendimin e Pedersenit, duke konstatuar se në kohën e aglutinimit, që ai konsideroi se është kryer në shek. VIII-IX, mbaresa e kallëzores njëjës nuk ishte **-om**, **-am**, por ishte **-n** e nyja që u aglutinua nuk ishte **tom** e **tam**, por **të**<sup>109</sup>.

Çështja e refleksit të grupit konsonantik **-nt** paralatin si dhe i kohës latine nuk është ndriçuar saktësisht. Janë disa shembuj të sigurt, në të cilët shihet se edhe **-nt** e vonshme ka kaluar në **-n**. Lidhur me kalimin **-nt** > **-nd** Çabej ka ardhur në përfundim të drejtë se “ka qenë në fuqi akoma në kohën turke” e sa “për periodat e mëparme...mbase ka ecur krahas me gjithë zhvillimin historik të shqipes”<sup>110</sup>. Këtu është i rëndësishëm zhvillimi i emrit të lumit Erzen, që e ka shënuar Çabej. Ky emër del Erzenta më 1308, ndërsa te Ana Komnena është shkruar Charzanes, në të cilën shihet se është kryer alternimi **-nt** > **-nd** > **-nn** > **-n**. Me këtë emër mund të përmendet edhe *Munikli*, përftuar nga emri i lashtë *Munticleus*. Nga kjo kuptohet se edhe kalimi **-nd** > **-nn** > **-n** u bë në kohë të ndryshme dhe, natyrisht, nuk do ta përjashtonte **-nd**-në e përftuar nga **-nt**-ja, kështu që edhe forma **-në** e nyjës së kallëzores njëjës duket të jetë përftuar në kohën pas përfundimit të rotacizmit<sup>111</sup> dhe para fazes së dokumentuar të shqipes.

H. Pedersenit arsyen e kalimit **nd** > **n** në formën e nyjës së kallëzores njëjës e ka pare te “mungesa e plotë e theksimit”<sup>112</sup>. Ky vlerësim duket se e arsyeton edhe mbetjen e grupit **nt** në fazën **nd** brenda parafjalës **ëndë**, **ndë** deri krejt afër kohës sonë, sepse parafjala, si fjalë e veçantë, nuk ka qenë në mungesë të plotë të theksimit. Si fjalë e përgjitur dyrrrokëshe do të kishte një thksim sekondar,

<sup>108</sup> Shih veprat *Rruga...* dhe *Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike*.

<sup>109</sup> Nyjat e shqipes, BUSHT SSHSH, 1-2, 1958, f. 14.

<sup>110</sup> *Për historinë e konsonantizmit të gjuhës shqipe*, Studime rreth historisë së gjuhës shqipe, Tiranë, 1971, f. 164).

<sup>111</sup> Shih *Prapavendosja...*, botim i dytë, Tiranë, 2008, f. 52-3.

<sup>112</sup> KZ 36, f. 314 dhe Sh. Demiraj, vep. e cit., f. 351.

prandaj grupi **nt** e **nd** brenda saj mbeti pa kaluar në **n** kaq kohë pas kalimit në trajtën e shquar të kallëzores.

E. Çabejt në punimin *Për historinë e konsonantizmit të gjuhës shqipe*<sup>113</sup> ka konstatuar se kalimi i parafjalës **ndë** në **në** duket të ketë përfunduar në gegërishten në fillim të shekullit XVIII, ndërsa për toskërishten është shprehur A. Xhuvani në punimin *Parafjalët*<sup>114</sup> se ”që nga mbarimi i shekullit të 19 zotëron përdorimi i parafjalës **në**”.

## 7. Rënia e nyjës **-t(ë)** në gjinore-dhanoren e shumësit

Rënia e nyjës shquese në gjinore e dhanore të emrave në shumës: [burrave-t → burrave, grave-t → grave etj.] mendohet të jetë bërë në këta dy shekujt e fundit dhe jo në tërë shqipen, pasi janë disa të folme që e kanë ruajtur shqiptimin e saj, siç është gjendja në të folmet e gegërishtes veriperëndimore.

Ndërsa gjinorja e numrit njëjës del tërësisht e pashquar, d.m.th. me nyjë zero në përdorim adnominal: [lëkurë viçi, mish lope etj.], në shumës në vend të formës së tillë me nyjë zero : [tufë luleve, fjalë burrave etj.] del forma me mbaresën **-sh**: [tufë lulesh, fjalë burrash etj.]. Kështu format: [luleve, burrave etj.] si gjinore dhe dhanore tërësisht e pashquar (si formë me nyjë zero) ishte jashtë përdorimit. Të përdorshme ishin pra vetëm trajtat e shquara me nyjën shquese **-t(ë)** të gjinores dhe të dhanore: [i,e,të,së shokëvet ; i,e të,së shoqevet : shokëvet, shoqevet etj.] dhe format gjysmë të shquara me përcaktorë të ndryshëm: [disa shokëve, disa sho-

<sup>113</sup> *Studime rreth historisë së gjuhës shqipe*, Tiranë, 1972, f. 160

<sup>114</sup> *Studime filologjike*, 1, 1964, f. 12.

qeve; këtyre shokëve, këtyre shoqeve etj.]. Meqë trajta pa nyjë shquese mud të përdorej vetëm me prani të përcaktorëve, forma e shquar shoqevet, shokëvet mund të përdorej pa nyjën shquese e të tarjtohej si formë e shquar.

Mospërdorim i kësaj nyje shquese është mundësuar edhe nga pozita e saj larg zanores së theksuar, pozitë që ka shkaktuar njëfarë vështirësie në shqiptimin e kësaj nyje.

## **8. Urdhërorja e shumësit me ndërkalje të trajtave atone të vetorëve**

Buzuku dhe autorët tanë të vjetër nuk kanë forma të vetës së dytë shumës të urdhërores me ndërhyrje të trajtave të patheksuara të vetorëve e të pjesëzës **u** të vevetores. Te këta autorë ato trajta vendosen pas mbaresës **-ni** të shumësit në urdhëroren pohuese: Buzuku: [besonimë, rëzonie, mbëlidhnie, zgjidhnie etj.]. Kështu ishte përdorimi edhe tek arbëreshët e Italisë që dëshmohet që te J. Variboba: [Puthnie]. Këto forma përdoren edhe sot në të folme të gegërishtes veriore e qëndrore. Në pjesën tjetër të të folmeve format e vetës së dytë shumës janë me ndërkalje të trajtave atone të vetorëve e të pjesëzës **u** : [kap-e-ni, thuaj-u-ni, thirr-ma-ni, lut-na-ni, jep-u-ni, liroj-i-ni, thuaj-i-ni, lah-u-ni etj.]. Duket se këto forma të reja janë zhvilluar më herët në të folmet e toskërishtes, meqë shfaqen edhe në të folmet e arbëreshëve të Greqisë.

Me vendosjen e mbaresës **-ni** pas formës së urdhërores njëjës bashkë me trajtat e përngjitura kundrinore të vetorëve u përftua një fjali e zgjeruar me kundrina brenda një fjale nën një theks e të kufizuar në të

majtë e në të djathtë nga pjesët e kallëzuesit foljor: *tema e foljes + kundrina + mbaresa e vetës së dytë shumës*. Ky ndërtim është çmuar me të drejtë si dukuri e posaçme e shqipes.

Në trajtat: [lejo-më-ni, merr-e-ni, jep-na-ni, jep-u-ni, hap-u-ni, largo-hu-ni etj.] elementet përemërore e ndajnë mbaresën nga tema e foljes së urdhërores dhe e vënë në kontakt me diçka që nuk është folje. Ne mendojmë se kjo e ka bërë të mundur përdorimin e mbaresës foljore **-ni** me fjalë jofoljore, me pasthirma që kanë kërkuar shënimin e vetës së dytë të subjektit, të cilit i drejtohen.

## 9. Përdorimi i mbaresës **-ni** të urdhërores me pasthirma

Në tërë shqipen mbaresa **-ni** përdoret me pjesëzën mohuese **mos**: **mos-ni**. Ajo e zhvendos këtë pjesëz nga funksioni i një segmenti të lidhur me kallëzuesin, në funksion të kallëzuesit foljor, me nënkuptim të foljes konkrete brenda kontekstit e me kuptim prohibitiv që sjell pjesza **mos**. Kjo formë e shumësit tregon se pjesëza është me mbaresë zero si shënuese e vetës së dytë njëjës:

mos fol- $\emptyset$  ashtu : mos fol-ni ashtu

→mos- $\emptyset$  ashtu : mos-ni ashtu

Pjesëza **mos** e pëson funksionalizimin e shënuar, sepse e ka përdorimin e lidhur para së gjithash me formën e mënyrës urdhërore. Me këtë pjesëz mbaresat **- $\emptyset$  ~ -ni** e kanë të neutralizuar kuptimin e diatezës: *mos-ni = mos lani / mos u lani* etj.

Të njëjtin funksionalizim këto mbaresat të urdhërores ua shkaktojnë edhe pasthirmave nxitëse: [forca ~ forca-ni, hë ~ hë-ni,

na ~ na-ni]. Me anë të këtyre mbaresave pasthirmat **eja**, **hajde** janë bërë forma të urdhërores së foljes **vij**: [eja ~ eja-ni, hajde ~ hajde-ni]. Në disa të folme këto forma kanë kaluar në **eni**, **hajdi**, gjë që tregon se **ejani**, **hajdeni** janë formime relativisht të vjetra. Këto forma Pedersen i konsideroi të përfutuara në kohën e huazimeve latine. Ai ka shënuar se "Prirja për konceptimin pasthirmor të këtyre dy urdhëroreve do të ketë ekzistuar edhe në lashtësi e do t'ia ketë hapur rrugën marrjes së formave latine **veni** dhe **vade**"<sup>115</sup>. Për një lashtësi parashkrimore të shqipes të këtyre formave flet edhe forma **eni** (< **ejani**), që e ka edhe Buzuku, prandaj është befasuese distanca kaq e madhe kohore midis formave të shënuara të këtyre dy pasthirmave dhe të pasthirmave të tjera që dalin të krijuara pas shkrimtarëve tanë të vjetër krejt afër kohës sonë.

Me pasthirmën **aman ~ ama-ni** mbaresat **-ø ~ -ni** janë vetëm në funksion të shënimit të numrit të subjektit, pa imponuar të nënkuptuarit e ndonjë foljeje. Në pasthirmën **korba ~ korba-ni**, që përdoret vetëm në toskërishte, shihet se mbaresa **-ni** ka hyrë në këtë përdorim në kohë të vona, për faktin se nuk është në opozicion me mbaresën zero për kuptim të vetës së dytë njëjës, mbasi pasthirmma **korba** përdoret në bashkëvajtje me tri vetat e njëjësit: **korba / unë / ti / ajo**.

Toskërishtja e përdor mbaresën **-ni** edhe me shumësin e emrave të tiparit [+ human] në funksion të rasës thimore, duke krijuar kështu pasthirmma nxitëse: **burra-ni**, **motra-ni**, **shokë-ni**, **shoqe-ni** etj. Mbaresa vjen këtu për të bërë një adaptim formal të emrit në thimore, që është i zëvendësueshëm vetëm me vetën e dytë të veto-rit: **ju**, **o burra – burra-ni**, **ju**, **o motra – motra-ni** dhe e kthen thirroren në pasthirmë.

Ky formim i pasthirmave me mbaresën **-ni** të urdhërores është parë si dukuri karakteristike për shqipen. Për këtë edhe V.

<sup>115</sup> *Kontribut për historinë e gjuhës shqipe.*

Bubeni ka shënuar: “Ndryshe nga gjuhët e tjera indoevropiane, ku një dukuri e tillë ndeshet rrallë ose më saktë vetëm si përjashtim, në gjuhën shqipe një dukuri e tillë vërehet mjaft shpesh”<sup>116</sup>.

## 10. Zëvendësimi i formantit *-në* nga *-inë*, *-unë* në kallëzore njëjës

Kalimi nga formanti i vjetër **-në** në formantin e ri (të rinovuar) të kallëzores së shquar njëjës **-inë** dhe **-unë** ka filluar qysh para shqipes së shkruar, sepse del në fazën fillimore edhe tek autorë tanë të vjetër të Veriut e të Matrënga.

Sipas S. Rizës<sup>117</sup> përdorimi formës së re “në origjinë ka përbërë një fenomen thjeshtë fonetik të një natyre pikërisht anapitike”. Tingulli **i**- ndërhynte kur “emri dilte në një grup konsonantik, përkatësisht kur ai theksohej mbi rrokjen (tej)parafundore”. Ai sjell këta shembuj:

1. [lavdinë. Shpirtinë, frujtinë, tfurkthinë, bagminë, Krishtinë, peshkunë],
  2. [ordhëninë, dhëndërinë, shekullinë, të mujtuninë, të shurdhëninë]
- dhe shembujt që ishin jashtë këtyre kushteve e që për këtë arsye nuk e kishin formën **-in**. **-un**:

[gjaknë, anëmiknë, dreqnë, pëllumnë, mëzatnë, pusnë, mundimnë etj.].

Ai ka shënuar edhe shembuj përjashtimorë nga autorët veriorë si p.sh.: [vendnë, korpnë, Krishtnë etj.] dhe [uillinë, hirinë, detinë, kalinë, djalinë etj.].

<sup>116</sup> Shih E. Angoni, *Pasthirrat në gjuhën e sotme shqipe*, SF, 4, 1973 dhe 1, 1974.

<sup>117</sup> *Emrat në shqipe ...*, Vepra 3, f.87.

S. Riza ka konstatuar se edhe Matrënga variantet **-në** dhe **-inë** i përdor në të njëjtat rrethana fonetike, që u përmendën për autorët gegë: [shpirtinë, kurminë, emërinë] dhe [zonë (< zotnë), Pilanë (< Pilatnë), të birrë (< të birnë), hirrë (< hirnë)]. Te Matrënga nuk ka gjetur asnjë shembull të përdorimit të formantit të inovuar **-inë** në vend të të painovuarit **-në**. Ai ka shembuj kur përdoret varianti **-në** aty ku pritej të ishte variant **-inë**: [Krishtnë, parajsënë] e ndonjë tjetër.

Nga shembujt e sipërm shihet se te Veriorët, edhe pse nuk është kristalizuar përdorimi i variantit **-inë**, **-unë** në kushtet e shënuara fonetike, ka fillua përdorimi i tij edhe jashtë këtyre kushteve si te [djalinë, detinë etj.]. Ky kalim nuk shihet te Matrënga.

Edhe te *Shkronjëtorja* e Sami Frashërit përdorimi i formantit të inovuar është ende i kufizuar kryesisht në rrethanat e shënuara fonetike, që do të thotë se tingujt **-i-** dhe **-u-** janë edhe në toskërishten e kësaj kohe kryesisht në funksion të tingujve anaptitikë.

Përdorimin e formës së inovuar të kallëzores njëjës tek emrat mashkullorë në rastet jashtë këtyre rrethanave fonetike, d.m.th. te emrat ku zanoret **-i** dhe **-u** nuk janë anaptitike: [bir-i-në, mal-i-në, djal-i-në, mik-u-në, zog-u-në etj.], që është përgjithësuar së pari në gegërishten e re, S. Riza e ka parë të përfutur nga një ndikim analogjik i kallëzoreve të tipit: [shpirtinë, emëninë, peshkunë etj.] mbi kallëzoret [birnë, lisenë, miknë, djalnë etj.].

Sh. Demiraj vlerësoi se “format e reja të kallëzores së shquar njëjës të tipit [bir-i-n, djal-i-n, fto-i-n, za-ni-n / zë-ri-n, bujk-u-n, ka-u-n, dhe-u-n] etj. janë përfutur nën ndikimin analogjik të formave të tjera rasore të paradigmes përkatëse, për ta rrafshuar kështu dallimin në ndërtimin e kallëzores së shquar nga ai i rasave të tjera, sidomos të lakimit të shquar” (Vep. e cit., f. 375). Ky autor vlerësoi se zanoret **-i**, **-u** të përdorura edhe në rrethanat e shënuara fonetike janë pasojë e po të këtij ndikimi analogjik.

Edhe ne mendojmë se përdorimi i zanoreve **-i-**, **-u-** në funksion anapititik nuk mund të jetë bërë nën ndikimin e paradigmes rasore të këtyre emrave. Ata u përdorën për të shmangur vështirësinë e shqiptimit që shkaktohej nga formanti **-në** në rrethanat e shënuara fonetike që para fazës së shqipes së dokumentuar. Po të kishim të bënim me ndikim të paradigmes rasore, ky ndikim do t'i përfshinte në të njëjtën kohë të gjithë këta emra pa marrë parasysh a dilnin këto zanore në funksion anapititik a jo. U desh shumë kohë deri në gegërishten e re të dyshekujve të fundit e pastaj edhe në toskërishten të përdorëshin trajtat: [lis-in(ë), djal-in(ë), mik-un(ë) etj.], të cilat mund të përftoheshin vetëm nën ndikimin e formave: [lavdinë, dhëndërinë, shekullinë, peshkunë etj.]. Me këto forma të reja u bë një unifikim i formës së shquar të kallëzores njëjës me formën e shquar të gjinore-dhanore-rrjedhore së emrave të gjinisë mashkullore, ku para nyjës shquese ishte zanorja **-i-**, respektivisht zanorja **-u-**: [lisin – lisit, mikun – mikut etj.]. Këto zanore në këtë paradigmë kishin vlera të ndryshme morfologjike: në rasën emërore ishin nyja shquese: [lis-i, mik-u etj.], në rasat gjinore, dhanore e rrjedhore ishin mbaresa rasore: [lis-i-t, shok-u-t (një lis-i, një shok-u etj.)], ndërsa në rasën kallëzore - tinguj të shtuar: [lis-i-n, shok-u-n etj.]. Ne mendojmë se kjo vlerë e ndryshme e këtyre zanoreve në kallëzore e në gjinore-dhanore-rrjedhore e ka penguar ndikimin e formës së shquar të këtyre rasave mbi kallëzoren. Ato, të përfutuara nën ndikimin e shënuar analogjik, dolën si forma formalisht unifikuese të lakimit të shquar dhe u bënë kështu pjesë e domosdoshme e kësaj paradigme.

Paradigma me kallëzore të tilla të shquar ndikoi që të përftoheshin format me këta tinguj të shtuar edhe tek emrat, të cilët mbetën jashtë ndikimit të emrave të shënuar me funksion anapititik të zanores **-i-**. Kështu nën ndikimin e kësaj paradigme format: [ftuan(ë), kruan(ë), ftuen(ë), kruen(ë)] etj. kaluan në format e inkuadrueshme në paradigme: [fto-in, kro-in] etj. nën trysninë e formave: [fto-i, kroi] dhe [fto-i-t, kro-i-t etj.]<sup>118</sup>. Në këtë ndikim u formuan edhe trajtat: [za-n-in - zë-r-in, dru-n-in - dru-

<sup>118</sup> Në një pjesë të gegërishtes u përfutuan edhe format: [fton-in, kron-in] etj.

r-in, mulli-n-in - mulli-r-in, fre-n-in - fre-r-in etj.], që i përjashtuan format e vjetra : [za-në - zë-në, dru-në, mulli-në, fre-në etj.]. Në këto forma të kallëzores para zanores **-i-** u shtua **-n-**ja, respektivisht **-r-**ja, e cila në rasat e tjera ishte pjesë e temës e ruajtur nga nyja shquese në emërore njëjës: [pen-i – per-i, mullin-i - mulliri, drun-i – drur-i etj.] dhe nga mbaresa rasore: [pen-i-t – per-it, mullin-i-t – mullir-i- t, drun-i-t – drur-i-t etj.]. Shihet pra se te këta emra formanti i ri i kallëzores **-in(ë)** do të mund të hynte në paradigmë me shtimin analogjik të bashkëtingëllorja **-n-**, respektivisht **-r-**. Pa qenë e mundur që të shtohet një tingulli konsonantik, nën ndikimin e emërores së shquar: [ka-u, thi-u, dhe-u, shi-u etj.] e të gjinore-dhanores së shquar: [ka-u-t, thi-u-t, dhe-u-t, shi-u-t etj.] u krijuan edhe format: [ka-un(ë), dhe-un(ë), thi-un(ë), shi-un(ë) etj.] në vend të formave: [ka-në, dhe-në, shi-në etj.].

## 11. Krijimi i së pakryerës sigmatike

Mendohet se e pakryera e tipit **hapsha** është përftuar nën ndikimin analogjik të formave të së pakryerës të foljeve **jam** e **kam** : [ish-a, ish-e, ish-te, ish-im, ish-i, ish-in; kish-a, kish-e, kish-te, kish-im, kish-i, kish-in.]. Arsyen e kalimit të tingullit fundor **-sh** të temës në pjesë të mbaresës vetore në të pakryerën Sh. Demiraj e sheh në ndjenjën gjuhësore popullore që ndarjen morfematike e ka bërë nga **ish-a** në **i-sha**, nga **ish-e** në **i-she** etj. Demiraj shënon se këto mbaresa të reja ”erdhën e u shtrinë shkallë-shkallë në të pakryerën e të gjitha foljeve të tjera (d.m.th. jo vetëm të atyre me temë në bashkëtingëllore – shënimi im) në një pjesë të madhe të të folmeve veriore, duke zëvendësuar mbaresat e mëparshme

të kësaj kohe”<sup>119</sup>. Foljet me temë në zanore, para kësaj mbarese të re kanë marrë tingullin **-j-**, që në formën e mëparme kishte rrjedhur nga tingilli **-nj** (punonja > punoja, kendonja > këndoja, lanja > laja etj.): [dojsha, dojshe, dojshim, dojshi, dojshin ; lajsa, lajshe, lajshim, lajsi, lajshin et.]. Demiraj shënon edhe se ”në të folmet e gegërishtes verilindore, në vetën e tretë njëjës të kësaj kohe përdoret mbareja vetore **-ke**, e cila i është shtuar formës së vjetër të kësaj vete” e se kjo mbarese ”është shtrirë këtu për analogji nga veta e tretë njëjës e së pakryerës së mënyrës habitore”.

